



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DEÇANIT
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM
& SHËRBIME PUBLIKE
SEKTORI PËR SIGURI DHE EMERGJENCA



VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA NË TERITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT



DEÇAN - 2018

Përmbajtja e Planit të Vlerësimit:

Pjesa e Parë

Hyrje	4
I. PROFILI I KOMUNËS SË DEÇANIT	
I./1. Pozita dhe karakteristikat gjeografike të territorit të Komunës së Deçanit	5
1.1. Përkufizimi hapësinor	5
1.2. Sipërfaqja e territorit të Komunës	6
1.3. Bjeshkët	10
1.4. Fondi i ujrave-hidrografia	11
1.4. Karakteristikat tjera	17
I./2. Demografia	21
1.2.1 Vendbanimet	22
1.2.2. Analiza demografike	22
1.2.3.Struktura e popullsisë	23
I./3. Të mirat ekonomike-materjale dhe të ambientit	34
3.1. Zonat dhe objektet industriale	34
3.2 Resurset kryesore ekonomike	35
3.4. Kapacitetet e furnizimit me ushqim	39
3.4.1. Sipërfaqet e punueshme bujqësore	39
3.3.2. Zonat e prodhimit bujqësor	45
3.3.3.Sistemet hidroteknike	46
3.3.4. Objektet e kultivimit të shtazëve dhe përpunimit të mishit	47
3.3.5. Fabrikat për prodhimin e ushqimit	48
3.3.6. Depot për deponimin e artikujve ushqimor	48
3.3.7. Sipërfaqet e pyjeve dhe parqet natyrore dhe nacionale	48
I./4. Infrastruktura teknologjike dhe e komunikacionit	53
4.1. Infrastruktura rrugore dhe urat	53
4.2. Energjetika	59
4.2.1. Sistemi energjetik	59
4.2.2.Largëpërquesit dhe trafostacionet	62
4.3.1. Sistemi i telekomunikacionit	64
4.3.2. Lista e personave juridik në telekomunikacion	65
4.3.3. Qendrat telekomunikuese, transmetuesit dhe repetitorët	68
4.3.4.Mediat e shkruara, TV dhe radiostacionet	68
I./5. Kapacitetet e furnizimit me ujë	69
5.1. Objektet për furnizim me ujë	69
5.2. Sistemi i distribuimit të ujit për pije	73
5.3. Burimet dhe rezervuarët e ujit për pije	73
5.4. Ndotësit e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore	73
I./6. Përkujdesja shëndetësore	74
6.1. Institucionet shëndetësore	74
6.2. Kapacitetet publike dhe private	78
I./7. Objektet e rëndësisë së veçantë	81
7.1. Objektet para shkollore, filllore dhe të mesme	81
7.2. Strehimoret dhe objektet tjera për strehim (llojet dhe kapaciteti)	84
7.2.2. Lagja “Dëshmorët e Kombit” në Baballoq	85
7.2.4. Struktura e popullsisë me prioritet për evakuim	86
I./8. Trashëgimia kulturore	87

Pjesa e dytë

II. IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE DHE VLERËSIMI I SHKALLËS SË RREZIKËSHMERISË

II./1. SHKAQET NATYRORE	94
1.1. VËRSHIMET	96
1.1.1 Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në shkaktimin e vërshimeve	97
1.1.2 Treguesit hidrologjik	97
1.1.3 Kushtet hidrometeorologjike	98
1.1.4 Infrastruktura e ndertuar për mbrojtje nga vërshimet	102
1.1.5 Rrezikimi i mundëshem i banorëve, të mirave materjale, kulturore dhe të ambijentit nga vërshimet..	103
1.1.6. Të dhënat statistikore të vërshimeve për muajt kritik të vitit	103
1.1.7. Lokacionet kritike të vërshimeve dhe vlerësimi i shkllës së rrezikëshmerisë	103
1.2. ZJARRET.....	118
1.2.1. Karakteristikat meteorologjike dhe ndikimi i tyre në shkaktimin e zjarreve pyjore.....	119
1.2.2. Harta e Zonave Pyjore	120
1.2.3. Lokacionet e zjarreve pyjore dhe vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë	121
1.2.4. Parametrat kryesor për caktimin e rrezikshmërisë nga zjarret në pyje	127
1.2.5. Karakteristikat bazë të zjarreve në pyje dhe masat mbrojtëse	130
1.2.6. Vlerësimi i rrezikshmërisë së zjarreve në fusha dhe masat mbrojtëse	133
1.2.7. Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit dhe masat mbrojtëse	134
1.2.8. Vlerësimi i rrezikshmërisë në pikat e shitjes së karburanteve dhe masat mbrojtëse	137
1.2.9. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE TË SHKAKTUARA NGA ZJARRET E MËDHA	145
1.2.10. NDIKIMET E ZJARREVE PYJORE DHE FUSHORE	146
1.3. Thatësitrat	148
1.4. Termetet	149
1.5.1. Stuhitë	158
1.5.2. Shembjet dhe Erozioni	159
1.5.3. Bora dhe Orteqet	163
II./2. Katastrofat tekniko – teknologjike	166
2.1. Fatkeqësitë e shkaktuara në objektet ekonomike	166
2.2. Fatkeqësitë e shkaktuara në objektet e banimit.. ..	167
2.3. Fatkeqësitë në Komunikacion.....	169
2.4. Fatkeqësitë Nukleare dhe Radiologjike	172
2.5. Fatkeqësitë mino-eksplozive	174
2.6. Fatkeqësitë Epidemiologjike	180
III. PASOJAT NGA VEPRIMET TERRORISTE	188
IV. PROBLEMET SOCIALE	191
TABELA KLASIFIKUESE E RREZIQEVE	193

Pjesa e tretë

V. FORCAT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

5.1. Struktura, organizimi, detyrat dhe kapacitetet reaguese të forcave për mbrojtje dhe shpëtim	194
Mbeshtetja financiare në raste Emergjente.....	206
5.2. Stervitja fushore “Ujku Vigjilent 02”.....	207
RAPORTI I NDODHJËS EMERGJENTE	208

Hyrje

a. Baza Ligjore e Vlerësimit:

Në bazë të ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027 të datës 19.10.2011, Plani i Reagimit Kombëtar pika III (Rolet dhe përgjegjësitë për komuna), Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera i nivelit qendror, ligji për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 dhe neni 25 pika VII të Statutit të Komunës si dhe Plani i vjetër "Vlerësimi i Rreziqeve" i miratuar me datën 28.05.2010, Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike bën azhurimin e planit të vjetër duke u bazuar në ndryshime të ligjeve dhe rregulloreve dhe situatave të reja që janë krijuar.

b. Qellimi i Vlerësimit

Me këtë Vlerësim identifikohen kërcënimet dhe rreziqet në Komunën e Deçanit, si dhe bëhet vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë së tyre. Gjithashtu, me këtë vlerësim identifikohen mundësitë dhe nevojat për parandalimin, zvogëlimin e rreziqeve, reagimin, rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga fatkeqësitë dhe katastrofat me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve të Komunës së Deçanit nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri. Si dhe krijimin e kushteve për kalimin e institucioneve dhe popullatës, sa më lehtë, nga gjendja emergjente në gjendje normale të jetës dhe punës.

Vlerësimi i Rrezikut nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësit tjera, paraqet dokumentin bazë dhe themelor të zhvillimit dhe ndertimit të Sistemit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit në teritorin e Komunës së Deçanit, e me këtë edhe avansimin dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen dhe Shpëtimin e njerzëve, të mirave materiale dhe të ambientit nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në teritorin e Republikës së Kosovës.

Qellimi i Vlerësimit është edhe krijimi i prioriteteve për një koordinim sa më efikas në mes të subjekteve relevante të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rastet e ndodhjes së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në teritorin e Komunës.

Zvogëlimin e rrezikut, gadishmerinë për të mare vendime të duhura dhe kthimin e shpejtë të shoqërisë në jetën normale.

Koordinimi i veprimeve (në raste të fatkeqësive përmasash të mëdha) të subjekteve Komunale përgjegjëse për Mbrojtje dhe Shpëtim me subjektet gjegjëse të Komunave fqinje dhe Subjektet relevante të nivelit qendror, sidomos, kur kemi të baj me realizimin optimal të masave të mbrojtjes dhe shpëtimit në realizimin e preventivës dhe arritjen optimale të gatishmërisë të të gjithë bartësve të mbrojtjes dhe shpëtimit, për ndërmarjen e masave operative gjatë fazës së mbrojtjes dhe shpëtimit nga Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë tjera në teritorin e Komunës.

c. Obektivat e Vlerësimit:

- Kuptimi i rrezikut
- Identifikimi i rrezikut
- Analiza e rrezikut
- Vlerësimi i rrezikut;
- Masat për parandalimin e fatkeqësive;
- Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerzëve;
- Mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale;
- Ruajtja dhe mbrojtja e ambientit.

Pjesa e parë

I. PROFILI I KOMUNËS SË DEÇANIT

I./1. Pozita dhe karakteristikat gjeografike të territorit të Komunës

1.1 Përkufizimi hapësinor

Komuna e Deçanit gjeografikisht ndodhet në pjesën përqendrore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.

Drejtimi i shtrirjes së territorit të Komunës së Deçanit është veri- përqendrore- jug- lindje në mes gjatësisë lindore: 20° 5' e 20" dhe 20° 32' e 8" dhe në mes gjatësisë veriore: 42° 33' e 30" dhe 42° 26' e 3" dhe sipas Sistemit Global të Pozicionimit: Veri - 47° 00' dhe 47° 20' dhe Lindje – 20° 52' dhe 20° 06' Komuna e Deçanit ka një pozite mjaft të mirë gjeografike. Gjetet pothuajse në qendër të Ballkanit, në vijën ajrore nga Deti Adriatik me gjatësi 90 km, kurse 220 km gjatësi nga Deti Egje. Deçani në përcaktimin kadastral kufizohet:

Në përqendrim kufizohet me Republikën e Shqipërisë që shtrihet prej PT –2539 deri PT- 2366 në gjatësi prej 5.5km.

Në veri-përqendrim kufizohet me Malin e Zi: PT-2366 deri 2424 me gjatësi 12.5 km.

Në veri kufizohet me Komunën e Pejës: PT-2424 deri 460 (Maznikë) me gjatësi prej 38.5 km .

Në jug-lindje kufizohet me Komunën e Gjakovës nga PT-460 deri te Gunga e Hereqit- në Jug nga PT 489 me gjatësi prej 24.05 km.

Në jug dhe përqendrim kufizohet me Komunën e Junikut nga Gunga e Hereqit- në Jug nga PT 489 deri te Qafa e Gusanit me gjatësi prej 24.35km.


Komuna e Deçanit ka rreth 40.100 banorë, një qendër administrative (Deçan)², 10 bashkësi dhe 37 fshatra, qyteti i Deçanit nga Kryeqyteti (Prishtina) ka një largësi prej 100 km.

Kodi postar për Komunën e Deçanit është **51000**, prefiksi i telefonisë fikse **+383 390** dhe nr i targave të automjeteve është **03**. Ndersa numrat emergjent në nivel vendi janë : **112** (Qendra Regjionale Operative në Pejë), **192** (Policia e Kosovës), **193** (Sherbimi i Zjarrefikseve) dhe **194** (Ndihma e Shpejtë) dhe faqe zyrtare <https://kk.rks-gov.net/decan/>



1.2. Sipërfaqja e territorit të Komunës :

Komuna e Deçanit shtrihet ne nje sipërfaqe prej 297 km² ose 29700 ha dhe përfshinë : 8.940.40ha tokë bujqësore, 14.420 ha tokë pjellore dhe 5.479.6 ha pyje



Lartësia mbidetare e territorit të Komunës së Deçanit varion prej 473 l.m.d e deri në 2656 l.m.d. Gjeravica që d.m.th.në sajë të krijimit të reliefit Komuna e Deçanit ndahet në dy pjesë:

- Në ultësi që është pjese e rrafshit të Dukagjinit
- Dhe në lartësinë që përfshin masivin e bjeshkëve të Nemura(Alpet Shqiptare)

Rrafshi i Dugagjinit është krijuar ne periudhën gjeografike- neogjen. Nga lëvizjet tektonike krijohet liqe qe përfshin tere Rrafshin e Dugagjinit. Nga mesi i Lacerit, niveli i ujit te liqenit fillon te ulet me vonë, fillon të tërhiqet përmes luginës së Drinit të Bardhë.

Konceptimi i zonave në komunën e Deçanit rezulton si ndarje natyrore, gjë që edhe në shtrirjen e planifikimit të këtyre hapësirave grupohen karakteristika të përbashkëta në aspektin e shfrytëzimit të tokës, në shtruarjen e rrjetit rrugor dhe shfrytëzimit të resurseve natyrore. Koncepti i zhvillimit hapsinorë të komunës së Deçanit si tërësi territoriale të zërthen territorin e komunës në tri zona me karakteristika të përbashkëta dhe ato:

- Sipërfaqet e rrafshëta
- Toka pjellore 14.420 ha
- Fshatrat përtej lumit të Deçanit: Strellci i Ulët, Isniqi, Prapaqani, Duboviku, Broliqi, Papiqi, Vranoci i Vogël.

Fshatrat në mes të lumit të Bardhe dhe lumit të Lloqanit: Deçani, Llukë e Epërme ,Llukë e Ulët, Lumbardhi, Dashinoci, Mazniku, Belegu, Kodralia, Pozhari, Irzniqi, Ratishi i Epërm, Ratishi i Ulët, Carrabregu i Epërm, Carrabregu i Ulët, Prokolluku, Glllogjani, Shaptej, Dubrava, Baballoqi, Gramaqeli, Jasiqi i Ri.

- Tërësia rrënzë bjeshkës 855,70 ha
- Strellci i Epërm, Lëbusha, një kuart i Isniqit, Hulaj, Pobërgja, Vokshi.
- Fshatrat në krahun e djathtë të lumit të Lloqanit: Lloqani, Sllupi, Dranoci.
- Zona malore 5479.6 ha Në këtë zonë shtrihen Bjeshkët e Nemuna që përformojnë vazhden e rripit nga rrëza e Bjeshkëve me paisazhin – florën dhe faunën e begatë. Pastaj masivi me kanionet piktoreske, për

tu kurorëzuar me kullosat e shkrepeve deri në majat më të larta në Kosovë, majat e Bjeshkëve të Nemuna.

Në këtë zonë, Belle llogaritet si vendbanim që për momentin nuk është e populluar, por evidentohet si vendbanim.

Bjeshkët e Nemuna apo Alpet Shqiptare shtrihen në pjesën përfundimtare të Komunës së Deçanit dhe vazhdojnë me Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Shkodrën mandej në Mal të Zi: Plavën, Gucinë, Luginën e Ibrit deri në Mokna me një sipërfaqe prej 3,500 km²

Lartësitë e Bjeshkëve të Nemuna pak ndryshojnë nga lartësia e vargmaleve alpike.

➤ Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të siujdhesës Ballkanike, me c'raste shkëmbinj të bardhe dhe të dhëmbëzuar formojnë pamje imponante.

Në vitin 2012 filloj projekti për adresimin dhe vendosjen e sistemit të adresave për tërë territorin e Deçanit. Kater (4) vite më vonë filloj edhe projekti tjetër për vendosjen e numrave për zonën urbane dhe rurale në Komunën e Deçanit.

Sistemi i digjitalizimit përfshinë emërtimin e të gjitha rrugëve në Komunën tonë si dhe vendosja e numrave për qdo shtëpi.

Me vendosjen e tabelave me emërtime dhe numrave Komuna e Deçanit ka kryer sipas ligjit digjitalizimin e adresave ku qdo shtëpi ka adresën dhe numrin e saj.

Projekti ende vazhdon edhe në vitin 2019 për arsye të përditësimit të dhënave sepse për ç'do ditë kemi ndërtime të reja, rrugë të reja etj.

□ Vitaliteti dhe Pleshmëria.

□ Në këtë zonë është grupuar toka pjellore e cila shtrihet përgjatë dhe në mes të rrjedhave të lumnjëve, të disa kodrave si rrafshnalta dhe tërë sipërfaqja e zonave rurale.

Komuna e Deçanit disponon me 8.940 ha tokë bujqësore që përfshinë 31% të sipërfaqes së tërësishme të komunës së Deçanit (29700 ha).

Kjo sipërfaqe bujqësore në bazë të kualitetit të tokës e shprehur në përqindje është sivejion:

tokë e mirë klasa I,II,III 60 %

tokë e mesme klasa IV 25 %

tokë e varfër klasa V, VI 15 %

Në zonat rurale, jetojnë rreth 74.19% e popullsisë së tërësishme të komunës .

Bujqësia është veprimtari kyçe në këtë trevë nga e cila sigurojnë të ardhura mbi 65% të banorëve të komunës së Deçanit .

□ Terësia rrëzë bjeshkës. Rrjedha e ujrave-Panorama e Kanijoneve

□ Në këtë zonë do të ketë një koncentrim të plotë të kapaciteteve kultivuese dhe prodhuese.

Në projektpropozimet e nxjerra, pikënisja bazohet në linjat qarkulluese të cilat përcjellin linearitetin e brezit të rrëzës së malit. Pastaj funksioni fleksibël i kësaj fashoje Ndërlidhja më sipërfaqet e rrafshëta, zonat banimore me fshatrat e shtrira në formën longitudinale në afërsi të zonën malore; Pikënisje dhe fuzionim më zonë turistike; Në këto hapësira depërtojnë rrjedhat e Lumit të Deçanit dhe Lumit të Lloqanit. Meqenëse përgjatë rrëzës së malit shtrihen linjat qarkulluese, jipet mundësia për destinimin e akaparimit, të produkteve natyrale dhe manufakturale të depozituara si produkte të gatshme dhe të parapërgaditura. Vlenë të përmendim grumbullimin e bimëve më efekt shërues, të cilat vjelen nga hapësirat e bjeshkëve, pastaj, grumbullimi i frutave:

- gështenjës,
- lajthisë,
- manit,
- mollave,
- dardhave,
- kumbullave. etj.

Është mundësia e ndërtimit të një qendrëje grumbulluese më shpërndarje në punkte duke filluar me grumbullimin e qumështit e deri të speciet e veqanta të bimëve mjekuese për Komunën e Deçanit. Tregu i gjelbër dhe tregu i kafshëve janë pjesë përbërëse e kësaj zone.

□ Zona malore-Natyrë dhe Pejzazhi


Në këtë zonë do të ketë një koncentrim të plotë të kapaciteteve turistike dhe kapaciteteve në sferën e blegtorisë.

Në zonën e Bjeshkëve të Nemuna , e cila paraqet një zonë malore, zhvillimi do të bazohet në veprimtaritë ekonomike të bazuara në resurset e natyrës – pejzazhi dhe kullosat, siç janë turizmi dhe blegtoria. Turizmi si një shtyllë orientuese për zhvillimin dhe avansimin e Deçanit në të ardhmën do të evaluohet përmes programeve afatgjata të cilat për fokus kanë zonat malore e në veçanti Bjeshkët e Belegut. Një ndër faktorët më rëndësi për zhvillimin e Deçanit është edhe grumbullimi dhe shfrytëzimi i rrjedhave të ujrave që burojnë nga kanijonet Bjeshkeve të Nemuna.



HARTA E TERITORIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT

Deçan / Decane



VLERËSIMI I RREZIQEVE

1.3. Bjeshkët:

Bjeshkët e Nemuna shtrihen në pjesën përfundimtare të Komunës së Deçanit dhe vazhdojnë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Shkodrën, mandej në Mal të Zi : Plavën , Gucin, Luginën e Ibrit deri në Mokna me një sipërfaqe prej 3500km².

Lartësia e Bjeshkëve të Nemura pak ndryshojnë nga lartësia e vargëmaleve alpike . Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të siudhësës Ballkanike, me ç'rastë shkëmbinjet e bardhe dhe të dhembëzuar formijnë pamje imponante .

Bjeshkët e Nemura shtrihen në mes të gjersisë gjeografike veriore 42-43° dhe 20- 23° të gjersia lindore. Gjatësia e kreshtave të këtyre bjeshkëve është 80 – 100 km² , kurse gjersia psh. në mes të Plaves dhe Deçanit është 40 km.

Nga masivi i Bjeshkëve të Nemura mundë të veqojmë këto maja më të larta:

- Maja e Gjeravicës 2656 m
- Maja e Rupes 2501m
- Maja e Qenit 2405m
- Maja e Strellcit 2377m dhe
- Rrasa e Zogut 2305m

Në teritorin e Komunës së Deçanit Bjeshkët e Nemuna përfshin pjesën:

Pjesën Qendrore e përbëjnë malet ndërmjet Bisticës (Lumbardhit) të Pejës dhe Deçanit: Bjeshkët e Strellcit me Majën e Strellcit (2377 m), Qafa e Nekut dhe Mylishevcit. Më në përfundim, kësaj pjese i takojnë Malet (Bjeshkët) e Lumbardhit me Majën Guri i Kuq (2522 m), Malet e Nexhinatit (2341 m) dhe Staraci (Plaku, 2426 m).

Pjesa jug dhe jugpërfundimtare të Bisticës së Deçanit e përbëjnë Malet (Bjeshka) e Deçanit, Malet (Bjeshka) e Vokshit (1641 m), Bjeshka e Junikut me Majën Rrasa e Zogut (2296 m), Gjeravica (2656 m), Bogiqja (2103 m), Maja e Ropës (2505 m), Maja e Qenit (2406 m) dhe Marjashi (2530 m).

Bjeshkët e Nemuna me lartësinë, strukturën e relievit, ndërtimin gjeologjik, elementet klimatike dhe botën organike na përkujtojnë Alpet.

Bjeshkët e Nemuna dallohen me maje të larta ,me lartësi mesatare mbi 2000m,dhe maja absolute e Kosovës Gjeravica me 2656 m, me shpatë të thepisura, me lugina të thella, me gryka të ngushta dhe me pragje të shumta , që paraqesin bukuri të rralla natyrore jo vetëm në Kosovë por edhe në Evropë. (Deçani me 16.632.96 ha,)

NATYRA E BJESHKËVE TË NEMUNA

Karakteristikat gjeomorfologjike

Bjeshkët e Nemuna paraqesin njërin nga masivet malore më të mëdhenj, më kompleks, më interesant dhe më të bukur të Ballkanit dhe më gjerë.

Është karakteristike se të gjitha majat e Bjeshëve të Nemuna nuk janë të mbërthyera në masivin edendur bjeshkatar, por paraqesin bimësi të shpërndarë bjeshkatore, prap se prap të lidhura në mes veti me qafë mali në formë valësh të zbutura e të tjera të cilat mundësojnë që relativisht lehtë të kalohet nga njëra maje në tjetrën.

Malet, luginat, grykat, kanjonët, shpellat etj., janë elementet morfologjike kryesore të cilët përcaktojnë fizionominë e pejsazheve të Bjeshkëve të Nemuna.

Në morfologjinë e Bjeshkëve të Nemuna janë të sintetizuara gati të gjitha proceset vepruese të faktorëve endogjen dhe eksogjen, gjatë të kalurës gjeologjike.

Relievin e Bjeshkëve të Nemuna, si një kompleks gjeomorfologjik, e karakterizojnë forma të shumta dhe të ndryshme- tektonike, glaciale, fluviale,të nivacionit, karstike dhe të denudacionit. Këto forma, gjenetikisht të ndryshme, shpesh herë kombinohen dhe plotësohen në mes vedi duke i dhënë pejsazhit të Bjeshkëve të Nemuna një pamje të veçantë me cirçe, lugina të akullnajave, morena , liqenj glacial etj, si pasojë e glaciacionit intenziv të pleistocenit.

Malet e kompleksit të Bjeshkëve të Nemuna, të përbëra kryesisht nga shkëmbinj rreshpor dhe magmatik, karakterizohen me një pejsazh më të butë dhe arkitekturë më të qetë të relievit, me shpatije të pjerrta, por në vazhdimsi njëra me tjetrën , me komplekse barishtore dhe pyjore si dhe me bollëk të burimeve dhe rrjedhjeve ujore. Te disa nga këto male, disa nga majat e tyre janë shkëmboredhe pa vegjetacion. Për nga pasuria dhe llojllojshmëria me elementet estetiko-dekorative (pyjet,kullosat,liqenjtë etj.) dhe me pamjen e mrekullushme nga majat e larta, veçohen së tepërmi Gjeravica . proceset tektonike , e cila më vonë është ndryshuar nga procese më të

reja tektonike dhe faktor të ndryshëm egzogjen. Nga proceset tektonike rrudhosëse janë formuar malet më të larta të këtij kompleksi. Maja e Gjeravicës e cila paraqet një tepe të një antiklinali, mandej paraqitja e rreshpeve të paleozoikut në nivele të ndryshme hipsometrike dhe e gëlqerorëve në shpatijet e rrëpinjta të Bisticës së Deçanit si dhe të antiklinalit të ndërlukuar të Maleve të Strellicit, janë fakte që tregojnë për prejardhjen tektonike parësore të këtij kompleksi malor.

Fizionomia e neorelievit (relievit të ri) të Bjeshkëve të Nemuna është formuar kryesisht nga proceset glaciale, fluviale dhe karstike, nga të cilat janë krijuar numër i shumtë i formave të ndryshme glaciale (cirçe, lugina të akullnajave, morena etj), fluviale (lugina lumore, kanjone, gryka, terraca lumore, kone të derdhjes, vorrbulla në shkëmbinjtë e shtratit etj) si dhe karstike (shpella, humnera, hurdha –gropa karstike etj.).

Në Bjeshkët e Nemuna , gjatë pleistocenit, ka egzistuar regjioni më i madh i akullzimit në Ballkan. Në regjionet burimore të lumenjve paraglacial , gjatë kohës glaciale janë formuar cirçe të mëdha nga të cilat akullnajat kanë lëvizur përgjatë shpatijeve malore.

Në regjionin burimor të Bisticës së Deçanit është formuar akullnaja luginore e degëzuar, e dyta për nga madhësia, e gjatë afër 20 km. Në Malet e Deçanit janë ruajtur mbetjet nga format relievo glaciale të përfaqsuara nga cirçet dhe lugjet (luginat) e akullnajave. Janë të ruajtur cirçet nën Majën e Gjeravicës, në pjesën përfundimtare. Në të vërtet këto paraqesin pjesën burimore të Bisticës sëKozhnerit. Në ujëmbledhsin e Erenikut ka egzistuar akullnaja e gjatë 14 m, ndërsa në ujëmbledhsin e Bisticës së Loçanit akullnaja e gjatë 12 km.

Nga veprimtaria e lumenjëve paraglacial dhe atyre postglacial, në luginat e akullnajave janë krijuar luginat lumore , zakonisht të tipit kompozit. Këto lugina i kanë krijuar Bistrica (Lumbardhi) i Deçanit, Lumi i Lloçanit, Ereniku etj.. Si lugina me bukuri të rrallë veçohen lugina e Bisticës së Deçanit dhe e Erenikut, të cilat veqohen me bukuri natyrore te veçanta dhe me motive impulsive gjeomorfologjike.

1.4. Fondi i ujrave-hidrografia:

Komuna e Deçanit shtrihet në pellgun e tre lumenjve , të cilët burojnë në masivin e Bjeshkëve të Nemuna. Në të cilat ka sasi të mëdha të reshurave atmosferike dhe të pasura me burime të shumta të ujit .

Të gjithë lumenjtë që përshkojnë teritorin e Komunës së Deçanit burojnë në teritorin e Komunës të Deçanit , ku përshkojnë këtë teritor dhe derdhen në Drinin e Bardhë i cili si ujëmbledhës derdhet në Detin Adriatik.

Lumejt më të mëdhenjë që burojnë në teritorin e Komunës së Deçanit janë:

1. Lumi i Deçanit,
2. Lumi i Lloçanit

Gjithashtu, teritorin e Komunës së Deçanit e përshkojnë edhe një numër i konsiderueshëm i projevave dhe prockave si:

- a) Duraku i Strellicit,
- b) Prroni i Behovcit,
- c) Projet e Vokshit,
- d) Prroni i Lëbushës,
- e) Prroni i Durakut,
- f) Prroni i Ratishit etj.

1. Lumi i Deçanit:

Përbëhet nga tri degë:

a. Burimit të Lumit që buron rrënez shpatijeve të Majes së Qenit në lartësi mbidetare 2135 m, dhe ka gjatësi 14km.

b. Prronit të Belegut i cili buron nga Kroni I Pashes dhe gjindet në mes të Majes së Madhe e Majes së Rupës në lartësi mbi detare 1985 m. Ka një gjatësi prej 6.8 km.

c. Prroni I Shqipërisë buron në rajonin e gjerë të Plaçicës së Vokshit nga Liqeni I Madh I Gjeravices (liqeni i Zemres) I cili gjindet në lartësi mbidetare 2240 m. Ka një gjatësi prej 9.5 km. Lumbardhi I Deçanit përshkon teritorin e Komunës së Deçanit deri në afërsi të fshatit Buqan (l.m.d. 480 m). Pellgu i tij përshkon fshatrat:Deçan,Isniq, Llukë e Epërme,Llukë e Poshtme, Lumbardh dhe Broliq ku kalon në teritorin e komunës së Pejës dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Eshhtë I gjatë 40.4 km.

2. Lumi i Lloqanit :

Më gjatësi 23,7 km , buron nga shpatijet e Kurvallës, Dervishëkomit, Stanishtës së Zogut dhe Gurrat e Hasanagës në lartësi mbi detare 2100m

Pellgu i Lumit të Lloqanit përshkon fshatrat Hulaj , Lloqan ,Carrabreg i Epër ,Prejlep Rastovicë, Baballoq , Gramaqel dhe Jasiq . Ky lumë përveqë që ujit fushat e këtyre fshatrave , uji i tij shpenzohet për ujitje të fushave edhe të shume fshatrave tjera si : Pobergjë , Voksh, Sllup dhe Dranoc etj.

Shtrati i Lumit të Lloqanit pjesërishtë është i rregulluar . Janë ngritë diga në Hulaj dhe Lloqan për pengimin e erozionit të shtratit të lumit dhe brigjeve të tij .Nga ura e Bajram Hasanit deri në fshatin Prejlep shtrati i lumit përgjatë rrjedhës së lumit është i rregulluar . Kurse në fshatin Baballoq ekziston rreziku përmanent për vërshimin e fshatit .Gjithashtu në pjesën e aksit rrugor në mes të Lloqanit dhe lagjes të Kasumajve ku rruga shkon përgjatë bregut të lumit është e domosdoshme që të rregullohet shtrati i lumit .

Shtrëtërit e Lumejve janë të cekët dhe të pa rregulluar që përiodikishtë vërshojnë tokat anësore . Brigjet e tyre janë të ekspozuar proqesëve erozive.

Teritori i Komunës së Deçanit përshkohet edhe me një rrjetë të dendur të prrojeve dhe prrockave , uji I të cilave mundëson ujitjen e kulturave bujqësore gjatë sezonit të vegjetacionit .

PRROJET E VOKSHIT

Burojnë në Malet e Vokshit në lartësi mbi detare 1460 m. kanë rrjedhë shumë të rrëpishme dhe disnivel të madh 860 m. nga 1460 m. zbresin në 600 m. përbehen nga:

1. Prroni i Bresnikut,
2. Prroni i Stonkave,
3. Prroni i Ternavës dhe
4. Prroni i Dubuqakut

PRRONI I BEHOVCIT

Prroni i Behovcit buron në shpatijet e Bjeshkës së Strelcit në lartësi mbidetare 1780m. dhe rrjedha e tij kalon në mes të dy fshatrave: në krahun e majtë të tij gjendet fshati Strelci i Ep. kurse në krahun e djathtë gjendet fshati Lëbushë. Në rrjedhën e poshtëme të tij përshkon fshatrat Isniq, gjegjësisht Lagjen Bruqaj dhe Osmanaj, kalon përmes fshatit Dubovikë dhe në aksin rrugor Kryshec-Berliq në Fushën e Thatë kalon në teritorin e Komunës së Pejës në lmd 518m.

Prroni i Behovcit është i gjatë 14950m.

Disniveli i Prronit është 1262m, kurse pjerrtësia mesatare në terë gjatësinë e tij (në teritorin e Komunës së Deçanit) është 4^o.83' ose shprehur në përqindje 8.44%.

Historia e vërshimeve të këtij prroni është mjaft e bujshme. Vërshimet e tij mund të jenë përmasash katastrofike.

Me qellim të ndërmarrjes së masave për parandalimin e proceseve erozive dhe vërshimeve, në pesën e epërme të rrjedhes së Behovcit, afër lagjes së Hajrizajve, janë të ndërtuara tri penda (diga) erozive dhe një mur mbrojtës.

Digat, në gjendjen e tanishme janë jashtë funksionit të tyre meqenëse për shkak të mbushjes së tyre me materie të ndryshme inerte (gurë, zhavorr, rërë etj.) nuk ka ndalje të mëtutjeshme të materialeve të cilat i sjellin rrymat e ujit nga shpatijet e Bjeshkës së Strelcit.

Digat janë ndërtuar gjatë viteve 30-ta e të rindërtuara në vitin 1951. Penda e tretë është ndërtuar gjatë viteve të gjashtëdhjeta. Digat gjinden në procesin e shkatërrimit për shkak të vjetërsisë dhe mos mirëmbajtjes dhe pastrimit të tyre.

Ekziston rreziku përmanent i shpërthimit të tyre. Masa e materialeve nga digat nën presionin e ujit do të vërshon në gjithë hapësirën poshtë digave duke krijuar përmbytje katastrofike të fushave dhe ekonomive familjare të fshatrave Lëbush, Strelci, Isniq, Dubovikë etj.

Gjithashtu do të shkatërrohen urat dhe aksi rrugor në lokalitetin e Zallit të Strelcit dhe me këtë edhe ndërprerja e komunikacionit në aksin rrugor Pejë–Deçan–Gjakovë.

Faktor përkeqësimi të rritjes së rrezikshmërisë së vërshimit të Prronit të Behovcit është edhe hedhja e mbeturinave në shtratin e tij, e posaçërisht e mbeturinave inerte, të cilat në masë drastike e kanë ngushtuar shtratin dhe zvogëluar thellësinë e tij.

Kurse faktor tjerë përkeqësimi janë edhe:

- Reshjet e dendura,
- Shkrirja e borës e shoqëruar apo jo me mot të ligë,
- stuhive në zonat malore,
- Kohë zgjatja e tyre,
- Ndërtimet e pakontrolluara në hapësirat përgjatë prronit – tokat bujqësore
- Pjerrtësia e lehtë e prronit në rrjedhën e poshtme të tij
- Intensiteti dhe kohëzgjatja e reshjeve
- Thellësia e pamjaftueshme e shtratit të prronit
- Vegetacioni dhe kapaciteti absorbues i tokës
- Prania e pengesave në qarkullimin e ujërave

Masat parandaluese:

- **Ndalimi i hedhjes së mbeturinave në shtratin e Prronit,**
- **Pastrimi i shtratit nga mbeturinat dhe vegetacioni,**
- **Rregullimi i shtratit,**
- **Ndërtimi i argjinaturave,**
- **Pastrimi i digave nga materiet inerte,**
- **Mirëmbajtja dhe përforsimi i digave,**
- **Legjislativi.***

PRRONI I DURAKUT

Është i gjatë 4 km e 750 m. Buron në shpatijet e Bjeshkes së Strelcit. Ka disnivel të madh 800 m.(prej 1400 m. zbrit në 600 m. l.md.)

1. Janë inspektuar 3 km. të rrjedhes së tij ; nga Izohipsa 1000m lmd. teposhtë rrjedhes deri të ura në aksin rrugor Deçan – Pejë në fshatin Lubenuq. Në shtratin e këtij prroni, përgjatë rrjedhes së tij në një gjatësi prej 2500 m. janë të ndertuara 8 penda mbrojtëse përmasash dhe dimenzionesh të ndryshme.
2. Përgjatë rrjedhes së prronit të Durakut. në krahun e majtë të tij janë të ndertuara edhe pesë penda mbrojtëse ansore.
3. Pendat janë të ndertuara nga gurët e gdhendur dhe betoni.

Kanali derivues Ligenit Artificial të Radonoqit

Kanali i cili furnizon me ujë ligenin artificial të Radonoqit nga Lumbardhi I Deçanit e ka të ngritur digën furnizuese të Verrat e Llukës. Kanali është i gjatë 8 km.dhe kalon nëpër këto vendbanime të komunës së Deçanit: Llukë e Epërme, Pozhar, Kodrali, Irzniq (lagja Dodaj dhe Mushkolaj) dhe vazhdon përgjatë fushës në veri-lindje të Irzniqit

Përgjatë kanalit nga të dy anët e tij është e dëmtuar ose e hjekur fare rrjeta mbrojtëse e telit së bashku me shtyllat e betonit.Nuk egzistojn zingjirët për shpëtim dhe vetëshpëtim të cilët kanë qenë të vendosur në të gjitha kaskadat e kanalit si dhe mbrojtëset anësore të urave janë hjekë ose dëmtuar në atë masë sa që nuk paraqesin mbrojtje të sigurt për kalim.

Në veqanti, vendi i derdhjes së ujit nga kanali në liqe paraqet rrezik të posaqem nga shkaku se uji ka krijuar një kanjon të thellë 20 deri 25m.me brigje shumë të rrëpishme dhe mundësi të mëdha erosive përmasash katastrofike për ambientin për rreth e tragjike për barite dhe kafshët shtëpiake.

* Materiali i marur nga

Shikuar në aspektin e sigurisë ky kanal paraqet rrezik përmanent për banorët e fshatrave nëpër teritorin e të cilave kalon si dhe për kalimtarët e rastit, fëmijët, nxënësit dhe kafshë të shtëpjjake.

Kanali gjatë periodes kohore: vjeshtë-dimër-pranver ka sasi të madhe të ujit dhe rrjedhë të fuqishme e çdo ramje në te ka përfundim tragjik.

TË DHENAT FIZIKO – TEKNIKE TË KANALIT DERIVUES DHE LIQENIT ARTIFICIAL TË RADONIQIT

Gjatë muajve maj qershor (shkrija e bores) ka kapacitet prej $Q= m^3/sek.ujë$.

1. Kurse gjatë muajve të verës bije në $Q= 1.0 m^3/sek.ujë$.
2. Kapaciteti i kanalit është $Q= 13 m^3/sek. ujë$.
3. Kanali kalon nëpër këto vendbanime të komunës së Deçanit: Llukë e Ep. Kodrali dhe Irzniq (lagjësia Dodaj dhe Mushkolaj).
4. Gjatësija e kanalit është $L= 7.500 m$.
5. Disniveli në mes të presës dhe fundit të kanalit është $71.77 m$.
6. Në kanal janë të ndertuara 46 kaskada me $H= 1 m$.
7. Mbi kanal gjinden 13 ura.
8. Pjerrtësia e kanalit është $0.01 – 0.004 \%$
9. Nga fundi i kanalit deri të derdhja në liqe është krijuar kanjoni me dimensione $40 x 25 x 2000 m$.
10. Gjatësija e liqenit është $5 km$.
11. I gjerë $2200 m$.
12. I thellë $50.5 m$.
13. Kapaciteti i liqenit është $13.000.000 m^3 ujë$.




TABELA E LUMEJVE TË KOMUNËS SË DEÇANIT

Nr.	L U M I	Deget e lumit	Burimet lumit	Lmd e burimit	Gjat. burimit	Lmd lumit	Pika ult e lu	Koordinatat	Disniveli lumejve	Gjatësia lumejve
1.	LUMI I LIOQANIT	Burimi në Stanisht të Zogut		1940 m	%	2100m	600m ura e Kasum. Lloqan		1360 m	23.7 km.
		Gurrat e Hasanages		1960 m	%					
2.	LUMI I DEÇANIT	Burimi i Bistrices	Maja e Qenit	2200 m	14 km.	2280 m	600m ura e Demes-Deçan		1680 m	40.4 km.
		Prroni i Belegut	Kroni i Pashes	2000 m	7 km.					
		Prroni i Shqipris	Liqeni i Pllaqices	2280 m	9.5 km.					

Kapaciteti i lumejve

Nr	Emri i lumit	Sipërf.e pellg. në km ³	Vëllimi i dobishëm- m ³	Kapac.vlersues i garant-m ³ /sec	Gjithësejt-m ³
1	Lumi i Deçanit	144	33x10 ⁶	3.5	45x10 ⁶
2	Lumi i Lloqanit	39	12x10 ⁶	1.2	15x10 ⁶
	Gjithsejtë				



Harta e rrjetit hidrografik

VLERËSIMI I RREZIQEVE



1.4. Karakteristikat tjera :

Flora

Teritori i Komunës së Deçanit përfaqëson zonën shumë të pasur me pyje dhe me tipe tjera vegetacioni. Flora e kësaj treve rradhitet në kate në të cilat bëjnë pjesë :

1 Gjetherënëset e fushave: Janë bimë, të cilat i ka kultivuar dora e njeriut nëpër megja të arave dhe livadheve si : shelgu , verra , plepa ,bagrena , vidha si dhe shumë llojshmëri te pemëve : molla, dardha ,arra, etj.

2. Zona e gështenjave:Nga Juniku deri në Strellc në lartësi mbidetare prej 500 deri 1000m dallohet zona e pasur me gështenja ,ky lloji i pemëve ka rëndësi të madhe si nga fryti ashtu nga lënda drunore

3. Zona e pyjeve gjetherënëse: Në lartësi derë në 1500m dallojmë pyjet gjetherënëse si bungu , ah, shkoza lajthia frashri , panja etj. Shërbejnë si lëndë djegëse dhe në ndërtimtari .

4. Zona e pishnajave : Në zonën e pishnajave paraqiten relikte dhe lloje endemike si : pisha e bardhë ,pisha e zezë, bredhi i kuqë, bredhi i bardhë , molika etj. Këto lloje të drunjve kanë rëndësi të madhe si në ndërtimtari ashtu edhe në industri .

5. Zona e kullosave: Mbi lartësitë 2000-2500m paraqitet zona e kullosave e cila është hapësirë shumë e përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë . Kjo zonë është e pasur edhe me bimë mjekuese dhe më së shumti haset si : boronica , pelini , lincuri, dhe të gjitha llojet çajit.

6. Zona e shkëmbinjve të zhveshur: Ngjitur me zonën kullosave në lartësi mbi 2500m shtrihet zona e zhveshur së cilës i mungon çdo lloji i vegetacionit.

PASQYRA TABELARE E SIPËRFAQEVE PYJORE NË KOMUNËN E DEÇANIT

Nr.	SEKSIONI	Pyje të larta /ha		Pyje ulëta të	Pyje të degraduara shkurre	Sipërf. të mbuluara me pyje) (5+6+7+8)	Sipërf. të zhveshura	Sipërf. tërësish. pyjore (9+10)
		Pyje	Kult. pyjore					
0	1	5	6	7	8	9	10	11
1.	Deçani	9431.18	267.47	1158.87	109.81	10967.33	1910.04	12877.37

PASQYRA TABELARE E DRUNJËVE NË PYJET E KOMUNËS SË DEÇANIT

Llojet e drujve pyjorë	Sip.(ha)	(%)
Gështenja		
Pishë (llojet Pinus)		
Bredh (llojet Abies)		
Ah (Fagus silvatica)		
Dushk (llojet Quercus)		
Lloje të tjera gjethëramëse		
Gjithsejt		

Fauna

Fauna e Bjeshkëve të Nemuna paraqet një rezervat shumë të pasur me lloje të ndryshme të kafshëve të egra të cilat jetojnë në pyje të dendura si : ariu , ujku ,dhelpira , lepuri , vjedulla ,derri i eger , reqebulli , kaprolli ,ketri ,etj si dhe një lloj-llojshmëri shumë e madhe e shtazëve që ndertojnë fole të përhershme ose sezonale. Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme mundë të konstatojmë së përbehet prej 8 llojeve të peshqeve, 13 lloje ujëtokësorë , 10 lloje rrshqitës 148 lloje shpendësh, 36 lloje gjitarë ,dhe 129 lloje fluturash..

Fauna kerkon kujdes dhe mbrojtje. Njeriu duhet të krijoj dashuri ndaj faunës Ai duhet të sjell në teren më shumë se sa të mer sepse në fund të fundit ajo është pasuri e jonë kombëtare. Kultivimi dhe begatimi i faunës në terrenet tona paraqet kulturen tone ndaj ambientit si dhe dashurin tone ndaj çdo gjëje që është e bukur, fisnike dhe e lire në natyrë.

Kushtet themeloere të domosdoshme për zhvillimin dhe kultivimin e faunës janë:

- klima
- ujë
- ushqimi dhe
- qetësia

Fauna rradhitet në dy lloje themelore:

1. Shkencore:

- Gjini
- Klasa
- Rende
- Familje dhe
- Lloje.

2. Ligjore:

- të mbrojtura
- mbrojtje të përhershme
- të mbrojtura me ndalim gjahu
- të pa mbrojtura

Çka janë egersirat- janë lloje të ndryshme të kafshëve të egra dhe zogjëve të cilat jetojnë të lira në natyrë.

Sipas rendit egersirat të cilat i përkasin faunës së Bjeshkëve të Nemura ndahen në:

1. Me qime:



- | | |
|--------------|-----------------|
| - dreri, | - dhelpira |
| - ariu | - lepuri |
| - ujku | - dhia e eger |
| - rrëqebulli | - kaprolli etj. |

2.Me pupla:

- shqiponja,



- pula e eger,
- huti,
- fëllenza
- turtullesha
- pata dhe rosa e eger

KLIMA

Klima e teritorit të Komunës së Deçanit nuk mund të meret e izoluar prej pjesëve tjera të Rrafshit të Dukagjinit, sepse edhe këtë teritor e karakterizojnë ato veqori klimatike që vlejnë për Rrafshin e Dukagjinit. Në veqoritë klimatike të teritorit të Komunes së Deçanit rol vendimtar luan edhe reliefi. Afersia e Bjeshkëve të Nemuna kushtëzojnë klimë të ashpër.

Në klimën e teritorit të Komunës së Deçanit gjatë periudhës së verës ndikon levizja e presionit të lartë të ajrit nga zonat subtropike në drejtim të veriut i cili gjendet nën ndikimin e aktivitetit të ciklonit nga Oqeanit Atlantik dhe Deti Mesdhe, si dhe gjatë dimrit nën ndikimin e anticiklonit Siberian.

Kushtet klimatike diktojnë regjimin e reshjeve atmosferike në teritorin e Komunës së Deçanit që karakterizohet me reshje të mëdha shiu e që për pasoj ka ndodhjen e vërshimeve meqenëse shtretërit e lumejve, relativisht të cekët, nuk mund të përballojnë sasi të mëdha të ujit dhe rrjedhës së shpejtë të tij.

Bora është reshje e rregullt e dimrit në këtë rajon. Ka patur vite kur ka pasur pasoja shumë të rënda nga bora. Anomalitë ekstreme të reshjeve të bores dhe temperaturave të ajrit në janar të vitit 1985, rezultojnë me stuhi të papritura të bores. Më i godituri në Rrafshin e Dukagjinit ishte Deçani.

Ortekët janë dukuri tipike për reliefin e llojit alpin, siç është reliefi i vargmaleve të Bjeshkëve të Nemuna. Mbështetja sportive dimnore dhe e turizmit për rekreacion në rajonet e Bjeshkëve të Nemuna, në të njëjtën kohë nënkupton edhe ekspozimin ndaj rreziqeve nga bora. Problemi i ortiqeve nga bora në këto vise ende nuk është hulumtuar dhe kërkon të i kushtohet kujdes i duhur.

Stuhit e breshërit, që zakonisht ndodhin në periudhën në mes pranveres së hershme e vjeshtes së vonë, gjithashtu janë karakteristikë e klimes së Deçanit. Kohëzgjatja e stuhisë së breshërit sillet prej disa sekondave e deri një orë. Më së shpeshti zgjatë 10 deri 15 minuta.

Temperaturat e ulta janë faktor i rëndësishëm meteorologjik që ka ndikim të madhë në klimën e këtij teritori. Temperaturat e ulta në vjeshten e hershme dhe pranverën e vonë lënë pasja të rënda posaqërisht në rritjen e frutave dhe në kultivimin e përimeve.



Ditët me diell:

Ditët me diell zgjasin rreth 44 % prej ditëve të mundëshme që është një vlerë e lartë. Mesatarisht numri i ditëve me diell mbi 9 orë në Deçan është 92 ditë gjatë vitit, e mbi 2000 m.lartësi mbi detare ka 115 ditë.

Lokalitetet	Mesatarja e ditëve me diell në orë gjatë vit.
Deçani – vendbanimet nën 700m. l.md.	1945
Tereni në 1000 m.l md.	2019
Tereni në 1500 m.l.md.	2121
Tereni në 2000 m.lmd.	2148



Tempëratuara e ajrit:

Megjithëse Deçani gjindet në l.m.d. prej 600 m. tempëratuara mesatare vjetore nuk lëshohen nën 0° C. Muaj më i ftoht është janari me tempëratuara mesatare mujore 0.2° C e muaj më i nxeht është korriku me tempëratuara të mesme mujore prej 21.5° C.

Lokalitetet	Temp.mesat. vjetor.	Ndryshi vj. të. Temp
Deçani- vendbanimet nën 700.m.l.m.d.	11,1° C.	21,1° C
Tereni në 1000 m.lmd.	9,3	20,1
Tereni në 1200 m.lmd.	8,5	19,5
Tereni në 1500 m.lmd.	7,4	18,6
Tereni në 2000 m.lmd.	5,0	17,1

Në Deçan nuk ka ditë me tempëratuara të mesme ditore më të ultë se -15° C. ose me të lartë se +30° C.



Reshjet:

Sasia mesatare vjetore e reshjeve në teritorin e Komunës së Deçanit levizë prej 900-1500 ml/ m² .Mesatarisht, gjatë vitit ka 126 ditë me të reshura.Mësë paku të reshura ka gjatë muajt korrik, gusht dhe shtator 6-8 ditë mesatarisht me sasi deri në 70 ml/ m². Kurse sasia më e madhe është gjatë gjysmës së ftoht të vitit ku sasia e të reshurave arrin deri 1500ml/m² në ditë.

Në Komunën e Deçanit, pos të reshurave në formë të shiut, ato paraqiten shpesh edhe në formë të botes prej nentorit deri në prill e mund të jenë edhe në Tetor e Maj. Mesatarisht ne Komunën e Deçanit janë 39 ditë me mbulesë bore 10 cm. Mbi 10 cm. borë ka 22 ditë. 30cm. e më tepër bore ka 6 ditë, e mbi 50cm. gjithsejt 2 ditë mesatarisht.

Sasia e të reshurave mujore dhe vjetore në ml/m²

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
101	102	74	66	57	48	45	34	60	104	114	103	908

Mbulesa e botes në teritorin e Komunës së Deçanit ka kohë zgjatje të ndryshme të qendrueshmëris mvarsisht nga reliefi dhe lartësia mbidetare. Qendrueshmëria ma e madhe e botes është në lartësi mbi 2000m.

Lartësia mbidetare në m.	Dita e paraqitjes së botes		Përioda e qendrueshmëris në ditë	
	Dita e parë	Dita e fundit	Me borë	Pa borë
600	15 XII	13 III	89	276
1000	17 XI	24 IV	159	206
1500	1 XI	2 V	183	182
2000	13 X	10 V	210	155

I.2. DEMOGRAFIA:

Fuqia e pare prodhuese është njeriu, popullsia është faktori kryesor dhe burim potencial i fuqis puntore si dhe faktor kryesor për zhvillimin politiko- shoqëror dhe ekonomik të një vendi.

Historik i shkurter rreth regjistrimeve ne Kosove nga periudha 1981-1991.

Regjistrimi i fundit i përgjithshëm valid në Kosovë është bërë në vitin 1981. Sot është vështirë të jepen vlerësime për numrin e saktë të popullsisë në Kosovë, e në këtë kuadër edhe të popullsisë së Komun[së Deçanit.

Ky regjistrim është realizuar nga Enti i Statistikor i Kosovës dhe ka përfshirë regjistrimin e numrit të popullsisë, personave, ekonomive shtëpiake dhe banesave.

Të dhënat statistikore të mbledhura dhe të publikuara nga ky ent deri në vitin 1988 mund të konsiderohen të besueshme. Në vitin 1991 është bërë edhe një regjistrim i përgjithshëm në Kosovë mirëpo të dhënat nga ky regjistrim duhet të merren me kujdes pasi që ai u bojkotua nga popullata shqiptare. ;

Të dhënat statistikore të cilat janë në disponim mund të ndahen në: *të dhënat për periudhën 1990-1999 të dhënat pas vitit 1999.*

Të dhënat para vitit 1990 janë të periudhës kur entet dhe institucionet shtetërore funksiononin normalisht, kështu që mund të konsiderohen si të besueshme. Të dhënat për periudhën 1990-1999 janë të mangëta dhe në pjesë të madhe nuk pasqyrojnë realisht situatën në Kosovë gjatë kësaj periudhe, kështu që si të tilla duhen të trajtohen me maturi.

Pas përfundimit të luftës të vitit 1999, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe vendore filluan të plotësojnë vakuumin statistikor, duke realizuar anketime dhe hulumtime. Shënimet e mbledhura nga organizatat ndërkombëtare së bashku me ESK mund të vlerësohen së paku si pjesërisht të besueshme.

Deçani më gjendjen e lëvizshmërisë demografike, si edhe komunat tjera ka një dallim nga mesatarja në nivel të Kosovës.

Gjendja shikuar në periudhën 1948—1981 është me disa dallime nga ajo e Kosovës.

Sipas regjistrimit të vitit 1948 në komunën e Deçanit kishte 39 vendbanime, 2794 ekonomi familjare me 20672 banor.

Sipas regjistrimit të vitit 1953, në kuadër të Rrethit të Pejës, bënin pjesë Këshilli popullor i Komunës-Strellci Epërm.

Në kuadër të rrethit të Gjakovës bënin pjesë këto KPK : Deçani me 10 fshatra , 874 shtëpi dhe 6834 banorë.

KPK i Irzniqit me 16 fshatra, me 786 familje dhe më 5865 banorë.

Sipas shënimeve të përpunuara, Komuna e Deçanit kishte 39 vendbanime 2912 ekonomi familjare me 22218 banorë.

Bazuar në regjistrimet e vitit 1961, Komuna e Deçanit kishte këtë strukturë:

Vendbanime 39, ekonomi familjare 3386 dhe 25582 banorë. Nga ky numër 22472 ose 87.8 % ishin shqiptar , 413 ose 1.6 % serbë , 2534 ose 9.9 % malazez, 51 ose 0.2 % musliman, 6 turqë .

Sipas regjistrimit të vitit 1971, Komuna e Deçanit kishte 39 vendbanime, 3795 ekonomi familjare me 31335 banorë , nga të cilët 29474 ose 94.2 % shqiptar , 310 ose 1.0% serbë, 1357 ose 4.3 % malazez dhe 133 ose 0.4 % muslimanë.

Sipas regjistrimit të vitit 1981 , Komuna e Deçanit kishte 40 vendbanime me 40640 banorë , nga të cilët 39179 ose 96.4 % shqiptar , 234 ose 0.6 % serbë , 898 ose 2.2 malazez , 217 ose 0.5 % muslimanë , 112 ose 0.3 % të tjerë .

Sipas regjistrimit serb në vitin 1991 , si dhe në bazë të parashikimeve, në komunën e Deçanit jetonin 49458 banorë , nga të cilët 48267 ose 97.6 % shqiptar, 188 ose 0.4% serbë , 611 ose 1.2 % malazez , 105 boshnjakë ose 0.2 % dhe 184 ose 0.4 % romë.

Sipas vlerësimeve të sotme në Deçan dhe në fshatrat e kesaj komune jetojne afro 41.000 banorë , prej tyre në qendrën urbane jetojnë afërsisht 6000 banorë ndërsa dëndësia e popullsisë është rreth 167 banorë për një km². Numri i popullsisë që jeton në hapsirat rurale është rreth 90 %.

Në Komunën e Deçanit popullsia shumicë janë shqiptarë , mirëpo, jetojnë edhe grupe të minoriteteve si : musliman (boshnjak) dhe romë . Kurse serbë ka vetëm në Manastirin e Deçanit dhe sipas informacioneve ka klerik dhe një numër të shërbyesve tjerë.

Popullsia e Deçanit arrin sipas disa vlerësimeve përafërsisht në 41.000 banor të cilët jetojnë në Deçan dhe në 37 fshatra. Popullsia e kësaj treve profesion primar e ka bujqësinë, mirëpo merret edhe më zëjtari kryesisht më zdrukthëtari e që janë të njohur si zëjtar të përpunimit të drurit (duhet cekur se në fund të vitit 2009 Juniku u shendrrua në Komune duke u ndarë nga komuna e Deçanit sëbashku me 2 fshatra Gjocaj dhe Jasiq).

Regjistrimi i fundit i përgjithshëm valid në Kosovë është bërë në vitin 2016. Vlerësimi i popullsisë së Kosovës ka për qëllim të sigurojë një vlerësim të saktë statistikor mbi popullsinë, i nevojshëm për institucione, organizata dhe individë, njëherit është praktike dhe standard që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi. Kjo për faktin se në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, komune a vendbanimi dhe vlerësimi i popullsisë është me se i nevojshëm për nxjerrjen e indikatorëve të rëndësishëm socio-ekonomik. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) do të vazhdojë të bëjë vlerësimin, çdo vit, të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune. Të dhënat vjetore statistikore mbi popullsinë janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash me çështjet sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara komunale, kombëtare dhe rajonale. Statistikat mbi popullsinë janë një emërues dhe tregues i rëndësishëm i vendimmarrësve, analistëve, hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të ndryshëm të të dhënave. Të dhënat mbi popullsinë përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimet e llogarive kombëtare, punësimit, ndarjeve buxhetore, standardit jetësor dhe çështjeve të tjera socio-ekonomike. Këto janë të dhënat e fundit zyrtare, të vlerësuara për numrin e popullsisë së Kosovës në nivel të komunave për vitin 2016.

1.2.1 Vendbanimet:

Dëshmi për ekzistimin e shumë vendbanimeve në Kosovë por edhe në trevën e Deçanit, janë gjurmët e shumta arkeologjike të zbuluara, sidomos ato të rastit.

Banorët e Katundit të vjetër sikurse edhe fshatrat tjera për rreth, ndahen në Lagje (Mëhallë) Vendbanimet në të kaluarën kryesisht kanë qenë fshatrat me kulla. Kullat janë të përhapura në të gjitha fshatrat e Deçanit. Kullat janë ndërtuar, në radhë të parë, për të banuar në to, së dyti për tu mbrojtur nga sulmet e armikut. Ekzistojnë tipe të ndryshme të kullave.

Karakteristikë për rrethinat e Deçanit janë edhe vendbanimet që ndërtohen gjatë stinës së verës, në bjeshkët e këtyre anëve të ashtuquajtura stane, këto janë vendbanimet sezonale që shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive në bjeshkët e kësaj treve.

Në vitin 2009 Juniku mer statusin e Komunes duke u shkeputur bashke me dy vendbanime Gjocaj dhe Jasiq duke e zbritur numrin e fshatrave në Komunen e Deçanit nga 41 në 37 vendbanime.

1.2.2. Analiza demografike:

Rritja e popullsisë

Sipas statistikave të marura nga analizat paraprake, regjistrimi i fundit i përgjithshëm valid në Kosovë është bërë në vitin 2016. Ky regjistrim është realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe ka përfshirë regjistrimin e numrit të popullsisë, personave, ekonomive shtëpiake dhe banesave. Bazuar në këto të dhëna, përkunder shtimit natyror pozitiv të popullsisë prej 20,867 banoreve për shkak të emigrimit nderkombëtar, popullsia rezidente e Kosovës për periudhën 01 Janar – 31 Dhjetor 2016 u rritë vetëm për 11,927. Duhet cekur se rreth 40% e banoreve të Komunes së Deçanit jetojnë në diasporë dhe njihen si banorë jorezident. Popullsia në Kosovë për vitin 2016 vlerësohet të jete 1.783,531 banorë resident.

1.2.3.Struktura e popullësisë:

Në Komunën e Deçanit, sipas vlerësimeve, në qendrën urbane, pra, në vetë qytetin dhe në 37 vendbanimet tjera të kësaj komune, jetojnë rreth 41.000 banorë. Popullsia shumicë është shqiptare mirëpo jetojnë edhe grupe tjera minoritare si mysliman, romë dhe ashkali. Popullsia në qendrën urbane është 6000 banorë. Dendësia e popullësisë është afërsisht 167 banorë për 1 km².


Struktura moshore e popullësisë (Komuna Deçan)

-Fëmijë dhe shkollor 0-14 vjeq -----	10.471 banorë
-Moshë 15-19 vjeq -----	4.181 banorë
- Moshë 20-64 -----	22.204 banorë
-Moshë 65+ -----	4477 banorë

Numri i përgjithshëm i banorëve si dhe nr/km² në Komunën e Deçanit sipas viteve:

VITI	NR. I BANORËVE	NR.BANOR. / km ²
1948	20672	55.72
1953	22218	59.88
1961	25582	68.95
1971	31335	84.46
1981	40640	109.54
1991	48267	130.01
2000	57640	155.3
2008	51590	167.11
2011	40.019	226.9
2014	41.564	230.9
2016	41.641	231.3

Numri i banorëve ndër vite në Komunën e Deçanit



Struktura sipas moshës-

Sipas vlerësimeve të fundit të realizuara nga Enti I Statistikave të Kosovës, në nivel të Kosovës, pjesëmarrja e popullsisë me grup-moshë 0-14 vjet është 642,613 banorë apo 35%, me grup-moshë 15-65 vjet 1.135,463 banorë apo 59% dhe mbi 65 vjet 116,795 apo 6%. Komuna e Deçani karakterizohet me popullësi në të cilën dominon moshja e re me 42.5% të banorëve nën moshën 19 vjeçare dhe kjo paraqet një potencial të rëndësishëm për zhvillim ekonomik në të ardhmen.

Struktura sipas gjinisë-

Sipas regjistrimit të vitit 2011 raporti në mes gjinisë mashkullore dhe femërore në Kosovë ishte 51.9% meshkuj dhe 48.1% femra. Gjinia mashkullore deri në këtë vit dominonte, kurse më pas, si pasojë e emigrimit dhe konfliktit u shkaktua rënie në përqindjen e meshkujve dhe raportin 50% me 50% m/f. Në Komunën e Deçanit ky raport vlerësohet të jetë po ashtu rreth 49.5% me 50.5% meshkuj 20.764 ndersa femra 20.085.

Gjithsej në Kosovë sipas ASK-së, 852.723 i përkasin gjinisë mashkullore dhe 832.386 banore të gjinisë femerore.

Struktura nacionale-

Nga aspekti etnik, Komuna e Deçanit kryesisht ka qenë e banuar me popullësi shqiptare derisa pjesëmarrja e pakicave ka qenë shumë ulët dhe në zvogëlim të vazhdueshëm. Sot popullësia e Deçanit, përbehet prej shqiptarëve me 99,6.% ndërsa pakicat marrin pjesë me rreth 0.4%

Koncepti i kontrollit të rritjes

Koncepti-shtimit natyror do të përshtatet me konceptin e rritjes-shtimit demografik në nivel të Planit Hapësinor të Kosovës –gjegjësisht me politikat e parapara shtetërore të Republikës së Kosovës.

Migrimi ndërkombëtar (i jashtëm)

Migrimi është sfidë pothuaj e të gjitha shteteve në mbulueshmërinë si dhe nxjerrjen e të dhënave statistikore reprezentative për migrimin ndërkombëtar ku, si çështje diskutohet në nivelet më të larta si ato shkencore, hulumtuese, profesionale po ashtu edhe ato politike. Kjo për faktin se vetë lëvizshmëria e njerëzve sot është shumë më e madhe se në të kaluarën, si dhe duke marrë parasysh se procesi i migrimit është proces dinamik, i ndryshueshëm në kohe, që prek shtresat e ndryshme të shoqërisë si dhe mjaft kompleks në aspektin e 2 . Për shkaqe të arsyeve të ndryshme të migrimit (kushteve më të mira ekonomike, arsimim, arsye politike, bashkim familjar, etj), Emigrimi i një personi nga vendi i mëparshëm rezident zakonisht nuk raportohet apo përcjellët me ç 'lajmërim tek institucionet kompetente nga vendi që largohet personi.

Viti 2015 vlerësohet të jetë një ndër vitet me së shumti emigrantë ndërkombëtar të regjistruar që ishin larguar nga Kosova. Ky emigrim, kishte përfshirë kryesisht grup moshat e reja, por, në një masë të caktuar edhe grup moshat e tjera (emigrim familjar). Në kontekstin etnik, më së shumti kishte prekur komunitetin shqiptar dhe atë rom, ashkali dhe egjiptian.

Numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2015, pa marrë parasysh statusin e qëndrimit (legal-illegal) apo qëllimin e emigrimit, është llogaritur të jetë 74,434 banorë, apo 4.2% e popullsisë rezidente në Kosovë. Numri i të kthyerve (imigrantëve kosovarë) gjatë vitit 2015 ishte 18,862 banorë¹.

Për shkak të shkallës së lartë të emigrimit, përkundër asaj që Kosova kishte regjistruar një shtim natyror prej 22,232 (2015), popullsia e Kosovës u zvogëlua për 33,340 banorë. Numri i popullsisë rezidente në Kosovë, me 1 janar 2016, është vlerësuar të jetë 1,771,604 banorë.

Tabela paraqet indikatorët demografik për periudhën 2011-2015

Indikatorët demografik	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Rritja / zvogël.	Mesatarja
							201 1-2015	
Popullsia	1,774,248	1,798,645	1,815,606	1,820,631	1,804,944	1,771,604	-27,041	-5,408
Nataliteti		34,101	27,650	29,723	32,087	31,116	154,677	30,935
Mortaliteti		7,622	7,287	8,317	8,165	8,884	40,275	8,055
Shtimi natyror		26,479	20,363	21,406	23,922	22,232	114,402	22,880
Shkalla e natalitetit		19.0	15.2	16.3	17.8	17.6	-1.4	17.2
Shkalla e mort.		4.2	4	4.6	4.5	5.0	0.8	4.5
Imigrimi		4,614	5,298	3,864	5,724	18,862	38,362	7,672
Emigrimi		6,695	8,700	20,246	45,333	74,434	155,408	31,082
Net migrimi		-2,081	-3,402	-16,382	-39,609	-55,572	-117,046	-23,409
Rritja absolute		24,398	16,961	5,024	-15,687	-33,340	-2,644	-529
Rritja në%		1.4	0.9	0.3	-0.9	-1.9	-2.0	-0.04
Urbane		38.3	38.6	38.9	39	38.9	0.6	38.7
Rurale		61.7	61.4	61.1	61.1	61.1	-0.6	61.3

¹ Agjencia e Statistikës së Kosovës " VLERËSIM: Popullsia e Kosovës 2015 Prishtine, Qershor 2016:
<http://ask.rksgov.net/sq/popullsia>

Lëvizja demografike

Migrimi fshat –qytet në koncept të banimit do të përshtatet me zbatueshmerinë e ruajtjes së tokës bujqësore dhe krijimin apo zgjerimin e vendbanimeve rreth bërthamës ekzistuese duke krijuar kushte pune dhe jetese të parapara me standarde konform jetës normale. □

Qëllimi i zhvillimit shoqëroro-ekonomik parasheh transformimin më të shpejtë dhe më dinamik në strukturën ekonomike dhe sociale të popullsisë. Në kushtet e zhvillimit të shpejtë ekonomik duhet pritur se dot përmirësohen kushtet jetësore dhe struktura kualifikuese si dhe ngritja e nivelit të arsimit do të ndikoj që popullësia të i pranoj format bashkohore të reproduksionit të faktorit demografik. Bazë për realizimin e këtij qëllimi është shtimi i investimeve në veprimtarit dhe degët të cilat sigurojnë inkuadrim të lartë dhe shtim të të ardhurave.

Nga kjo arsye është e nevojshme të studjohen problemet e dendësisë së popullsisë, shpërndarja hapësinore, ndryshimet që kanë të bëjnë me lëvizjen e numrit dhe të strukturës së popullsisë dhe të familjeve. Ashtu sikurse mungojnë të dhënat për fatin e vendbanimeve dhe banorëve të tyre në epokën antike dhe në mesjetën e hershme, mungojnë të dhënat për Komunën e Deçanit gjer kah mesi i shekullit XIV.

E kaluara historike, në trevën e Deçanit ka len vragët e veta në rrafshin e përgjithshëm të zhvillimit sidomos lufta e fundit e viteve 1998/ 99. e cila trevën e Deçanit e la të shkatërruar 90% si në infrastrukturë ashtu edhe në ekonomi. Megjithatë, shkollimi, zhvillimi kulturor dhe emancipimi kanë patur ndikim në rritjen e nivelit të zhvillimit të gjithëmbarshtëm.

Politika e kopulacionit duhet të anoj kah ndërrimet e më tejshme në të gjitha strukturat e popullsisë të cilat dot ushtrojnë ndikim në zhvillimin më të shpejtë ekonomik e social dhe në humanizmin e riprodhimit biologjik të popullsisë.


Politika e populacionit duhet të anoj kah zvogëlimi i mortalitetit që me kohë dot shpjer gjer të zbutja e konsideruar e problemeve demografike, sociale dhe ekonomike. Nevojitet të krijohen kushte që lëvizjet hapësinore të popullsisë së fshatrave të jen në pajtim me nevojat shoqërore dhe me mundësitë e sektorit bujqësor për të pranuar tepicën e popullsisë bujqësore nga fshati.

Qëllimi i zhvillimit shoqëroro-ekonomik parasheh transformimin më të shpejtë dhe më dinamik në strukturën ekonomike dhe sociale të popullsisë. Në kushtet e zhvillimit të shpejtë ekonomik duhet pritur se dot përmirësohen kushtet jetësore dhe struktura kualifikuese si dhe ngritja e nivelit të arsimit do të ndikoj që popullsia të i pranoj format bashkohore të reproduksionit të faktorit demografik. Bazë për realizimin e këtij qëllimi është shtimi i investimeve në veprimtarit dhe degët të cilat sigurojnë inkuadrim të lartë dhe shtim të të ardhurave si:

- Prodhimtaria e pemëve dhe perimeve,
- Blegtoria,
- Bletaria,
- Pylltaria,
- Zejtaria,
- Tregtia
- Turizmi etj

*Të dhënat janë marrë nga Enti i Statistikave të Kosovës

Ndarja administrative e komunës së Deçanit



PASQYRA DEMOGRAFIKE

Nr	Fshatrat sipas bashkësive lokale	Numri i banorëve	Gjatësia në km. dhe koha e kalimit në minuta.	Furnizimi më ujë			Ndërtesat e	Shkollat dhe foshnjoret			Ndërtesa publike	Pompa të benzinës
				Hidr ant	Lumen j	Puse		Shko lla	Fosh njore	Nr. i Nx.		
1	Deçan	3803	%	2	2	50	20	1+2	2	2340	14	3
2	Llukë e Epërm	1451	2.1 3.6	1		72				113	3	1
3	Belle	8	7.5/12.8			%				0	%	
4	Carrabreg i Ep.	1446	1.8 3.00	1		94					1	2
5	Carabreg i Ulët	2059	1.4 2.4			53						
6	Beleg	826	3.6 6.17	1		110		1	1	157	1	
7	Dranoc	1046	3.1 5.3			70		1	2	267	1	
8	Voksh	570	5.8 9.9			20		1			2	
9	Pobergj	1314	4 6.85			29		1		165	2	
10	Sllup	338	4.6 7.88			12						
11	Lloqan	499	1.6 2.74			15						
12	Hulaj	158	2.9 4.97			8						
13	Prejlep	2165	5.5 9.42			71		1	1	198	3	1
14	Rastovicë	1238	7.15 12.2			52		1	1	251	1	
15	Gramaqel	1097	12 20.5			63		1	2	288	1	
16	Baballog	1598	10.2 17.4			94		1		154	2	
17	Dubrav	278	11.9 20.4			31						
18	Shaptej	591	11.15 19.1			43						
19	Irzniq	1739	8 13.7			132		1	1	240	4	
20	Kodralli	808	5.5/9.4			41						
21	Prokulluk	288	7.9 13.5			30						
22	Glllogjan	984	9.9 16.9			91		1	1	275	2	1
23	Ratishë i epërm	210	9.9 16.9			30						
24	Ratishë i Ulët	560	11.7 20			23		1	1	111	2	
25	Lumbardh	717	5.5 9.42			100		1	1	115	2	1
26	Pozhar	424	4.5 7.71			54					1	
27	Llukë e Ulët	506	4.8 8.22			51				151		
28	Dashinoc	299	10.9 18.6			38						
29	Maznik	447	14.2 24.3			40		1	1	80	1	
30	Vranoc i Vogël	101	12 20.5			13						
31	Prapaqan	740	7.6 13.00			83		1	2	342	3	
32	Dubovik	1060	6.3 10.8			120		1			1	
33	Papiq	174	7.2 12.3			13						
34	Isniq	3871	2.5 4.28			131		1	2	511	4	1
35	Lëbushë	1145	2.6 4.45	1		61		1		30	2	
36	Strellc i Epërm	3347	4.4 7.54			98		1	1	380	3	1
37	Strellc i Ulët	2114	6 10.2			86		1		247	2	
Gjithsejt		40.019	320km 9.14h	5	2	2365	20	20	19	6415	85	11

NUMËRI I BANORËVE DHE EKONOMITË FAMILJARE NË KOMUNËN E DEÇANIT

Nr	Fshatrat sipas Bashkësive Lokale	Numri i banorëve	Ekonomi familjare
1	Baballoq	1.598	255
2	Beleg	826	130
3	Belle	8	2
4	Carrabreg i Epërm	1.446	205
5	Carrabreg i Ulët	2.059	302
6	Dashinoc	299	42
7	Deçan	3.803	602
8	Drenoc	1.046	169
9	Dubovik	1.060	141
10	Dubravë	278	43
11	Glllogjan	984	139
12	Gramaçel	1.097	160
	Hulaj	158	31
13	Isniq	3.871	578
14	Irnziq	1.739	241
15	Kodralli	808	136
16	Lëbushë	1.145	169
17	Lumbardh	717	115
18	Lloqan	499	91
19	Llukë e Epërme	1.451	189
20	Llukë e Ulët	506	74
21	Maznik	447	61
22	Papiq	174	25
23	Pobërgj	1.314	192
24	Pozhar	424	65
25	Prapaqan	740	109
26	Prekolluk	288	46
27	Prilep	2.165	293
28	Rastavicë	1.238	160
29	Ratish i Epërm	210	34
30	Ratish i Ulët	560	58
31	Sllup	338	44
32	Strellc i Epërm	3.347	506
33	Strellc i Ulët	2.114	305
34	Shaptej	591	80
35	Voksh	570	82
36	Vranoc i Vogël	101	13
Gj		40.019	5.887

(Këto statistika janë të marura nga ASK-ja të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 por gjendja reale e ekonomive familjare është me e lartë por si shifër është zyrtare)

1.2.4. Papunësia dhe shkalla e varfërisë:

Varfëria në Kosovë ende vazhdon të jetë një nder problemet kryesore. Në Kosovë norma kombëtare e varfërisë është e lidhur me papunësinë e lartë dhe prandaj nuk pritet të përmirësohet ndjeshëm gjatë periudhës 2015-2018 thuhet në raportin e fundit të Bankes Botërore.

Raporti vë në pah se papunësia mbetet e lartë për shkak se ritmi i krijimit të vendeve të punës pritet të absorbojë vetëm dy të tretat e punëkërkuësve të rinj.

Në tregun e punës në Kosovë, sipas të dhënave të zyrtare, çdo vit hyjnë 25 deri në 30 mijë të rinj, të cilët konsiderohen të afte për punë.

Sipas rezultateve të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë në vitin 2017 ishte rreth 30% , që krahasuar me vitin 2016 ka rritje për 4%

Vlera mesatare e varfërisë së përgjithshme në komunën e Deçanit është rreth 11.56 % .

Vlera maksimale e varfërisë sillet diku rreth 46 %.

Faktorët të cilët ndikojnë në rritjen e shkallës së varfërisë janë identifikuar më sa vijon :

- Shkalla e ultë e zhvillimit ekonomik
- Procesi I ngadalshëm I zhvillimit ekonomik
- Shkalla e lartë e papunësisë –

Metodologjia e përlogaritjes së përqindjes tek shkalla e varfërisë së popullsisë në nivel të gjithëmbarshtëm të Kosovës e poashtu edhe të komunës së Deçanit është bazuar në metodën e devijimit standard .

Sipas shënimeve që disponon Enti për Punësim në evidencë të papunë që kërkojnë punë si aktiv janë **4897** veta kurse kjo shifër në bazë të numrit të banorëve që ka kjo komune duhet me qenë edhe më e lartë.

Për çdo vit numri i të papunëve ndryshon për arsye të ndryshme si psh : Punesimi, emigrimi, vdekjet etj.

- Përqindja e të papunësuarve sipas strukturës nivelit të arsimimit dhe strukturës gjinore

Të papunësuar	Femra	Meshkuj	Gjithsej:
Të pakualifikuar	736	1109	1845
Gjysmë të kualifikuar	128	273	401
Të kualifikuar	122	434	556
Shkollë të mesme	449	1348	1797
Shkollë të lartë	21	33	54
Universitar	53	100	153
Sipas nivelit të arsimimit:			4806

Në Komunën e Deçanit jetojnë edhe pakicat minoritare me të drejta të barabarta shkollimi dhe punësimi

Të papunësuar	Boshnjak	Gjithsej	Ashkali	Gjithsej
Të pakualifikuar	F: 3 M: 2	5	F: 31 M: 46	77
Gjysmë të kualifikuar			M:2	2
Të kualifikuar	F:1 M:3	4		
Shkollë të mesme	F:1 M:2	3		
Shkollë të lartë				
Universitar				
Sipas nivelit të arsimimit:		12		79

Skema pensionale në Komunen e Deçanit

Në Komunen e Deçanit sipas viteve varion edhe përfitimi i ndihmave sociale sipas kategorive po ashtu edhe skemat pensionale dhe llojet e tyre. Të gjitha të dhënat janë të paraqitura në tabelen me poshte sipas kategorive që parashihen me ligj.

<u>Llojet e pensionit</u>	<u>Numri</u>
Pensionet bazike të moshës	3150
Pensionet kontribut pagues të moshës	645
Pensionet e përsoneve me aftësi të kufizuara	336
Skema për familjet me fëmije me aftësi të kufizuara (0-18 Vjeç)	48
Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës	510
Skema e pensioneve për veteranet e luftës	3611
Skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK)	43
Skema e pensioneve të Forcave të Sigurisë së Kosovës	7
Pensionet për minatorët e Trepçës	1
Skema e kompensimeve për përsoneat e verbër	19
Pensionet familjare	60
Pensionet paraplegjik dhe tetraplegjik	100

Vërejtje : Numri i përgjithshëm i pensioneve ndryshon nga muaji ne muaj për arsye te ndryshme si (vdekja, disa familje largohen nga skema sociale etj)

Të dhënat janë marre nga statistikat e mirëqenies sociale 2017 si dokument zyrtar
Si dhe një pjesë janë marre nga zyrtari i Administratës së pensioneve komunale Deçan

Në Deçan egziston edhe shtëpia e komuniteteve e cila trajton përsoneat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike. Në vitin 2018 kjo shtëpi kishte të vendosur 10 përsone ku 9 prej tyre janë të komuniteti shqiptar dhe 1 i përket komunitetit serb.

Në komunën e Deçanit, nga Asistenca Sociale mbrenda vitit 2018 kanë përfituar rreth 325 familje. Ndarja e asistencës sociale behet në dy kategori:

1. Kategoria e pare që janë me komision mjekësor dhe (160 familje)
2. Kategoria e dyte që janë me femije deri nën moshën 5 vjeqare (165 familje)

1.2.5. Shkalla e dendësisë: (226 banor/ km²)

Është bërë identifikimi i ngastrave dhe është digjitalizuar hapësira e banimit. Janë studiuar sipërfaqet tani të ndërhuara dhe analizohet mundësia për dendësisifikim.

Nga kjo analizë rezulton:

o Planifikimi i i destinimit të përzier

Inkurajimi i banimit, duke përfshirë banimin e volitshëm dhe duke e shëndërruar hapësirën mbi shitore në ndërtesa komerciale më kosto të lirë.

o Të bëhet konsolidimi i vëndëve për regjenerim.

Komuna e Deçanit veçohët më dendësi të ulët banimore e cila pas digjitalizimit sillet për afërsisht 60 banor në një hektar. Kjo kuot, dendësisifikimi, është në qendrën e qytetit dhe kryesisht në polet e koncentruara më banim, gjë që hap shtigjet për të krijuar mundësinë e plotësimit të zbrazëtirave urbane dhe rritjen e numrit të banorëve për hektar.

Format për dendësisifikim

Të rritët dendësia e banimit deri në 150 banor për hektar në sipërfaqet e koncentruara më popullësi.

Në zonat periferike të vendbanimeve të arrihet dendësi deri në 50 banor për hektar.

Realizimi i rritjes së dendësisë banimore do të bëhet më planifikimn e objekteve në etazha në zonën e parë të qytetit.

Ndarja e sipërfaqeve sipas shkallës së dendësisë:

D1..... 30 - 60 banor për hektar

D2..... 20 – 30 banor për hektar

D3..... 10 - 20 banor për hektar

D4..... 2 – 10 banor për hektar

Pas vitit 1999 e vitet ne vazhdim ekziston një rritje e grafikonit i migrimit i banorëve nga fshati në qendrën urbane te vetë Deçanit dhe ne qendrat tjera urbane te Kosovës.



Dendësia rurale

I.3. Të mirat ekonomike-materiale dhe të ambientit

3.1. Zonat dhe objektet industriale:

Pjesëmarrja e veprimtarive prodhuese dhe sherbyese në krahasim me veprimtarit tjera ekonomike është më e vogël, kështu biznesi me veprimtari tregtare ka treguar një pjesëmarrje më të madhe në biznesin privat.

Në vitin 2018 kemi 1834 biznese që janë të regjistruara në zyrën për regjistrim të bizneseve, 149 janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, 20 ortakë të përbashkëta, 2 shoqëri aksionare, 2 kompani të huaja, si dhe duhet cekur se 259 janë biznese me pronare femra.

Në komunën e Deçanit aktivitete biznesore ushtrojnë 330 biznese në qendrën urbane kurse 447 biznese në lokalitete tjera rurale.

Në bazë të dhënave mbi numrin e punëtorëve të punësuar në bizneset e regjistruara në Komunën e Deçanit e të prezantuara në pasqyra statistikore mbi regjistrimin e bizneseve shihet se në komunën e Deçanit gjithsej të punësuar janë 3500 punetore.

Në sektorin shoqëror janë të regjistruara 25 ndermarje të cilat para futjes së masave të dhunëshme nga sistemi I kaluar, kanë patur një trend të lartë të zhvillimit ekonomik e sidomos :

- Industria e drurit,
- Industria metalike,
- Industria ushqimore dhe
- Turizmi

Gjendja e tanishme në këto ndermarje është mjaftë e rëndë nga fakti se pos dëmtimeve dhe plaqkitjeve që kanë pësuar nga lufta ka ndikuar edhe kompetencat e AKM – es në menaxhimin e këtyre pronave.

Industria metalike ka patur këto ndermarje:

- Fabrika e autopjesëve “Ramiz Sadiku”
- Fabrika e Pompave me piston
- Fabrika e rrjetit të armiruar. (Të Privatizuara)

Industria e përpunimit të drurit:

- Kompleksi përpunimit të drurit “Gjeravica”
- Fabrika e mobiljeve massive (Të Privatizuara)

Industria ushqimore:

- Fabrika e përpunimit të mjaltit “Apiko”
- Kopërativat bujqësore. (Të Privatizuara)

Në Komunën e Deçanit funksionojnë tri ndërmarrje shoqërore publike:

- Kompania e Pastrimit “Higjiena”
- “Ujesjellesi”
- “Drini i Bardhe”

Gjithashtu në Deçan veprojnë organizata të ndryshme joqeveritare të cilat meren me fusha dhe aktivitete të ndryshme si: OJQ “Jeta”, OJQ “Shoqata e Intelektualeve të Pavarur”, OJQ “Deçani Eco City”, OJQ “Pema”, OJQ “Agimi”, OJQ “Bjeshka”, OJQ “Bletarëve”, OJQ “Pastrimi Rural”, OJQ “Besimi”, etj.

3.2 Resurset kryesore ekonomike

Komuna e Deçanit ka këto pasuri natyrore-rezerva:

- Mermeri
- Guri gëlqeror
- Uji mineral
- Pyjet (gjethoret-gështenja) dhe haloret
- Lumenjtë –për ujitjen e tokave
- Hidrocentrali-Kozhnjer-“Lumëbardhi”
- Tokat bujqësore
- Frutat pyjore
- Burimet e ujit për pije
- Drurit
- Zejtaria dhe artizanatet e ndryshme

Komuna e Deçanit ka një pozitë të përshtatshme gjeografike, kushte të volitshme klimatike, florë dhe faunë të pasur, sasi të shumta burimesh të ujit, pasuri dhe bukuri natyrore që nënkupton se posedon të gjitha parakushtet për një zhvillimin të gjithmbarshëm në fusha të ndryshme e veçanërisht të:

Turizmi

Turizmi është ndër veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne. Në vendet e zhvilluara, por edhe në ato në transicion, është produkt i rëndësishëm eksporti dhe gjenerator i punësimit. Përfshin një gërshetim të gjerë dukurish dhe raportesh që lindin gjatë kohës së udhëtimit turistik, ndërsa për zhvillimin e tij ndikojnë faktorët jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në aspektin ekologjik, social dhe kulturor të jetës. Resursi strategjik i turizmit kosovar është hapësira me shumë vlera, deri tani të ruajtura, që në afat të gjatë gjithnjë e më shumë do të ketë rëndësi.

Pozita gjeografike, klima, malet, grykat, flora dhe fauna, trashëgimia natyrore dhe kulturore janë elemente bazë që Deçanin e bëjnë destinacion turistik për turistët e vendit dhe të huaj.

Një nder degët më të rëndësishme dhe më me perspektivë e ekonomisë së komunes së Deçanit është turizmi, duke ju falenderuar bukurive të rralla që dhurojnë Bjeshket e Nemura, në të cilat egzistojnë kushte shumë të volitshme për zhvillimin e turizmit.

Perspektiva zhvillimore e komunës së Deçanit është e përqendruar në këtë segment.

Resurset natyrore të Bjeshkëve të Nemuna si:

- ⇒ Konfiguracioni i reliefit,
- ⇒ Kushtet klimatike-hidrografike,
- ⇒ Sasia e reshjeve të mëdha të borës,
- ⇒ Qëndrimi i gjatë i borës,
- ⇒ Karakteristikat e veçanta të florës dhe faunës

japin mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e aktiviteteve të lloj-llojshme turistike dhe rekreative të cilat mundë të zhvillohen në tri forma:

1. stacionar,
2. vikend-shetitje dhe
3. transit.

Lartësia mbidetare (2656 m.) e Bjeshkëve të Nemuna ofron kushte të përshtatshme për zhvillimin e turizmit sezonal dimëror dhe turizmit sezonal veror. Turizmi dimëror zënë një vend të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit në komunën e Deçanit duke ju referuar tereneve shumë të përshtatshme natyrore, hapësinore e klimatike për zhvillimin e skitarisë profesionale dhe të asaj masive në Bjeshkën e Belegut dhe në Bjeshkët e Vokshit (Kurvallë).

Sipas një studimi hulumtues për terene sportive, të berë në Bjeshken e Belegut dhe në Bjeshkët e Vokshit, kanë sipërfaqe prej 31500 m² prej 30000 skitares.

Projekti i hartuar “Bjeshka e Belegut” si zonë turistike, rekreative-sportive për sporte dimërore duhet të realizohet me arsyeshmerin se prezantohen vlerat:

- ⇒ ekologjike,

- ⇒ shkencore,
- ⇒ edukative-arsimore,
- ⇒ turistike,
- ⇒ sportive

me interes të gjerë shoqërorë jo vetëm për komunën e Deçanit dhe regjionin por me vlera të larta ndërkombëtare. Duke bërë sensibilizimin e vlerave turistike do të bëhet tërheqja e investitorëve për investime në sektorin e turizmit.

Në kontekst të zhvillimit të turizmit duhet të përmendim:

- pushimoren e fëmijve “Pishat e Deçanit”si e vetmja qender relaksuese dhe rehabilituese e fëmijëve në Kosovë.
- Kompleksi i hoteleve të vjetra me villat përcjellëse,
- Kompleksi i hoteleve të reja të cilat nuk janë venë në shfrytëzim për shkak të vjedhjeve të dhunëshme nga pushtuesi ,
- Bjeshkët e Belegut ofrojnë kushte të shkëlqyshme për turizem sezonal. Për zhvillimin e turizmit në këto bjeshkë egziston Projekti i ndertimit të stazave të skijimit.



Pamje nga Terene për sporte dimërore (bje. e Belegut)

(Me 10 Mars 2018 është mbajtur gara e skijimit “Kupa e Gjeravices 2018” ku njëherit është bërë edhe promovimi i turizmit në bjeshkët e Belegut)

- skijimit dhe objekteve përcjellëse që do të jetë atraksion i vetetë i sporteve dimërore për Deçanin dhe Kosoven në përgjithësi.
- Atraksion i vetetë do të jetë për zhvillimin e sporteve dimërore edhe Bjeshka e Vokshit, gjegjësisht kompleksi i Dervishkomit me Gjeravicen dhe Liqejt e saj. Dervishkomi paraqet vend shumë të përshtatëshem për skijim të fëmijve dhe zhvillimin e skijimit amator gjegjësisht atij masiv. Kurse Gjeravica, me lartësi mbi detare 2565m. do të ishte atraktive për dashamirët e alpinizmit.
- Ndersa Liqejt e Gjeravices do të jenë përll e vetetë për dashamirët e bukurive natyrore.
- “Gushavci”, gjegjësisht Burimi i ujit të thartë është parakusht shumë i përshtatëshem për ngritje të një kompleksi hotelesh për pushim dhe rekreacion. Gjithashtu “Gushavci” mundë të shfrytëzohet për ngritjen e kapaciteteve për përpunimin e ujit mineral i cili nga testimi ka dalë me kualitet mjaftë të lartë.

Këto janë vetëm disa prej parakushteve, që shfrytëzimi i tyre do të i jepte impuls të madhë zhvillimit të gjithë mbarshëm të ekonomisë së Komunes së Deçanit dhe mirëqenjes sociale të popullatës së saj e ndalimin e migrimit të rinjëve në botën jashtme.

Shpresë dhenëse është se për këte lami ekonomike interesimi i biznismenëve është i madhë.

Nder prioritetet strategjike të zhvillimit të turizmit janë:

- ✓ Lirimi i pronave të uzurpuara, Kompleksi i hoteleve të Pishat e Deçanit
- ✓ Lirimi i Pushimores së fëmijve nga KFOR- I Italian
- ✓ Ngritja e objekteve hoteliere- turistike
- ✓ Ndertimi i një fshati turistik
- ✓ Ndertimi i qendrave të skijimit
- ✓ Ndertimi i segmentit rrugor Deçan – Plavë etj.



Liçeni i Pllaqicës Vokshit (liçeni i Zembrës)



Liçeni i Madh i Gjeravicës

Në ato bjeshkë ekziston një numër i madh i liçeneve me origjinë glaciale të njohur në gjuhën popullore si “sytë e maleve”, një llojlojshmëri biologjike me gjithë larmin e organizmave të gjallë, flora dhe vegjetacioni, me masivin malorë të mbi 1000 llojeve, gjerë më tani të hulumtuara. Ekziston një mozaik i ndërlikuar dhe kompleks i bashkësive bimore në hapësira të cilat ndryshohen pak a shumë në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me ndryshimet e kushteve të ambientit, klimës, mezo dhe mikro klimës, reliefit, përbërjes gjeologjike, përbërjes pedologjike, si dhe kushteve hidrologjike. Të gjitha këto bukuri janë të shtrira në pjesën e ulët malore, të mesëm dhe në pjesën e lartë malore. Pastaj karakterizohet me llojlojshmëri të faunës, të gjitarëve dhe të shpendëve që janë mjaft të rralla në Ballkan, si luqerbullit, ariut të murrmë, kaprollit, dhia e egër, shqiponja e maleve, fajkoi thonjëbardhë, pulë të egra, etj.

Maje me lartësi mbidetare mbi 1000 nmd në Komunën e Deçanit

Gjeravica 2656

Maja e Marjashit 2533

Maja e Rupës 2501

Maja e Strelcit 2377

Dervishkambi 2200

Bjeshka e Dobroshit; 1800

Bjeshka e Belegut 1900

Bjeshka e Kurvallës 1750

Bjeshka e Prelepit 1682

Bjeshka e Milishevcit 1800

Bjeshka e Roshkodolit 1600

Rrasa e Zogut 2305

Jedova 1640

Kunora 1694

Pllaqica e Vokshit 1900

Bjeshka e Madhe 1800

Bjeshka e Budoshit 1500

Bjeshka e Lumëbardhit 2105



Panoramë e Bjeshkëve të Nemuna

3.4. Kapacitetet e furnizimit me ushqim:

3.4.1. Sipërfaqet e punueshme bujqësore:

Në zonat rurale jetojnë rreth 74.19% e popullsisë së tërësishme të komunës .
Bujqësia është veprimtari kyç në këtë trevë nga e cila sigurojnë të ardhura mbi 65% të banorëve të komunës së Deçanit .

Ekzistojnë kushte specifike që e favorizojnë bujqësinë e Deçanit dhe prodhimin e rendimenteve të kualitetit të lartë.

Prodhimtaria bujqësore është orientuar në: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtorale, shpendari, bletari dhe peshkatari.

Punonjësit që merren me veprimtari bujqësore në shkallën më të madhe janë me arsim të mesëm, por të kualifikimeve të ndryshme. Në zhvillimin e bujqësisë kontribuojnë edhe ekspërtët dhe teknikët e bujqësisë, ku në këtë komunë janë mbi 45 agronom të diplomuar dhe afër 200 teknik të bujqësisë të cilët ndihmojnë me këshilla profesionale dhe punë të drejtpërdrejtë.

Nevojitet riaktivizimi i kooperativave ekzistuese në bazë të procesit të ri mbi organizimin e kooperativave, ngritja e serave për përimekultura, plantacioneve (për dredhëza, lajthi mjedra, kumbulla, molla), ngritja e minifermave (qumështore, për viça për majmëri, për mështjerra për rreproduksion, të deleve), ngritja e fermave të pulave, ngritja e parkut të bletëve për sezonin e gështenjës, hullive të peshkut etj.

Kultivimi i kulturave bujqësore

Bujqësia si degë e ekonomisë është bazë e zhvillimit të ekonomisë së Deçanit. Ekzistojn kushte specifike të cilat favorizojn bujqësin e kësaj Komune për prodhimin e rendimenteve bujqësore të kualitetit të lart të tyre.

Prodhimtaria bujqësore është e orjentuar në:

- Prodhimtarin bimore,
- Prodhimtarin blegtorale,
- Shpendtari dhe
- Bletari

Projektet prioritare në strategjin e zhvillimit ekonomik nga lëmi I bujqësisë dhe blegtorisë në Komunen e Deçanit janë:

- Riaktivizimi I kooperativave bujqësore në bazë të procesit të ri të organizimit të kooperativave
- Ngritja e serave për përime kultura,
- Ngritja e plantacioneve: me dredhza, manaferra, lajthi, mjedra, kumbulla, molla etj.
- Ngritja e minifermave qumështore, viçave për majmëri, mështjerrave për rreproduksion, të deleve etj.
- Ngritja e fermave për pula dhe brojler
- Ngritja e parkut të bletaris etj.

1. Sipërfaqet bujqësore dhe kualiteti I tyre:

Në Komunen e Deçanit, tokë bujqësore ka 8940.4 ha, e cila sipërfaqe në bazë të kualitetit të tokës shprehur në përqindje është:


- Tokë e mire – klasa I, II, III, ----- 60 %
- Tokë e mesme – klasa IV ----- 25 %
- Tokë e varfer – klasa V, VI ----- 15 %
- Tokë në pronësin private janë 7980 ha.
- Tokë në pronësin shoqërore janë 960 ha.
- Numri I popullësisë që jeton në hapsirat rurale është rreth 90 %,
- Mosha e popullësis punuese që jeton në viset rurale është 18 – 60 vjeq.
- Nga bujqësia sigurojnë të ardhura mbi 65 % e banorëve të Komunes,
- Kontribut japin në shtimin e prodhimtaris bujqësore edhe ekspërtet dhe tekniket e bujqësisë.

Kultivimi i kulturave bujqësore:

- Sipërfaqe me kultura bujqësore janë 8940.4 ha.
- Tokë e lërueshme është 51,2 % ose 5916 ha.
- Kulturat kryesore janë: misri, gruri, pemet dhe përimet.
- Në prodhimtari dominojnë: misri dhe përime kultura.

Prodhimi vjetor I kulturave lavertare sipas viteve është si në tabelë:

Krahasimi ne Sip/ha te aplikueseve ne vitin 2015-16-17




2.Blegtoria:

Në komunën e Deçanit dominojnë kullosat natyrale me 7.200 ha. Blegtoria si degë mjaft e rëndësishme e bujqësisë sonë është nën sektor shumë i rëndësishëm që në vazhdimësi po japë rezultate të mira në bujqësi gjysme komerciale të komunës sonë. Në bjeshkë ka kullosa të gjëra ku gjenden terrenet më të gjata të skijimit në territorin e Evropës,të lidhura ndërmjet veti me ndihmën e platove (podiumeve).

Blegtoria e komunës së Deçanit ka pësuar dëme shumë të mëdha nga lufta e fundit, dëmet janë rreth 70 % në dëmtimin e infrastrukturës – stallave dhe në numrin e kafshëve shtëpiake (gjedhe, dele, kuaj etj).

Po japim një tabelë si pasqyrë të strukturës së fermave kryesore- gjendja e tanishme. Fondi blegtoral dhe struktura blegtorale është si në tabelën vijuese.



Para kushtet janë shumë të favorshme për një blegtori intensive dhe me perspektiv të gjatë të zhvillimit. Ketë e mundësojnë resurset e mëdha natyrore që disponon komuna e Deçanit. Sipërfaqe e mirë me kullosa natyrale (mbi 7,000.00 ha), tokë punuese prej 8940.4 ha dhe resurse ujore në të gjithë territorin e saj.



Kafshet shtëpiake pas lufte kanë qenë në numër të vogël por, numri i tyre është prej viti në vit gjithënjë në rritje. (shiqo tabelen)

Kategoria e fermave:

	Ekzistenciale		Të mesme		Komerciale	
Gjedhe	- 4	60 %	5-9	38 %	> 10	2 %
Dele	- 40	20 %	40-80	60 %	> 80	20 %
Pula	- 10	80 %	-----		> 1000	20 %

Lista e aplikueseve te fermerve për subvencione viti 2018– Deçan

Kultura ose lloji i kafsheve	Nr i aplikueseve	Sip/ha krerë,copë	Shuma e subvencinit	Shuma totale
Grurë	79	282.41	150/ha	40,678 €
Miser	280	818	150/ha	108,043 €
Lopë Qumshtorë	319	2673	70/krerë	189,980 €
Bletë	76	5529	15/koshere	75,210 €
Mollë	44	43.9	400/ha	17,020 €
Kumbullë	5	3.14	400/ha	1,336 €
Arrë	12	15.39	400/ha	4,900 €
Vreshta	2	5.99	1000/ (0.10-100 ha)	2000 €
Mjeder	5	2.7	400/ha	1,344 €
Patate	5	3.46	300/ha	1,551 €
Laker	5	2.41	300/ha	648 €
Shalqinje	1	0.20	300/ha	60 €
Spec	16	4.44	300/ha	2,571 €
Qepë	7	1.58	300/ha	489 €
Elb	1	1.51	100/ha	136 €
Theker	10	44.71	100/ha	3,986 €
Fasul	13	10.43	300/ha	1,980 €
Kunguj	4	133.09	300/ha	1,032 €
Pula	1	5000	0.50/pulë vojse	2,465 €
Dhi	4	228	15/krerë	4,650 €
Dele	23	2296	15/krerë	33,495 €
Boronicë		2.88		
Lajthi		1.27		
M.Fidane		34000		
Gjithsejt:	607			493,574 €

- Kryesisht kemi rritje të lopëve qumshstore.
- Delet janë në rritje jo të kënaqëshme dhe në këte ka ndikuar mos importimi racave kualitative i deleve.
- Përpunimi i produkteve blegtorale në Komunën tonë bëhet në ekonomit familjare me metoda të vjetra, meqenëse nuk kemi fabrikë për përpunimin e këtyre produkteve.
- Numri i shoqërive të bletëve është në rritje dhe dukshme në të cilën ka ndikuar dhenja e donacioneve për shtimin e shoqërive të bletëve.
- Plasimi në treg bëhet në mënyrë individuale pa ndonjë organizim të veçantë.
- Nevojat e Komunës plotësohen me produkte blegtorale afër 60 %

Pemëtaria:

Sipërfaqet me pemishtet në komunën e Deçanit janë gjithnjë e me shume në rritje, sidomos në sektorin privat. Vitin 2017 në komunën e Deçanit janë mbjellur 61.5 ha pemishte të reja intensive me projekt elaborate si dhe numër i madh i trupave të pemëve në ekonomitë familjare dhe afër 10 ha me peme të imta (plantazhe të vogla me dredhëz).

Deçani si regjion pemëtarë ka temperatura mesatare gjate vegetacionit (IV-X) prej 16.3° C me 450 mm shi, ka nevojë për ujitje plotësuese artificiale prej 200-400 mm/m² shi.



5. Bletaria :

Regjioni i Deçanit ka kushte të mira natyrore për zhvillimin e bletarisë duke pasur parasysh faktin se është territor ekologjik edhe më një multi-florë mjaltëdhënëse prej nga rezultojnë edhe prodhimet e bletës shumë cilësore. Për kundër pasojave të mëdha nga lufta dhe gjendjes së dobët ekonomike, ky sektor ka arritur të mbijetojë dhe të prezantohet në nivele vendore dhe ndërkombëtare. Edhe bletaria si pjesë integrale e bujqësisë i ka bregat e veta që meritojnë një trajtim të veçantë duke pasur parasysh që pemëtaria edhe përimekultura janë shumë të varura nga bletaria. Pos kësaj dihet se aty ku grumbullohen dhe konsumohen prodhimet e bletës ka mirëqenie shëndetësore dhe sociale. Duke pasur parasysh synimet tona për integrim në bashkësinë evropiane atëherë edhe bletaria me prodhimet e veta duhet të përgjigjen standardeve adekuate. Për të arritur kjo kërkohet një angazhim i ekspertëve dhe avancim teknologjik i pajisjeve që përdoren në bletari, kur dihet se paralufte Deçani ka disponuar më një stacion modern të bletarisë, por paslufte është marrë nga manastiri i Deçanit. Duke ditur rëndësinë e bletarisë është e domosdoshme që në strategjinë komunale për zhvillimin e bujqësisë të zë një vend me rëndësi edhe bletaria ku dihet se në Komunën e Deçanit momentalisht gjinden afër 5600 koshere me bletë.



3.3.2. Zonat e prodhimit bujqësor:

Zonat për prodhim bujqësor janë të identifikuar kryesisht në viset rurale, ku shumica e familjeve kanë sipërfaqe të pamjaftueshme të tokës dhe të ndarë në disa parcela, gjë që pamundëson zbatimin teknologjisë bashkëkohore në prodhimtarinë bujqësore. Edhe në këto parcela kanë filluar të ndërtohen shtëpi banimi, objekte tjera përcjellëse, pompa dhe rezervuarë për karburante, gjë që në një masë e zvogëlon edhe më shumë sipërfaqen e tokës bujqësore.

Në Komunën e Deçanit, tokë bujqësore ka 8940 ha, e cila sipërfaqe në bazë të kualitetit të tokës shprehet në përqindje është:

- Tokë e mire – klasa I, II, III, ----- 60 %
- Tokë e mesme – klasa IV ----- 25 %
- Tokë e varfer – klasa V, VI ----- 15 %
- Tokë në pronësin private janë 7980 ha.
- Tokë në pronësin shoqërore janë 960 ha.
- Numri I popullësisë që jeton në hapsirat rurale është rreth 90 %,
- Moshë e popullësisë punuese që jeton në viset rurale është 18 – 60 vjeq.
- Nga bujqësia sigurojnë të ardhura mbi 65 % e banorve të Komunës,
- Kontribut japin në shtimin e prodhimtarisë bujqësore edhe ekspërtet dhe tekniket e bujqësisë.

Në territorin e komunës veçojmë këto Zona të Prodhimit Bujqësor:

- ⇒ Strelc: Shurdenet, Bohriqet.
- ⇒ Isniq : Nënë Drum. Luginat, Kodrat, Peshutat etj.
- ⇒ Prapaqan: Fusha e Thatë.
- ⇒ Lumbardh: Livadhet e Mëdha.
- ⇒ Irzniq: Pemishta.
- ⇒ Carrabreg: Livadhet e Gata, Gerdajat.
- ⇒ Prejlep: Rrepishtat, Plugishtat.
- ⇒ Gramaqel: Shavaret.
- ⇒ Lloqan: Qesta.
- ⇒ Drenoc: Malijet e Drenocit.
- ⇒ Baballoq: Devollet

3.3.3.Sistemet hidroteknike:

Lumejt më të mëdhenjë që burojnë në teritorin e Komunës së

Deçanit janë:

3. Lumi i Deçanit,
4. Lumi i Lloqanit dhe

Gjithashtu, teritorin e Komunës së Deçanit e përshkojnë edhe një numër i konsiderueshem i projekteve dhe proçekave si:

- a) Duraku i Strelcit,
- b) Prroni i Behovcit,
- c) Prrojet e Vokshit,
- d) Prroni i Glllogjanit,
- e) Prroni i Lëbushës,
- f) Prroni i Durakut,
- g) Prroni i Ratishit etj.

Në rrjedhën e këtyre lumenjve janë ndërtuar për ujitje katër (4) kanale të betonuara:

- kanali derivues i liqenit artificial të Radoniqit.,
- kanali ujitës Deçan – Lumbardh,
- kanali ujitës Hulaj – Lloqan
- kanali ujitës Deçan – Drenoc
- kanali ujitës Prapaqan
- kanali ujitës Isniq-Lëbushë-Strellc
- kanali ujitës Hulaj- Dranoc
- kanali ujitës Prokolluk- Glllogjan
- kanali ujitës Pobergj- Polana

Dy Penda ujë ndarëse:

- penda të Verrat e Llukës dhe
- penda të Llugat e Deçanit (poshtë Manastirit) dhe pjesërisht i rregulluar shtrati i Lumit të Loqanit në fshatin Prejlep në gjatësi 1600 m.

Me qëllim të pengimit të proceseve erozive në disa shtretër të projekteve të teritorit të komunës janë ndërtuar:

Penda erozive:

në shtretërit e këtyre lumenjve dhe projekteve:

- ▶ Prroni i Lëbushës – nje objekt (pendë), e cila është e ndërtuar për pengimin e vërshimit të aksit rrugor Deçan-Pejë në lokacionin e fshatit Lëbushë.
- ▶ Prroni Behovcit – mbi të cilin është ndërtuar një pendë dhe muri mbrojtës në krahun e majtë të prronit me qëllim të pengimit të vërshimit të Lagjes Hajrizaj në Strellc të Ep. dhe në shtratin e
- ▶ Prronit të Durakit, përgjatë rredhës së tij, janë të ndërtuara 8 penda: të cilat janë ndërtuar me qëllim të pengimit të erozionit të shtratit dhe brigjeve të këtij prroni dhe pengimin e vërshimit të aksit rrugor Deçan-Pejë, gjegjësisht distancën rrugore Strellc i Ep. – Lybeniq (teposhtëza e Strelcit)
- ▶ Në shtratin e lumit të Lloqanit afër fshatit Hulaj dhe nje ne fshatin Lloqan.

3.3.4. Objektet e kultivimit të shtazëve dhe përpunimit të mishit:

Komuna e Deçanit karakterizohet me prodhim shtazor të bollshem dhe cilsor si dhe me kullosa sipërfaqesh të mëdha që janë parakusht primar për ushqimin e kafshëve dhe mbajtjen e rritjen e tyre. Kjo ka bërë të mundëshme që në decenjen e fundit kultivimi i shtazëve në Komunën e Deçanit të jetë në masë të madhe, gjë që ka bërë që jo vetëm të plotësohen nevojat familjare me produkte me preardhje shtazore, por që të ketë këso prodhimesh edhe për treg, gjegjësisht për prodhim komercial.

Në Komunën e Deçanit në vitin 2016 në Llukë të Epërme është bërë përpunimi i fabrikes së përpunimit të mishit "Vëllëzërit Neziraj".

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sot kemi këtë pasqyr të kultivimit të shtazëve në Komunën e Deçanit:

Nr.	Kategoria e fermave	Nr. i fermave	Njësija në copë/ krer	Lokacioni	Vërejtje
1.	Ferma të lopëve	311	2673	Isniq Irnqiq Glllogjan Pozhar Deçan Dubovikë Beleg Vranoc Gramaqel Baballog Maznikë Drenoc	- Qumshstore - Reprodukim
2.	Ferma të deleve	23	2296	- Strellc i Ep. - Strellc i Ult - Shaptej - Prejle - Dashinoc - Maznikë - Lumbardh	- Reprodukim
	Ferma të dhive	2	288	- Deçan - Beleg - Isniq - Drenoc - Rostovicë - Dubovikë	
3.	Ferma të pulave	2	5.000	- Strellc i Ulet - Strellc i Ulet	-Vojce - e rritjes se zogjve

3.3.5. Fabrikat për prodhimin e ushqimit:

Fabrika për prodhimin e ushqimit, në Komunën e Deçanit, nuk ka.
Janë 10 furra te cilat meren me bukëpjekje dhe prodhime tjera nga brumi

Nr	Emertimi i veprimtarisë	Kapaciteti i prodhimit në kushte normale/24 ^h	Kpacificiteti i prodhimit në kushte emergjente/24 ^h	Vërejtje
1	NTP "EUROPA" Deçan	300	1500	
2	NTP "PASHTRIKU 2" Deçan	200	1000	
3	NTP "EGZONI" Deçan	400	2500	
4	NTP "RINIA" Deçan	300	3000	
5	NTP "ERMIRA" Deçan	300	1500	
6	NTP "STRELLCI" Str.i Epërm	200	1000	
7	NTP "ISNIQI" Isniq	200	1500	
8	NTP "BESJANA" Irzniq	200	500	
9	NTP "TE BREJA" Prilep	200	1000	
10	NTP "OREKSI" Deçan	150	1000	
	<u>Gjithsej:</u>	<u>2450</u>	<u>14500</u>	

3.3.6. Depot për deponimin e artikujve ushqimor:

Në komunën e Deçanit, deponi për deponimin e ushqimit gjegjësisht të artikujve ushqimor të konsumit të gjerë në pronësi shoqërore nuk ka.
Deponit e tilla gjenden vetëm në sektorin privat të supermarketeve të cilat meren me tregtimin e artikujve ushqimor të konsumit të gjerë.

Nr.	Emertimi i Supermarketit	Depoja - kapaciteti	Frigoriferi - kapaciteti	Vërejtje
1	"BANANA"			nuk bashkëpu.
2	"TROPICAL"	150m ² (10 t.)	3X1000=3000/ l.	
3	"ETC"			nuk bashkëpu.
4	"Liridoni"			nuk bashkëpu.
5.	"Viva Fresh"			

3.3.7. Sipërfaqet e pyjeve dhe parqet natyrore dhe nacionale:

Me Kushtetuten e Kosoves garantohet e drejta e e njeriut për shfrytëzimin e ambientit dhe parashtrihen detyrat dhe obligimet e njerëzve punonjës dhe qytetarëve , bashkësive shoqërore – politike dhe organizatave punuese që të organizojnë kushte për mbrojtje dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe atyre të krijuara me punë të ambient të njeriut.

Hapat e pare të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë fillojnë në fillim të viteve 70-ta. Në vitin 1974 fillon të veproj i pa mvarun *Enti për mbrojtjen e natyrës së Kosovës*, Pas lufte UNMIK-u në Kosovë ka vepruar në bazë të rregullores 1999/1me të cilën i gjith pushteti legjislativ dhe ekzekutiv i mvishet UNMIK-ut.

Sot këto kompetenca i ka Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosoves (AMMK) institucion qeveritarë i cili angazhohet që përmes monitorimit të integruar të mjedisit, sistemit efikas të informimit mjedisorë dhe raportimit të vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit, të ruajë kualitetin e ajrin, ujit, tokës dhe biodiversitetit, të promovojë shfrytëzimin e burimeve të ripërtrishme të

energjisë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore me qëllim që të sigurojë një mjedis të shëndetshëm për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme në harmoni me progresin e zhvillimeve ekonomike dhe sociale.

Mbrojtja e ambientit nuk është vetëm çështje ekologjike dhe teknologjike, por më e gjerë – shoqërore madje edhe politike. Meqë ambienti është pjesë integrale e zhvillimit shtrohet nevoja që ai të planifikohet e jo vetëm të evidentohen pasojat.

Çështjet e ambientit natyror mund të përmbliken në dy grupe çështjesh:

- a. **Ekologjike**, respektivisht ruajtjen e baraspeshës natyrore, bimore dhe shtazore me kushte më të favorshme të ambientit të caktuar.
- b. **Ambientit të njeriut**, respektivisht pengimin dhe menjanimin e të gjitha disfavoritëve të ambientit të caktuar në të cilin jeton.

Ambienti Natyror:

Rrafshit të Dukagjinit e në gjirin e tij, teritorit të Komunës së Deçanit, natyra si e rrallë herë i ka dhuruar bukuritë natyrore.

Relievi i lloj-llojshëm dhe larmëria gjeografike që nga ultësirat e deri në masivet e larta të Bjeshkëve të Nemura e prerë me luginat e lumejve: Lumbardhit të Deçanit, Lloqanit dhe Erenikut, pikërisht një natyrë e tillë imponon dhe obligon që mbrojtjes së saj të i çasemi me seriozitet.

Disa pjesë të kufizuar hapsinore janë të mbrojtura, ndërkaq duhet të mbrohen (sipas ligjit të aplikushëm mbi mbrojtjen e natyres)

Munges e mbrojtjes së ambientit për shumë vite dhe në munges të Planit gjeneral urbanistik, pasojat e luftes, infrastruktura, numri i automjeteve, shkatrimet e shtëpive, ndertimet e pa kontrolluara, planifikimet jo adekuate urbanistike, mungesa e deponimit të hekurishtave, mungesa e kanalizimit të ujrave të zeza, prerjet e pa kontrolluara të pyjeve etj. Paraqesin burimin kryesor të problemeve të grumbulluara që kanë të bëjnë me situatën e mjedisit në Komunën e Deçanit.

Ndotja e mjedisit dhe pasojat për shendet: Njerzit e pa kujdesëshem, me vetëdije apo pa të me veprimet e veta kanë rrezikuar gjatë vitit 2017 seriozisht shëndetin e fëmijëve dhe të rriturve në këtë Komunë. Nga statistika e mare në Shtëpinë e Shëndetit “Adem Ukëhaxhaj” në Deçan rezulton se ndihmë shëndetsore kanë kërkuar 289 pacient nga smundja e Pneumonisë, Diarrea 2300, Pharig.ac.7123, Helmintiaza 253, Influeza 1906 etj.

Në Komunë vepron Ndermarja publike “Higjiena” e cila është aktive në ngrumbullimin e mbeturinave, transportimin e tyre dhe mirëmbajtjen e hapsirave publike me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së ambientit.

Ndotja e ajrit: Në ndotjen e ajrit në Komunën e Deçanit ndikojnë gazrat e lëshuara nga automjetet që sipas një statistike janë rreth 8000, veprimtaritë e bizneseve private, ndezja e mbeturinave etj. Në kuadrin të Komunes nuk vepron asnjë ndermarje industriale me përjashtim të Ndermarjes industriale “Metaliku” e cila operon me një kapacitet të vogël.

Ndotja e ujit: Për Komunën në tersi e për qendrën në veqanti, problem paraqet mungesa e rrjetit të kanalizimit që për pasojë ka derdhjen e ujrave të zeza në kanalet e ujitjes, në lumej si Lumin e Deçanit, Lloqanit, Erenik, prroje ose në gropa septike të cilat nuk janë të ndertuara sipas kriterëve standardë e që paraqet rrezik për ndotjen e puseve, uji i të cilëve përdoret për pije.

Ndotja e tokës dhe degradimet e saj: Ndotja e tokës bëhet jo vetëm nga derdhja e ujrave të ndotura të pa pastruara dhe nga kimikatet, por edhe nga plehurat kimike që janë përdorur mbi sasinë e lejuar për të rritur në mënyrë artificiale prodhimin bujqësor. E njëjta gjë është edhe me pesticidet të cilat përdoren për mbrojtjen e bimëve nga smundjet dhe demtuesit pa udhëzimin e ekspertëve të bujqësisë. Një sasi e këtyre kimikateve depozitohen në tokë të cilën bimët si ushqim e deponojnë në trupin, farenë dhe frytin e tyre e pastaj nga njeriu si ushqim kalojnë në trupin e njeriut.

- Pas lufte është shumë e theksuar shëndrimi i tokës bujqësore në troje për ndertim,
- Tokat bujqësore janë dëmtuar edhe nga mbeturinat e ngurta si: gur, tulla, betonarmeja, hekurishta
- Brigjet e lumejve dhe shtrati i tyre është dëmtuar nga eksploatimi i rëres dhe zhavorit etj.

Gjendja e pyjeve: Komuna e Deçanit ka 5469.6 ha pyje prej të cilave 4500 ha janë në pronë private.

Në Shkurt 2015 është themeluar Parku Kombetar i bjeshkëve të Nemuna në kuadër të Ministrise së Ambientit dhe Planifikimit Hapesinor. Pjesën e parkut të territorit të Komunes së Deçanit e menaxhon Drejtoria e Parkut Kombetar (Bjeshket e Nemuna) me seli në Pejë.

Që nga viti 2000 pyjet kanë qenë të atakuara nga prerjet ilegale si: Bjeshka e Belegut, Prejlepit, Isniqit (Pleqja) E në këte kuader pyjet më të damtuara janë: Bjeshka e Deçanit, Carrabregut dhe Vokshit psh. Jedova në kompleksin e Bjeshkës së Vokshit në një sipërfaqe prej 80 ha. pothuajse është çpyllzuar tërësisht. Kjo dukuri vazhdon edhe sot por me një intenzitet me të ngadalësuar.

Rezervatët natyrore të mbrojtura janë

1. Maja e Rops në Bjeshkët e Nemuna me një sipërfaqe 61 ha
2. Rezervati i dhive të egra në Kozhnjerë me sipërfaqe prej 161 ha

-Rezervatet shkëmbore – hulumtuese

1. Bjeshka e Prejlepit

2. Kompleksi i Gjeravicës me liqej

3. Parku popullor i Deçanit që përfshin : kompleksin e pishës të zezë të pastër dhe të gështenjës .

Parqet Kombëtare janë lokalitete shumë atraktive si nga aspekti i ruajtjes së burimëve natyrore të punës konkrete edukative të nxënësve dhe të punës kërkimore –shkencore ,ashtu edhe nga aspekti i zhvillimit të turizmit stacionar dhe të formave tjera ekskurzive . Fenomeni natyror dhe biologjik i Bjeshkëve të Nemuna shtrton domosdoshmëri e veqimit të kompleksëve për të zgjedhur Park Kombëtar. Mirpo për shpalljen e tyre dhe madhesinë më parë duhet të arrihet marrëveshja me organizatat e interesuara për qeverisjen dhe eksploatimin e pyjeve ,organizatat përkatëse profesionale dhe me organizatat e interesuara politike – shoqërore.

PARKU NACIONAL “ Bjeshkët e Nemuna “

Duke realizuar mbrojtjen e larmis biologjike dhe pejsazhore në Kosovë dhe me qëllim të mbrojtjes, ruajtjes, zhvillimit, përparimit, shfrytëzimit dhe administrimit të vlerave të natyres në teritorin e Bjeshkëve të Nemuna si qender biodiversiteti në Ballkan duhet të rregullohet shfrytëzimi i qendrueshëm i natyres në Bjeshkët e Nemuna si dhe të behet pengimi i veprimeve të damshme të faktorit antropogjen dhe sigurimi i kushteve sa ma të volitshme të zhvillimit të pa penguar të natyres.

Në Shkurt 2015 është themeluar Parku Kombetar i bjeshkëve të Nemuna në kuadër të Ministrise së Ambientit dhe Planifikimit Hapesinor. Pjesën e parkut të territorit të Komunes së Deçanit e menaxhon Drejtoria e Parkut Kombetar (Bjeshket e Nemuna) me seli në Pejë.

Parku nacional “Bjeshket e Nemuna” përfshin sipërfaqen prej 62488 ha. dhe shtrihet në teritorin e katër komunave: Gjakovë, Deçan, Pejë dhe Istog dhe benë një tersi të lidhur natyrore.

Nga fshati Koshare, ku fillon kufiri administrativ i Komunës së Deçanit me Komunen e Gjakoves, vazhdon në veri – lindje deri në fshatin Gjocaj, nga kjo pikë, kufiri vazhdon në drejtim të veri – lindjes në mes të izohipseve 600 dhe 700 m. l. md. Në pjesën më të mëdha të fshatrave Junik dhe Voksh deri të pika e kujtur Shkoza. Prej këtu kufiri vazhdon në drejtim të veri – lindjes deri të pika në pjesën veriore të fshatit Voksh dhe më tutje vazhdon në drejtim të fshatit Pobergjë. në afërsi të majes së Variqit dhe vazhdon në drejtim të fshatit Hulaj. Nga kjo pike kufiri vazhdon në drejtim të veriut deri të pika në veriprendim të Manastirit të Deçanit dhe në afërsi të Lumbardhit të Deçanit kufiri vazhdon në drejtim të veri-lindjes deri në Kodren e Qavzave duke vazhduar përgjatë izohipses 700 m. l.md. deri të Gryka e Strellcit. Nga kjo gryk kufiri vazhdon në mes të izohipseve 600 dhe 700m l.md. në drejtim të Kodres së Rudenicave ku edhe përfundon kufiri i Parkut Nacional në pjesën e territorit të Komunës së Deçanit dhe fillon kufiri administrativ i Komunës së Pejes.



Bjeshka e Madhe- Deçan

Parimet e mbrojtjes së Parkut Nacional:

Aktivitetet që zhvillohen në Parkun Nacional bazohen në këto parime:

- Ruajtja dhe përfitimi i biodiversitetit dhe peizazheve ekzistuese në gjendjen e barazpeshes natyrore dhe harmonizimin e raporteve me veprimtaritë e njeriut.
- Pengimi i veprimtarive të dëmshme të njeriut dhe çrregullimet në Parkun Nacional si pasojë e zhvillimeve teknologjike.
- Sigurimi i kushteve më të mira për ruajtjen dhe zhvillimin e lire të natyrës gjatë shfrytëzimit.
- Sigurimi i të drejtës qytetare për mjedis të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë.

Zhvillimi i aktiviteteve në Parkun Nacional:

- Mbrojtja, ruajtja dhe përparimi i vlerave bio gjeografike të teritorit, ekosistemeve dhe llojllojshmërisë së floras dhe faunës,
- Ngritjen e objekteve për kultivimin e fidaneve dhe fidanishteve për farëra,
- Prezentimi i trashëgimisë etnologjike dhe vlerave tjera kulturo-historike,
- Aktivitetet shkencore hulumtuese,
- Aktivitetet kulturo arsimore,
- Rregullimi i teritorit,
- Vendosja dhe zhvillimi i funksioneve turistike, rekreative dhe funksioneve tjera.

Në teritorin e Parkut Nacional nuk lejohet:

- Prerja dhe shkatërrimi i drujve, shkurreve e vegjetacionit tjetër përveç prerjeve sanitare,
- Të futen lloje jo autoktone të bimëve të egra,
- Të futen lloje jo autoktone të shtazve të egra,
- Të ndërtohen objekte të cilat do të ndotin ajrin dhe tregojnë keqsimin e kualitetit të ujit dhe rrezikojnë florën dhe faunën,
- Ndërtimi i objekteve nukleare, deponimi i mbeturinave komunale dhe të industrisë, materjeve radioaktive dhe materjeve tjera të rrezikshme etj.

KOMPLEKSI I GËSHTENJAVE

Pyjet me gështenja janë të rralla në Kësovë me përjashtim të Dukagjinit ku kemi komplekse të mëdha pyjesh të gështenjave, të cilat nga Peja deri në Gjakovë formojn një brez të terë vegjetacioni. Nga kjo arsye është me rëndësi që këto pyje me gështenja si relikte terciar me i ruajt. Gështenja si lloj është shumë i rëndësishem si në:

- Industri (drurit, farmaceutike, letres dhe celulozes), si
- Burim i ushqimit,
- Gjenerues mjalti, e
- Dru dekorativ.

Ne Dukagjin, pyjet e geshtenjave zakonisht ndodhen afer vendbanimeve dhe janë te nenshtruara ndikimeve antropgjene. Frutat e geshtenjave ne keto ane me të madhe përdoren për ushqim dhe jane kryesisht ne pronesi private.

Ne kohet e fundit, komplekset e geshtenjave nuk jane ne gjendjen e deshirueshme për shkak të premjeve të pa kontrolluara dhe smundjeve. Nga këto arsye ka ardhë deri te degradimi dhe rrezikimi i tyre, prandaj është me se e domosdoshme qe te ndermerenmasa për përmirsimin e kualitetit te tyre dhe ruajtjen .

➤ **Menaxhimi i mbeturinave ne Komunen e Deçanit**

Në Mars të vitit 2018, kryetari i Komunes z.Bashkim Ramosaj së bashku me GIZ-in Gjerman nënshkruan nje memorandum për menaxhimin e mbeturinave për komunën e Deçanit.Fillimisht u krijua grupi punues të cilët kanë bërë mbledhjen e të dhënave në teren, regjistrimin e ekonomive familjare dhe bizneseve, si dhe punimin e planit të punës dhe planit operativ.

Plani fillimisht përfshiu qendrën e Deçanit dhe dy Carrabreget, pastaj eshte bere shpërndarja e kontejnerëve në 11 fshatra të territorit.

Deri me tani janë shpërnda rreth 1600(240 l) kontejner familjar, 195(1.1 l) kontejner për institucione dhe biznese të mëdha si dhe nga Komuna e Deçanit janë siguruar rreth 1200 kontejner (120 l) qka dmth se deri në fund të vitit 2018 mbulueshmeria arriti rreth 43% të territorit të komunës sonë.Projekti eshte i parapare të vazhdoje deri në vitin 2022.

Gjithashtu në vitin 2018 në Komunen e Deçanit si dhe në qdo komune tjetër filloj aksioni “Ta Pastrojme Kosoven” ku komuna jonë mori një sere aktivitetesh duke bërë pastrimin e të gjitha deponive ilegale në territorin tonë.



I./4. Infrastruktura teknologjike dhe e komunikacionit

4.1. Infrastruktura rrugore dhe urat:

Infrastruktura është pjesë përbërëse e jetës së qytetarve dhe paraqet trungun e funksionimit të bazës ekonomike të një teritori.

Rrugë të reja të ndertuara në vitin 2018 janë rreth 13 km, ndersa gjithsej rrugë të asfaltuara në teritorin e Komunes sone janë 210 km duke mos i përfshirë rrugët regjionale rreth 35 km që mirembahen dhe menaxhohen nga Ministria e Infrastruktures.

Komuna e Deçanit është e mbuluar rreth 25% e territorit me sistem të kanalizimit ku rreth 48 km janë në fazën e dytë ndersa 3.5 km janë në fazën e tretë të punimeve, por ende mbeten edhe 200 km sistem për tu ndertuar, kurse me sistem të ujësjellësit është i mbuluar 98% e territorit të Komunës në përjashtim të tri fshatrave Ratish i Epërm , Ratish i Ulët dhe Maznik (fshatra të cilat në vitin 2019 është bërë planifikimi që edhe këto fshatra të hyjnë në sistemin e ujësjellësit me qka komuna e Deçanit e përmbyll komplet territorin me shtrirjen e ujësjellësit).

Transporti i mallrave dhe udhëtarve, në teritorin e Komunës së Deçanit, zhvillohet vetëm nëpërmjet rrugëve automobilistike.

Rrugët :

Investimet e bëra në infrastrukturën rrugore në komunën e Deçanit si nga komuna ashtu edhe nga Ministritë përkatëse kanë bërë që rrugët të jenë në masë të madhe të ndertuara dhe të mirëmbajtura. Rruga magjistrale që lidh Deçanin me Pejën dhe Gjakovën është në gjendje të mirë dhe mirëmbahet nga Ministria e Infrastruktures, në përjashtim të pjesës së qytetit duke filluar nga ura e Demes deri në dalje të fshatit Carrabreg që mirëmbahet dhe menaxhohet nga Komuna.

Gjithashtu, rrugët lokale në qytetin e Deçanit si dhe fshatrat janë të ndertuara rreth 70% të rrugëve.

Meqense një pjesë e madhe e territorit të Komunes së Deçanit e përfshin zona e bjeshkëve të Nemuna, rrugë të cilat nuk janë të asfaltuara por rrugët mirëmbahen kohë pas kohe , në raste të vërshimeve, shembjeve, erozionit dhe dukurive të rasteve tjera, por mungojnë investimet kapitale në to. Duhet cekur se të gjitha rrugët e bjeshkëve janë të kalueshme.

Në vitin 2018 ka filluar ndërtimi i rrugës Deçan- Plavë që shpie në bjeshkën e Belegut dhe bjeshkët tjera.

Pasqyra e rrjetit rrugor që përshkon territorin e komunes tone duket kështu:

Rruga magjistrale **Pejë- Gjakovë** përshkon terit. e kom. së Deçanit: **Lybeniq -Strellc- Lëbushë – Isniq – Deçan – Carrabreg – Prejlep – Rastovicë – La.”Dëshmorët e Kombit”-Hereqë** në gjatësi 15.15km

Nr.	KATEGORIZIMI I RRUGËVE	GJATËSIA / km.
1	Magjistralja Pejë – Gjakovë	15.15 km.
2	Rrugë Regjionale	9.5 km.
3	Rrugë Lokale	120.92 km.
	Totali	154.8 km

RRJETI RRUGOR I KOMUNËS SË DEÇANIT

RELACIONI	GJAT / Km	KOORDINATAT E LOKALITETIT
Deçan – Lëbushë	2.52	N: 423342.48 E:201725.45
Deçan – Strellc i Epër	4.35	N:423442.30 E:201737.24
Deçan – Strellc i Ultë	6.35	N:423438.28 E:201904.58
Deçan – Isniq	2.52	N:423326.11 E:202808.35
Deçan – Dubovikë (0.93)	6.18	N:423419.95 E:202014.87
Deçan – Prapaqan	6.32	N:423337.77 E:202025.93
Deçan – Papiq (0.57)	0.578	N:423330.06 E:202036.05
Deçan – Broliq	8.74	N:423317.51 E:202135.38
Deçan – Llukë e Epër (0.28)	2.18	N:423241.09 E:201826.56
Deçan – Llukë e Ultë (0.70)	4.95	N:423246.82 E:202005.84
Deçan – Pozhar	4.25	N:423221.03 E:202007.21
Deçan – Kodrali (1.00)	5.31	N:423155.17 E:202010.87
Deçan – Lumbardh (1.00)	5.69	N:423247.02 E:202051.97
Deçan – Vranoc i Vogël (3.60)	7.85	N:423326.33 E:202457.45
Deçan – Dashinoc (0.85)	10.57	N:423209.47 E:202352.48
Deçan – Maznikë	12.96	N:423253.69 E:202602.94
Deçan – Carrabreg i Ultë	1.2	N:423151.56 E:201741.68
Deçan – Beleg (2.40)	3.60	N:423202.85 E:201902.20
Deçan – Prejlep	4.45	N:423027.22 E:201904.74
Deçan – Prokolluk (0.59)	7.8	N:423029.87 E:202018.41
Deçan – Irzniq	7.98	N:423112.39 E:202049.11
Deçan – Ratish i Epërm	10.6	N:423122.48 E:202236.08
Deçan – Ratish i Ultë	11.89	N:423111.33 E:202326.11
Deçan – Glllogjan	9.96	N:423027.75 E:202145.10
Deçan – Shaptej (2.1)	11.87	N:423000.39 E:202244.81
Deçan – Dubravë	12.1	N:422928.53 E:202137.37
Deçan – Gramaqel	13.18	N:422853.93 E:202156.63
Deçan – Jasiq i Ri	14.69	N:422818.17 E:202153.06
Deçan – Rostovicë (0.74)	7.1	N:422942.41 E:201939.47
Deçan – Lagja “Dëshmorët e Kombit”	7.67	N:422840.17 E:202014.84
Deçan – Baballoq	10.11	N:422910.20 E:202056.50
Deçan – Gramaqel	11.90	N:422853.93 E:202156.63
Deçan – Lagja “Agim Ramadani”	8.7	N:422844.59 E:201842.02
Deçan – Carrabreg i Epërm	1.74	N:423136.28 E:203054.69
Deçan – Drenoc	3.1	N:423054.69 E:201727.65
Deçan – Sllup	4.4	N:423025.05 E:201655.19
Deçan – Lloqan	2.56	N:423133.61 E:201653.85
Deçan – Pobergjë (1.19)	4.19	N:423128.26 E:201551.76
Deçan – Voksh	5.57	N:423037.99 E:201619.54
Deçan – Hulaj	2.8	N:423204.81 E:201548.10
Deçan – Belle	8.6	N:423441.16 E:201237.33
Deçan Rostovicë - Junik	12.08	N:422834.17 E:201638.47
Deçan – Voksh – Junik (rrugë Rajonale)	9.5	////////////////////
Deçan – Hidrocentrali “Lumbardhi”	11.90	N:423520.09 E:201045.24
Rruga: Irzniq-Kodrali-Pozhar-Liukë-Prap,	5.63	////////////////////
Rruga “Drumi i Telit”: Isniq-Stre.Ult-Lube,	5.7	////////////////////
Rruga: Polana-Drenoc-Prejlep	3.07	////////////////////
TOTALI	120.92 km	Deçani: N:423224.56 E:201716.23

LARGËSIA E DEÇANIT ME QENDRAT KRYESORE TË KOSOVËS DHE ATO RAJONALE

Nr	RELACIONI ME QENDRAT KRYESORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	GJATËSIJA NË/km	KOHË e KALIMIT/h
1	DEÇAN – PRISHTINË	98.1	1.58
2	DEÇAN – PEJË	13.8	0.17
3	DEÇAN – KLINË	43.5	0.48
4	DEÇAN – ISTOG	39.3	0.44
5	DEÇAN – GJAKOVË	20.4	0.22
6	DEÇAN –PRIZREN	58.9	1.09
7	DEÇAN –SUHAREKË	63.6	1.17
8	DEÇAN – SHTIMJE	94.3	1.43
9	DEÇAN – FERIZAJ	107	2.10
10	DEÇAN – KAQANIK	126	2.30
11	DEÇAN – GJILAN	142	2.40
12	DEÇAN – KAMENICË	178	3.21
13	DEÇAN – VITI	128	2.26
14	DEÇAN – LIPJAN	104	2.2
15	DEÇAN – PODUJEVË	128.3	2.31
16	DEÇAN - DRENAS	76.6	1.26
17	DEÇAN – SKENDERAJ	95.3	1.32
18	DEÇAN – VUSHTRI	92.1	1.47
19	DEÇAN – MITROVICË	82	1.34
20	DEÇAN – RAHOVEC	45	0.51
21	DEÇAN – MALISHEVË	59	1.07

Nr	RELACIONI ME QENDRAT KRYESORE RAJONALE	GJATËSIJA NË/km	KOHË ZGJATJA/h
1	DEÇAN – TIRANË	284	4.39
2	DEÇAN – SHKUP	161	3.05
3	DEÇAN – PODGORICË	214.6	4.34
4	DEÇAN – BEOGRAD	454	6.30
5	DEÇAN – ZAGREB	870	9.03
6	DEÇAN – LUBLANË	1010	10.44
7	DEÇAN – SARAJEVË	332.33	5.14

4.2. Energjetika:

4.2.1. Sistemi energjetik*:

Energjetika, në kushtet bashkëkohore, është një resurs i pa zëvendësueshëm në kuptim të zhvillimit ekonomik, të ushtrimit të veprimtarive, të ngritjes dhe mbajtjes në nivel të standardit jetësor dhe mirëqenies sociale në përgjithësi.

Sistemin energjetik e përbëjnë:

- ▶ Prodhimi,
- ▶ Transferimi apo bartja,
- ▶ Distribuimi apo shpërndarja dhe
- ▶ Shpenzimi.

Prodhimi i energjisë elektrike bëhet në elektrana, të cilat mund të jenë Hidroelektrana dhe Termo- elektrana si dhe energji të ripërtëritshme. Prodhimi i energjisë elektrike në Republikën e Kosovës bëhet nga Termo-elektratat “Kosova-A dhe B” nga të cilat furnizohet edhe Komuna e Deçanit. Në sistemin energjetik të Kosovës (KOSTT) është i kyqur edhe Hidrocentrali “Kelkos”(3 hidrocentrale dhe 1 mledhes të ujit) me një prodhim prej 23 MgW energji elektrike.

1. Hidrocentrali “Deçani” me një kapacitet prodhimi 8.4 MgW
2. Hidrocentrali “Belleja” me një kapacitet prodhimi 9.2 MgW
3. Hidrocentrali “Lumbardhi 2” me një kapacitet prodhimi 5.49 MgW
4. Si dhe hidrocentrali tek zalli i Rupes (ende nuk është në funksion)



Energjia elektrike, nga termo-elektratat “A dhe B”, bartet nëpërmjet të rrjetit të tensionit të lartë deri të Nënstacionet e mëdha të tensionit të lartë.

Furnizimi i Komunës së Deçanit me energji elektrike bëhet nga trafostacioni i tensionit të lartë i cili është i vendosur në lokacionin Verrat e Llukës dhe ka këto karakteristika teknike:

Nr.	Lokacioni	Emri i tr.sta	Fuq.inst./MgW	Nr i t.	Niveli i trafos	Vlera/€
1.	Deçan	NS Deçan	31.5	1	110/10(20)	
2.	Deçan	NS Deçan	20	1	110/10(20)	
3.	Deçan	NS Deçan	40	1	110/10(20)	
4.	Deçan	NS Isniqi	8	2	35/10(20)	

Vlerësimi i rrezikshmerisë së rrjetit elektrik*



TS – Deçan 35.1 MgW Llukë



NS – Isniq 35/10 kV Isniq

Energjia elektrike nga stacioni i LLukes bartet deri të transforstacionet e ashtu quajtura distribuive të cilat janë të vendosura pranë vendbanimeve dhe pranë Zonave industriale.

Nga ky stacion bëhet shpërndarja në 8 lartëpërques : Deçani, Ledina, Prapaqani, Lumbardhi, Lluka, Juniku, ARC dhe Isniqi.

Ndërsa nga nënstacioni Isniq janë 6 dalje 10 kV (largpërques): Demhalilet, Bletaria, Isniq Zukaj, Manastiru, Parketaria dhe Kaqorraj beton.

Sistemi energjetik në Komunën e Deçanit tanimë bën furnizimin 24 orë me energji elektrike vetëm ne raste të ndonjë fatkeqësie natyrore ose dëmtimi në rrjet ose në raste të riparimit të rrjetit apo ndrrimit komplet të tij.

Investimet e bëra nga ana e KEDS-it në rrjet nëpër shumë fshatra ka ndikuar në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike edhe në zonat më të thella.

Investime do të kete edhe në vitet në vazhdim pasi që ka ende vendbanime ku nuk është prekur rrjeti elektrik.



Pasqyrë e gjendjes së sistemit energjetik në Komunën e Deçanit

Mini Hidroelektranat:

Edhe pse energjia e lumenjve dhe të rrjedhave në Komunën e Deçanit e përdorur për mijëra vjet (për të vërejtje në levizje mullinj), mundësitë sistematike hulumtuese për shfrytëzimin e saj për qëllim të ndertimit hidrocentraleve të vegjël të ashtuquajtura Mini hidroelektrana në territorin e Komunës kanë filluar vetëm në vitin 1958, kur është ndertuar dhe ka filluar prodhimin e energjisë elektrike Mini hidroelektrana "Koznjar" në Deçan.

Përparësia e prodhimit të energjisë elektrike me anë të Mini hidrocentraleve qendro në këta parametra dhe që nuk kanë efekte të kundërta në mjedis në krahasim me Hidrocentralet e mëdha:

- Rritja e rinovueshme e energjisë elektrike,
- Hapsirë e vogël për ndertimin e tyre,
- Ndertimi i digave të vogla,
- Shfrytëzimi i ramjes së lirë të ujit,
- Ndryshime të vogla në ekosistemet si:
 - ndikimi në tokë,
 - përmbajtjet nga hapja e portave të digave,
 - ndikimi në botën shtazore të ujërave të ëmbla,
 - ndikimet në ambijent gjatë ndertimit etj.
- Kostoja e lirë e ndertimit,
- Kostoja e lirë e shpërndarjes,
- Pothuajse nuk kanë defekte etj.


Koncepti i ndertimit të Mini Hidroelektraneve ndryshon nga vendi në vend, bazuar :

- ⇒ Kushtet natyrore si;
 - Hidrologjike,
 - Meteorologjike,
 - Topografike dhe
 - Tiparet e morfologjike të tokës.

⇒ Kushtet e zhvillimit teknologjik dhe standardit ekonomik të vendit.

Në Europë dhe në Botë, fuqia prodhuese e energjisë elektrike me anë të Mini Hidroelektraneve, ndryshon në shtete të ndryshme duke filluar psh në Itali nga 1.MW – 1.5MW e deri në 25MW në Kinë.

Megjithatë, në Evropë e më shumë e pranohet kapacitet prej 10 MW e caktuar si limit i sipërm dhe është mbështetur nga Shoqata Europiane e hidrocentraleve (ESHA) dhe Komisionit Evropian.



Parashikimet e ndertimit të Mini hidroelektraneve në shtretërit e lumejve në Komunën e Deçanit

Sipas parashikimeve dhe projekteve egzistuese mbi shtretërit e lumejve në komunën e Deçanit, gjegjësisht mbi lumin e Deçanit dhe Lumin e Lloqanit janë ndertuar 4 Mini Hidro elektrane.

4.2.2. Largëpërquesit dhe trafostacionet:

Sektori energjetik tash për tash nuk është në gjendje të bëjë furnizimin me rrymë gjatë 24 orëve, gjë që bizneset dhe qytetarët e komunës janë të detyruar të bëjnë shpenzime shtesë duke përdorur gjeneratorë. Sistemi i rrjetit elektro-energjetik nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e qytetarëve, nga se në shumicën e vendbanimeve të komunës ky sistem është i stërvjetëruar. Trafostacionet janë të kapacitetit të vogël .

Shiko tabelen me poshte:

SKEMAT NJË POLARE TS – 110/10/ (20) kV DEÇAN

Emri i LP	Nr. Trafove	Fuqija Sins (MVA)	Gjatësija e LP/km	Lokacioni i TS (fshatrat)
LP: Ledina	11	5.42	37.93	Llukë, Beleg, Ledina, Prokolluk, Baballoq, Dubravë, Gramaqel, Irzniq, Glllogjan Shaptej, Fushëmirë, Ratish, Dashinoc, Maznikë.
LP: Prapaqani	11	8.62	47.1	Llukë, Isniq, Prapaqan, Papiq, Dubovik, Broliq. (tjerat në teritorin e Komunës së Pejës)
LP: Deçani	17	6.82	7.53	Llukë "Rio...", Deçan, Carrabreg i Epërm, Carrabreg i Ultë.
LP: Isniqi	7	4.26	14.01	Isniq, Lëbushë, Strellc i Epërm, Strellc i Ult. Tahirsylaj, Kuklec, Tishukaj, Mehmetaj, Ahmetxhekaj, Osmanaj, Rexhahmetaj
LP: Lumbardhi	31	1.70	10.75	Llukë, Pzhar, Kodrali, Llukë e Ultë, Lumbardh.
LP: Isniqi (Zukaj)	5	0.57	3.73	Isniq (Zukaj, Januzaj), fabrika e pompave, Gurthyesi)
LP: Juniku	52	10.11	45.15	Lloqan, Dranoc, Sllup, Sllup (Pompat), Polana, Pobergjë, Voksh, Prejlep, Rostovicë, Lagja "Dëshmorët e Kombit", Junik, Jasiq, Gjocaj, Lagja "A", Ramadani",
LP: Lluka	02	0.40	0.60	Lluka e Epërme.
LP: Parketara	03	2.26	1.62	Metaliku-Ukajt, Parketara, KFOR-i
LP: Demhaliit	07	0.79	1.03	NTP-Stina, Demhaliit.
LP: Bletaria	07	1.78	6.03	Bletaria, Manastiri, Pushimorja e fëmive, Hotelet, Kampi, Hulaj.
LP: ARC - Policia	01	0.2	2.0	Agjencioni i regjistrimit civil
LP: Manastiri	01	0.4	1.6	Manastiri i Deçanit
Gjithësejt	192 (136-Deçan)	////////////////////	196 km	////////////////////////////////////

Duhet cekur se në 10 vitet e fundit KEDS ka bërë investime të medha si në tensionin e lartë gjithashtu edhe në tensionin e ulët.

Sa i përket qytetit të Deçanit, investimet janë bërë në të dyja rrjetet duke u zvendësuar përquesit e zhveshur (telat) në kablo dhe shtylla të betonit. Rruga kryesore nga ura e Demes e deri tek “Bonita Gaz” i tërë sistemi ka kaluar në kablo nëntoksore.

Investime ka pasur edhe nëpër fshatra duke bërë zvendësimin e shtyllave të vjetra të drurit në ato të betonit dhe kabull.

Në fshatrat si Kodralia, Carrabregu i Epërm ,Carrabregu i Poshtëm, Prapaqan, Duboviku, Lebusha, Strelci, Glllogjani, Gramaqeli, Dranoci etj janë bërë investime të medha në tensionin e ulët si dhe atë të lartit duke e rregulluar sistemin elektrik mjaft mir.

Gjithashtu në fshatrat Hulaj, Irniq, Lumbardh, Maznik , Pozhar, Prokolluk, Prilep, Rastavic është bërë intervenime në tensionin e lartë por që ka nevoj të madhe për tu rregulluar edhe tensioni i ulët.

Në Janar 2019, është bërë shkeputja e fshatrave të Vokshit (Dranoc, Sllup, Pobergj, Voksh, Lloqani) nga sistemi i përbashket i rrymes me Junikun i cili eshte ndarë dhe ka nje linje të përbashket me Jasiqin dhe Gjocaj dhe fshati Prilep e Rastovice qe edhe keta furnizohen në nje linje ndaras nga Juniku e Vokshi.

Ende ka pjese nepër fshatra ku rrjeti nuk eshte prekur dhe paraqet rrezik si për banoret ashtu edhe për qytetaret tjer.

Vërejtje:

Mbi gjendjen e Sistemit Energjetik në Komunën e Deçanit shiko planin “ Vlerësimi i rrezikshmërisë së rrjetit elektrik në Komunën e Deçanit”.

4.3.1. Sistemi i telekomunikacionit:

Sistemi i telefonisë fikse dhe mobile në Komunën e Deçanit duke përfshirë të gjithë territorin, nga telefonia fikse është i mbuluar rreth 45% kurse operatorët mobil si VALA, ZMobile dhe IPKO janë të shtrirë në të gjitha hapësirat e territorit duke përfshirë edhe vendet malore (Bjeshket e Nemura).

Duhet cekur se ne disa pika që lartësia mbidetare kalon mbi 700m ka pika të vdekura të komunikimit Njesia e PTK-së në Deçan posedon një central digjital të telefonisë fikse me një kapacitet prej 1400 numrash dhe mundësi lidhjesh të shumta:

- Telefonike,
- Interneti dhe
- Televizioni.

Me telefoni fikse në masë prej 90% janë të lidhura fshatrat:

1. Deçan,
2. Lloqan,
3. Carrabreg i Epërm,
4. Carrabreg i Ultë,
5. Beleg,
6. Llukë e Epërme dhe
7. pjesërisht fshati Isniq.

Kurse me telefoni mobile teritori i Komunës së Deçanit ka mbulueshmëni 100%.

Ndërsa për raste emergjente, nga ZAKE e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, me Radiolidhje Bazë mbulohen të gjitha (10) Bashkësitë Lokale të Komunës.

4.3.2. Lista e përsoneve juridik në telekomunikacion:

REGJISTRI KONTAKTUES I PËRSONELIT DHE SUBJEKTEVE ME RENDËSI NË
KOMUNËN E DEÇANIT

**PLANI I NDËRLIDHJES PËR REAGIM EMERGJENT NË BASHKËSIT LOKALE NË
TERITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT**

Nr.	BASHKESIA LOKALE	PËRSONI KONTAKTUES	TIPI dhe LLOJ I RADIOLIDHJES	Nr. SERIK I RADIOLIDHJES	SHENJA THIRRESE
1.	Shkolla fillore " Lan Selimi " LUMBARDH	Smajl Lekaj Tel. 044 / 639 – 306	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 51000128	LUMI 200
2.	Shkolla fillore "Bajram Curri" STRELLC I EP.	Bashkim Berisha Tel. 044 / 247 – 411	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 51000127	LUMI 201
3.	Shkolla fillore " Maxhun Çekaj "IRZNIQ	Mehdi Dodaj Tel. 044 / 182- 927	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 50900160	LUMI 202
4.	Shkolla fillore " Drita " GRAMAQEL	Mujë Avdiaj Tel. 044 / 178-892	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 50900159	LUMI 203
5.	Shkolla fillore " Jusuf Gervalla "PRAPAQAN	Avdyl Shala Tel. 044 /333 - 739	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 50900204	LUMI 204
6.	Shkolla fillore " Sylë Alaj " DRENOC	Zeqir Nitaj Tel. 044 /861-243	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 61000900	LUMI 206
7.	Shkolla fillore " Isa Boletini "ISNIQ	Shaban Mehmetaj Tel. 044 /155-905	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 60900633	LUMI 207
8.	Shkolla fillore " Sylejmon Vokshi "PREJLEP	Sami Lokaj Tel. 044 /180 - 437	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 61000924	LUMI 208
9.	Shkolla fillore "E.Mekuli" MAZNIKË	Hysni Ramaj Tel. 044 /334-159	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 61000893	LUMI 209
10.	Shkolla fillore " Lidhja e Prizrenit " DEÇAN (BL – Carr.E	Qazim Maloku Tel. 045 120-703	Radiolidhje Bazë - Kenëod	TK – 762 G 61000902	LUMI 211

LISTA KONTAKTUESE E PËRSONAVE ME RENDËSI NE DREJTORINË PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM – NJPZSH-së: DEÇAN

nr.	Emri dhe mbiemri	Funksioni - detyra	Vendbanim	nr. telefonit
1.	Izet Zenuni	Drejtor i DMSH dhe Sherbime Publike	Gramaqel	045 120- 700
2.	Stacioni i NJPZSH-së	Kujdestaria	Deçan	193 /
3.	Besim Selmanaj	K-da. i njësisë së NJPZSH-së	Glllogjan	045 120-710
4.	Besim Kameraj	ZAKE	Lëbushë	044 182-765

LISTA KONTAKTUESE E NJESIVE TE NJPZSH- ve NË KOMUNAT FQINJE

PEJË:

nr.	Emri dhe Mbiemri	Nr. telefonit
1.	Stacioni i NJPZSH-së – kujdestaria	039/ 33 570
2.	Komandanti i njësisë	193

GJAKOVË:

nr.	Emri dhe Mbiemri	Nr. telefonit
1.	Stacioni i i NJPZSH-së - kujdestaria	193
2.	Komandanti i njësisë	

Lista kontaktuese me Agjensionin Pyjor Rajonal – PEJË:

Nr	Emërtimi	Përsoni juridik	Selia	Nr. telefonit
1	Agjensioni pyjor rajonal	- Drejtor Ibish Blakaj	Pejë	044 143-550

Regjistri i përonave juridik në Komunë

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Funksioni	Mobil
1	Bashkim Ramosaj	Kryetar i Komunës	045 120- 707
2	Sami Cacaj	Nënkryetar i Komunës	045 120-777
3	Haki Shehaj	Kryesues i Asambles	044/ 178-963
4	Jashar Dobraj	Drejtor i Drejtorisë së Administratës	045 120-701
5	Izet Zenuni	Drejtor i Drejtorisë për MSh e ShP	045 120-700
6	Agron Demukaj	Drejtor i Drejtorisë Bugjet e Financa	045 120-555
7	Ramë Melaj	Drejtor i Drejtorisë Urb.Gjeod.Kadast.	045 120-708
8	Nasim Haradinaj	Drejtor i Drejtorisë Bujqësi e ZhR	044 297-801
9	Bekim Vishaj	Drejtor i Drejtorisë së Arsimit	044 178-996
10	Musa Berisha	Drejtor i Drejtorisë Shëndetsisë MS	044 129-660
11	Halil Tolaj	Drejtor i Drejtorisë Inspektoratit	045 120-705
12	Fitore Shala	Drejtoreshë e Drejtorisë Ekonomi e Zhvillim	049 226-293
13	Leonora Ukëhajdaraj	Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport	045 120-593


Plani i radiatorit të thirrjeve emergjente nga ZAKE në Komunë

NR.	EKIPA – PËRSONELI	KANALI	SHENJA THIRRËSE	FREKVENCAT
1.	KOMITETI I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE	KANALI – II –	“ BUNA “	158. 3375 MHZ. DHE 162. 9375 MHZ.
2.	KOMANDANTI I INCIDENTIT NË KOMUNË	KANALI – IV -	“ DRINI “	
3.	ZYRTARI I NJPZSH-SË	KANALI – VII -	“ RRUFEJA “	
4.	ZYRTARI I ZAKE-ËS	KANALI – VI -	“ BAZA “	
5.	ZYRTARI I SHPK-ËS	KANALI – V -	“ ERENIKU “	
6.	ZYRTARI I SHEM-ËS	KANALI - VII -	“ IBRI “	
7.		KANALI – IX -	“ DUKAGJINI “	
8.	PËRFAQËSUESI I KRYQIT KUQ	KANALI – VII-	“ DURAKU “	
9.	PËRFAQËSUESI I OJQ-ËVE	KANALI - /// -	- /// -	

Pasqyra e subjekteve për reagim në raste emergjente në Komunë

Nr.	Njësia	Telefoni - Shenja
1.	Policia e Kosovës	0390/ 361-020 112
2.	FSK-ja	
3.	Njesia e NJPZSH -së	045 120-710 193
4.	Shebimi emergjent medikal	0390/ 361-305
5.	Kryqi i Kuq	044 297-440
6.	Qendra Rajonale e Alarm.e Koord.Emergj.(QRAKE)	112

Policia.....	112 dhe 0390 / 361- 020
Ujësjiellësi	0390 / 361 – 034; (mobil 044/ 134-004 – drejtori Nazmi Selmanaj
Distribucioni i KEDS-it (kujd.)...	0800 79 100 ; (mobil 049 779-059 Drejtor- Betim Elezaj)
Shërbimet publike (Higjena).....	0390 / 361 –034;(mobil 049 766-358 Drejtor Sali Kuçi)
QKMF.....	0390 / 361 – 305
Hidro – ekonomia	0390 / 361 – 438
PTK	0390 / 361 – 001



4.3.3. Qendrat telekomunikuese, transmetuesit dhe repetitorët:

Në Komunën e Deçanit, veprojnë tri Posta:

- në Deçan ,
- në Strellc të Epërm dhe
- Deçan tek Qendra për Regjistrimin civil dhe Automjete

Të cilat me shërbimet e veta mbulojnë tërë territorin e Komunës së Deçanit. PTK-ja qytetarëve të Komunës, pos shërbimeve postare ju ofron edhe shërbimet e telefonisë fikse dhe të asaj mobile "Vala". Mbulueshmëria e territorit të Komunës së Deçanit është 40-45% me telefoni fikse, kurse "Vala" mbulon pothuajse 100% territorin e Komunës.

Qytetarëve të Komunës së Deçanit, shërbimet e veta iu ofron edhe operatori i dytë i telefonisë mobile "Ipko" si dhe operatori i tretë Z-Mobile që gjithashtu kanë mbulueshmëri të rrjetit.

Duhet cekur se në disa pika që lartësia mbidetare kalon mbi 700m ka pika të vdekura të komunikimit.

Infrastruktura e objekteve të PTK-së është e pamjaftueshme për nevojat e qytetarëve.

Në pjesën dërmuese të territorit të komunës funksionon edhe rrjeti i internetit. Në komunë funksionon Qendra për Informim, Alarmim dhe Koordinim, nga e cila mund

të aktivizohet sistemi i alarmit për tërë territorin e Komunës së Deçanit, raste të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive të tjera.

4.3.4. Mediat e shkruara, TV dhe radiostacionet:

Në përgjithësi informacion është çdo lloj lajmi, i cili bën të mundur komunikimin e ndërsjelltë përmes të shkruarit, të folurit etj. Informacioni është diçka që mund të mësojmë, njohim apo kuptojmë. Në gjuhën e përditshme do të thotë njohuri apo dituri rreth një çështjeje apo ecurie. Informacioni, në një përkufizim më të gjerë, është mbledhja, përpunimi dhe renditja e një të dhëne që shton diturinë dhe njohurinë e marrësit. Me fjalë të tjera informacioni është rrethana në të cilën të dhënat dërgohen dhe merren, sipas parimit "jap dhe marr". Informacioni është koncept i përdorur gjerësisht në shumë fusha të jetës së përditshme.

Kriteret bazë të klasifikimit të mediave përcaktohen kryesisht nga forma se si i ofrohen ato konsumatorit mediatik për tu shfrytëzuar.

Mediat klasifikohen kryesisht në katër grupe kryesore të cilat janë :

1. Mediat televizive
2. Mediat radiofonike
3. Mediat e shkruara
4. Rrjetet sociale (interneti)
- 5.

Në Komunën e Deçanit veprimtarinë e vet e zhvillojnë mjetet e informimit publik, të shkruara dhe elektronike:

EMERTIMI	LLOJI	KORRESPONDENTI	GJUHA
Radio "Top Iliria"	Radiodifuzion	Adelina Çekaj	Shqip
Kosova Sot	Gazetë ditore	/	Shqip
Koha ditore	Gazetë ditore	Ilir Osmanaj	Shqip
Zëri	Gazetë ditore	/	Shqip
Epoka e Re	Gazetë ditore	/	Shqip
Bota Sot	Gazetë ditore	/	Shqip
Lajm	Gazetë ditore	/	Shqip

Kontrolli i hapësirës mediale të shpërndarjes kabllore në Kosovë behet përmes kompanive të mëdha si IPKO, KUJTESA dhe PTK si dhe kompani tjera më të vogla si: TIK TV, ART MOTIOV etj të cilat kanë shtrirë rrjetin e tyre të televizionit digjital kabllore në tere territorin e Kosoves.

Secila nga kompanitë ka marrëveshje për transmetimin e paketave të ndryshme televizive si psh. : Ipko ka marrëveshje me DIGITALB, Kujtesa me Tring Tv, paketa këto që bartin shum programe televizive si nga Kosova ashtu edhe Shqipëria.

Rrjetet sociale janë web-media që përcillen në mbarë botën me një shpejtësi të rrufeshme, prandaj në ditët e sotme përdorimi i tyre ka marrë një zhvillim të jashtëzakonshëm. Përdoruesit e tyre janë të gjithë ata që kanë në dispozicion kompjuter, telefon dhe lidhje me internet. Përdoruesit e internetit kanë sot mundësinë të lidhen me të gjitha llojet e mediave(gazeta, portalete ndryshme etj). Interneti konsiderohet si një gjigant mediatik, sepse mendohet që në vitet e ardhshme njerëzit jo vetëm revistat apo gazetatat, por edhe radion dhe televizionin do ta shfrytëzojnë kryesisht përmes tij.



1./5. Kapacitetet e furnizimit me ujë:

5.1. Objektet për furnizim me ujë

Komuna e Deçanit ka nje mbulueshmëri të territorit me sistem të ujesjellesit, rreth 301 km apo 98% të teritorit duke përjashtuar fshatrat Ratish i Epërm, Ratish i Ulet dhe Maznik.

Kushtet atmosferike të sezonës dimër, pranverë dhe verë Të viteve të fundit, janë përcjellura me thatësi të lartë e të reshura atmosferike minimale, për banorët e Komunës së Deçanit ku ka krijuar probleme shtesë në pikëpamje të furnizimit me ujë të pijshëm sidomos në sezonën e verës kur temperaturat janë të larta, të reshurat mungojnë si dhe fluksi i madh i bashkatdhetarëve.

Këto kushte të stërzgjatje së thatësisë, jo vetëm që kanë krijuar problem në lokalitete ku mungon rrjeti i ujësjesit, por kjo është duke u reflektuar edhe në lokalitetet me rrjet të ujësjesit ngase burimet e ujit nga të cilat bëhet furnizimi me ujë i rrjeteve të ujësjesit e kanë zvogëluar sasinë e ujit.

Që të kemi një pasqyrë të gjendjes momentale të furnizimit me ujë në territorin e komunës, poshtë po i paraqesim disa të dhëna:

- Në vitin 2018 sasia e ujit të ofruar (shpenzuar) në metra kub për të gjithë qytetaret është 4.059.630 m³ dhe numri i mostrave të marrura gjatë vitit ishte 192,ku të gjitha kanë rezultuar me ujë që i plotëson standardet e kërkuara.

Me ujë, nga ujësjellësi i cili menaxhohet nga Kompania Regjionale “Hidrodrini” furnizohen këto fshatra:

- | | |
|----------------------|--------------------------------|
| 1. Deçani, | 12. Dubovikë , |
| 2. Llukë e Ep. | 13. Prapaqan, |
| 3. Carrabreg i Ep. | 14. Papiq, |
| 4. Carrabreg i ultë, | 15. Broliq, |
| 5. Belegu, | 16. Lagja “Dëshmorët e Kombit” |
| 6. Kodrali, | |
| 7. Pozhar, | |
| 8. Llukë e Ultë | |
| 9. Isniqi, | |
| 10. Strellci i Ep. | |
| 11. Strellci i Ultë, | |

Nr	Fshtrat	Numri i eko. familjare	Numri i banorëve	Nevoja ditore për ujë të pijshëm për kokë banori / 2 litra
1	Deçan	602	3803	12400 litra
2	Llukë e Epër	169	1451	2500
3	Carrabreg i Epër	205	1446	3808
4	Carabreg i Ulët	302	2059	2338
5	Beleg	130	826	2400
6	Prapaqan	109	740	2150
7	Dubovik	141	1060	2814
8	Papiq	25	174	204
9	Isniq	578	3871	12300
11	Strellci i Epër	506	3347	12000
11	Strellci i Ulët	305	2114	5300
12	Lagja “Dëshmorët e Kombit”	123	500	1722
	GJITHSEJ :	3195	22103	48528

Fshtrat të cilat furnizohen me ujë nga rrjeti i ujësjellësit, por që nuk mbikëqyrën nga Ndërmarrja e ujësjellësit “Hidrodrini” njesia Deçan janë:

- Pobergjë,
- Hulaj
- Drenoc
- Sllup,
- Lloqan.
- Voksh,
- Lëbushë

Nr	Fshtrat	Numri i familjeve	Numri i banorëve	Nevoja ditore 2/ Për kokë banor
1	Dranoc	169	1046	3500
2	Voksh	82	570	908
3	Pobergj	192	1314	1900
4	Sllup	44	338	700
5	Lloqan	91	499	974
6	Hulaj	31	158	460
7	Lëbushë	189	1145	3000
	GJITHSEJ:	798	5070	11396

Në vitin 2014 është bërë përrurimi i ujësjellësit të ri për 10 fshatra të komunës së Deçanit dhe sot në vitin 2018 jashtë sistemit kanë mbetur vetëm Ratishi i Ulët i Ratishi i Epërm si dhe Mazniku.

Viti 2019 do të përmbyllë komplet territorin e Komunës së Deçanit me sistem me ujë të pijes ku do të përfshihen edhe tri fshatrat e lartëcekura.

Rekapitullimi tabelar:

	Mënyra e furnizimit me ujë	Numri i familjeve	Numri i banorëve	Kërkesa ditore për ujë në raste emergjente
1	Furnizimi me ujë nga ujësjellësi i mbikëqyrur	5616	22103	63930 litra
2	Furnizimi me ujë nga ujësjellësi i cili nuk mbikëqyret	814	5070	11396 litra
3	Furnizimi me ujë nga puset (bunarët)	2178	13469	30492 litra
	GJITHESËJT	8608	40642	105818 litra

KERKESA:

Bazuar në parametrat statistikor të paraqitur më lartë, për përballimin e gjendjes emergjente të plotësimit të nevojave të popullatës së Komunës së Deçanit (**kategoria e tretë të cilët furnizohen me ujë nga puset**) me ujë të pijshëm është nevojë e domosdoshme që të sigurohen këto mjete:

1. autocisternë për ruajtjen dhe bartjen e ujit të pijshëm (e testuar në pikëpamje higjieniko-sanitare) 2 copë.
2. rezervuar nga masa plastike me kapacitet prej 1000 – 1200 litra për deponimin dhe ruajtjen e ujit në fshatra 27 copë

5.2. Sistemi i distribuimit të ujit për pije:

5.3. Burimet dhe rezervuarët e ujit për pije:

Nr	Rjeti i Lokalitetit	Burimi	Koordinatat	Kapaciteti i burimit	Kapaciteti i rezervuarit	Gjatesia e rr. primar	Gj. Rrjetit sekondar	Lokalite. që furnizohe	Mundësit e ndotjes
1	Deçan	Kilometri i 6 – Gryka e Deçanit	N: 42.55877 E: 20.22451	70 l/s	470 dhe 510m ³	5 km. 6 km.		Deçan, Carrabreg, Beleg, Llukë, Pozhar, Kodrali, Lumbardh	
2	Deçan	Belle	N: 42.56901 E: 20.20788	40 l/s	800 m ³	6.85km km.		Dubovikë, Prapaqan, Papiq, Broliq, Kryshec	
3	Lëbusha	Ledina e Fierit (malet e Lëbushës)	N: 42.56482 E: 20.27873	20 l/s	220 m ³	0.9 km		Lëbushë	
4	Isniqi	Livadhi i Destanve –te Guri(gryka e Deçanit)	N: 42.55319 E: 20.24919	33 l/s		4.8km		Isniq	
5	Strellci	Gurrat e Bardha (bjeshka e Strellcit)	N: 42.59288 E: 20.25381	35 l/s	660 m ³	4.5km		Strellci i Ep. dhe Strellci i Ult	
6	Rajoni Vokshit	Gjipsi (bjeshka e Vokshit)	N: 42.52629 E: 20.17832	40 l/s	?	7.61km		Pobergjë, Hulaj, Lloqan, Silup, Drenoc	
7	f. Voksh	Kroni i Llokës, Kroni i Ana e gjveshur (Gollostranat)	N:42° 30' 35" E:20° 14' 56" N:42° 30' 21" E:20° 15' 24"	32 l/s	?	1.74km 1.37km		Voksh	

5.4. Ndotësit e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore:

Për Komunën në tersi e për qendren në veqanti, problem paraqet mungesa e rrjetit të kanalizimit që për pasojë ka derdhjen e ujrave të zeza në kanalet e ujitjes, në lumenjt si Lumbardhin e Deçanit, Lloqanit, Erenik, prroje ose në gropa septike të cilat nuk janë të ndertuara sipas kritereve standarde e që paraqet rrezik për ndotjen e puseve, uji i të cilëve përdoret për pije.¹

Të dhënat nga NP "Ujësjellësi" Deçan

I./6. Përkujdesja shëndetësore:

6.1. Institucionet shëndetësore:

Shëndeti përcakton drejtëpërdrejt aftësinë e shoqërisë për të marrë pjesë në të gjitha sferat e jetës - shoqërore, politike dhe ekonomike.

Ndotja e mjedisit shpesh mund të jetë shkak i problemeve serioze dhe gjerësisht të përhapura shëndetësore.

Shërbimet shëndetësore publike në Kosovë kryhen në tri nivele: në shërbimin parësor, shërbimin dytësor dhe në shërbimin tretësor, po ashtu kemi edhe shërbimet shëndetësore private.

Kujdesi shëndetësor

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Deçan si organ komunal i cili mbanë përgjegjësinë për organizimin dhe mbarëvajtjen administrative në këtë hapësirë, në mënyrë sistematike pranon dhe analizon informata për cilësinë e shërbimeve mjekësore në territorin e komunës së Deçanit.

Nga ky organ fillohet hierarkia administrative e organizimit të shërbimeve shëndetësore për të vazhduar me stafin udhëheqës-profesional në mbulimin e gjithë hapësirës së komunës së Deçanit. Në fazat implementuese ndërmerren hapa veprimi sipas gjendjes së krijuar, me ç'rast gjendja në ndërkohë konstatohet më sa vijon:

- Në Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare “Adem Ukëhaxhaj” në Deçan realizohet implementimi i programit të “Mjekësisë Familjare” si formë e veçantë të organizimit të Kujdesit Primar Shëndetësor;
- Në Q.K.M.F ka auditim klinik .Edukim të vazhdueshëm profesional për procedurën e auditimit.
- Trajnim të vazhduar të stafit për aplikim të punës mjekësore të bazuar në evidencë.
- Posedohen regjistra të sëmundjeve dhe përdorën kodet e sëmundjeve kryesisht për përshkrimin e diagnozave.
- Punëtorët shëndetësor dhe stafi ndihmës merr pjesë në trajnime dhe edukime të vazhdueshme profesionale sipas nevojave individuale dhe atyre të shërbimit.
- Në mënyrë sistematike behët evoluimi i trajnimit dhe edukimit.
- Infermieret kanë përcjellur kurset e mjekësisë familjare dhe kurset për kompjuter.
- Është paraparë trajnimi e stafit në planin e zhvillimit të Q.K.M.F.
- Përdorën të dhëna të veçanta për përcjelljen e sëmundjeve kronike.
- Posedojmë mekanizma për raportim të përvojave të mira brenda dhe jasht Q.K.M.F.
- Ka mekanizma dhe marrëveshje për mënyrën e referimit në nivele të tjera shëndetësore.
- Janë organizuar mekanizma përcjellës se kur pacientet tonë lëshohen nga trajtimi spitalor ose vdesin.

Ekziston procedurë për punë të laboratorit dhe shërbimit radiologjik. Mangësitë dhe vështirësitë gjatë aplikimit të shërbimeve shëndetësore

Bartja e të dhënave nga njësitë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe prej aty në departamentin e shëndetësisë dhe mirëqenës sociale në komunën e Deçanit, behën në mënyrë sistematike.

Reparti i Gjinekologjisë funksionon edhe në Deçan, ku behen vizita të shumta nga qytetaret.Kemi dy mjek gjinekologe te cilet me ndrrime kryejne detyren ne Gjinekologhi.Në vitin 2017 kemi pasur vetem 6 lindje në Deçan, pasiqe shumica e femrave lindin ne Peje ose Gjakovë.

I tërë organizimi i shërbimeve shëndetësore, si dhe gravitimi i vendbanimeve drejt qendrave të mjekësisë familjare, është dhënë në organogramin e mëposhtëm.

Sherbimi Emergjent medikal funksionon në kuadër të Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare “Adem Ukëhaxhaj” në Deçan dhe në tri qendra të mëdha kemi implementim të pjesërisht të mjekësisë Familjare si formë e veçantë e organizimit të Kujdesit primar shendetësor, e cila konsiston më sa vijon:

- Trajnim të vazhduar të stafit mjeksor për aplikim të punes mjekësore,
- Nuk shfrytëzojn internet për qasje në resurse educative si: MEDLIN, BMJ etj.
- Janë bërë hulumtime të kufizuara por jo të bazuara në të dhëna në dispozicion nga dosjet e shkruara ose elektronike,
- Disponojn me strategji por nuk kan akoma implementim të teknologjis imformative sipas standardeve të mjeksisë bashkëkohore,
- Posedojn procedur për punë laboratorike dhe sherbim radiologjik.

- Aplikohet mjeksi urgjente të improvizuar sipas nevojave emergjente,
- Trajnime të vazhdueshme të stafit profesional sipas nevojave individuale ose të atyre të shërbimit.
- Trajnimi i stafit në planin e zhvillimit Qendres së Mjekësisë Familjare,
- Nuk aplikohet metoda e shkresave dhe ankesave për të mësuar përshtypjen e pacientëve dhe klientëve për cilsin e shërbimeve mjekësore.

Pasqyra tabelore e shërbimeve medikale në K. e Deçanit

Nr	Lokacioni	Numri i punëtorëve		Numri i pacientëve	
		Gjithsej	Ndërrimi i natës	Të palëvizshëm	
				Të rendomtë	
1	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – Deçan	102	12	8	530
2	QMF - Strelc i Epër	4			25
3	Ambulanca - Prapaqan	1			20
4	QMF- Isniq	6			40
5	Ambulanca - .Prejlep	0			25
6	QMF- Irzniq	3			40
7	Ambulanca - Gramaqel	2			15
8	Ambulanca - Lumbardh	1			15
9	Ambulanca - Ratish i Ulët	0			10
10	Ambulanca - Raj. I Vokshit	1			20
	Gjithsej	120			

Shërbimet shëndetësore në Komunën e Deçanit, kryhen vetëm në nivelin parësorë (primar). Ky shërbim kryhet në:

- Një QKMF,
- Tri QMF dhe
- Gjashtë Ambulanca.

Kurse shërbimi mjekësor sekondar, për qytetarët e Komunës së Deçanit, kryhet në Qendrat Spitalore Regjionale në Pejë dhe Gjakovë.

Ndërsa shërbimi mjekësor terciar kryhet në Qendrat Klinike Univerzitare në Prishtinë.

Shërbimet në QKMF:

1. Shërbimi emergjent
2. Mjekësia familjare
3. Shërbimi internistik
4. Shërbimi i O R L
5. Shërbimi Pediatrik
6. Shërbimi Stomatologjik

7. Shërbimi i vaksinimit
8. Shërbimi Gjinekologjik-me maternitet
9. Shërbimi dermatologjik
10. Shërbimi i R T G
11. Shërbimi i Laboratorit
12. Shërbimi i patronazhes

Përsonele mjekësore sipas specializimeve:

1. Specialist internist 2
2. Specialist pediater.....2
3. Specialist Gjinekolog.....2
4. Specialist Dermatovenolog.....1
5. Specialist Toksikolog.....1
6. Specialist mjekësis familjare 10
7. Mjek te përgjithshem 8
8. Mjek Stomatolog.....4

Sherbimi mjekësor dytësor për pacientët e Komunës së Deçanit kryhet në spitalet Rajonale në Pejë dhe në Gjakovë,
Kurse sherbimi mjekësor tretësor kryhet në Qendren Klinike Universitare në Prishtinë.

SHERBIMET EMERGJENTE AMBULANTORE NË KOMUNËN E DEÇANIT

Nr	LOKALITETI	SHERB. MEDIK.	PËRSONELI MJEKSOR	PËRSONELI MEDICINAL	SHTRETER	AUTO AMBULANCA
1.	Deçan	Qendra Krye.e mjek. Fami.	23	66	10	3
2.	Strellc i Ep.	QMF	1	3		
3.	Prapaqan	Ambulancë	0	1		
4.	Isniq	QMF	2	4		
5.	Prejlep	Ambulancë	0	0		
6.	Irzniq	QMF	1	2		
7.	Gramaqel	Ambulancë	1	1		
8.	Lumbardh	Ambulancë	0	1		
9.	Ratish i ult	Ambulancë	0	0		
11.	Pobergjë	Ambulancë	0	1		

Infrastruktura:

- kapaciteti i pranimit në raste emergjente: 500 mbrenda 24 orve
- shtreter: 9 shtreter
- sallë operacioni: -jo
- morg etj.-jo

Furnizimi me energji elektrike:

- nga rrjeti publik-PO
- ëolltazha 220
- gjenerator po (198 kë)
- sistem të ndriqimit emergjent-Po
- sistem të alarmit-Po

Furnizimi me ujë:

- ujësjellësi i qytetit, -Po
- rezervuar dhe kapaciteti- dy rezervuar me kapacitet prej 300 lit
- cistern për ujë -jo

Ushqimi:

- friz,
- frigorifer
- rezerva ushqimore,

Barnat:

- esenciale (lista) - furnizimi nga M SH (marrim shum pak – kemi munges)
- rezerva – Skemi

Paisjet teknike medicinale:

- a. paisje kirurgjikale, - për intervenime te vogla
- b. sistem sterilizimi, - Autoklav dhe sterilizator
- c. paisje radiologjike – fikse, - nji Aparat R T G
- d. paisje radiologjike – tran. - Skemi
- e. Ultrazë -Dy ultraza
- f. EKG, _____-Dy aparata
- g. Aparat oksigjeni, -Nji dhe tri boca
- h. Aspirator, - nji
- i. Inhalator - Dy
- j. Deflibirator - nji
- m. Karrika stomatologjike -3

Grumbullimi i gjakut:

- a. aparatura dhe mundëst e grumbullimit, nuk bëhet

Transporti dhe mjetet e transportit:

- a. Dy autoambulanca
- b. Nji Kombi bus për bartje te pacientve nën dijalizë.
- c. Nji Niv për patronazh
- d. dhe tri auto tjera ne defekt- te pa rexhistruara .
- e. një automjet i tipit Peugeot 2008

Sipërfaqja e objektit:

Përdhes:

Gjithsejtë sipërfaqja katit përdhes:800 m²

Kati i I :

Gjithsejtë sipërfaqja e katit të parë.....800m²

Aneks salla 100m²

Objekti i emergjences..... 110m²

Gjithsejt në QKMF

1810m²

Orari i punës në kushte normale:

- a. i rregullt: prej 7^h deri 15^h
- b. kujdestaria: prej 15^h deri 07^h

Fatkeqësit e mundëshme në ndërtesen e Q. K. M. F.-ës dhe ambulanta shëndetësore:

Aksidentet dhe fatkeqësit teknologjike

1. Zjarret
2. Eksplozimet
3. Kontaminim
4. Rrezatimi
5. Havarit në makineri
6. Aksidentet dhe fatkeqësitë në vendin e punës

Aksidentet dhe fatkeqësitë shoqërore

1. Rrezikimi i ndërtesës nga trazirat në vend
2. Demonstratat
3. Grevat
4. Kurdisja e mjeteve zjarr shpërthyesë dhe eksploduese
5. kurdisja e mjeteve kimike-biologjike
6. Sulmi terrorist

Fatkeqësit e mbrendëshme:

1. eksplozimi i rezervuarve të nxemjes qendrore.

6.2. Kapacitetet publike dhe private:

Ambulanta: Regjioni i Vokshit

Sipërfaqja -150 metra katror

Përsonei:

-1 mjek te prktikes se përgjthshme

-2 Dy infermjere

Orari i punes 7 deri 15

Largësia me QKMF 3 km

Furnizimi me uji nga ujisjelsi i fashatit

Objekti eshte rrezuar mirepo zyra e infermieres eshte vendosur brenda zyres se Gjendjes civile ne Polana.

Ambulanta Prejlep – jo funksionale

Sipërfaqja e objektit 150 merta katror

Përsonei :

-1 infermjere

Orari 7 deri 15

Largësia me QKMF 5km

Furnizimi me uji nga pusi me hidrofor

Ambulanta Gramaqel

Sipërfaqja e objektit 160metra katror

Përsonei :

-1 mjek te praktikes se përgjthshme

-2 Infermjere

Orari 7 deri 15

Largësia me QKMF -13km

Furnizimi me uji nga pusi me hidrofor

QMF - Irznig

Sipërfaqja e objektit 157 metra katror

Përsonei :

-1mjek te praktikes se përgjthshme

-2 Infermjere

Orari i punes 7 deri 15

Largësia me QKMF 8 km

Furnizimi me uji nga pusi me hidrofor

Ambulanta Ratish – jo funksionale

Sipërfaqja e objektit 150 met.katror

Përsonei :

-1 infermjere

Orari 7 deri 15

Largësia me QKMF -16 km

Furnizimi me uji nga pusi me hidrofor

QMF –Isniq

Sipërfaqja e objektit 198 metr.katror

Përsonei :

-1 Mjek Specialist i mjeksis familjare

-1 mjeke –Stomatologe

-4 infermjere

Orari i punes 7 deri 15

Largësia me QKMF - 4 km

Furnizimi me uji nga ujisjelsi i fshatit

Ambulanta Lumbardh

Sipërfaqja e objektit 170 metra katror

Përsonei :

-1 mjek te praktikës se përgjithshme

-1 infermjere

Orari 7 deri 15

Largësia me QKMF – 8 km

Furnizimi me uji nga pusi me hidrofor

Ambulanta Prapagan

Sipërfaqja e objektit 150 met. katror

Përsonei :

-1 infermjere

Orari i punës 7 deri 15

Largësia me QKMF -8 km

Furnizimi me uji nga ujisjellsi i fshatit

QMF Strelc

Sipërfaqja e objektit 150 metra katror

Përsonei:

-1 Mjek specialist i mjeksis familjare

-1 Teknik Laborant

-4 infermjere

Opari i punës 7 -15

Largësia me Q K MF – 4 km

Furnizimi me uji nga ujisjellsi i fshatit*


SHËRBIMET MJEKËSORE PRIVATE NË KOMUNËN E DEÇANIT

	Ordinanca mjek. private	Ordinanca stomatologjike private
Nr.i institucioneve	17	10
Numri i përsoneit mjekësor privat	23 + 25 24 M / 24 F	11 + 7 12 M / 6 F

VËREJTJE:

Të dhënat për shërbimet mjekësore private nuk janë të plota.

* Të dhënat janë marë nga drejtori i QKMF-së z.Selmon Berisha
VLERESIMI I RREZIQEVE - KD



I.7. Objektet e rëndësisë së veçantë:

7. 1. Objektet para shkollore, fillore dhe të mesme:

Parimi kryesor i politikës së arsimit në Komunën e Deçanit është “arsim gjithëpërfshirës”, sipas të cilit të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e Deçanit duhet të kenë mundësi të vijnë shkollimin.

Popullata e arsimuar mirë dhe e aftësuar mirë është me rëndësi për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik dhe mirëqenien ekonomike të vendit.

Në Kosovë që nga viti 2000 ka filluar të aplikohet sistemi i ri i arsimit I klasifikuar sipas ISCED 97 (KSNA : Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit – modeli 5+4+3-4), duke e bërë sistemin e arsimit të Kosovës të përputhshëm me shtetet e BE.

Rrjeti shkollor, në Komunën e Deçanit, është i organizuar në shkolla kryesore dhe paralele të ndara fizike. Mësimi mbahet në dy gjuhë: Në gjuhën shqipe dhe boshnjake.

Arsimi në Komunën e Deçanit përcillet në hierarkinë administrative nga organizimi i rreshtimit të nxënësve në hapësirat shkollore deri të drejtorati për arsim, sport dhe kulturë në Deçan si dhe ndërlidhja me degën regjionale në Pejë, gjegjësisht vertikalia me ministrinë e arsimit shkencës dhe teknologjisë në Prishtinë.

Të dhënat e fundit për arsimin në komunën e Deçanit janë marrë nga Drejtorati Komunal për Arsim në Deçan, ku jepen detajet për formën e organizimit të procesit mësimor në gjithë hapësirën e komunës së Deçanit si dhe elaborohen të dhënat rreth numrit të nxënësve, mësimdhënësve, hapësirat shkollore si dhe forma e zhvillimit të procesit të gjendjes dhe investimit, nga etapa e pas luftës e deri në ditët e sotme.

Arsimi në këtë komunë zhvillohet në katër nivele :

- **Arsimi parashkollor**
- **Arsimi fillor**
- **Arsimi i mesëm i ultë**
- **Arsimi i mesëm i lartë**

Ndërsa shkolla të mesme të larta janë 2.

Niveli 3: Prej të dhjetës deri në të dymbëdhjetën apo trembëdhjetën.

1. Gjinnazi “Vëllezërit Frashëri” Deçan
2. Gjinnazi “Sami Frashëri” Irzniq (**Nuk funksionon**)
3. SHMT”Tafil Kasumaj” Deçan

Niveli 3 – Shkollimi i mesëm i lartë

Në gjinnazin “Vëllezërit Frashëri”Deçan ekzistojnë këto drejtime:

- Gjinnazi i përgjithshëm shkalla e shkollimit është katër vjeçar.
- Gjinnazi i Sh. natyrore shkalla e shkollimit është tre vjeçar .
- Gjinnazi i Sh. shoqërore shkalla e shkollimit është tre vjeçar .

Të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Deçanit janë në gjendje funksionale ,është bërë meremetimi dhe renovimi i shumicës së shkollave që kanë qenë të shkatërruara nga lufta e fundit në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe vjeçare janë renovuar dhe ndertuar nje numer I konsidrueshem I shkollave nga shoqata të ndryshme.

Gjatë luftës janë dëmtuar dhe vjedhur të gjitha kabinetet e lëndëve të ndryshme shkollore dhe është dëmtuar inventari pothuajse në tërësi dhe ka nevojë për ndërtimin e anekseve shkollore, pajisjen me inventar , kabinete dhe salla të edukatës fizike.*

* Të dhënat janë marrë nga Drejtorja e Arsimit

STATISTIKA E SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME TË KOMUNES SË DEÇANIT PËR VITIN SHKOLLOR 2018 / 2019.


NR	Emri i shkollës	Mësimdhënës	Nxënës	Vendi
1	Gjimnazi "V. Frashëri"	51	857	Deçan
2	ShMT."Tafil Kasumaj"	37	512	Deçan
3	"Lidhja e Prizrenit"	59	1013	Deçan
4	"Isa Boletini"	35	512	Isniq
5	"Bajram Curri,,"	27	410	Strellc i Epërm
6	"Drita"	15	182	Gramaqel
7	"Deshmoret e Kombit"	20	247	Strellc i Ulët
8	"Jusuf Gërvalla"	27	379	Prapaqan
9	"Sylë Alaj"	20	267	Dranoc
10	"Heronjt e Dukagjinit"	16	220	Glllogjan
11	"Lan Selimi"	26	243	Lumbardh
12	"Maxhun Çekaj"	12	215	Rrezar -Irnqiq
13	"Sylejman Vokshi"	13	198	
14	"Deshmoret e Vokshit"	12	165	Pobergjë
15	"Ardhmërija"	16	147	Beleg
16	"Faik Konica"	13	114	Ratishë
17	„Esad Mekuli,,"	13	95	Maznikë
18	Rexhep Kadrijaj	14	250	Rastavicë
19	K.i Verrave të Llukës	12	120	Llukë e Epërme
20	<u>Dëshmorët e Baballoqit</u>	11	158	Baballoq

1. Numri i përgjithshëm i nxënësve : 6311 2. Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve : 449

3. Numri i përgjithshëm në Administratë : 30 4. Punëtor Teknik : 92

Në aspektine Mbrojtjes nga zjarri, të gjitha shkollat e Komunës së Deçanit, janë inspektuar nga Sektori i Kontrollit të Katastrofave dhe Inspektori i parandalimit të zjarrit. Janë konstatuar dhe evidentuar të metat dhe mangësitë e mbrojtjes nga zjarri dhe janë propozuar masat që duhet ndermarë strukturat udhëheqëse të shkollave për parandalimin e zjarreve.

Të gjitha shkollat dhe subjektet tjera të rëndësisë së veçantë i kanë të hartuara Planet e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.



7. 2. Strehimoret dhe objektet tjera për strehim (llojet dhe kapaciteti):

Përkujdesja është masë shumë e rëndësishme në kuadër të Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Organizohet dhe pregaditet krahas me masat tjera të Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Ka rëndësi të veçant që të harmonizohet mirë me masat tjera si evakuimin dhe strehimin.

Fatkeqësitë elementare, brënda një kohë shumë të shkurtër lënë një numër të madh njerzish, jo vetëm pa kulm mbi kokë, por edhe pa mjete më të domosdëshme për jetë. Për këtë asye, krahas evakuimit dhe strehimit, planifikohet edhe përkujdesja për të evakuarit dhe të strehuarit qysh më parë, në bazë të vlerësimit nga fatkeqësit elementare dhe fatkeqësit tjera. Parashikohen dhe sigurohen mjete materiale të domosdoshme për furnizimin e atyre të cilët kanë mbetur pa to.

Krahas përkujdesjes parashikohet dhe pregaditët edhe vendosja e domosdoshme për një kohë të caktuar në objekte publike (hotele, shkolla, shtëpi, pushimore etj) për të gjithë njerzit që evakohen nga vendbanimet e përhershme .

Evakuimi bëhet me qëllim të largimit të popullsisë prej vendeve dhe objekteve të rrezikuara në objekte dhe vende më pak të rrezikuara. Kjo mënyrë e sigurisë së njerzve dhe të mirave materiale të tyre është praktikuar tek populli i ynë shekuj me radhë. Populli i ynë i ka braktisur shpeshëher shtëpit e veta dhe është strehuar në vende të caktuara deri sa është eliminuar rreziku ose ka kaluar armiku.

Një Evakuim i popullit tonë ka ndodhë edhe gjatë luftës së fundit në vitet 1998 / 99, që për të ju shmangë terrorizmit të forcave serbe ku është detyruar të evakohet në shtetet fqinje : Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi.

Evakuimi planifikohet në Komunë nga strukturat komunale, përgjegjëse për Mbrojtje dhe Shpëtim, duke ju përmbajtur Planit Komunal për Evakuim i cili përfshin, pos tjerash:

- Udhëzimet e hollësishme për qytetarët mbi mënyrë dhe kohën e evakuimit,
- Evidencimin e familjeve dhe anëtarët e familjeve për evakuim,
- Vend grumbullimin, mënyrën dhe mjetet për transport,
- Rugët dhe drejtimet e evakuimit,
- Destinimin (vendosjen),

Posaqerisht duhet patur kujdes evakuimin me prioritet për kategorit e veqanta të popullatës si:

- Evakuimin e fëmijve deri në moshën 14 vjeqare,
- Nënmat me fëmij të vegjël,
- Përsonat e sëmurë,
- Përsonat e moshuar
- Përsonat e pa fuqishëm dhe me nevoja të posaqme etj.

Mandej pregaditën dhe sigurohen mjete për shtrojë-mbuloj, veshëmbathje, barna, përkujdesje shëndetësore sociale dhe nevoja tjera. Gjithashtu duhet të sigurohen mjete të transportit për evakuimin e njerzve nga zonat e rrezikuara.

Në Komunën e Deçanit në raste të krijimit të situatave emergjente nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për strehimin e përkohshëm të evakuarve ekzistojnë qendra të strehimit kolektiv:

1. Lagja “ Dëshmorët e Kombit” në Baballoq
2. Shkollat fillore dhe të mesme të komunes së Deçanit
3. Si dhe objekte tjera të pabanuara që mund të përdoren për strehimore dhe që gjinden largë perimetrit të rrezikut.

7.2.2. Lagja “Dëshmorët e Kombit” në Baballoq

Kjo Lagje gjendet përbri aksit rrugor Deçan – Gjakovë në largësi nga qendra administrative e Komunës prej 12 km.

Infrastruktura:

Në këtë Lagje janë 130 shtëpi të ndërtuara nga materiali i forte. Shtëpitë janë tri dhe katër dhomëshe, gjegjësisht 2+1 ose 3+1. Mundësia e vendosjes është 740 banor.

Secila shtëpi ka nyjen sanitare.

Lagja ka ujësjellësin, kanalizimin dhe rrymën elektrike. Brendia e Lagjes gjegjësisht rrugët e saj janë të asfaltuara.

Këtij vendbanimi i mungojnë :

- Shkolla
- Foshnjorja dhe
- Përkujdesja shëndetësore gjegjësisht shtëpia e shëndetit.

Mundësia e zgjerimit të kapacitetit:

Në rast krijimi të ndonjë situatë emergjente kapaciteti i kësaj Lagje ka mundësi zgjerimi si:

- mundësia e vendosjes së 100 tendave për 600 banor
- vendosja e 10 kontejnerëve për vendosjen e rezervave ushqimore dhe veshmbathjes dhe materialeve tjera.
- Momentalisht në kete lagje janë të vendosura 103 familje me 500 banorë të cilet në pamundësi të ndërtimit individual janë sistemuar në këtë lagje përkohësisht dhe nuk janë banorë të përhershëm.



N: 42° 28' 37"; E: 20° 20' 20"

7.2.3. Struktura e popullsisë me prioritet për evakuim:

Në Komunën e Deçanit, sipas vlerësimeve, në qendrën urbane, pra, në vetë qytetin dhe në 37 vendbanimet tjera të kësaj komune, jetojnë rreth 41000 banorë. Popullsia shumicë është shqiptare mirëpo jetojnë edhe grupe tjera minoritare si mysliman, romë dhe ashkalinj. Popullsia në qendrën urbane është 7.000 banorë. Dendësia e popullsisë është afërsisht 167 banorë për 1 km².

Struktura moshore e popullsisë

-Fëmijë dhe shkollor -----10.471 banorë
-Pensionier-----2.500 banorë

Struktura gjinore është sa vijon:

-Femra-----19.894
-Meshkuj -----20.125

Në Komunën e Deçanit ekzistojnë 5.887 ekonomi familjare ku madhësia e familjes është përafërsisht 6 banorë për një ekonomi familjare.

Përsonat me aftësi të kufizuara në Komunën e Deçanit :*

Nr.	Fshati	Numri i përsonave	Nr.	Fshati	Numri i përsonave
1	Baballog	22	19	Loqan	3
2	Beleg	11	20	Llukë e Epërme	12
3	Broliq	2	21	Llukë e Ultë	6
4	Carrabreg i Epërm	19	22	Lumbardh	9
5	Carrabreg i Ultë	28	23	Maznikë	14
6	Dashinoc	2	24	Pobergjë	21
7	Drenoc	18	25	Pozhar	7
8	Dubovikë	14	26	Prapaqan	12
9	Dubravë	7	27	Prejlep	29
10	Gramaqel	13	28	Prokolluk	3
11	Ulj	2	29	Rostovicë	15
12	Irzniq	21	30	Ratishë	9
13	Isnig	28	31	Shaptej	10
14	Jasiq	1	32	Sllup	5
15	Kodralli	5	33	Strellc i Epërm	43
16	Lagja " A. Ramadani "	9	34	Strellc i Ultë	41
17	Lagja "D.e Kombit"	5	35	Voksh	3
18	Lëbushë	13	36	Glllogjan	15
Nr. Përgjithëshem					487

Deri në fund të vitit 2018 , sipas të dënave nga shoqata « Handikos » Deçan janë përafërsisht rreth 600 përsona me aftësi të kufizuar.

* Të dhënat janë nga Shoqata "Handikos" Deçan

I./8. Trashëgimia kulturore:

“Humbja e një të mire kulturore është varfërim shpirtëror jo vetëm për popullin që e posedon, por edhe për tërë njerëzimin!”

Nga Deklarata për Mbrojtjen e të Mirave Kulturore

Trashëgimia kulturo-historike - Zonat dhe objektet e trashëgimisë datojnë nga të gjitha periudhat historike. Sot, ato gjithnjë e më tepër po u ekspozohen ndikimeve që i rrezikojnë vlerat burimore të tyre, të manifestuara si rrënim i pjesërishëm ose i tërësishëm, mbindërtim, ndryshim destinimi, shkatërrim të mjedisit dhe ndërhyrje tjetër degraduese. Në bazë të të dhënave momentale del se: komuna e Deçanit nuk posedon projekte për objekte me vlerë

kulturo-historike.

- Në vazhdimësinë e jetës, duke filluar nga parahistoria e deri në ditët e sotme, territori i Komunës së Deçanit është i pasur me monumente kulturo-historike e fetare të cilat paraardhësit iu kanë lanë trashëgim pasardhësve të tyre si dëshmi të ekzistimit të tyre në këto troje dhe paraqesin bazën e trashëgimit shqiptar, e si të tilla shërbejnë si burim material për studimin e së kalueses së popullit shqiptar.
- Këto monumente paraqesin origjinalitetin krijues, aftësitë tekniko-teknologjike, arkitekturale, shprehjen e artistëve vendas si dhe rrethanat kulturore, historike, ekonomike, sociale e fetare të periudhave kur janë ndërtuar.
- Ruajtja dhe trajtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Deçanit, sikurse përgjithësisht në Kosovë, i është nënshtruar edhe situatave politike që kanë dominuar në Kosovë nënë regjimin e ish Jugosllavisë, situatë kjo e cila nuk ishte aspak e favorshme për shqiptarët e në këtë kontekst as për trashëgimin e tyre kulturore.
- Kjo trashëgimi etno – kulturore, për fat të keq, pati fatin e shkatërrimit të dyfisht:
 1. Kohën si faktor shkatërrues dhe
 2. Shkatërrimet e planifikuara në kushtet e okupimit serb.
- Faktori kohë në një mënyrë apo tjetër tejkalohet dhe nuk ishte aq e dhimbshme;
- Shkatërrimet e planifikuara janë realizuar në emër të planifikimeve hapësinore, planeve urbanistike të qyteteve dhe kishin për qëllim zhdukjen e komplekseve urbane dhe objekteve me vlera të veçanta kulturore – historike e fetare të kulturës shqiptare. Ky shkatërrim i planifikuar arriti kulminacionin gjatë luftës së viteve 1998 – 1999, kur këto monumente u plaçkiten, u dogjën dhe u rrënuan nga forcat paramilitare, policore dhe ushtrake serbe.
- Gatishmëria në rast rreziku, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, është çështje parësore e çdo shoqërie dhe ka për qëllim që të pakësohen humbjet në trashëgimin kulturore të cilat shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë që shkaktohen nga njerëzit.
- Në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, rëndësi e madhe i kushtohet zbatimit të PARIMEVE të cilat janë sajuar për qasje preventive me qëllim të përmirësimit të kushteve të përgjithshme për një jetë afatgjatë të trashëgimisë kulturore dhe porosisë domethënëse të saj.



ARTIZANATET



KULLAT



MULLIJT



XHAMITË

Trashëgimia arkitekturore:

Deçani që shtrihet rrëzë bukurive natyrore të bjeshkëve të Nëmura, ka pasur kushte të volitshme për ndërtimin e shtëpive prej gurit posaçërisht objekteve - kullave, e që janë produkt i kushteve natyrore të një regjioni gjeografik por gjithashtu edhe i rrethanave historike ekonomike dhe shoqërore në përgjithësi.

Historiku i ndërtimit të kullave të Deçanit fillon qysh nga fundi i shekullit XVII, kurse lulëzimin e ndërtimit të tyre e kanë pasur gjatë shekujve XVIII, XIX dhe gjatë shekullit XX. Banorët e kësaj ane për t'u përshtatur nevojave të kohës dhe jetës, realizuan banesat e fortifikuara të tipit kulla, ku Qyteti i Deçanit njihet ndryshe si **qytet i kullave**.

Kulla e kësaj ane është karakteristike jo vetëm si tip i veçant i shtëpisë por edhe për arsyen se ajo është një dokument i gjallë i kushteve shoqërore dhe ekonomike, që mori zhvillim të ndërtimit në fshatra dhe qytete veçanërisht kur lëvizja kombëtare morri hov gjatë shekullit XIX.

Këto tipe të shtëpive të stilit të fortifikuar, kanë pasur rol të shumëfishtë, veçanërisht roli mbrojtës ishte kryesori si sinonim i mbrojtjes dhe i qëndrësës. Ky karakter mbrojtës përveç atij banues, shihet nga vet forma e ndërtimit, e mbyllur, prej materialit masiv prej guri, me frëngjitë e shumta përgjatë murit të kullës.

Trashëgimia arkitektonike deçanasve përbënë një vlerë dhe pasuri të veçant për kulturën dhe historinë e popullit shqiptar, e në këtë kuptim një vend të rëndësishëm zë konstrukti i kullave, tipi dhe forma e ndërtimit dhe dukja e tyre. Në këtë traditë ndërtimore, një vend të veçant zënë edhe materiali shkëmbor-guror i bjeshkëve dhe i lumenjve të kësaj ane duke bërë që të dallohen për një tipologji të veçant me vlera të mëdha të shtrirjes në këtë anë.

Faktori shoqërorë - historik ka pasur rëndësinë e dorës së parë që ka ndikuar në ndërtimin, formën dhe mënyrën e shfrytëzimit të kullës si shtëpi banimi. Kullat tipike janë ato me nga tre dhe katër kate, ku kati i parë i kullës shfrytëzohej për të strehuar bagëtinë, ndërsa katet e sipërme për banim dhe mirëpritje.

Kulla është një dëshmi e kulturës së lartë shpirtërore e materiale e masave të gjera si dhe një etnopsikologji e materializuar, muret e të cilave nuk janë ndërtuar vetëm me gurë të zgjedhur të Bjeshkëve të Nëmura por edhe me vuajtjet trimërinë, burrërinë e aspiratave shekullore të këtij populli që shkroi historinë e vet me gjakun e derdhur për lirinë kombëtare.

Gjatë viteve të luftës 1998-1999, forcat serbe kanë shkatërruar ose dëmtuar 826 kulla në tërë territorin e Kosovës e vetëm në Komunën e Deçanit, pas luftës në vitin 1999 janë identifikuar 263 kulla, e nga i gjithë ky sfond sot numërohen 67 kulla kurse sfondi i kullave si objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare në Kosovë që kanë mbijetuar kohës dhe luftës, sot numërohen vetëm një 1 % e tyre.

Në Komunën tonë që nga paslufta e deri më tani nga Institucionet vendore, ato lokale dhe ndërkombëtare është investuar në restaurimin si dhe ruajtjen e disa kullave me vlera të trashëgimisë kulturore dhe historike, përderisa kemi raste tjera edhe të ruajtjes së këtyre vlerave edhe nga e vet pronaret e këtyre objekteve.

Është më rendësi të ceket se përpos kullave Komuna e Deçanit ka edhe një numër të madh të vlerave tjera kulturore – arkitektonike siç janë: ansamblet arkeologjike, lokalitetet arkeologjike, monumentet, peizazhet etj si dhe kemi në listën për mbrojtjen e monumenteve dhe tërësive nga UNESCO-ja Manastirin e Deçanit. Shumë nga këto vlera janë të identifikuar si dhe të vendosura në mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme por kemi edhe vlera që për shkaqe të ndryshme objektive dhe subjektive ende të pa eksploruara.

Lisat e aprovuar nga MKRS për Trashëgiminë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme

I. Kategoria: Trashëgimia arkeologjike

A. Nënkategori: Monumentet/Ansamblet

Nr.	Emërtimi	Përiudhat	Vendi - Komuna	Statusi Nr. i Vendimit	Nr. unik në databazë
41.	Murgorja e Zojës së bekuar në Belle	Mesjetë	Belle, Deçan		2837

A. Nënkategori: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat

Nr.	Emërtimi	Përiudhat	Vendi - Komuna	Statusi Nr. i Vendimit	Nr. unik në databazë
210.	Lokalitet i periudhës romake në Irzniq	Romake	Irzniq, Deçan		4196
211.	Lokalitet arkeologjik i periudhës romake në Irzniq	Romake	Irzniq, Deçan		2995
212.	Tuma e vetmuar në Irzniq	Parahistori	Irzniq, Deçan		3234
213.	Fortifikim parahistorik	Parahistori	Baballoq, Deçan		3650
214.	Lokalitet arkeologjik parahistorik	Parahistori	Baballoq, Deçan		3235
215.	Fortifikim i antikitetit vonë	Antikitet i vonë	Strellc i Epërm, Deçan		3233
216.	Lokalitet arkeologjik romak	Romake, Antikitet i vonë	Rastavicë, Deçan		3179
217.	Kalaja antike në Belle	Antikitet i vonë	Belle, Deçan		3164

II. Kategoria: Trashëgimia arkitekurore

A. Nënkategori: Monument/Ansambël

Nr.	Emërtimi	Përiudhat	Vendi - Komuna	Statusi Nr. i Vendimit	Nr. unik në databazë
551.	Kulla e Zymer Himës	Shek. XVIII	Deçan		2828
552.	Mulliri i Shabanajve	Shek. XIX	Deçan		1458
553.	Xhamia e Deçanit	Shek. XIX	Deçan		1539
554.	Kulla e Demukëve	Shek. XIX	Deçan		2058
556.	Mulliri i Gjirkokajve	Shek. XVIII	Deçan		1536
557.	Kulla e Ramë Shabanit	Shek. XIX	Prapaçan, Deçan		2826
558.	Kulla e Ramiz Kukleçit	Shek. XIX	Isniq, Deçan		3171
559.	Kulla e Kukleçve	Shek. XVIII	Isniq, Deçan		2613
560.	Xhamia e Isniqit	Shek. XVII	Isniq, Deçan		3171
561.	Kulla e Musë Mehmetit	Shek. XIX	Isniq, Deçan		3308
562.	Kulla e Smajl Nimon Balaj	Shek. XIX	Isniq, Deçan		3309
563.	Kulla e Regjë Iber Balaj	Shek. XIX	Isniq, Deçan		3310
564.	Kulla e Zenun Ahmetit	Shek. XIX	Isniq, Deçan		3311
565.	Kulla e Sali Gecës	1800	Isniq, Deçan		3312
566.	Kulla e Mujë Mehmetit	Shek. XIX	Isniq, Deçan		3313
567.	Mulliri i Tahir Sadrive	Shek. XIX	Isniq, Deçan		3180
568.	Kulla e Sadik Ibishit	Shek. XIX	Isniq, Deçan		3405
569.	Xhamia e Pozharit	Shek. XVIII	Pozharë, Deçan		3170
570.	Kulla e Demë Ali Pozharit	Shek. XIX	Pozharë, Deçan		3151
571.	Mulliri i Beqir Halil Haxhosaj	Shek. XIX	Prokolluk, Deçan		964
572.	Xhamia e Drenocit	Shek. XX	Drenoc, Deçan		1371
573.	Kompleksi i Kullave në Lagjen e Mazrekaj	Shek. XIX	Drenoc, Deçan		3314
574.	Kulla e Tahir Baqit	Shek. XIX	Drenoc, Deçan		4140
575.	Mejtepi në fshatin Llukë e Epërme	Shek. XIX	Llukë e Epërme, Deçan		1622

576.	Kulla e Ali Gecit	Shek. XVIII	Llukë e Ultë, Deçan	2055
577.	Kulla e Florim Januz Gecaj	Shek. XIX	Llukë e Ultë, Deçan	3585
578.	Xhamia e Carrabregut	1816	Carrabreg i Epërm, Deçan	1737
579.	Kulla e Muhamet Dervish Çekaj	Shek. XIX	Irzniq, Deçan	3167
580.	Kulla e Zymer Fetës	Shek. XIX	Irzniq, Deçan	3316
581.	Mulliri i Sadik Berishës	Shek. XIX	Irzniq, Deçan	1302
582.	Kulla e Shaban Murat Gjukaj	Shek. XIX	Strellc i Ultë, Deçan	3149
583.	Kompleksi i Dëshmorëve	Shek. XX	Glllogjan, Deçan	3150
584.	Qardaku i Azem Hamëz Ahmetaj	Shek. XIX	Lëbushë, Deçan	1367
585.	Xhamia e Lëbushës	1793	Lëbushë, Deçan	1385
586.	Kulla e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës	Shek. XX	Dubovik, Deçan	3211
587.	Kulla e Donikë Jusuf Gërvallës	Shek. XX	Dubovik, Deçan	3584
588.	Xhamia e Vokshit		Voksh, Deçan	2136
589.	Tyrbja e Sadri Pepajt	Shek. XIX	Kodralli, Deçan	1291
590.	Kulla e Miftar Alisë	Shek. XIX	Lumbardh, Deçan	3315
591.	Kulla e Bajram Xhafer Lekaj	Shek. XIX	Lumbardh, Deçan	3527
592.	Xhamia e Baballoqit	1868	Baballoq, Deçan	3169
593.	Kulla e Hamëz Mataj		Baballoq, Deçan	4132
594.	Kulla e Gjyle Kadriajaj	Shek. XIX	Rastavicë, Deçan	3317
595.	Kulla e Himë Nimonit	Shek. XIX	Pobergjë, Deçan	4133
596.	Kulla e Haxhë Alisë	Shek. XIX	Pobergjë, Deçan	4174
597.	Kulla e Ali Jusuf Mataj	Shek. XIX	Pobergjë, Deçan	4134
598.	Kulla e Ali Avdijaj	Shek. XIX	Gramaqel, Deçan	4148
599.	Mulliri i Avdyl Zenel Jasiqi	Shek. XVIII	Gramaqel, Deçan	1289
600.	Kulla e Ramë Stojkaj	Shek. XIX	Gramaqel, Deçan	1408
601.	Mulliri i Daut Osë Hulaj Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit	Shek. XIX	Hulaj, Deçan	1317
622.		Shek. XX	Glllogjan, Deçan	4440

623.	Kulla e Bajram Qerim Istrefaj	Shek. XIX	Strellc i Epërm, Deçan		4446
624.	Kulla e Reshat Istrefaj	Shek. XIX	Strellc i Epërm, Deçan		4447
626.	Koshi i drithit – Enver Likaj	Shek. XIX	Carrabreg i Ulët, Deçan		4453
627.	Kulla e Hasan Mehmetit	Shek. XIX	Dubovik, Deçan		4470

IV. Kategoria: Peizazhet Kulturore

A. Nënkategori: Monumentet/Ansamblet

Nr.	Emërtimi	Përiudhat	Vendi - Komuna	Statusi Nr. i Vendimit	Nr. unik në databazë
1555.	Blini në Rastavicë	Shek. XVIII.	Rastavicë, Deçan		1516
1556.	Verrat e Llukës		Llukë e Ulët, Deçan		3145

Vërejtje:

Të dhënat e cekura më lart janë marrë nga Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme të aprovuar dhe publikuar nga Ministria për Kulturë Rini dhe Sport për vitin 2018*

Pjesa e dytë

I. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË

a. Frekuenca e ndodhjes:

- **Shumë e mundshme:** Mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm.
- **E mundshme:** Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm, ose së paku një gjasë në 10 vitet e ardhshme.
- **Ka gjasa:** mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një shans në 100 vitet e ardhshme.
- **I pa mundshëm:** Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme.
- **Tepër i pamundshëm:** Mundësia një herë në 500 vite

Efekti goditës në komunitet (shkalla e ashpërsisë), Karakteristikat:

Ashpërsia	Karakteristikat
Katastrofë	<ul style="list-style-type: none">▪ Vdekje të shumëllojshme▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për 30 ditë apo më shumë.▪ Më shumë se 50% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.
E Ashpër	<ul style="list-style-type: none">▪ Lëndimet /apo sëmundjet/ rezultojnë në paaftësi të përhershme.▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 2 javë.▪ Më shumë se 25% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.
E mesme	<ul style="list-style-type: none">▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme.▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 10 ditë.▪ Më shumë se 15% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.
E kufizuar (mbrojtur)	<ul style="list-style-type: none">▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme.▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 1 javë.▪ Më shumë se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.
E Ultë	<ul style="list-style-type: none">▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet e trajtuara me ndihmën e parë.▪ Humbje e vogël e standardit të jetesës.▪ Ndërprerja e objekteve/shërbimeve kritike për 24 orë e më pak.▪ Më pak se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.

Profili i Komunitetit

Faktorët Kyç të Komunitetit

Gjeografik	Demografik	Të mirat materiale	Infrastruktura kritike	Objektet e rëndësishme të veçanta
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tiparet e mëdha gjeografike ▪ Modelet tipike meteorologjike 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Madhësia e popullatës, shtrirja/shpërndarja, përqendrimet ▪ Numri i njerëzve në zonat e cenueshme ▪ Popullatat e veçanta ▪ Kafshët 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numrat ▪ Llojet ▪ Vjetërsia ▪ Rregullat e ndërtimit ▪ Rreziqet e mundshme dytësore 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sistemi i Uji të pijshëm ▪ Energjia ▪ Depot ushqimore ▪ Mullinjtë ▪ Kanalizimet 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkolla ▪ foshnjoret ▪ Spitalet ▪ Ndërtesat qeveritare ▪ Ndërtesat publike ▪ Ndërtesat industriale ▪ Pikat e karburanteve

Faktorët Kyç të Komunitetit- vazhdim

Komunikacioni dhe Telekomunikacioni	Trashëgimia Kulturore	Ambienti	Humbjet Ekonomike
<ul style="list-style-type: none"> . Rrugët . Urat/Tunelet . Hekurudha . Aeroporti . Posta dhe telekomunikimi 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendet arkeologjike ▪ Muzetë ▪ Vlerat historike dhe kulturore 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Toka ▪ Uji ▪ Ajri 	Sipas klasifikimit

PROCEDURA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT

Pasojat e mundshme dhe kualifikimi i tyre
Kualifikimi i pasojave dhe probabilitetit

Klasifikimi	Pasojat për jetë dhe shëndet (J)
1. E parëndësishme	Veç një dëm i rëndë, paaftësi e përhershme
2. E kufizuar (e ngritur)	Veç një dëm i rëndë, lëndim serioz
3. E mesme	Një vdekje, disa lëndime serioze
4. Kritike (serioze)	Disa vdekje (<5), disa lëndime serioze (20), deri në 500 të evakuuar
5. Katastrofike	Disa vdekje (>5), me dhjetra lëndime serioze, më shumë se 500 të ev

Klasifikimi	Pasojat mbi pronat (P) ose ndërprerja (N)- harxhimet totale të dëmeve në EURO
1. E parëndësishme	<2 500
2. E kufizuar (e ngritur)	2 500 - 25 000
3. E mesme	25 000 – 50 000
4. Serioze	50 000 – 1 000 000
5. Katastrofike	>1 000. 000

Çelësi:

- 1. E Ultë ●
- 2. E Mbrojtur ●
- 3. E Mesme ●
- 4. E Ashpër ●
- 5. Katastrofike ●

VËRSHIMET

II. IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE DHE VLERËSIMI I SHKALLËS SË RREZIKËSHMËRISË

PROFILI I RREZIKUT TË VËRSHIMEVE

PROFILI I RREZIKUT	
RREZIKU: VËRSHIMET	
MADHËSIA E MUNDSHME (PËRQINDJA E KOMUNITETIT QË MUND TË GODITET): KRITIKE: 10 DERI 25 %	
FREKUENCA E NDODHJES: ■ Shumë e mundshme: Mundësia afër 50%, së paku dy herë në vit.	MODELI SEZONAL: PRANVERË: MARS, PRILL, VJESHTË: TETOR NËNTOR DIMËR: JANAR ,SHKURT
ZONAT QË MUND TË GODITEN MË SË SHUMTI: F. STRELLC, F. ISNIQ, F. DUBOVIKË , F. PREJLEP, GRAMAQEL, JASIQ, BABALLOQ	
KOHËZGJATJA E MUNDSHME: Për më tepër përvoja tregon se kohëzgjatja e çdo vërshimi është relativisht e shkurtër (më së shumti 3-4 ditë).	
SHPEJTËSIA E MUNDSHME E MËSYMJES (SHUMA E MUNDSHME E KOHËS SË PARALAJMËRIMIT): PARALAJMËRIMI 3 – 6 ORË.	
SISTEMET EKZISTUESE TË PARALAJMËRIMIT: SISTEMI I INTEGRUAR I PARALAJMËRIMIT (112), SHËRBIMET E ZJARRFIKËS DHE SHPËTIMIT(193) POLICIA- DEÇAN: 0390/361-020	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?: Jo	

GODITJA E FAKTORVE KYQ TË KOMUNITETIT

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Dhjetëra vdekje dhe qindra lëndime të rënda, për shkak të goditjes së valës së ujit, rrënimëve, dhe prurjeve të materivë të ngurta.	E ashpër
Pasuria	Në zonat e goditura nga vërshimet uji depërton në oborret dhe shtëpitë e qytetarëve, duke shkatërruar pasurinë, dhe të mirat materiale të qytetarëve.	E ashpër
Infrastruktura Vitale	Dëmtimi i ujësjellësit, kanalizimit, energjisë, tokave të bukës, teknologjisë informative	E ashpër
Objektet e Rëndësisë së Veçantë	Dëmtimi i objekteve shkollore, objekteve qeveritare, rrugëve, urave etj.	E ashpër
Shërbimet Emergjente	Dëmtime të pajisjeve të njësive reaguese	E mesme
Ambienti	Për shkak të prurjeve të mëdha të ndryshme, lymit dhe kontaminimit, dëmtohet mjedisi.	E ashpër
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë	E mesme
Dëmet Ekonomike	Shkatërrim dhe dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E ashpër

II./1. Shkaqet natyrore

1.1. VËRSHIMET:

1.1.1. Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në shkaktimin e vërshimeve:

Lumejt e Komunës së Deçanit i janë lënë mëshirës së natyrës dhe shfrytëzimit të pandërgjegjshëm të njerzëve. Mbrojtja nga vërshimet në Komunën e Deçanit është e pavolitshme. Shtretërit e lumenjve janë dëmtuar në shkallë shumë të madhe si pasojë e nxjerrjes së pakontrolluar të rërës dhe zhavorrit. Hudhja e mbreturinave në shtratin e lumit, mos rregullimi i shtretërve të lumenjve, rritja e botes bimore përreth shtratit dhe në shtrat të lumit, uzurpimi i tokave në të dy anët e lumit, mungesa e mirëmbajtjes së shtretërve të lumit nga institucionet gjegjëse janë faktorë që ndikojnë në shkatërrimin e shtratit të lumenjve. Vitet e fundit vërehet një përmirësim dhe një angazhim i institucioneve përgjegjëse për ruajtjen e mjedisit si dhe vëdijesimi me i lartë i qytetareve si në keqpërdorimin e lumenjeve, uzurpimi dhe hudhja e mbeturinave. Dalja e ujit të lumit jashtë shtratit është edhe si pasojë e faktorit natyror, ku reshjet bien në kohëzgjatje të mëdha dhe si pasojë e të gjithë **këtyre faktorëve është përmbytja e tokës bujqësore.**

1.1.2. Treguesit hidrologjik:

Sezona e vërshimeve:

Në Kosovë janë dy periudha kohore ose stinë të vitit që karakterizohen me vërshime: Stina e dimrit për shkak të reshjeve të shumta të borës dhe stina e pranverës dhe vjeshtës për shkak të reshjeve të shumta të shirave.

Shenjat pararendëse:

Situatat më të rënda paraqiten jo në mënyrë të menjëhershme, zakonisht kur fillon shkrirja e borës dhe kur kemi shira me kohëzgjatje dy tri ditësh.

Karakteristike janë edhe vërshimet që vijnë nga reshjet jashtëzakonisht violente shpesh brenda disa orëve të shoqëruara me stuhi. Këto janë vërshime shumë të lokalizuara që zhvillohen brenda një kohë të shkurtër. Ato janë mjaft vështirë që të parashihen në mënyrë precize

Reshjet:

Shikuar në mënyrë vizuale, është evidente se muajt me reshje më të mëdha të dëborës janë Janari dhe Shkurti kurse muajt me reshje më të mëdha të shirave janë: Marsi, Prilli, Tetori dhe Nëntori.

Tempëraturat:

Klima e Kosovës është kryesisht kontinentale me disa ndikime mesdhetare dhe alpine, verërat janë të nxehta dhe dimrat të ftohtë. Tempëraturat ekstreme shkojnë deri në + 39/40° C në verë dhe – 20 °C në dimër. Për arsye të relievit me kontraste, në Kosovë ekzistojnë variacione termike të mëdha në mes të zonave më të nxehta dhe zonave më të freskëta. Faktori tempëraturë ndërhyjnë pak, si zakonisht, në shpjegimin e ndjeshmërisë së vërshimeve, përveç ndoshta në dy situata krejt të veçanta.

Në vlera ekstreme për përkeqësimin e situatës për disa ditë : ky do të mund të ishte rasti gjatë pranverave dhe vjeshtave me shira të shpeshta, dhe dimrave me reshje të shpeshta dhe të mëdha dëbore.

Era

Deçani nuk është një regjion me shumë erëra: në përgjithësi erërat janë të dobëta dhe të mesme.

Një drejtim i veçantë i erës tashmë është konstatuar e ai është drejtimi i veriu.

Valët e të ftohtit, bora:

Tempëraturat dimërore mund të arrijnë minus 10 gradë dhe bora është e shpeshtë edhe në zonat fushore.

Thatësia :

Mungesa e ujit mund të jetë e madhe. Kosova, një vend me një sektor rural të madh ka rregullisht periudha të vapës së madhe që mund të shkaktojnë një gjendje të thatësisë e që krijon pastaj gjatë vërshimeve erozione të konsiderueshme.

Stuhitë:

Largësia nga deti, reliefi i Deçanit me kodrina, dhe pyjet e mbuluara me vegjetacion që shkaktojnë një frenim natyror, limitojnë forcën e erës, në veçanti në raport me regjionet e fushës që e rrethojnë.

Megjithatë rreziku i stuhisë duhet të merret parasysh, sidomos sa i përket vërshimeve të shpeshta që shkaktohen në pranverë dhe në vjeshtë.

Konkludim

Për të konkluduar mund të themi se rreziku i vërshimit është shumë i shpeshtë, kryesisht për arsye të shirave shpeshherë të shumta dhe stuhive ose një periudhe të gjatë të motit të lig, të shoqëruar me një rrjet të evakuimit të ujërave të shiut jo adekuat dhe me një sistem të alarmimit meteorologjik jo ekzistues.

1.1.3. Kushtet hidrometeorologjike:

Shkaqet kryesore të vërshimeve në Komunën e Deçanit

- Reshjet
- Mbulimi (ndërtimi mbi tokat bujqësore), faktor që përkeqëson gjendjen e lumenjve të vegjël

Vërshimet mund të ndodhin nga :

- Dalja nga shtrati e rrjedhës së ujit, një ngjitje e ngritje e shtresës nëntokësore të ujit, një stagnim i ujërave të shiut në zona fushore.
- Luginave të përrenjve
- Rrjedhave të ujit në sektorin urban.

Faktorët e përkeqësimit :

Shumë faktorë që paraprijnë sqarojnë paraqitjen e këtij fenomeni.

Bëhet fjalë :

- për një rrjet hidrografik të dendur
- për një pjerrtësi të lehtë të lumenjve që mundësojnë evakuim të dobët të ujit.
- Intensiteti dhe koha e zgjatjes së reshjeve
- Sipërfaqja dhe pjerrtësia e basenit ku derdhet uji
- Mbulimi vegjetal dhe kapaciteti i absorbimit të tokës
- Prania e pengesave në qarkullimin e ujërave

Situata mund të përkeqësohet në dalje të dimrit pas shkrires së borës në pranverë dhe në vjeshtë si pasojë e shirave të shumta apo të rrëmbyeshëm.

Karakterizimi i flukseve të vërshimeve :

- Vërshime që ndodhin pas një periudhe të shumë ditëve ose të shumë javëve të reshjeve të mëdha.
- Niveli i lumenjve rritet ngadalë, tërësia e rezervarëve mbushet.
- Një reshje madje edhe mesatare mund të shkaktojë dalje nga shtrati të lumenjve. Ky fenomen është mjaft i ngadalshëm për t'u paraparë lehtë dhe kjo ka të bëjë në përgjithësi me basenin ku derdhen ujërat.

Ato që vijnë nga reshjet jashtë zakonisht violente shpesh brenda disa orëve të shoqëruara me stuhi. Këto janë vërshime shumë të lokalizuara që zhvillohen brenda një kohe të shkurtër. Ato janë mjaft vështirë që të parashihen në mënyrë precize.

Skenarët më të mundshëm të vërshimëve:

VARIANTI I PARË:

- Nga mesi i muajt Shtator teritorin e Komunës së Deçanit e ka përfshi një vale e motit të lig me të reshura të mëdha shiu i përcjellur me erëra të forta deri në stuhi.
- Nga këto të reshura ka ardhë deri të rritja enorme e nivelit të ujit të rrjetit të lumejve dhe projeve e prockave në teritorin e Komunës së Deçanit.
- Gjithashtu, nga shkak i të reshurave intensive, ka ardh deri të stergopja e truallit me ujë dhe paraqitja e ujrave nëntokësore si dhe paraqitja e dukurive erosive dhe rrëshqitjes së dheut.

Nën ndikimin e faktorëve të lartë përmendur vjen deri të rritja enorme e nivelit të ujit të Lumit të Lloqanit i cili në një situatë të tillë do të vërshoj lokalitetin poshtë rrjedhes së tij duke filluar në jug të fshatit Prejlep; pjesen veriore të Rostovices; Baballoqin deri në Jasiq të Ri.

Nga një situatë e tillë do të pësojnë ekonomit familjare, rrezikohet jeta dhe shëndeti i banorëve të fshatrave të cilat gjinden përgjatë rrjedhes së këtij lumi, demtohet infrastruktura rrugore si dhe rrjeti i ujësjellësit që është i shtrirë në këto fshatra.

VARIANTI I DYTË:

Në fshatin Lloqan, në shtratin e Lumit të Lloqanit gjindet e ndertuar diga (penda) mbrojtëse e cila është e stermshur me rërë, zhavor, gur, drunj dhe materje tjera të cilat gjatë të reshurave të mëdha atmosferike uji i lumit i ka sjellë dhe deponue në këte digë.

Diga, nën presionin e masës së grumbullar dhe demtimit të bazamentit të saj nga proceset erosive, veshtir se do të përballon.

Me shpërthimin e saj do të vjen deri të bartja e masës së deponuar e cila është në sasi të pa llogaritëshme.

Nën veprimin e rrymave të ujit dhe vuarjes në levizje të kësaj mase do të rrezikohen urat mbi këte lum si:

- ura e Kasumëve,
- ura në aksin rrugor Carrabreg i Ep. – Drenoc,
- ura e Bajramhasanëve në aksin rrugor Deçan – Gjakovë
- ura në fshatin Prejlep dhe urat në fshatin Baballoq dhe Gramaqel.
- si dhe aksi rrugor ura e Kasumëve-Lloqan.

Kjo situatë do të shkaktonte ndërprerjen e komunikacionit urban dhe atij rajonal.

Kanali i Liqenit të Radoniqit:

Kanali i cili furnizon me ujë liqenin artificial të Radoniqit nga Lumi i Deçanit e ka të ngritur digën furnizuese të Verrat e Llukës. Kanali është i gjatë 8 km dhe kalon nëpër këto vendbanime të komunës së Deçanit: Llukë e Epërme, Pozhar, Kodrali, Irzniq (lagja Dodaj dhe Mushkolaj) dhe vazhdon përgjatë fushës në veri-lindje të Irzniqit. Përgjatë kanalit nga të dy anët e tij është e dëmtuar ose e hjekur fare rrjeta mbrojtëse e telit së bashku me shtyllat e betonit. Nuk egzistojnë zingjirët për shpëtim të cilët kanë qenë të vendosur në të gjitha kaskadat e kanalit si dhe mbrojtëset anësore të urave janë hjekë ose dëmtuar në atë masë sa që nuk paraqesin mbrojtje të sigurtë për kalim.

Në veçanti, vendi i derdhjes së ujit nga kanali në liqe paraqet rrezik të posaqem nga shkaku se uji ka krijuar një kanjon të thellë 20 deri 25m me brigje shumë të rrëpishme dhe mundësi të mëdha erosive përmasash katastrofike për ambientin për rreth e tragjike për barite dhe kafshët shtëpijake.

Shiqur në aspektin e sigurisë ky kanal paraqet rrezik përmanent për banorët e fshatrave nëpër territorin e të cilave kalon si dhe për kalimtarët e rastit, fëmijët, nxënësit dhe kafshë shtëpijake.

Kanali gjatë periodes kohore :vjeshtë-dimër-pranver ka sasi të madhe të ujit dhe rrjedhë të fuqishme e çdo ramje nëte ka përfundim tragjik.

Vrejtje e përgjithëshme:

Dukuria e ndertimit të shtëpive për banim në zona të cilat janë përher të ekspozuara vershimeve dhe zona erozive pran brigjeve të lumejve dhe projeve dhe në sipërfaqe ku grumbullohen sasi të mëdha të ujrave sipërfaqësore siq është rasti në Prejlep, Baballoq, Gramaqel dhe Jasiq i Ri, dhe kjo falë mungesës legjislative dhe neglizhences së faktorëve të urbanizmit.

Gjithashtu, është vërtetuar se në vazhdimësi janë duke u ngulfat shtretërit e lumenjve dhe projeve si pasojë e hedhjes së mbeturinave inerte dhe të amvisërisë si dhe mbjellja e trungjeve të verrave dhe shelgjeve mu në shtratin e lumit dhe projeve nga ana e pronarve, tokat e të cilëve gjinden pran dhe me këte është duke u ngushtuar fyti kapërdimës i ujit dhe rritja e mundësisë së vërshimeve.

Kjo dukuri është veçanërisht e theksuar përgjatë rrjedhës së Lumit të Lloqanit duke filluar që nga fshati Lloqan e deri në Jasiq të Ri, si dhe në shtratin e Prronit të Behovcit në Lokalitetin e Zallit të Strelcit.

Kjo dukuri e ngushtimit të shtratit të lumejve paraqitet shumë ashpër në shtratin e Lumit të Lloqanit në këto lokalitete:

1. Lloqan: afër Lagjes Tolaj përgjatë shtratit të Lumit në krahun e majtë të tij janë mbjellur drunjw si Verra dhe Shelnje mu në shtratin e lumit, duke u devijuar rrjedha e lumit në drejtim të aksit të rrugës Regjionale Carrabreg - Voksh.
2. Shtrati i të njëjtit lum është ngushtuar në të dy krahët e tij të ura në aksin rrugor Carrabreg i Ep. – Drenoc nga shkaku i hedhjes së mbeturinave inerte në shtratin e lumit.
3. Në Zonën kadastrale të fshatit Prejlep, në lokalitetin “Rakitat”, përshkak të mbjelljes së drujve në shtratin e lumit si dhe të hedhjes së mbeturinave inerte në te, gjithashtu është ndryshuar drejtimi i Lumit duke i rrezikuar pronat në krahun e djathtë të tij.

Ngushtime të shtretërve të lumenjve



Lloqan



Carrabreg i Ep.



Strelc i Ep.



Prejlep

1.1.4. Infrastruktura e ndërtuar për ujitje dhe mbrojtje nga vërshimet:

Në rrjedhën e këtyre lumejve ja në ndërtuar për ujitje katër (4) kanale të betonuara:

- kanali derivues i liqenit artificial të Radoniqit.,
- kanali ujitës Deçan – Lumbardh,
- kanali ujitës Hulaj – Lloqan
- kanali ujitës Deçan – Drenoc
- kanali ujitës Prapaqan
- kanali ujitës Isniq-Lëbushë-Strelc
- kanali ujitës Hulaj- Dranoc
- kanali ujitës Prokolluk- Glogjan
- kanali ujitës Pobergj- Polana

Dy penda ujë ndarëse:

- penda të Verrat e Llukës dhe
- penda të Llugat e Deçanit (poshtë manastirit) dhe pjesërisht i rregulluar shtrati i Lumit të Loqanit në fshatin Prejlep në gjatësi 1250 m.

Me qëllim të pengimit të proceseve erozive në disa shtretër të projeve të teritorit të komunës janë ndërtuar:

Penda erozive:

Në shtretërit e këtyre projeve:

► Prroni i Lëbushës – nje objekt (pendë), e cila është e ndërtuar për pengimin e vërshimit të aksit rrugor Deçan-Pejë në lokacionin e fshatit Lëbushë.

► Prroni Behvcit – mbi të cilin është ndërtuar një pendë dhe 2 mure mbrojtëse në krahun e majtë të prronit me qëllim të pengimit të vërshimit të Lagjes Hajrizaj në Strelc të Ep. dhe në shtratin e

► Prronit të Durakit, përgjatë rredhës së tij, janë të ndërtuara 8 penda: të cilat janë ndërtuar me qëllim të pengimit të erozionit të shtratit dhe brigjeve të këtij prroni dhe pengimin e vërshimit të aksit rrugor Deçan-Pejë, gjegjësisht distancën rrugore Strelc i Ep. – Lybeniq (teposhtëza e Strelc-it)

TABELA E OBJEKTEVE TË NDERTUARA NË RRJEDHAT E LUMEJVE DHE PROJEVE NË TERITORIN E KOMUNES SË DEÇANIT

	Lumejt dhe projekt	Ura	Penda	Mure mbrojtëse	Kaptazha për ujitje	Rregullim shtrati	Vërejtje
1	Lumbardhi i Lloqanit	9	2	/	1	1	Shtrati i rregulluar 1600 m.-f.Prejlep
2	Lumbardhi i Deçanit Kanali i ujitjes Deçan-Lumbardh	11	/	2	2	1	Ne vitin 2018 ka filluar rregullimi i shtratit si dhe ndërtimi i shëtitoreve nga te dyja anët e lumit.
3	Projet e Vokshit	5	/	/	/	/	
4	Prroni i Selishtave	1	/	/	/	/	
5	Prroni i Lëbushes	1	5	/	/	/	
6	Prroni i Behovcit	6	3	2	/	1	
7	Prroni i Durakit	2	8+5	/	/	/	
8	Kanali i Radoniqit	11	/	/	/	/	I rregulluar në gjatësi 8km.
9	Lumbardhi i Pejës	1					Vranoc i Vogel
	Gjithësejt	47	18+5	4	5	1	

1.1.5. Rrezikimi i mundshëm i banorëve, të mirave materjale, kulturore dhe të ambientit nga vërshimet

Vërshimet në Deçan manifestohen duke shkaktuar lëndime në njerëz, dëme të konsiderueshme në të mira materiale, pronë, infrastrukturë vitale (kritike), objekte të rëndësishme të veçantë, ambient dhe njëkohësisht, shpesh kanë rrezikuar edhe trashëgiminë kulturore. Gjithashtu vërshimet shkaktojnë edhe dëme të konsiderueshme ekonomike.

1.1.6. Të dhënat statistikore të vërshimeve për muajt kritik të vitit:

Lumi / Prroni	Muajt kritik	Zona vërshuese	Përioda koho. e zgjatjes së versh.
Duraku	- nëntor, - dhjetor, - shkurt - mars.	Aksi rrugor Strellc i E. - Lubeniç	Nga dy ditë deri në dy javë, kjo në varshmëri me kohëzgjatjen dhe intenzitetin e të reshurave dhe intenzitetin e shkrirjes së borës
Behovci		Lagja Hajrizaj, Zalli i Strellcit (aksi rrugor Strellc-Lëbushë) ; Lagja e Bruçve dhe Osmanaj (Isniç); fshati Dubovikë.	
Lumi i Lloqanit		Fusha në lindje të fshatit Prejlep; fusha Devolle e fshatit Baballoq; f. Baballoq; lagjet Regaj dhe Mushkolaj në fshatin Gramaqel dhe fshati Jasiç i Ri.	
Lumi i Deçanit		Fshati Vranoc (ura Vranoc i Vogël – Vranoc i Madhë)	

1.1.7. Lokacionet kritike të vërshimeve dhe vlerësimi i shkallës së rrezikëshmerisë:

Vërshimet janë definuar si akumulim i ujit në kuader të sasisë së ujit dhe derdhja e ujrave të tepërta nga shtrati i lumit në ambientin e afërt .

Pos kushteve meteorologjike, egzistojnë edhe faktorë të tjerë në ndodhjen e vërshimeve si:

- Rrjedha e rrëpishme e lumenjve me disnivel të lartë
- Brigjet e ulta të shtratit të lumenjve
- Mungesa e sipërfaqeve të pyllëzuara
- Pyjet e degraduara
- Mos rregullimi i shtratit dhe brigjeve të lumit
- Mungesa e ngritjes së digave (pritave)
- Eksploatimi pa kriter i rërës dhe zhavorit
- Mungesës së legjislacionit dhe në fundë
- Prireja e jonë për hudhjen e mbeturinave të të gjitha llojeve në shtratin e lumenjve.

Kushtet klimatike diktojnë regjimin e reshjeve atmosferike në teritorin e Komunës së Deçanit që karakterizohet me reshje të mëdha shiu gjatë sezonës së pranverës dhe vjeshtës së vonëshme e që për pasojë ka ndodhjen e vërshimeve meqenëse shtretërit e lumenjve, relativisht të cekët, nuk mund të përballojnë sasi të mëdha të ujit dhe rrjedhës së shpejtë të tyre.

Pothuajse të gjitha fshatrat e Komunës së Deçanit, pak a shumë janë të prekura nga rreziku i vërshimit:

- vërshimet pas stuhive ne zonat malore,
- vërshimet pas shirave te vazhdueshme ne zonat fushore
- vërshimet pas shkrirjes se borës te shoqëruara apo jo me mot të lig.

Natyrisht Komuna e Deçanit është e ndjeshme ndaj vërshimeve dhe këto ndodhin shpesh.


Vërshimet e fundit katastrofike në Komunën e Deçanit kanë ndodhë në nëntor të vitit 1979 kanë prekur më shumë se 1100 persona, duke shkaktuar edhe dëme të konsiderueshme materiale.

- Ndërsa vërshimet e fundit në komunën tonë kanë ndodhur me datë 03.02.2018 duke shkaktuar vërshime të mëdha në Deçan, Carrabreg, Dranoc, Prilep, Baballoq si dhe Isniq. Pasoja në njerëz nuk ka pasur vetëm dëme materiale që kapen shumen 330.000€


Duke marrë parasysh kushtet klimatike që dominojnë në komunën tonë me shtim enorm të të reshurave atmosferike gjatë sezonave vjeshtë- dimër- pranverë, pastaj disnivelit të burimit të lumenjve deri në teritoret urbane me rrjedhë të fuqishme dhe të furishme e sasi të madhe të ujit, mundësi të bartjes së materialit drunor, guror, rërës dhe zhavorit plus mbeturinat e hedhura të hekurishtave, betonarmes e shasit e automjeteve ,është konstatuar dhe vlerësuar se këta lumenj dhe proje në mënyrë të pashmangëshme do të dalin nga shtrati duke vërshuar jo vetëm token bujqesore por edhe rrezikue njërezit dhe shtëpitë e tyre.

Veçanërisht vërshimet janë të theksuara nga Prroni I Behovcit I cili mund të rrezikoi :

- Lagjen Hajrizaj dhe aksin rrugor Pejë –Deçan Strelc të Epërm ,
- Lagjen e Bruqve në Isniq
- Fshatin Dubovikë
- Prroni i Durakut në Strelc të Epërm rrezikon Lagjet Shabanaj dhe Curraj si dhe aksin rrugor Deçan-Pejë në vendin e quajtur “Teposhtëza e Strelcit”
- Mundësija e vërshimit të tokës bujqesore dhe erozioni i brigjeve të Lumbardhit të Deçanit dhe Lumbardhit të Lloqanit .
- Zgjidhje urgjente duhet bërë për parandalimin e vërshimit të lumbardhit të Lloqanit në hyrje të fshatit Baballoq i cili kërcënohet dhe vërshohet rregullisht gjatë të reshurave atmosferike,
- Si dhe Lagja Mushkolaj në Gramaqel dhe fshati Jasiq i Ri etj.



Harta Nr. 1





Zonat vërhuese në Komunën e Deçanit: harta Nr.1 dhe 2

ZONAT E VËRSHIMIT TË LUMEJVE DHE PRROJEVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

Nr.	LUMI ose PRRONI	FILLIMI I ZONËS VERSHUESE	LOKALITETET E ZONËS VERSHUESE	MBARIMI I ZONËS VERSHUESE	GJATËSIA E ZONËS VERSHUESE	VREJTJE
1	LUMI I LLOQANIT	Izohypsa 520 (në lindje të fshatit Prejlep)	Fusha në lindje të fshatit Prejlep; fusha Devolle e fshatit Baballoq; f. Baballoq; lagjet Regjaj dhe Mushkolaj në fshatin Gramaqel dhe fshati Jasiq i Ri.	Fshati Jasiq i Ri	4700 m.	
2	LUMI I DEÇANIT	Ura e Demës – Deçan (aksi rrugor Deçan – Pejë)	Fusha në veri të Deçanit; Llukë e Ep.dhe e Ultë: Lumbardh Kotradiq dhe Vranoc	Fshati Vranoc (ura Vranoc i Vogël – Vranoc i Madhë)	12500 m.	Vershime me tendenca të theksuara të proceseve erozive
3	PRRONI I BEHOVCIT	Izohypësa 700 – lagja Hajrizaj në Srellc të Ep.	Zalli i Strellcit; Isniq (lagja e Bruqëve) dhe f. Dubovikë.	Fshati Dubovikë (izohypsa 520)	6000 m.	
4	PRRONI I DURAKUT	Izohypsa 700 në veri të f.Strellc i Ep.	Aksi i magjistrales Strellc-Lubeniq	Ura afër udhëkryqit të fshatit Lubeniq	600 m.	

Vërshim në Zonë Urbane



Kategoria e rrezikut	Hidrologjike	
Lloji	Fatkeqësi natyrore	
Rreziku	Vërshim + Erozion	
Modeli	Sezonal	
Lokacioni	Lagjja Tolaj - Lloqan	

Historiku

Në Komunën e Deçanit janë dy periudha kohore ose stinë të vitit që karakterizohen me vërshime: Stina e dimrit për shkak të reshjeve të shumta të borës dhe stina e pranverës dhe vjeshtës për shkak të reshjeve të shumta të shirave.

Situatat më të rënda paraqiten jo në mënyrë të menjëhershme, zakonisht kur fillon shkriuara e borës dhe kur kemi shira me kohëzgjatje dy-tri ditësh.

Karakteristike janë edhe vërshimet që vijnë nga reshjet jashtëzakonisht violente shpesh brenda disa orëve të shoqëruara me stuhi. Këto janë vërshime shumë të lokalizuara që zhvillohen brenda një kohë të shkurtër. Ato janë mjaft vështirë që të parashihen në mënyrë precize

Shikuar në mënyrë vizuale, është e evidente se muajt me reshje më të mëdha të borës janë janari dhe shkurti kurse muajt me reshje më të mëdha të shirave janë: Marsi, prilli, tetori dhe nëntori.

Klima e Komunës së Deçanit është kryesisht kontinentale me disa ndikime mesdhetare dhe alpine, verërat janë të nxehta dhe dimrat të ftohtë. Tempëraturat ekstreme shkojnë deri në + 39/40° C në verë dhe – 20 °C në dimër. Për arsye të relievit me kontraste, në Kosovë ekzistojnë variacione termike të mëdha në mes të zonave më të nxehta dhe zonave më të freskëta. Faktori tempëraturë ndërhyjë pak, si zakonisht, në shpjegimin e ndjeshmërisë së vërshimeve, përveç ndoshta në dy situata krejt të veçanta.

Në vlera ekstreme për përkeqësimin e situatës për disa ditë: ky do të mund të ishte rasti gjatë pranverave dhe vjeshtave me shira të shpeshta, dhe dimrave me reshje të shpeshta dhe të mëdha bore.

Deçani nuk është një regjion me shumë erëra: në përgjithësi erërat janë të dobëta dhe të mesme. Një drejtim i veçantë i erës tashmë është konstatuar e ai është drejtimi i veriut.

Tempëraturat dimërore mund të arrijnë minus 20 gradë dhe bora është e shpeshtë edhe në zonat fushore.

Mungesa e ujit mund të jetë e madhe. Komuna e Deçanit, një vend me një sektor rural të madh ka rregullisht periudha të vapës së madhe që mund të shkaktojnë një gjendje të thatësisë e që krijon pastaj gjatë vërshimeve erozione të konsiderueshme.

Largësia nga deti, reliefi i Komunës së Deçanit me kodrina, dhe pyjet e mbuluara me vegjetacion që shkaktojnë një frenim natyror, limitojnë forcën e erës, në veçanti në raport me regjionet e fushës që e rrethojnë.

Megjithatë rreziku i stuhisë duhet të merret parasysh, sidomos sa i përket vërshimeve të shpeshta që shkaktohen në pranverë dhe në vjeshtë.

Për të konkluduar mund të themi se rreziku i vërshimit është shumë i shpeshtë, kryesisht për arsye të shirave shpeshherë të shumta dhe stuhive ose një periudhe të gjatë të motit të lig, të shoqëruar me një rrjet të evakuimit të ujërave të shiut jo adekuat dhe me një sistem të alarmimit meteorologjik jo ekzistues.

Vërshimet në Komunën e Deçanit, shikue në bazë të historikut të ndodhjes së tyre shohim se ato janë të shpeshta (2-3 herë) gjatë vitit dmth me gjasa shumë të mundëshme dhe me një efekt deri të mesem.

Në Komunën e Deçanit, vetëm në vitin 1979 kanë ndodhë vërshime me një efekt serioz.

Gjendja

LUMBARDHI I LLOQANIT KA SASI DHE RRIJJE ENORME TË NIVELIT TË UJIT, VALET E FUQISHME TË UJIT JANË DUKE SJELLË ME VEHTË SASI TË MËDHA MATERJALI DRUNOR, GURË, ZALL ETJ. E GJITHË SASIA E UJIT DHE MATERJALET E NGURTA QË I SJELLË RRYMA E UJIT DUKE FILLUAR NGA DIGA MBROJTËSE E CILA GJINET NË AFËRSI TË LAGJES TOLAJ, PËRPLASEN FURISHEM NË KRAHUN E MAJTË TË LUMIT NË NJË GJATËSI 100 – 150 M. DUKE E GËRRYAR BREGUN E MAJTË TË TIJ.


NGA KY VEPRIM I RRYMAVE TË UJIT, NË DREJTIM TË QESTES, NË NJË DISNIVEL RRETH 80 M. NGA SHTRATI I LUMIT DHE NË NJE GJATËSI AFËR 180 M. E THELLËSI DERI 10 M. (SIPAS VLERSIMIT TONE) JANË KRIJUAR PLASARITJE TË CILAT KANË TENDENCË RRIJJE, E QË PËR PASOJ DO TË KETË RRËSHQITJEN E DHEUT NË SASI TË PA LLOGARITËSHME.

- A. DIGA MBROJTËSE E CILA GJINET NË ZONËN E NDODHJES EMERGJENTE ËSHTË E STERMBUSHUR ME MATERJALE TË CILAT ËSHTË DUKE I SJELLË RRYMA E UJIT,
- B. POSHTË MURIT MBROJTËS TË DIGËS UJI ËSHTË DUKE E GËRRYER BAZAMENTIN E DIGËS,
- C. NË DIGËN MBROJTËSE JANË VREJTUR TË QARAT E PARA,
- D. NË KËTË GJENDJE DHE NGA EFEKTI I PESHËS SË MATERIALIT TË GRUMBULLUAR DIGA VËSHTIRË SE DO TE MUND TË PËRBALLON GJATË.

MBI URË TË KASUMËVE , NGA VEPRIMET E UJIT, DUKËSHEM ËSHTË DUKE U RREZIKUAR AKSI I RRUGËS RAJONALE DEÇAN – VOKSH DHE QARKULLIMI I AUTOMJETEVE NË KËTË PJESË TË RRUGËS ËSHTË MJAFT I PA SIGURTË. REZIKOHEN 7 SHTËPI ME 35 BANOR, NESE NUK VJEN DERI TE NDERPRERJA E TË RESHURAVE BRENDA 6 DERI 10 ORË.

Sasia

Gjasat



Goditja

- NUMËR I KUFIZUAR I FAMILJEVE TË GODITURA, PA PASOJA DHE EFEKTE TJERA. PËR KOMUNITETIN.
- Zhvendosje e lokalizuar e banorve të rrezikuar në lagjet tjera të fshatit lloqan.
- Gjendja paraqitet e ashpër për ambientin shkak të pruerve të masës drunore, , gurve dhe lymit.
- Nga mundësia erozive e bregut të majtë të lumit do të paraqiten efekte dytësore për ambientin.
- Mbështetje e mjaftueshme nga niveli lokal.
- S' ka kontaminim të ujit për pije.

Banor	Familje	Hendikap	Femra	Meshkuj	Fëmijë	Pleq	Të mira materiale	Infrastrk. kritike	Ob. të rëndësishë veçantë	Trashegimia kulturore	Demët ekonomike
42	7	/	25	17	13	7	-ushqime, -veshëmb. -mobileri etj	-aksi i rrugës rajonale	/	/	25.000

SITUATA E PËRGJITHËSHME:

Bora me trashësi mbi 80cm që kishte rënë disa ditë me radhë në teritorin e Komunës së Deçanit, ka filluar të shkrihet si pasojë e temperaturave të larta ndikuar nga pasojat e ngrohjes globale. Kjo shkrije e shpejtë ka bërë që vërshimet të mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të teritorit të Komunës së Deçanit, duke rrezikuar njerëzit dhe shkaktuar shkatërrime në pasuri, në rrugë, ujësjellës, kanalizime, rrjetin elektrik, paralizimin e shërbimeve emergjente dhe shërbimeve tjera për qytetarë. Numri i personave që duhet evakuuar për një kohë 10 deri 15 ditë është mbi 150 në tërë teritorin e Komunës së Deçanit:

- NGA KËTO TË RESHURA KA ARDHË DERI TË RRITJA ENORME E NIVELIT TË UJIT TË RRJETIT TË LUMEJVE DHE PRROJEVE E PRROCKAVE NË TERITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT.
- GJITHASHTU, NGA SHKAKU I TË RESHURAVE INTENSIVE, KA ARDHË DERI TË STERNGOPJA E TRUALLIT ME UJË DHE PARAQITJA E UJRAVE NËNËTOKËSORE SI DHE PARAQITJA E DUKURIVE EROSIVE DHE RRSHQITJES SË DHEUT.
- FACTORËT E LARTË CEKUR KANË NDIKUAR NË PARAQITJEN E PLASARITJEVE TË TRUALLIT NË ZONAT PRANË BRIGJEVE TË LUMEJVE.

SKENARI – 1:

LUMBARDHI I LLOQANIT KA SASI DHE RRITJE ENORME TË NIVELIT TË UJIT, VALET E FUQISHME TË UJIT JANË DUKE SJELLË ME VEHTË SASI TË MËDHA MATERJALI DRUNOR, GURË, ZALL ETJ. E GJITHË SASIA E UJIT DHE MATERJALET E NGURTA QË I SJELLË RRYMA E UJIT DUKE FILLUAR NGA DIGA MBROJTËSE E CILA GJINET NË AFËRSI TË LAGJES TOLAJ, PËRPLASEN FURISHEM NË KRAHUN E MAJTË TË LUMIT NË NJË GJATËSI 100 – 150 M. DUKE E GËRRYAR BREGUN E MAJTË TË TIJ. NGA KY VEPRIM I RRYMAVE TË UJIT, NË DREJTIM TË QESTES, NË NJË DISNIVEL RRETH 80 M. NGA SHTRATI I LUMIT DHE NË NJE GJATËSI AFËR 180 M. E THELLËSI DERI 10 M. (SIPAS VLERSIMIT TONE.) JANË KRIJUAR PLASARITJE TË CILAT KANË TENDENCË RRITJE, E QË PËR PASOJ DO TË KA RRSHQITJEN E DHEUT NË SASI TË PA LLOGARITËSHME.

SKENARI – 2:

- ⇒ DIGA MBROJTËSE E CILA GJINET NË ZONËN E NDODHJES EMERGJENTE ËSHTË E STERMBUSHUR ME MATERJALE TË CILAT ËSHTË DUKE I SJELLË RRYMA E UJIT,
- ⇒ POSHTË MURIT MBROJTËS TË DIGËS UJI ËSHTË DUKE GËRRYAR BAZAMENTIN E DIGËS,
- ⇒ NË DIGËN MBROJTËSE JANË VREJTUR TË QARAT E PARA,
- ⇒ NË KËTË GJENDJE DHE NGA EFEKTI I PESHËS SË MATERIALIT TË GRUMBULLUAR DIGA VËSHTIR SE DOTE MUND TË PËRBALLON GJATË.

MBI URË TË KASUMËVE , NGA VEPRIMET E UJIT, DUKËSHËM ËSHTË DUKE U RREZIKUAR AKSI I RRUGËS RAJONALE DEÇAN – VOKSH DHE QARKULLIMI I AUTOMJETEVE NË KËTË PJESË TË RRUGËS ËSHTË MJAFT I PA SIGURTË.

REZIKOHEN 7. SHTËPI ME 35 BANOR, NESE NUK VJEN DERI TË NDERPRERJA E TË RESHURAVE BRENDA 6 DRI 10 ORË.

- ⇒ GJATË INSPEKTIMIT NË ORA _____ NGA FAMILJARËT E FAMILJES TOLAJ MOREM NJOFTIMIN SE NJË FËMIJ I TYRE I MOSHËS 5 VJEQARE KA HUMBUR.

E. ME MARJEN E KËSAJ INFORMATE, ME ANË TË RADIOLIDHJES KEMI KONTAKTUAR DHE KËRKUAR NDIHMË NGA "DRINI" PËR GJETJEN E FËMIUT.

F. NË ORA _____ EKIPI I KËRKIM SHPETIMIT NGA BRIG.E ZJARRFIKJES KA FILLUAR KËRKIMIN E FËMIUT TË HUMBUR,


G. EKIPI FILLIMISHT KA FILLUAR KREHJEN E BRIGJEVE TË LUMIT KU BESOHE TË JETË STRUKUR FËMIU,

EKIPI I KËRKIM SHPETIMIT, PAS 30MIN. KËRKIMI INTENZIV E GJETI FËMIUN NË SHKURRE PRANË BRIGJEV TË LUMIT NË GJENDJE TË PËRKEQËSUAR SHENDETËSORE DHE TË NJEJTIN EKIPI EMERGJENT DHENDETËSOR E MORI NËN PËRKUJDESJE DHE E DERGO PËR TRAJTIM MJEKSOR NË QENDREN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE NË DEÇAN.

SKENARI –3:


1. ZONA EMERGJENTE NDODHET NË KUADRATIN V: _____ DHE L : _____ TË FLETËS SË HARTËS TOPOGRAFIKE PEJA – 4.

- ⇒ PIKA KRITIKE V : 42° 31' 37" DHE L: 20° 16' 49" TË SË NJEJTËS HARTË.
- ⇒ RESHJET ATMOSFERIKE ,ME KALIMIN E KOHËS, JANË DUKE U SHTUE NË INTEZITETIN E RAMJES.
- ⇒ SIPAS PARASHIKIMEVE ATMOSFERIKE EDHE PËR 24 ORËT E ARDHËSHME NUK KAN TË NDALUR.
- ⇒ LUMI , GJITHËNJE E MATEPËR KA RRITJE TË NIVELIT TË UJIT DHE PRUERJE TË MËDHA TË MATERJALEVE TË NDRYSHME TË NGURTA.
- ⇒ NGA KJO PESHË DHE GRRYERJA E BAZAMENTIT TË DIGËS , NË MURET MBROJTËSE TË SAJ JANË PARAQITUR TË QARAT E PARA,
- ⇒ GJITHASHTU, NGA VEPRIMET E UJIT, NË ANËN E MAJT TË LUMIT NË DREJTIM TË LOKACIONIT TË QESTES KA FILLUE RRSHQITJA E MASËS SË DHEUT NË DREJTIM TË SHTRATIT TË LUMIT,
- ⇒ ME KRIJIMIN E KËSAJ GJENDJE KEMI KËRKUE NGA "DRINI" QE NGA KOMITETI KOMUNAL PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM TË VPROHET SIPAS FAZËS 2. TË KRITEREVE PËR MBROJTJE NGA VËRSHIMET,



HARTA E ZONËS VËRSHUESE

Vërshim në Zonë Urbane dhe Fushore



Kategoria e rrezikut	Hidrologjike
Lloji	Fatkeqësi natyrore
Rreziku	Vërshim
Modeli	Sezonal
Lokacioni	Strellc-Isniq-Dubovik



Historiku

Prroni i Behovcit buron në shpatijet e Bjeshkes së Strellcit dhe rrjedha e tij kalon në mes të dy fshatrave: në krahun e majt të tij gjindet Strellci i Ep. kurse në krahun e djathtë gjindet Lëbusha. Historia e vershimeve të këtij prroni është mjaft e bujshme. Vershimet e tij mund të jenë përmasash katastrofike.

Në pesën e epërme të rrjedhes së Behovcit, afër lagjes së Hajrizajve, janë të ndertuara tri penda mbrojtëse të cilat janë të mbushura plotësisht me materiale të ngurta të cilat i ka sjellë uji nga shpatijet e Bjeshkës së Strellcit.

Digat, në gjendjen e tanishme, janë jashtë funksionit të tyre meqenëse përshkak të mushjes së tyre nuk ka ndalje të materjaleve të cilat i sjellin rrymat e ujit.

Digat janë në procesin e shkatrrimit për shkak të mos mirëmbajtjes dhe pastrimit të tyre.


Egziston rreziku përmanent i shpërthimit të tyre. Masa e materjaleve nga digat nën presionin e ujit do të vershon në gjithë hapësirën poshtë digave duke krijuar përmytje katastrofike të fushave dhe ekonomive familjare të fshatrave Lëbush, Strellc, Isniq, Dubovikë etj.

Gjithashtu do të shkatërrohen urat dhe aksi rrugor në lokalitetin e Zallit të Strellcit dhe me këte edhe ndërprerja e komunikacionit Pejë – Deçan – Gjakovë.

Ndikimi:

- ⇒ Njerzit,
- ⇒ Ekonomit familjare,
- ⇒ Të mirat familjare,
- ⇒ Infrastruktura,
- ⇒ Ndotje e ambientit

Gjasat
↑



Efekti

Goditja	<ul style="list-style-type: none"> - NUMER I KUFIZUAR I FAMILJEVE TË GODITURA, PA PASOJA DHE EFEKTE TJERA. PËR KOMUNITETIN. - GJENDJA PARAQITET E ASHPËR PËR AMBIJENTIN SHKAK TË PRUERVE TË MASËS DRUNORE, , GURVE DHE LYMIT. - QARKULLIM I KUFIZUAR I NJERZËVE E AUTOMJETEVE BËHET NËN PËRKUJDESJE TË POLICISË NË PIKAT KRITIKE - MBËSHTETJE E MJAFTUESHME NGA NIVELI LOKAL. - KONTAMINIM TË UJIT PËR PIJE dhe EFEKTE TJERA.
----------------	--

Komuniteti	Banor	Familje	Hendik	Femra	Meshk	Fëmijë	Pleq	Të mira materiale	Infrastrk. kritike	Ob. të rendësisë veçantë	Trashegimia kulturore	Demët ekonomike
	200	25	?	?	?	?	?	-orindi - veshmba. -ushqim, -ushqim Kafshësh -të mbjellura, - degradim i fushave.	-Urat -pendat -akset rrugore -rrjeti i ujësjellësit -etj.	/	/	2500-50000€

Pasojat	<p><u>PASOJAT DIREKTE:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. RREZIKOHEN NGA PËRMBYTJA _____ FAMILJE ME _____ ANËTAR FAMILJE DHE TË MIRAT MATERIALE . 2. Zhvendosje e lokalizuar e banorve të rrezikuar të fshatit Strellc, Isniq dhe Dubovik 3. RREZIKOHET NGA PËRMBYTJA DHE PROCESET EROZIVE MAGJISTRALJA PEJE-DEÇAN 4. RREZIKOHEN URAT E AKSIT RRUGOR NE LOKALITETIN ZALLI I STRELÇIT. 5. DEGRADIM I SHTRATI TË LUMIT 6. NESE NDODH RRËNIMI I DIGËS MBROJTËSE DHE MURIT MBROJTËS NE LAGJEN HAJZERAJ DO TE RREZIKOHEN SERIOZISHT BANORËT E KESAJ LAGJE. <p><u>PASOJAT E ME VONSHME:</u></p> <p>1.SHPËRTHIMI I DIGËS DHE MASES SE MATERJEVE TE GRUMBULLUARA, NGA PRESIONI I UJIT TË PRRONIT NË KËTË VENDNDODHJE, DO TË VJEN DERI TË PËRMBYTJA E FUSHES NË RRJEDHEN E POSHTËME TE PRRONIT DHE DEPONIMI I MATERJALEVE LYMORE DHE INERTE NË FUSHË, QË PËR PASOJ DO TË KETË DEGRADIMIN E FUSHAVE PJELLORE DHE VONES NE MBJLLJET PRANVERORE.</p> <p>2. NDOTJE E AMBIJENTIT</p>
----------------	---

Vërejtje	Në vitet e fundit është intervenuar në këtë pjesën e epërme ku është ndërtuar ura te Mulliri i Hajrizve, gjithashtu edhe në rrugën “Ramë Kameraj” është ndërtuar një urë, ku këto investime në një mase të madhe kanë eliminuar mundësitë e vërshimeve në këto pjesë, dhe janë më pak të rrezikuar banorët dhe të mirat materiale të tyre.
-----------------	--

SKENARI- 1:

Në Komunën e Deçanit, gjatë 24 orëve të fundit, ka filluar që të bjerë shi pandërprer dhe si rezultat i këtyre të reshurave Lumi Lloqanit ka ngritje të nivelit të ujit. Në fshatin Lloqan, gjegjësisht banorët e Lagjes Tolaj, kanë filluar të shqetësohen për shkak të mundësisë të depërtimit të ujit në oborre dhe objekte banimi.

Skenari- II

Në Komunën e Deçanit nga mesi i muajt Nëntor 2018, ka filluar që të bjerë shi pandërprer dhe si rezultat i këtyre të reshurave lumi Lloqanit të delë nga shtrati dhe të rrezikoj familjet në Lagjen Tolaj në fshatin Lloqan dhe ne hyrje të fshatit Baballoq dhe Gramaqel (Lagja Mushkolaj) Po ashtu kemi edhe informata nga tereni që edhe fshati Jasiq i Ri është rrezikuar nga vërshimet.

Nepërmjet te Zyres Komunale për Alarmim dhe Koordinim Emergjent eshte lajmerue Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpetim, për ngritjen e nivelit te gatishmerise ne fshatrat e Komunes se Gjakoves nepër teritorin e te cilave kalon Lumi i Lloqanit.

Skenari -III

Komunën e Deçanit që nga fillimi i Marsit e ka përfshirë një mot i lig me reshje të pandërprera të shiut dhe shkrirjes së borës që kishte rënë disa ditë me heret , ku si pasojë, Prroni i Behovcit, ka rritje enorme të nivelit të ujit i cili ka gjasa reale të shkaktoj dëme të mëdha në infrastrukturë banimi, bujqësi, infrastruktur rrugore etj.

Diga në Lagjen Hajrizaj dhe muri mbrojtës i kesaj dige, për shkak të pruarjeve të mëdha të masës së madhe drusore, gurore dhe lymit veshirë se munde të përballon stuhinë e ujit. Shtrohet menjëher nevojja e evakuimit të popullatës së kësaj lagje dhe sigurimi i strehimit, ushqimit dhe nevojave tjera.

Gjithashtu pruarjet e mëdha të ujit seriozisht kanë rrezikuar Magjistralen Peje – Deçan, duke vërsuar trasenë në vendin e quajtur “Zalli i Strelcit”, ku janë dëmtuar edhe dy ura dhe për pasojë ka ardhur deri te ndërprerja e qarkullimit të automjeteve dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacion.

Ky aks është nën përkujdesjen e Policisë së Kosovës.

Sipas gjendjes së paraqitur duhet evakuar edhe Lagjen e Bruqve në fshatin Isniq si dhe të ngritet niveli i Gatishmerisë Emergjente në fshatin Dubovik.


- ME KRIJIMIN E KËSAJ GJENDJE, TË VEPROHET SIPAS FAZËS 2. TË KRITEREVE PËR MBROJTJE NGA VËRSHIMET,

KRITERET PËR SHPALLJEN E MBROJTJES NGA VËRSHIMET

KRITERET PËR SHPALLJEN E MBROJTJES NGA VËRSHIMET

e përgaditjeve për kryerjen e punëve, masave dhe aktiviteteve për mbrojtje nga vërshimet dhe shpallja e fazave të mbrojtjes nga vërshimet të cilat janë në kompetencë të Komunës

FAZAT E MBROJTJES NGA VËRSHIMET	KRITERET PËR SHPALLJEN E MBROJTJES NGA VËRSHIMET SIPAS FAZAVE	SHKALLA DHE LLOJET E AKTIVITETEVE, MASAT DHE PUNËT SIPAS FAZAVE TË MBROJTJES NGA VËRSHIMET
FAZA-1. PREGADITJET PËR MBROJTJE NGA VËRSHIMET	PREGADITJET PËR MBROJTJE DHE PARAQITJA E VËRSHIMEVE ; SHIRAT VËRSHUESE; RREBESHET E MËDHA TË SHIUT; SHIRAT ME INTENZITET TË MADH .	AKTIVITETET PREVENTIVE, MASAT DHE PUNËT GJATË PËRIODES PREGADITORE; ELIMINIMI PREVENTIV I SHKAQEVE POTENCIALE TË VËRSHIMEVE DHE ORGANIZIMI I MBROJTJES NGA VËRSHIMET.
FAZA-2. Mbrojtja e jashtëzakonshme nga përmbytjet (vërshimet)	Paralajmerimi dhe paraqitja e shirave vërshuese në kohëzgjatje të madhe,	AKTIVITETET E JASHTËZAKONËSHME, MASAT DHE PUNËT NË REALIZIMIN E MBROJTJES NGA VËRSHIMET, EVAKUM I KUFIZUAR I POPULLËSISË DHE TË MIRAVE MATERJALE
FAZA-3. GJENDJA E JASHTËZAKONËSHME DHE ELIMINIMI I PASOJAVE NGA PËRMBYTJET	PARALAJMERIMI DHE PARAQITJA E DERDHJES SE VALËVE VËRSHUESE NGA RRJEDHËJA THEMELORE NË KUSHTET E RESHJEVE TË PA NDËRPRERA.	GJENDJA E JASHTËZAKONËSHME, EVAKUIMI I POPULLATËS DHE TË MIRAVE MATERJALE, ELIMINIMI I PASOJAVE TË VËRSHIMIT.



ZJARRET

1.2. ZJARRET PYJORE:

Profili i Rrezikut	
REZIKU: ZJARRET NË SIPËRFAQE TË HAPURA	
MADHËSIA E MUNDSHME (PËRQINDJA E KOMUNITETIT QË MUND TË GODITET): Kritike: 25 deri 50%	
FREKUENCA E NDODHJES: <ul style="list-style-type: none"> • Shumë e mundshme: Mundësia afër 100%, së paku dy herë në vit. 	Modeli Sezonal: Pranverë: Shkurt-Mars Verë: Korrik - Gusht - Shtator
ZONAT QË MUND TË GODITEN MË SË SHUMTI: TËRË MASIVI I BJESHKËVE TË NEMUNA	
KOHËZGJATJA E MUNDSHME: NË PRANVERË PREJ 12 ORËVE DERI NË 3 DITË, NDËRSA NË VERË PREJ 15 DERI NË 30 DITË.	
SHPEJTËSIA E MUNDSHME E MËSYMJES (SHUMA E MUNDSHME E KOHËS SË PARALAJMËRIMIT): ➤ Paralajmërim 6 deri 12 orë.	
SISTEMET EKZISTUESE TË PARALAJMËRIMIT: SISTEMI I INTEGRUAR 112	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? Po	

Cënueshmëria nga goditjet në Faktorët Kyç të Komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Shkalla e goditjes në banorë gjatë kohës së Zjarrit në vendin e Incidentit e ashpër (dhjetëra vdekje dhe qindra lëndime të rënda, për shkak të daljes së banorëve në stane dhe në piknik)	E ashpër
Pasuria	Në shumë zona malore Banorët dalin në stane, dhe me vete marrin një pjesë të pasurisë së tyre.	E mesme
Infrastruktura Vitale	Dëmtimi i lartë përçuesve të tensionit të lartë, të Hidrocentralit "Lumbardhi"	E mesme
Objektet e Rëndësisë së Veçantë	mungesa e objekteve dhe infrastrukturës në zonat malore	E Ultë
Dëmet Ekonomike	shkatërrimi i masiveve pyjore, erozioni, rryllëzimi ...	E ashpër
Ambienti	për shkak të zjarreve të mëdha dhe tymit dëmtohet mjedisi si dhe krijohen parakushtet për erozion masiv	E ashpër
Trashëgimia Kulturore	dëmtimi i vegjetacionit, flora, fauna, speciet e veçanta dhe pikat turistike	E ashpër
Shërbimet shtetërore	nuk ka infrastrukturë që do të dëmtohej ose paralizohej.	E Ultë
Shërbimet Emergjente	Dëmtime të pajisjeve të Njësive reaguese(NJPZSH).	E kufizuar

1.2.1. Karakteristikat meteorologjike dhe ndikimi i tyre në shkaktimin e zjarreve pyjore:

Pyjet e Komunës së Deçanit janë të prirura për të u prekur nga zjarret gjatë gjithë vitit e sidomos në pranverë dhe gjatë verës jashtëzakonisht të nxehtë dhe të thatë.

Shkaqet e zjarreve janë në radhë të parë me karakter:

- 1 Antropogjenik (pa kujdesia e njerëzve),
- 2 Djegëja për kullota,
- 3 Venja e zjarreve me qellim e interesa personale dhe
- 4 Natyrore (të rralla apo të pa mundshme).

Shumica e zjarreve ndodhin në pyje halore por, nuk përjashtohen as pyjet gjeth ramëse e as ato në fusha.

Që nga viti 2000 në Komunën e Deçanit është rritur ndjeshëm rreziku i zjarreve në pyje, për të arritur kulmin në vitin 2007, e kjo në të vërtetë, për shkak të ndërthurjes tepër të pa favorshme të kushteve klimatike (temperaturat e larta të verës) dhe pranisë së mbulesës së thatë bimore, u shkaktua një numër i madh zjarresh.

Dendësia e zjarreve në komunën e Deçanit ndryshon në bazë të rajoneve, duke qenë më e lartë në Bjeshkët e Strellcit, Isniqit, Deçanit e Carrabregut dhe më e vogël në Bjeshkët e Vokshit dhe Junikut.

Humbja specifike (kosto/ha) ndryshon sipas kategorisë së bimësisë që përfshihet në zjarr. Ajo është më e vogël për kullota dhe më e lartë për pyjet e larta halore e gjetherënëse.

Demet nga zjarret në pyjet e larta janë kategori e humbjeve të drejtëpërsëdrejta ekonomike. Shkalla e këtyre humbjeve kërkon të tërhiqet vëmendja e gjithë subjekteve të interesuara e në rend të parë autoritetit pyjor, por duke përfshi dhe shërbimet Emergjente të Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Masat për menaxhimin e zjarreve, që duhet të përforcohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, janë: vënia në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi, vigjilencë për raste zjarri gjatë gjithë periudhës së shtimit të rrezikut të zjarreve dhe ndërtimi i pritave kundër zjarrit.

Duke u ballafaquar me këtë problem, kaq të mprehtë tashmë, duhet të ekziston një strategji e mbrojtjes së pyjeve e cila kërkon kontributin e të gjitha strukturave për t'u bërë efektive dhe për të arritur rezultatet e pritshme për mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare, siç janë pyjet.

Në pyjet me rrezik zjarri duhet të jetë në dispozicion një rrjet vrojtimi-sinjalizimi (me disa kulla vrojtimi zjarri për çdo bjeshkë), që përdoret nga shërbimi pyjor gjatë stinës së zjarreve. Legjislativi, infrastruktura në dispozicion dhe pajisjet për shuarjen e zjarreve janë në ngecje zhvillimore.

- Zjarret në pyje dhe kullota shpesh janë ngjarje të një shkalle më të vogël, në krahasim me ato që kanë ndikim dramatik mbi jetën dhe pronën. Përjashtim bëjnë zjarret që mbulojnë sipërfaqe të mëdha shkurresh ose pyje ku përfshihen edhe zona të banuara, pasi këto të fundit mund të shkaktojnë shkatërrim në një zonë të gjerë.


- Shkaqet kryesore të zjarreve vijnë nga njerëzit, duke përfshirë neglizhencën, aktivitetet bujqësore të kontrolluara jo ashtu siç duhet, si për shembull djegien e kullotave, aksidentet dhe vëniet e qëllimshme të zjarrit.

- Si rezultat, zonat specifike të rrezikut janë lehtësisht të identifikueshme, ndërkohë që parandalimi, lehtësimi, mbrojtja dhe parapërgatitja janë të mundura dhe mund të kenë efekte të ndjeshme për uljen e rrezikut.

- Në rastet e zjarreve që përfshijnë sipërfaqe të tëra, është shumë e vështirë për t'u kontrolluar, qofshin këto zjarre të shkaktuara nga njerëzit ose zjarre natyrore dhe drejtimi dhe forca e erës janë faktorë të veçantë në pa parashikueshmërinë e tyre.

- Në vendin tonë, rreziku më i madh i zjarreve të pyjeve është evident në fund të pranverës dhe gjatë periudhave të verave të thata. Që prej 2003-së, rreziku i zjarreve të pyjeve në komunën e Deçanit është rritur në mënyrë të konsiderueshme, si në shpeshhtësi, ashtu edhe në përmasa të zonave të prekura.

1.2.3. Lokacionet e zjarreve pyjore dhe vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë:



ZJARRET NË PYJE

1 Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga zjarret në pyje

Pyjet e Komunës së Deçanit janë të prirura për të u prekur nga zjarret gjatë gjithë vitit e sidomos në pranverë dhe gjatë verës jashtëzakonisht të nxehtë dhe të thatë.

Shkaqet e zjarreve janë në radhë të parë me karakter:

1. Antropogjenik (pa kujdesia e njerëzve),
2. Djegëja për kullota,
3. Venja e zjarreve me qellim e interesa personale dhe
4. Natyrore (të rralla apo të pa mundshme).

Shumica e zjarreve ndodhin në pyje halore por, nuk përjashtohen as pyjet gjeth ramëse e as ato në fusha.

Që nga viti 2000 në Komunën e Deçanit është rritur ndjeshëm rreziku i zjarreve në pyje, për të arritur kulmin në vitin 2007, e kjo në të vërtetë, për shkak të ndërthurjes tepër të pa favorshme të kushteve klimatike (tempëratat e larta të verës) dhe pranisë së mbulesës së thatë bimore, u shkaktua një numër i madh zjarresh.

Dendësia e zjarreve në komunën e Deçanit ndryshon në bazë të rajoneve, duke qenë më e lartë në Bjeshkët e Strellcit, Isniqit, Deçanit e Carrabregut dhe më e vogël në Bjeshkët e Vokshit dhe Junikut.

Humbja specifike (kosto/ha) ndryshon sipas kategorisë së bimësisë që përfshihet në zjarr. Ajo është më e vogël për kullota dhe më e lartë për pyjet e larta halore e gjetherëne.

Demet nga zjarret në pyjet e larta janë kategori e humbjeve të drejtëpërsëdrejta ekonomike. Shkalla e këtyre humbjeve kërkon të tërhiqet vëmendja e gjithë subjekteve të interesuara e në rend të parë autoritetit pyjor, por duke përfshi dhe shërbimet Emergjente të Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Masat për menaxhimin e zjarreve, që duhet të përforcohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, janë: vënia në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi, vigjilencë për raste zjarri gjatë gjithë periudhës së shtimit të rrezikut të zjarreve dhe ndërtimi i pritave kundër zjarrit.

Duke u ballafaquar me këtë problem, kaq të mprehtë tashmë, duhet të ekziston një strategji e mbrojtjes së pyjeve e cila kërkon kontributin e të gjitha strukturave për t'u bërë efektive dhe për të arritur rezultatet e pritshme për mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare, siç janë pyjet.

Në pyjet me rrezik zjarri duhet të jetë në dispozicion një rrjet vrojtimit-sinjalizimi (me disa kulla vrojtimi zjarri për çdo bjeshkë), që përdoret nga shërbimi pyjor gjatë stinës së zjarreve. Legjislacioni, infrastruktura në dispozicion dhe pajisjet për shuarjen e zjarreve janë në ngecje zhvillimore.

Vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë nga zjarret në pyje

Përcaktimi i shkallës së rrezikshmërisë së pyjeve dhe tokave pyjore nga zjarret, bëhet sipas nr. të poeneve të nxjerrë nga kriteret cpecific sipas llojeve të drunjëve të grumbullit pyjor dhe karakteristikave tjera.

Nr	Shkalla e rrezikshmërisë	Nr i poeneve
I.	shumë e madhe	≥ 480
II.	e madhe	381-480
III.	mesatare	281-380
IV.	e vogël	≤ 280

Legjenda e paraqitjes së grumbullit pyjor sipas llojeve të drunjëve e që paraqesin shkallen e rrezikshmërisë adekuate është

Nr	Shkalla e rrezikshmërisë	Ngjyra në hartë
I.	shumë e madhe	e kuqe
II.	e madhe	e kuqrrremtë
III.	mesatare	e verdhë
IV.	e vogël	e gjelbërtë

Zjarret Pyjore

Kategoria e rrezikut	Teknologjike (të shkaktuara nga faktori njeri)
Lloji	Fatkeqësi Bio-fizike
Rreziku	Zjarr
Modeli	Sezonal
Lokacioni	Bjeshka e Deçanit



Historiku

HISTORIKU I ZJARREVE NË KOMUNËN E DEÇANIT:

Në dhjetëvjeçarin e fundit, ndodhja e zjarreve në Komunën e Deçanit është shtuar si në numër e po ashtu edhe nga sipërfaqja e prekur, që të dy këta tregues janë mbi karakteristikat mesatare.

Statistika e zjarreve të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës 2008-2018 tregojnë se ka pasur një numër të konsiderueshëm zjarresh kryesisht në qendrën urbane, rurale gjithashtu gjatë kësaj periudhe ka pasur zjarre në pyje, fushore, zjarre në ndërtesat e banimit familjar, në objektet afariste – lokale afariste, zjarre në automjete të udhëtarëve, në trafo për shpërndarjen e rrymës elektrike e tjera.

Harta e rrezikut të zjarreve për Komunën e Deçanit është sajuar në nivel të Bashkësive Lokale. Ajo mbështetet në të dhënat e ndodhjeve të zjarreve, përmasat e sipërfaqeve të djegura e të prekura dhe parametra tjerë me peshë të cilat janë mare nga Shërbimi Zjarrfikës dhe Shpëtimit të Komunës së Deçanit.

Nga analiza që është bërë shkaqeve, kohës, dëmeve të shkaktuara tjera. Rezulton si ma poshtë:

Gjendja

Numri i përgjithshëm i zjarreve gjatë periudhës 2003 – 2007 kanë ndodhur 272 raste nga këto:

- Zjarre në objektet e banimit familjar = 25 raste
- Zjarre në objektet publike shkolla = 2 raste
- Zjarre në objektet e biznesit privat lokale afariste = 2 raste
- Zjarre në trafostacionet për shpërndarjen e rrymës elektrike dhe në ormanët e rrymës elektrike = 6 raste
- Zjarre në automjete të udhëtarëve = 5 raste
- Zjarre në deponit e mbeturinave = 7 raste
- Zjarre në pyje, fusha, ngastra bujqësore, ushqim i thatë kafshëve = 225 raste

Zjarret gjatë vitit 2009 :

- ⇒ Zjarre pyjore=3
- ⇒ Zjarre në objekte banimi=9
- ⇒ Zjarre në objekte afariste=2
- ⇒ Zjarre fushore= 7
- ⇒ Zjarre në mbeturina= 6
- ⇒ Zjarre në automjete= 3
- ⇒ Zjarre në ushqimin e kafshëve=4

Total zjarre: 35 zjarre


Rastet e zjarreve të mëdha gjatë kësaj periudhe

- Zjarr në masivin pyjor në bjeshkët Strellcit 14.04.2007 në sipërfaqe prej 30 hektar (harta nr. 2)
- Zjarr në malet e Dashinocit 23.04.2007, në sipërfaqe prej 30 hektarësh,
- Zjarr në masivin pyjor të Bjeshkëve të Prejlepit 24.04.2007, në sipërfaqe prej 90 hektarësh, (harta nr. 3)
- Zjarr në masivin pyjor të Bjeshkëve të Kurvallës 24.04.2007, në sipërfaqe prej 90 hektarësh. (harta nr. 4)
- Zjarret që ndodhen në Bjeshken e Strellcit, Deçanit, Pobergjis, Junikut etj në vitin 2012 etj

Numri i përgjithshëm i zjarreve gjatë periudhës 2008 – 2017

Gjithsej : **923** raste nga këto:

- Zjarre në objektet e banimit familjar = 114 raste
- Zjarre në objektet publike shkolla = 5 raste
- Zjarre në objektet e biznesit privat lokale afariste = 28 raste
- Zjarre në trafostacinet për shpërndarjen e rrymës elektrike dhe në ormanët = 33 raste
- Zjarre në automjete të udhëtarëve = 28 raste
- Zjarre në deponit e mbeturinave = 77 raste
- Zjarre në pyje, fusha, ngastra bujqësore, ushqim i thatë kafshëve = 638 raste



Në vitin 2018 ka pasur gjithsej 70 raste të zjarreve ku:


52 raste ishin zjarre në pyje, fusha, ngastra bujqësore, ushqim i thatë i kafshëve

6 raste në objekte të banimit familjar

1 rast zjarri në automjete

1 rast zjarri nga rryma si dhe **10** raste zjarri në deponit e mbeturinave.

GRAFIKONI I ZJARREVE NE PYJE SIPAS SIPËRFAQES / HEKTAR



SITUATA E PËRGJITHËSHME:

SKENARI – 1:

Një zjarr i madh i përcjellur me erëra të forta ka përfshirë Regjionin e Pejës, veqanerish Komunën e Deçanit, gjegjësisht masivin e Bjeshkës së Vokshit, dhe Deçanit duke rrezikuar 150 banorë të cilët verojnë në stane. Gjithashtu rrezikohen një numër i konsiderueshëm banorësh, të cilët janë kryesisht mërgimtarë, në mesin e tyre gra dhe fëmijë që kanë dalë në piknik nëpër bjeshkët e lartë cekura. Gjithashtu, nga stuhia e zjarrit është në rrezik edhe regjioni i gjerë i Vokshit.

SKENARI – 2:

Një zjarr i madh ka përfshirë tërë territorin e Bjeshkëve të Komunës së Deçanit, duke rrezikuar jetën e njerëzve (të cilët kanë dalë me bagëti në stane, dhe qytetarë që kanë dalë në piknik, të mirat materiale, infrastrukturën vitale (lartë përçuesit e tensionit të lartë të Hidrocentralit “Lumbardhi” dhe objektin e Hidrocentralit), dhe mjedisin. Sipas informacioneve të para, në regjionin e Bjeshkëve të përfshira nga zjarret ka dhjetëra të lënduar në mesin e tyre gra dhe fëmijë të cilët rrezikohen gjatë evakuimit nga shtyllat dhe larg përçuesit e tensionit të lartë të djegura dhe të rrëzuara. Në mesin e popullatës që kanë dalë në stane dhe në piknik, ka të moshuar, gra, dhe fëmijë të cilët kanë nevojë për ndihmë. Në shumë vende janë nderpre akset rrugore nga stuhit e zjarrit qka, në masë të madhe është vështirësuar depërtimi i ekipeve të shpëtimit në bjeshkët ku kërkohet ndihmë.

SKENARI –3:

Më problematike mbetet gjendja në pjesën veri- prendimore dhe përendimore të Komunës së Deçanit në Bjeshkën e Belegut, Bjeshkën e Prejlepit, Bjeshkën e Deçanit, e pyjet e Vokshit. Harta me zonat që janë nën flakë është zvogëluar në 48 orët e fundit është një përmirësim të situatës, falë mobilizimit të ekipeve të emergjencës, të autoriteteve të pushtetit lokal, apo dhe vetë banorëve të zonave përreth. Megjithatë, janë disa pjesë ende problematike, ku gjuhët e flakëve janë prezente dhe po bëjnë kërdinë në mjedisin përreth, duke qënë dhe rrezik për banorët që gjenden në nje rreze të afert me zjarret. E vështirë mbetet situata në pjesën përendimore të komunës në pyjet e kullotat e Bjeshkëve të lartëpërmendura, apo dhe situata në Malin e Vokshit. Terreni i thyer, mungesa e infrastrukturës për të çuar mjetet motorike zjarrëfikëse kanë favorizuar përhapjen e zjarreve në këto zona duke i lënë si të thuash në mëshirë të fatit deri sa të ndodhe vetëshuarrrja e flakëve. Në krahasim me vitet e tjera këtë rradhë në përballimin e krizës së zjarreve ka më shumë bashkëpunim me komunitetin, ndaj dhe apelohe për kujdes dhe vëmendje për informimin sa më të shpejtë nga ana e qytetarëve të ekipeve të shpëtimit apo shtabet lokale të emergjencës, të cilat janë në gatishmëri 24 orë. Si dhe ligji duhet të zbatohet rreptë ndaj të gjithë atyre personave që direkt apo indirekt janë përgjegjës për zjarrvënien dhe demet që shkaktohen. Jane me dhjetra kallëzime penale për personat që dyshohen se janë fajtorë për vënien me qëllim të zjarreve në pyje dhe kullota.

1.2.4. Parametrat kryesor për caktimin e rrezikshmërisë nga zjarret në pyje

1. Vegjetacioni

Vegjetacioni (lloji i përbërësve)		Shifra, klasa e periudhës kohore të rregullimit	Numri i poenave
1.1	Pyjet halore		200
1.1.1	Kulturat e pyjeve me halor		
1.1.2.	Pyjet heliofite të halorëve (pisha, larshë, çiparis)		
1.1.2.1	Deri më 30 vjetë vjetërsie		200
1.1.2.2	31-60 vjet dhe të moshave të tjera		180
1.1.2.3	Më tepër se 60 vjet vjetërsie		160
1.1.3.	Pyjet skiofite të halorëve (bredhi dëllinja)		
1.1.3.1	Deri më 30 vjet vjetërise		160
1.1.3.2	31-60vjet vjetërsie dhe të moshave të tjera		140
1.1.3.3	Më tepër se 60 vjet vjetërise		120
1.2.	Përbërësit e përzier (pyjet me pisha dhe hormoq)		
1.2.1.	Kulturat e përziera		180
1.2.2.	Përbërësit e përzier heliofile (pisha, larshë, bung, gjethorë të butë)		
1.2.2.1	Deri 30 vjet vjetërsi		180
1.2.2.2	31-60 vjet vjetërsi		100
1.2.3	Pyjet e përziera skiofite (bredhi, dëllinja, ahu)		
1.2.3.1	Deri 30 vjet vjetërsi		120
1.2.2.2.	31-60 vjet vjetërsi dhe moshave të tjera		100
1.2.3.3.	Më tepër se 60 vjet vjetërsi		80
1.3.	Përbërësit e pyjeve gjethore		
1.3.1	Kultura dhe plantazhe të gethorëve		120
1.3.2.	Përbërësit heliofit të gjethorëve (Bungu, gjethorët e butë)		120
1.3.2.1.	Përbërësit e degraduar		
1.3.2.2.	31-60 vjet vjetërsi		100
1.3.2.3.	Më tepër se 60 vjet vjetërsi		80
1.3.3.	Përbërësit e gjethorëve skiofit (ahu)		
1.3.3.1.	Përbërësit e pyjeve të degraduara		80
1.3.3.2.	Deri më 30 vjet vjetërsi		80
1.3.3.3.	31 dhe 60 vjet vjetërsi dhe të moshave të tjera		60
1.4.	(maki dhe garigu		200
1.5.	Shkurret dhe kaqubat		160
1.6.	Tokë pyjore e papërpunuar		80

2. Faktori antropogjen ndahet në tri kategori.

- Kategoria e parë I.(pyejt për vende turistike, rekreacion, parqet, rezervatet dhe afër deponive... 60 poena
- Kategoria e dytë II. Pyjet ekonomike pranë të cilave kalon rruga publike, largpërquesi bëhet kullotja, ... 40 poena
- Kategoria e tretë III, pyjet të cilat mblidhen produktet dytësore, bëhet gjuetia dhe peshkimi si dhe punët melioruese e kultivuese... 20 poena

3. Klima

Përshkrimi	
3.1.	Mesatarisht temperaturë vjetore
3.1.1.	Mbi 12 C
3.1.2.	9.1-12 C
3.1.3.	Deri 9.0 C
3.2.	Mesatarisht sasia vjetore e të reshurave
3.2.1.	Der më 800mm
3.2.2.	800-1200mm
3.2.3.	Mbi 1200mm
3.3.	Mesatarisht lagështia vjetore relative e ajrit
3.3.1.	Mbi 70%
3.3.2.	71-80%
3.3.3.	Mbi 80%

5. Orografia

Nr	Parametri orografik
5.1.	Ekspozimi
5.1.1.	Jugore dhe fushore
5.1.2.	Lindje dhe përdim
5.1.3.	Veriore
5.2.	Lartësia mbidetare
5.2.1.	Deri 500m
5.2.2.	500-800m
5.2.3.	Mbi 800m
5.3.	Prirje (inkliminim)
5.3.1.	Më tepër se 45
5.3.2.	31-45
5.3.3.	15-30

6. Rendi pyjor

	Lloji i përbërësve
6.1.	Të parregulluara
6.2.	Pjesërisht të rregulluara
6.3.	Të rregulluara

Përbërës të rregulluar mund të konsiderohen ato pyje të cilët kanë të ndërtuara dhe të mirëmbajtura rrugët kundër zjarrit, rrugët dhe shtigjet të cilat pastrohen rregullisht dhe rrallohen e krasiten degët në pjesët anësore dhe reduktohet materiali i imët që digjet.*

* Agjensioni Pyjor Regjional

Lloje të zjarreve pyjore



Zjarr në pyje halore



Zjarri në pyje shkurre



Zjarr në Kurvallë



Zjarr në pyje halore-Jodovë



Zjarr në pyje gjetheramse

1.2.5. Karakteristikat bazë të zjarreve në pyje

- Zjarret në pyje dhe kullota shpesh janë ngjarje të një shkalle më të vogël, në krahasim me ato që kanë ndikim dramatik mbi jetën dhe pronën. Përrjashtim bëjnë zjarret që mbulojnë sipërfaqe të mëdha shkurresh ose pyje ku përfshihen edhe zona të banuara, pasi këto të fundit mund të shkaktojnë shkatërrim në një zonë të gjerë.
- Shkaqet kryesore të zjarreve vijnë nga njerëzit, duke përfshirë neglizhencën, aktivitetet bujqësore të kontrolluara jo ashtu siç duhet, si për shembull djegien e kullotave, aksidentet dhe vëniet e qëllimshme të zjarrit.
- Si rezultat, zonat specifike të rrezikut janë lehtësisht të identifikueshme, ndërkohë që parandalimi, lehtësimi, mbrojtja dhe parapërgatitja janë të mundura dhe mund të kenë efekte të ndjeshme për uljen e rrezikut.
- Në rastet e zjarreve që përfshijnë sipërfaqe të tëra, është shumë e vështirë për t'u kontrolluar, qofshin këto zjarre të shkaktuara nga njerëzit ose zjarre natyrore dhe drejtimi dhe forca e erës janë faktorë të veçantë në pa parashikueshmërinë e tyre.
- Në vendin tonë, rreziku më i madh i zjarreve të pyjeve është evident në fund të pranverës dhe gjatë periudhave të verave të thata. Që prej 2003-së, rreziku i zjarreve të pyjeve në komunën e Deçanit është rritur në mënyrë të konsiderueshme, si në shpeshhtësi, ashtu edhe në përmasa të zonave të prekura.

Masat e parandalimit të zjarreve në pyje nga autoriteti pyjor

Përgjegjësia për mbrojtjen e pyjeve u takon autoriteteve pyjore. Masat për menaxhimin e zjarreve nga autoriteti pyjor janë:

- 1 Vërja në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi,
- 2 Vigjilenca në raste zjarri gjatë periudhës së shtimit të rrezikut të zjarreve,
- 3 Ndërtimi i pritave kundër zjarreve,
- 4 Pajisja e NJPZSH-së Komunale me mjete materialo-teknike për shuarjen e zjarreve në teren malor.
- 5 Formimi i njësisve zjarrfikëse të specializuara për shuarjen e zjarreve në teren malor.
- 6 Duke u përballuar me probleme të ndodhjes së zjarreve në pyje Qeveria duhet të përgjigjet me një kuadër të gjerë ligjor i cili përcakton masa parandaluese institucionale të detyrueshme dhe efektive për të arritur rezultate të pritshme për mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare.
- 7 Vetëdijesimi i faktorit njeri për ruajtjen pyjeve nga zjarret.
- 8 Hapja e rrugëve të kalueshme nëpër pyje që njësia e zjarrëfiksive të afrohen sa ma afër vatrave të zjarreve.
- 9 Asnjë person pa leje paraprake s`mund të ndezë zjarr të hapur në pyjet ose në tokat pyjore .
- 10 Agjencia pyjore lëshon leje për ndezjen e hapur të zjarreve, kur ky veprim i tillë është në përputhshmëri me shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyllit.
- 11 Kjo lëmi duhet të rregullohet me ligj
- 12 Sot për sot mungon një program i organizuar mirë për parandalimin e zjarreve në pyje.

Shërbimi zjarrfikës

Shërbimi zjarrfikës në nivelin komunal, duhet të ndihmohet në shuarje të zjarrit edhe nga njesite vullnetare të zjarrfiksive. Sidomos në fazën e posazbulimit të paraqitjes së zjarrit, do të intervenojnë me mjetet e veta që kanë në disponim. Ndërhyrja e shpejt pas zbulimit, do të bëjë të mundur me pak angazhim të mjeteve të shuhet zjarri shumë shpejt duke e mbrojtur pyllin në mënyrë shumë efikase.

Prandaj, puntorët e Agjencisë Pyjore duhet të angazhohen të parët në shuarje të zjarrit, sepse veprimi i shpejt jep rezultate të dëshiruara.

Puntorët të cilët do të angazhohen në shuarje të zjarrit, duhet të kenë seminare të cakëtuara, me qëllim të njohjes dhe përdorimit të pajimeve në shuarje. Kjo njohuri në mes tjerash do t'u shërbej edhe për sigurinë e tyre personale.

Varësisht nga pylli dhe përmbajtja e tij, e me qëllim të pengimit të shtrirjes së zjarrit, Njesia e APK në Deçan do të planifikoj hapjen e shtigjeve dhe brezeve kundra zjarrit. Ndërkohë, do të bëhet edhe plani detal sipas shkallës së rrezikshmërisë, duke përcakëtuat saktësisht numrin, gjatësinë, gjërësinë 4-15 m. dhe karakteristikat e tjera të brezeve kundra zjarrit.

Masat preventive-kultivuese

Njesia e APK në Deçan, do të planifikoj masat specifike preventive dhe kultivuese. Këto masa do të përfshijnë

- Kultivimin e grumbullit pyjor,
- Rrallimin e nevojitur dhe me kohë të grumbullit pyjor,
- Krasitja dhe pastrimi i degëve të thata,
- Hapja dhe mirëmbajtja e shtigjeve, brezeve, largpërquesëve, dhe rrugëve,
- Mirëmbajtja dhe rregullimi i burimeve ekzistuese dhe rrejdhave e ujmbledhësave etj.

Në pyjet e klasifikuara të shkallës nga I-III të rrezikshmerisë nga zjarri, punët pyjore në krasitje dhe pastrimin e degëve të thata në pyje dhe vuarja e rendit pyjor duhet të bëhet deri në fillim të sezonit veror ku dhe shkaktohen zjarret pyjore.

Njesia e APK në Deçan, do të mbajnë evidencen mbi gjendjen e shtigjeve, rrugëve e brezeve kundra zjarrit, mundësinë e kalimit të automjeteve, automjeteve me paisje speciale, cisterna etj.



Pyjet , kjo pamje e bukur



Pyjet, kjo pasuri nacionale e dëmtuar

1.2.6. Vlerësimi i rrezikshmërisë së zjarreve në fusha

Rreth 95% e popullsisë së Komunës së Deçanit jeton në zona rurale në një sipërfaqe prej 10.801 ha. tokë bujqësore dhe varet kryesisht prej bujqësisë ekstensive dhe blegtorisë, megjithatë, ndodhja e zjarreve në tokat bujqësore është përgjithësisht jo e dendur dhe prekë sipërfaqe të kufizuara.

Mirëpo, viteve të fundit janë shpeshtuar zjarret në fusha në teritorin e Komunës së Deçanit, të cilat janë të shkaktuara kryesisht nga faktori antropogjen si pakujdesi ose për interesa personale:

- djegëja e megjave,
- djegëja e barojave të këqija,
- djegëja e barit të thatë,
- djegëja e shkurreve në favor të zgjerimit të tokës punuese,
- e deri të zjarret në stërnishta gjatë sezonës së korrje shirjeve



Zjarr fushor

MASAT PREVENTIVE TE ZJARREVE NE FUSHA (SEZONALE)

Shtabi Komunal në sezonin e korrje-shirjeve, sipas Ligjit të mbrojtjes nga zjarri, janë të obliguar që së pakut 20 ditë para fillimit të sezonës së korrje-shirjeve të hartojnë Planin e mbrojtjes nga zjarri, në të cilin duhet të parashohin dhe të ndermarin këto masa:

1. organizimi i kujdestarisë, shërbimit të vëzhgimit, lidhjes dhe informimit të përhershëm gjatë korrje shirjeve;
2. makinat të cilat marinë pjesë në korrje shirje duhet të jenë teknikisht në rregull dhe të siguruara kundër shkaktimit të zjarrit me anën e hedhjes së xixave, nxehtësisë së madhe dhe mënyrave tjera;
3. makinat duhet të jenë të pajisura me aparate zjarrfikëse, lopata, kazma dhe pran tyre të sigurohen fuqi me ujë;
4. furnizimi i makinerisë me karburant të bëhet në vend të sigurt dhe karburanti rezervë të ruhet së paku 150m. larg të lashtave në hije i shoqëruar me mjete përkatëse për shuarjen e zjarrit;
5. ndalohet pirja e duhanit dhe zjarri i hapur;
6. komplekset e mbjellura me të lashta të ndahen në ngastra përafërsisht në çdo 50ha. ngastrat të kufizohen me korridore në gjersi prej 15m. dhe kjo gjersi të kositet menjëherë dhe të lëvrohet;
7. shtabet komunale, për punëtorët të cilët marinë pjesë në korrje shirje, janë të obliguar të organizojnë kurse dhe stërvitje me qëllim të aftësisë për aplikimin e masave kundër zjarrit.

1.2.7 Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit

Studimi për Mbrojtje dhe Shpëtim nga Zjarri është pjesë përbërëse e studimeve urbanistike. Në to parashikohet zbatimi dispozitave të Ligjit të Ndërtimit, Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri, normave, rregulloreve teknike për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarri, si dhe normave ndërkombëtare të pranuar. Projektet për të gjitha llojet e ndërtimeve përfshijnë edhe Projektin e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Zjarri.

Komunës së Deçanit, lufta e fundit, i solli dëme mjaft të mëdha në ndërtimtari ku janë shkatërruar totalisht një numër mjaft i madh i objekteve të banimit, industriale, publike e private.

Faza e rindërtimit dhe e ndërtimit pas lufte ka qenë e nivelit shumë të lartë. Shumica e këtyre ndërtimeve nuk i përmbushin kërkesat për mbrojtje nga zjarri si:

- Mundësia e zgjerimit të zjarrit në objektet fqinjë,
- Zgjerimi i zjarrit në ndërtesë,
- Qëndrueshmëria e konstruksionit,
- Rrugët e evakuimit,
- Sistemi i lajmërimit dhe alarmit,
- Qasja e zjarrfikësve në objekt etj.

Shkaqet dhe pasojat:

- Ndërtimet pa leje
- Krijimi i vonshëm i institucioneve
- Mospërfillja e procedurave dhe kriterëve për leje ndërtimi
- Zbatuesmerija jo efikase e Ligjit të ndërtimit në aspektin e Mbrojtjes nga Zjarri etj.

Planifikimi:

Për të u siguruar se çdo ndërtim të jetë i sigurt për shfrytëzim, punë, banim, argëtim, administratë etj. duhet që të:

- Planifikohet,
- Projektohet,
- Ndërtohet dhe
- Shfrytëzohet

konform Ligjeve dhe rregullave teknike që janë në fuqi. Kjo është përgjegjësi e institucioneve qendrore dhe lokale.

Masat që duhet ndërmarr:

- Koordinimi i punëve në mes të institucioneve që janë përgjegjëse në fushën e mbrojtjes nga zjarri në aspektin e ndërtimit të objekteve,
- Zbatimi i Ligjit të ndërtimit dhe Ligjit të MNZ-ës,
- Hartimi i projekteve konform ligjit, kontrollimi i punimeve, dhe pranimit teknik i objekteve duke respektuar kërkesat e mbrojtjes nga zjarri,
- Të jepen udhëzime mbi procedurën e marrjes së lejeve dhe përbërjen e dokumentacionit teknik për mbrojtje nga zjarri,
- Të kompletohen rregullat teknike për mbrojtje nga zjarri në harmoni me direktiven Evropiane për mbrojtje nga zjarri,
- Të punohet plani për plotësimin e kushteve teknike të objekteve ekzistuese e sidomos objekteve publike të institucioneve dhe private,
- Të merën hapa për ndërprerjen e veprimtarive të ndryshme që sjellin pasoja për jetën e njerëzve dhe të pronës,
- Të urdhërohet largimi nga mjediset publike të pajisjeve, të materialeve dhe lëndëve të rrezikshme si të lëndëve plasëse, municioneve, helmeve të forta, lëngjeve lehtësisht të ndezshme dhe të djegshme, lëndëve radioaktive, të cilat nuk janë ndërtuar e vendosur sipas Ligjit.
- Të nderprehet veprimtaria në të gjitha kategoritë proceseve teknologjike të veprave e objekteve dhe institucioneve, kur ato paraqesin rrezik për jetën e njerëzve dhe të pronës.

Zjarret në Objekte Banimi

Kategoria e rrezikut	Teknologjike (të shkaktuara nga faktori njeri)	
Lloji	Fatkeqësi Bio-fizike	
Rreziku	Zjarr	
Modeli	Gjatë vitit	
Lokacioni	Zjarr në objekt banimi në Lagjen e Dëshmorëve- Baballoq	


Historiku

Për sa i takon zjarreve të shtëpive, banesave kolektive, lokaleve afariste shoqërore dhe private janë theksuar faktorët e mëposhtëm:

- 1 Ekzistenca e ndërtesave të banimit kolektiv me linja elektrike të vjetra dhe të mirë mbajtura keq. Ky është renditur si njëri prej shkaqeve kryesore.
- 2 Përdorimi i pakontrolluar i energjisë elektrike pas ndërprerjeve të gjata të saj shkaktojnë zjarre nëpër shtëpi dhe objekte tjera. Kur njerëzit më në fund furnizohen me energji elektrike ata i mbingarkojnë rrjetet ngaqë përipiqen ti shfrytëzojnë sa më shumë. Shpesh ata rrezikojnë duke bërë lidhje të paligjshme në rrjet. Si pasojë, vetëm gjatë viteve 2003 – mars 2008 ka pasur 25 zjarre në shtëpi, kryesisht për shkak të mbingarkimit të rrjetit (sipas të dhënave nga Sektori e Mbrojtjes dhe Shpëtimit).
- 3 Vendosja e ushqimit të kafshëve në brendi të objekteve të banimit dhe pranë objekteve të tilla,
- 4 Mos kujdesi i prindërve që burimet e zjarrit (shkrepsat) të i lënë afër dorës së fëmijëve
- 5 Mungesa e dijeve në komunitet për parandalimin e zjarrit,
- 6 Mungesa e hidrantëve ose jo funksionaliteti i tyre dhe
- 7 mungesa e pajisjeve kundër zjarrit
- 8 Rrufeja
- 9 Keqpërdorimi me energji elektrike nga njerëz te pandërgjegjshëm dhe nganjëherë te pakujdesshëm etj.

Shumë i mundëshëm

Gjasat
↑
jasa



Efeki

Goditja	<ul style="list-style-type: none"> - Djegia e një objekti banesor në Lagjen e Dëshmorëve - NUMËR I KUFIZUAR I FAMILJEVE TË GODITURA - EVAKUIMI I BANORVE TË RREZIKUAR NGA BANESAT - GJENDJA PARAQITET E ASHPËR PËR OBJEKTIN DHE OBJEKTET PËR RRETH PËR SHKAK TË PËRHAPJES SË ZJARRIT - DO TË PARAQITEN EFKTE DYTËSORE PËR AMBIJENTIN DHE FAMILJET PËR RRETH. - MBËSHTETJE E MJAFTUESHME NGA NIVELI LOKAL. 											
Pasojat	Banor	Familje	Handikap	Femra	Meshkuj	Fëmijë	Pleq	Të mira materjale	Infrastr. kritike	Ob. Rands. veqa.	Tra. Kult.	Dëme
	8	1	/	2	/	6	/	-shtëpi -orendi -veshëm. -shtroj -ushqim -paisje tje. sht.	/	/	/	25000-50000€
	<ul style="list-style-type: none"> - PASOJA ME FATALITET DHE VIKTIMA, - NJË I VDEKUR, - KATËR TË LËNDUAR, - KERKESA PËR NDIHMË MJEKËSORE DHE HOSPITALIZIM 											
Skenari	<p>Në Lagjen “Dëshmorët e Kombit” Baballoq, me datën _____, në orët e vona të mbrëmjes ka shpërthyer një zjarr në një objekt banimi, me që rast është djegur shtëpia një katëshe prej tri dhomave dhe zgjerim me një aneks.</p> <p>Në këtë shtëpi kanë banuar familja 8 anëtarëshe.</p> <p>Një fëmijë (gjinisë mashkullore) i moshës 6 vjeçar ka vdekur në zjarr nga pamundësia për vetëshpëtim dhe shpëtim.</p> <p>Me rastin e shpërthimit të zjarrit familja ka qenë duke fjetur.</p> <p>Zjarri është vrejtur nga fqinjët e kësaj familje dhe intervenimi për shpëtim dhe lokalizim të zjarrit është bërë nga të njëjtit.</p> <p>Shuarja e zjarrit është bërë nga Njësia e Zjarrfikësave.</p>											

1.2.8. Vlerësimi i rrezikshmërisë në pikat e shitjes së karburanteve dhe masat mbrojtëse

Në qendrën administrative dhe vendbanimet në pjesën rurale të komunës janë të evidentuara:

- 1 deponi karburantesh / egziston në fshatin Isniq tek ish fabrika e pompave por nuk është në funksion
- 2 Dhjetë (10) pika të shitjes së karburanteve,
- 3 tri (3) pikë shitëse të gazit.

Fatmirësisht deri më tani nuk është evidentuar asnjë rast zjarri në këto pika të shitjes, edhe pse është një numër i këtyre pikave të shitjes që nuk i plotësojnë kushtet teknike dhe hapësinore për një veprimtari të tillë duke marrë për bazë shkallen e lartë të rrezikshmërisë që paraqesin, sidomos disa pika të cilat veprimtarin e vetë e ushtrojnë në qendrën striktë urbanistike dhe më të frekuentuar nga automjetet dhe kalimtarët e rastit të qytezës së Deçanit, ku nga shpërthimi dhe zjarri eventual pasojat njerëzore, materiale dhe hapësinore do të ishin katastrofike dhe të pa parashikueshme.

Shikuar në aspektin e mos ndodhjes së zjarreve në këto vende duhet cekur kontributin e jashtë zakonshëm të Drejtorisë Komunale të Mbrojtjes dhe Shpëtimit në aplikimin e legjislationit (Ligjit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe Ligjit të Mbrojtjes nga Zjarri).

MASAT MBROJTËSE KUNDËR ZJARRIT

1. Territori i vendosjes së objektit duhet të jetë i pastrua nga barishtet e thata
2. Me rastin e ndërtimit të objektit i stacionit të karburantit duhet të respektohet Rregullorja mbi ndërtimin e stacioneve për furnizim me karburante të mjeteve motorike dhe depozitim dhe toçitjen e karburanteve.
3. Duhet të respektohet rregullorja për objektin e stacionit të karburantit nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri.
4. Automjetet që transportojnë karburante duhet të posedojnë aparate për shuarjen e zjarrit të kenë shiritin e tokëzimi i cili takohet me për tokëzimet tjera gjatë mbushjes dhe shkarkimit.
5. Automjeti duhet të jetë i fikur , ndalohet shitja gjatë kohës së zbarkimit të autocisternës.
6. Për objektin duhen të kryhen atestimet e rrufepritësve dhe përtokë zusëve të tjerë si prozhatoreve dhe ndriçimet tjera nga servisi i liçensuar atëherë sa herë është nevoja.
7. Ndalohet rreptësisht ndezja e zjarrit në territorin e depos dhe pikës së shitjes të karburanteve.
8. Në objektin e derivateve të karburantit duhen të vendosen shenjat Ndalim pirjes së duhanit , Ndalim flakës së haptë, Ndalim përdorimit të veglave që shkaktajnë shkëndija, Stop autocisterna në zbrazje e tjera.
9. Objekti duhet të posedoj Hidrantët për shuarjen e zjarrit me presion të ujit, dhe të kryer shqyrtimi nga servisi i liçensuar.
10. Në objekti duhen të jenë të vendosur arkat me rërë t' thatë, kazmat, lopatat për shpërndarjen e rërës tjera.
11. Objekti duhet posedoj aparatet për shuarjen e zjarrit fillestar me pluhur të thatë,

Zjarret në Stacione Karburantësh

Kategoria e rrezikut	Teknologjike (të shkaktuara nga faktori njeri)	
Lloji	Fatkeqësi Teknologjike	
Rreziku	Zjarr	
Modeli	Gjatë vitit	
Lokacioni	Stacioni i karburantëve "Petrol Company" Carrabreg	

Historiku


Në qendrën administrative dhe vendbanimet në pjesën rurale të komunës janë të evidentuara:

- një (1) deponi karburantesh
- dhjetë (10) pika të shitjes së karburanteve,
- tri (3) pikë shitëse e gazit .

Fatmirësisht deri më tani nuk është evidentuar asnjë rast zjarri në këto pika të shitjes, edhe pse është një numër i këtyre pikave të shitjes që nuk i plotësojnë kushtet teknike dhe hapësinore për një veprimtari të tillë duke marrë për bazë shkallen e lartë të rrezikshmërisë që paraqesin, sidomos ato pika të cilat veprimtarin e vetë e ushtrojnë në qendrën striktë urbanistike dhe më të frekuentuar nga automjetet dhe kalimtarët e rasti të qytezës së Deçanit, ku nga shpërthimi dhe zjarri eventual pasojat njerëzore, materiale dhe hapësinore do të ishin katastrofike dhe të pa parashikueshme.

Shikuar në aspektin e mos ndodhjes së zjarreve në këto vende duhet cekur kontributin e jashtë zakonshëm të Drejtorisë Komunale të Mbrojtjes dhe Shpëtimit në aplikimin e legjislacionit (Ligjit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe Ligjit të Mbrojtjes nga Zjarri).

Gjasat



- DJEGËJA E PIKËS SË KARBURANTËVE NË CARRABREG
- NUMER I KUFIZUAR I FAMILJEVE TË GODITURA
- GODITJA E SHKOLLËS FILLORE
- EVAKUIMI I NXËNËSVE NGA SHKOLLA
- EVAKUIMI I BANORVE TË RREZIKUAR NË BANESË
- GJENDJA PARAQITET E ASHPËR PËR OBJEKTIN , OBJEKTET DHE SHKOLLËN PËR SHKAK TË PËRHAPJES SË ZJARRIT
- DO TË PARAQITEN EFKTE DYTËSORE PËR AMBIJENTIN DHE FAMILJET PËR RRETH,,
- MBËSHTETJE E PAMJAFTUESHME NGA NIVELI LOKAL

PIKAT E NDIJESHME NË ZONEN EMERGJENTE DHE LARGËSIA NGA VENDI I INCIDENTIT:

1. Shkolla fillore "Lidhja e Prizrenit" ----- 70m.
2. Parkingu i NTP "Ndertimi" ----- 8m.
3. QKMF-e "Adem Ukhaxhaj" -----132m.
4. Stacioni i autobusëve -----26m.
5. Magjistralla Deçan – Gjakovë ----- 0.5m.
6. Udhëkryqii Megjistrales Deçan- Gjakovë ----- 57m.

Goditja

Banorët	Familje	Hendikap	Femra	Meshkuj	Nxënës	Të mira materjale	Ifrastruk. kritike	Ob. Randësis veqant	Tr. kulturore	Demet ekonomik
104	13	2	/	/	1365	Infrastruktura e stacionit të karburantëve	Rrjeti i TL dhe rrjeti i ndriçimit të rrugës Deçan-Carrabreg	Shkolla, QKMF	/	5000€

Pasojat

- Rrezikimi i shëndetit dhe jetës së nxënësve të shkollës fillore
- Rrezikimi i shëndetit dhe jetës së pjesëmarrësve në komunikacion,
- Rrezikimi dhe damëtimi i mjeteve motorike në komunikacion,
- Rrezikimi i objekteve banesore dhe banorëve për rreth
- Ndhmë mjekësore kanë kërkuar 5 nxënës, të cilët nuk kanë patur lëndime fizike, por nga paniku dhe frika kanë patur shenja alivanosje. Kurse 6 nxënës i janë nënështuar trajtimit mjekësor nga afiksimi me tym i cili është krijuar nga djegëja e derivateve të naftës.

Skenari një:

Me 12 Gusht _____ nga qyterarë është njoftuar Policia se në qendrën tregtare “Viva Fresh Store” në Deçan, rruga “Luan Haradinaj” ka shpërthyer një zjarr me përmasa të medhaja ku numri i qytetarëve që gjinden brenda është i lartë. Policia në të marur lajmin ka njoftuar Brigaden e Zjarrefiksive për zjarrin e shpërthyer në këtë qendër tregtare. Dyshohet që mund të shpërthej edhe sistemi i gazit që është instaluar në objekt. Te dhënat e para flasin se mund të ketë të lënduar dhe të traumatizuar nga shpërthimi.

Me të marrë informatën njesia ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe ka filluar intervenimin, Policia ka bërë sigurimin e zonës rreth objektit. Në aksion janë bashkangjitur edhe QKMF-ja Kqyri i Kuq dhe njesite tjera relevante që kanë të bëjnë me sigurinë në nivel lokal. Duke marrë parasysh se nga përmasat e mëdhaja të zjarrit është kërkuar ndihmë edhe nga komunat fqinje Juniku, Peja dhe Gjakovë. Rreth situatës së krijuar është njoftuar edhe Agjencioni për Menxhimin e Emergjencave. Fatmirësisht, me angazhimin e personelit të stacionit dhe agjencioneve tjera zjarri është lokalizuar dhe shuar dhe është bërë evakuimi i njerëzve deri në destinacionin e sigurt kurse qytetarët e lënduar janë dërguar në spitalet rajonale më të afërta.

Skenari dy:

Në orët e pasdites të datës _____, Njesia e Zjarrefiksive në Deçan është informuar rreth për intervenim ndaj zjarrit në Udhëkryqin e Rostovicës afër Stacionit të karburantëve “Fati Petroll”.

Në vendin e incidentit, gjatë mbushjes së automjetit me karburant ka shpërthyer zjarri në automjet dhe kjo për shkak të mos respektimit të normave ligjore, të cilat dalin nga Ligji i Mbrojtjes nga Zjarri, në këtë rast të mos fikjes së automjetit gjatë mbushjes me karburant.

Me intervenimin e zjarrefiksive në kohën e duhur dhe kontributin e udhtarëve të rastit të cilët automjetet kanë larguar nga objekti i Stacionit, zjarri është lokalizuar dhe shuar po pasojë ma të mëdha, pos djegëjes së tërësishme të automjetit.

Skenari tre:

Në orët e mesditës të datës2010, gjatë shkarkimit të autocisternes me karburant, përshkak të mosrespektimit të rregullave për shkarkimin dhe depozitimin e derivateve të naftës dhe mosrespektimit të të rregullave të mbrojtjes ndaj zjarrit, ka shpërthyer zjarri në Stacionin e shitjes së karburantëve “Ylli Com” në Carrabreg. Fillimisht, zjarri e ka kaplue autocisternen, pastaj nga stihija e zjarrit janë përfshi edhe stabilimentet për mbushjen e atomjeteve me karburant, me q’rast janë krijuar flakë zjarri të cilat kanë krijuar valë të nxehta përvluese dhe tym të dendur. Nga kjo situatë e krijuar, seriozisht janë rrezikuar zjarrefiksitet dhe personeli i stacionit në fjalë. Nga kjo stihija zjarri në parkingun e NTP “Ndertimi”, që gjendet përballë Stacionit, nga zjarri janë kaplue edhe dy maune të ngarkuara me material ndërtimor druri dhe i cili parking ndodhet gjithsejt 35m. largësi nga ndërtesat e shkollës fillore “Lidhja e Prizrenit”.

Nga kjo situatë e krijuar, nga Komandanti i Incidentit, është dhënë alarmi për evakuimin e nxënësve dhe personelit arsimor nga ndërtesat e shkollës fillore. Evakuimi i nxënësve është bërë sipas “Planit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit” të kësaj shkolle dhe është arritur që për një kohë rekorde të evakohen të gjithë nxënësit dhe personeli arsimor nga shkolla, pa pasoja të natyës serioze.


Fillimisht, nxënësit me personelin arsimor, janë vendosë në anën lindore të shkollës, largë çdo rreziku nga zjarri. Pas evakuimit, ndihmë mjekësore kanë kërkuar 5 nxënës, të cilët nuk kanë patur lëndime fizike, por nga paniku dhe frika kanë patur shenja alivanosje. Kurse 6 nxënës i janë nënshtruar trajtimit mjekësor nga afiksimi me tym i cili është krijuar nga djegëja e derivateve të naftës.

Meqenëse, mbështetëja lokale e forcave për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit ka qenë e pa mjaftueshme, është kërkuar ndihma e njësive të zjarrefiksive të Komunave fqinje nga Peja dhe Gjakova, si dhe njësisë së zjarrefiksive të KFOR-it Italian e cila është e stacionuar në Deçan, Falë vetëmohimit dhe profesionalizmit të këtyre njësive, në orët e vona të pasdites së kësaj date është arritur që zjarri të vëhet nën kontroll dhe të lokalizohet.

Gjithashtu duhet falenderue kontributin dhe sakrificën e qytetarëve të cilët kanë ndihmuar në evakuimin e udhtarëve nga autobusi dhe largimin e tij nga stacioni i autobusëve në Udhëkryqin e Carrabregut, i cili ka patur defekt në momentin e shpërthimit të zjarrit, evakuimin banorve nga shtëpitë për rreth vendit të incidentit dhe ndihmën e ofruar për evakuimin e nxënësve si dhe bartjen e të plagosurve në Qendrën mjekësore.

Sigurimi i vendit të incidentit dhe nderperja e mbikqyerja e komunikacionit në aksin rrugor të Magjistrates Deçan-Gjakovë, është bërë nga Policia e Stacionit Policor të Deçanit.

Ndërsa ndihma mjekësore, në vendin e ngjarjes, të lënduarve dhe të afiksuarve iu është ofruar nga ekipet medikale të Qendres Krvesore të Mjekësisë Familjare të Decanit. kurse trajtimi i tyre



Harta e Zonës së Incidentit: N:42°31' 52" E: 20° 17 ' 40 "

REGJISTRI

i stacioneve të karburanteve në territorin e Komunës së DEÇANIT- 2017

Nr	Emërtimi i stacionit të Karburanteve	Selia e stacion. karburanteve	Sasia (kapacitet i) lëngjeve	Lloji i Lëngje naftëror	Viti i ndërtimit	Lloji i pronës	Aparatet për zbrazje elëngjeve	Pëlqime në lokacion	Pëlqime në dokum. investit	Leje ndert. Drejt .Urban	Leje nga Mbrojt të ambienti	Kategoria e rrizkshmis nga zjarri
	<i>Zona Urbane</i>											
1 —	“Kosova Petroll “ (Jo funksionale)	Sheshi “Mentor Tolaj” – Deçan	4 x 20.000 =80.000 litra	naftë benzinë	1967	pronë shoqëro	4	+	+	+	-	II
2 +	AL Petrol	rruga “Luan Haradinaj” Deçan	3 x 50.000 = 150.000 lit	naftë benzinë	1993	pronë privat	3	+	+	+	-	II
3 +	“Bonita “	rruga Dëshmorët e “Kombit Deçan”	2x 30.000 1x 20.000 = 80.000 lit.	naftë benzinë	1994	pronë private	2	-	-	-	-	II
4 +	Petroll Company	Deçan Rruga “Luan Haradinaj”										
5. +	Petrol Company	Carrabreg i Epërm Rr”Deshmorët e Kombit”										
	<i>Zona Rurale</i>											

5 —	“Dekor” pikë e shitjes dhe mini deponi (Jo funksionale)	Isniq Te ish fabrika e pompave	4 x 251.500 litra	Naftë benzinë	2005	pronë private	6	-	-	-	-	II
6 —	KB“ Strellci” (Jo funksionale)	fshati Strellci epërm Deçan	3x 30.000 =90.000 lit.	naftë benzinë	1987	pronë K.Bujqë	3	+	+	+	-	II
7 +	“Vëllezërit Gjukaj”	fshati Strellci i epërme –Deçan	3x 25.000 =75.000 lit.	naftë benzinë	2000	pronë private	3	-	-	+	-	II
8 —	“ Labinoti “ (Jo funksionale)	fshati Strellci i ultë – Deçan	5000 litra	naftë	2003	pronë private	1	-	-	-	-	II
9 —	“ Dizdari Petroll” (Jo funksionale)	fshati Zllapek – KK- Deçan	3 x 30.000 = 90.000 litra	naftë benzin	2000	pronë private	3	-	-	-	-	II
10 —	“ AL Petrol ” (Jo funksionale)	fshati Zllapek KK- Deçan	3 x 25.000 =75.000 litra	naftë benzinë	2001	pronë private	3	-	-	+	-	II
11 —	SH.A. Isniqi (Jo funksionale)	fshati Isniq	1 x 30.000 lit.	naftë	1987	pronë private	0	+	+	+	-	II
12 —	N.T.Sh.” Butrinti “ (Jo funksionale)	fshati Dubovik KK- Deçan	1x 50.000 1x 28.000 = 78.000 lit.	naftë benzinë	2001	pronë private	2	-	-	-	-	II
13 —	“Berisha S” (Jo funksionale)	fshati Pozhar KK- Deçan	1 x 28.000 lit.	naftë	2002	pronë private	1	-	-	-	-	II
14 +	“ Vali R “ (aktivizohet vetëm gjate veres)	fshati Lumbardhë KK- Deçan	2 x 25.000 = 50.000 litra	naftë benzinë	2002	pronë private	2	-	-	-	-	II
15 +	“ Agonisi GAS”	fshati Carrabregu i Epërme – Deçan	2 x 50.000 1 x 60.000 = 160.000 lit.	naftë benzinë	2001	pronë private	3	-	-	-	-	II

16 —	“Dukagjini 98 “ (Jo funksionale)	fshati Irzniq KK- Deçan	3 x 50.000 =150.000 litra	naftë benzinë	2001	pronë private	3	-	-	+	-	II
17 +	“ Fati Petroll”	fshati Rastavic KK- Deçan	1 x 30.000 1 x 40.000 = 70.000 litra	naftë benzinë	1987	pronë e K.Bujqs	3	-	-	+	-	II
18 —	“ Kosova Vaj “ (Jo funksionale)	fshati Rastavic KK- Deçan	3 x 50.000 =150.000 litra	naftë benzinë	2002	pronë private	4	-	-	-	-	II
19 —	“Shqiptoni Comerc” (Jo funksionale)	fshati Pobergjë KK- Deçan	3x 30.000 = 90.000 litra	naftë benzinë	2003	pronë private	2	-	-	-	-	II
20 +	“Kujtimi Petroll”	fshati Gllogan	2 x 20.000 =40.000 litra	naftë benzinë	2005	pronë private	3	-	-	-	-	II
21 —	“Goni CO” Stacioni me gaz (Jo funksionale)	rruga “Luan Haradinaj” Deçan	1 x 4.5 m3	Gaz	2005	pronë privat	4	-	-	-	-	II
22 +	T-OIL Tahirsylaj	Isniq										
23 +	HIP-Petroll	Lluke e Epërme										
24 +	M.N.T. Migjeni	Prilep										



1.2.9. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE TË SHKAKTUARA NGA ZJARRET E MËDHA

1. Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Parandalimit dhe Lehtësimit

- Faktorët e parandalimit, si fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe institucional, mund të kenë ndikim të rëndësishëm në uljen e rrezikut. Këto fushata mund të ndërmerren në nivel qendror, nivel rajonal dhe lokal, sipas nevojave specifike të rreziqeve në zonën përkatëse.
 - Publiku dhe institucionet duhet të jenë të ndërgjegjshëm për legjislacionin ekzistues, që ndalon ndezjen e zjarreve në zonat me rrezik të lartë dhe rregullat duhet të jepen si mesazhe të thjeshta.
 - Një sistem serioz vëzhgimi dhe patrullimi ndihmon në ndërgjegjësimin, informimin dhe zbatimin e legjislacionit.
 - Mund të nevojiten ndryshime në praktikat bujqësore për sa u përket rreziqeve në rritje.
- Alternativa, opsione dhe udhëzime mund të jenë të nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin për mos djegien e kullotave në periudhat kur rrezikshmëria e përhapjes dhe e daljes jashtë kontrollit është e lartë.

2. Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Parapërgatitjes dhe Mbrojtjes

- Inkurajimi dhe zbatimi i masave ekzistuese të mbrojtjes, si për shembull, barrierat për parandalimin e zjarrit, kullat për monitorimin e pyjeve dhe një situatë patrullimi i përforcuar për pyjet, është çelësi për mbrojtjen e zonave të mëdha nga zjarret.
- Mbështetja dhe përforcimi i një rrjeti të përhershëm ekzistues të mbikëqyrje-sinjalizimit (me disa kulla vrojtimi) jep këtë përgjigje thelbësore të hershme.
- Investimet, fuqizimi dhe përdorimi racional i teknikës mund të çojnë në përballim të situatës përpara se kjo e fundit të mos mund të kontrollohet nga njeriu.

3. Faktorët për t'u marrë parasysht gjatë fazës së Përgjigjes

- Shpejtësia e përgjigjes është faktori kryesor në parandalimin e përhapjes së zjarrit në një pyll të vogël ose të zjarrit në shkurre, për të mos marrë përmasat e një emergjence civile.
- Drejtimi i zjarrit është shumë i paparashikuar dhe e gjithë popullsia vendëse ose e përkohshme në çdo rast duhet të përgatitet për t'u evakuuar. Evakuimi duhet të bëhet mundësisht sipas planevetë gatishmërisë ekzistuese dhe të testuar.
- Duhet të identifikohen dhe të paracaktohen zonat e sigurta për evakuimin së bashku me rrugët e sigurta për të shkuar në ato zona që ekzistojnë ose që janë dhënë si mundësi.
- Publiku dhe institucionet duhet të mbahen të mirinformuara nëpërmjet mjeteve të nevojshme (si për shembull, stacioneve lokale të radiove) dhe duhet të lejohen ose të inkurajohen të kthehen në shtëpitë e tyre kur situata të jetë përsëri absolutisht e sigurt.
- Në emergjencat e zjarreve të një madhësie të konsiderueshme mund të kërkohet ndihmë ndërkombëtare për shuarjen e zjarrit, si për shembull zjarrfikës të fuqishëm, helikopterë dhe avionë të prodhuar posaçërisht për këtë qëllim, veçanërisht nga vendet fqinje.

4. Faktorët për t'u marrë në konsideratë gjatë fazës së Rikthimit në Gjendjen Normale

- Dëmtimet në lidhjet e transportit, të energjisë elektrike dhe të telekomunikacioneve duhet të jenë me përparësi për t'u rregulluar, sapo situata të jetë e sigurt për të bërë një gjë të tillë.

- Situata duhet të monitorohet nga afër për shpërthime të papritura të vatrave të zjarrit fillestar ose të zjarreve dytësore, që ndodhin nga i njëjti shkak fillestar ose nga materialet djegëse që zhvendosen nga era.
- Kthimi i situatës në normalitet sjell mundësi për të mësuar nga një rishikim i plotë i shkaqeve dhe ndikimit të asaj çfarë ndodhi, duke analizuar rëndësinë e paralajmërimit në kohën e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme si dhe përgjigjen e duhur.
- Një rishikim i plotë siguron përmirësime të mundshme gjatë operacioneve të përballimit, të parandalimit dhe të lehtësimit të situatës së krijuar.
- Humbja ekonomike që vjen si rezultat i zjarrit, duhet të paraqitet me koston e mundshme të lehtësimit kundrejt një situatë të përsëritur, si mjet për të kërkuar investime për parandalimin.
- Etapa e menjëhershme e pas ngjarjes, mund të paraqesë një mundësi për të aplikuar për burime shtesë për parandalimin, lehtësimin dhe mbrojtjen.

1.2.10. NDIKIMET E ZJARREVE PYJORE DHE FUSHORE:

Në tokë bujqësore:

Bujqësia është potenciali kryesor ekonomik në Komunën e Deçanit.

Sa i përket tokave bujqësore, Komuna e Deçanit përballet me të njëjtat sfida sikurse të gjitha Komunat tjera të Republikës së Kosovës, e këto janë:

- Humbja e tokës bujqësore duke e shëndrruar në tokë ndërtimi,
- Fragmentimi i parcelave,
- Ndotjet e ndryshme,
- Deponit etj.

Degradimi i tokës nga zjarri paraqet nevojë imediate që ripërtëritje e pyllit dhe e tokave është më se i nevojshëm.

4.8.2. Në vegjetacion:

Zjarri shkakton ndryshime dramatike në vegjetacion, duke dëmtuar ose shkatërruar pjesë të bimëve ose bimësi të terë, varësisht nga intensiteti i djegëjes së zjarrit dhe kohë zgjatja e ekspozimit të bimëve temperaturave të larta. Karakteristikat e bimëve si trashësia e lëvores dhe diametri i kërcellit, ndikojnë në ndjeshmërinë ndaj zjarrit. Llojet e drunjve të vegjël më lehtë dëmtohen se sa ata të mëdhenjtë.

Lëvoret e pishave janë më të trash dhe kanë veçori të mira izoluese ndaj zjarrit se sa llojet e drunjve gjeth trasha të cilat dëmtohen më lehtë nga zjarri.

Kurorat e drunjve janë mjaftë të prekshme në temperatura mbi 732° C.

Temperatura e ajrit dhe e vegjetacionit në kohën e djegëjes janë faktor kritik.

4.8.3. Në dhe:

Efektet e zjarrit në tokë dallojnë shumë. Kohë zgjatja dhe intensiteti i zjarrit duhet të meren në konsideratë.

Materiet organike të tokës pyjore gjinden në fillim të shtresës së dheut.

Zjarret fushore-malore zakonisht shkatërrojnë shtresën e humusit duke shkaktuar disa efekte sekondare:

- Largimi i materialit termik izolues që për pasoj ka nxehjen e dheut për një kohë më të gjatë dhe nxehja gjatë vitit është më e thellë.
- Si rezultat i ndikimit të nxehtësisë shkatërrohen proteinat dhe molekulat tjera në kompozime më të thjeshta ose edhe në forma elementare, të cilat i shkatërrojnë bimët,
- Asgjësimin e kribave të tokës dhe efekte tjera.

4.8.4. Në ujë:

- Pjerrtësia e trenit,

Pasojat e zjarreve të pyjeve, në kualitetin e ujit, ndryshojnë varësisht nga karakteristikat e zjarreve të veçanta dhe ambienti në të cilin ndodhë:

- Shtresa e tokës,
- Temperatura etj.

Të gjitha këto ndikojnë në ndryshimet e kualitetit të ujit që ndodhet në hapësirat e djegura.

Në disa ekosisteme zjarret malore rrezikojnë kualitetin e ujit në disa mënyra:

- Me djegjen e vegjetacionit rritet procesi i erozionit,
- Paraqitja e vërshimeve që pason me :
- Bartje të grimcave të dheut, neutrinteve të tretur organik dhe materiale tjera.

Si rezultat i erozionit sedimentet (nitratat dhe nitritet) depozitohen në ujë. Kjo ndikon në paraqitjen e turbiditetit (turbullimit) të ujit që në mënyrë indirekte ndikon në shëndetin e njerëzve duke shkaktuar paraqitjen e mikrobeve dhe rritjes së rrezikut për njerëzit që vijnë në kontakt me ujin e pa trajtuar,

4.8.5. Në ajër:

Zjarret ndikojnë në ndryshimin e kualitetit të ajrit. Kualiteti i ajrit afektohet nëse sipërfaqe të mëdha digjen për të njëjtën ditë duke krijuar sasi të mëdha tymi.

Tymi përbëhet nga:

- Grimca të imta hiri të lëndëve të djegura dhe
- Pikave të lëngëta.

Produktet tjera të djegëjes janë gaze të pa dukshme si:

- Monoksid karboni,
- Dyoksid karboni,
- Hidrokarbure dhe
- Në sasi të vogla edhe oksidet e azotit.

Grimcat e tymit zvogëlojnë dukshmërinë. Shpejtësia e përhapjes së tymit varet nga stabiliteti atmosferik dhe shpejtësia e erës. Të gjitha këto ndikojnë negativisht në:

- Hapësirat e populluara,
- Auto rrugëve,
- Aeroporteve dhe
- Vendeve të ndjeshme ndaj tymit.

4.8.6. Në njerëz:

Gjatë procesit të djegëjes lirohet tymi dhe produktet e djegies. Përqendrimet larta të tymit mund të jenë faktor serioz i përkeqësimit të shëndetit të njerëzve sidomos të ata me sëmundje respiratorike.

Tymi mund të ketë efekte negative afat gjata dhe afat shkurtra. Përsosni gjatë menaxhimit të zjarreve të cilët janë të ekspozuar në përqendrime të larta të tymit, zakonisht vuajnë nga probleme të sistemit respiratorik dhe iritimeve të tyre.

Rreth 90% e emisioneve të grimcave nga zjarri janë po aq të vogla që lehtë mund të hynë në sistemin respiratorik. Këto grimca përmbajnë me qindra kompozime kimike disa prej të cilave janë helmuese. Ekspozimi i gjatë dhe i përsëritur në përqendrime relative të tymit gjatë shumë viteve , mund të ndikon në sistemin respiratorik dhe në shfaqjen e kancerit.

Ekziston së paku një grup i komponimeve që gjinden në tym të cilat mund të kenë ndikim akut në individ, sidomos kur bimët helmuese si që janë bimët kacavjerrëse digjen.

Segmente të ndryshme të popullsisë siç janë:

- Të rinjtë,
- Të moshuarit,
- Njerëzit me probleme kardiopulmonare,
- Njerëzit në kushte psikiatrike dhe
- Duhanxhinjtë

Janë të prekur nga problemet shëndetësore.

Po ashtu, zjarret malore shkaktojnë edhe sulmin në zemër.

Ka të dhëna kur zjarrfikësit kanë pësuar sulm në zemër gjatë fikjes së zjarreve të mëdha malore. Gjatë ekspozimit ndaj zjarrit mundë të ketë edhe lëndime direkt siç janë djegiet e shkallëve të ndryshme.

4.8.7. Në kafshë:

Pos efekteve tjera negative të zjarreve në kafshë, këtu përfshihen edhe shkatërrimi i çerdheve dhe mbytja e zogjve dhe kafshëve të ngujuara nga zjarri.*

* Nga Plani i MNZ-Deçan

1.3. Thatësitrat:

Katego. rrezikut	Atmosferike	
Lloji	Fatkeqësi natyrore	
Rreziku	Thatësitë	
Modeli	Korrik, Gusht, Shtator	
VLERËSIMI	K. e Deçanit shtrihet në pellgun e tre lumejve dhe një rrjeti të dendur të projeve dhe prockave të cilët burojnë në masivin e Bjeshkëve të Nemuna, në të cilat ka sasi të mëdha të reshurave atmosferike dhe të pasura me burime të shumta të ujit, të cilat burime shfrytëzohen për rrjetin e kapacitetit të ujësjellësit me të cilin, Komuna, është e mbuluar rreth 71.19%. Ndërsa, toka nën ujitje është pothuajse 100%.	

Thatësitë është një periudhë e zgjatur mujore apo vjetore, kur një rajon ka mangësi në furnizim me ujë. Në përgjithësi, kjo ndodh kur një rajon, në vazhdimsi ka reshje atmosferike nën mesataren e nevojshme. Ajo mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm mbi ekosistemin dhe bujqësinë e rajonit të prekur. Edhe pse thatësitrat mund të vazhdojnë për disa vite, madje edhe një periudhë të shkurtër kohore, thatësira, mund të shkaktojë dëme të mëdha në ekonominë lokale të Zonës së goditur. Ky fenomen global ka një ndikim të gjerë sidomos në bujqësi. Kombet të Bashkuara vlerësojnë se një zonë e tokës pjellore e madhësisë së Ukrainës është humbur çdo vit për shkak të thatësitës, shpyllëzimit, dhe jostabilitetit të klimës. Periudhat e thatësitës së zgjatur kanë qenë prej kohësh një shkas kryesor për migrimit masiv dhe luajti një rol kyç në një numër i migrimesh të vazhdueshme dhe kriza tjera humanitare n


	Mënyra e furnizimit me ujë	N.famil.	N banorëve	Kërkesa dit.për ujë n raste em.
1	Furnizimi. nga ujësjellësi i mbikëqyrur	5616	24060 ose 60.43%	63930 litra
2	Fu. nga ujësjellës.i cili nuk mbikëqyret	814	4010 ose 10.76%	11396 litra
3	Furnizimi me ujë nga pusët (bunarët)	2178	11552 ose 28.81%	30492 litra
GJITHESEJT		8608	40 100	105818 litra

Tabela e karakteristikave Hidro – meteorologjike:

1.	Mesatarisht temperaturë vjetore	Mbi 12 C
		9.1-12 C
		Deri 9.0 C
2.	Mesatarisht sasia vjetore e të reshurave	Der më 800mm
		800-1200mm
		Mbi 1200mm
3.	Mesatarisht lagështia vjetore relative e ajrit	Mbi 70%
		71-80%
		Mbi 80%

I

1.4. Termetet



Qendrat e termeteve në Botë – 1963 - 1998

Kategor. e rrezikut	Gjeologjike	
Lloji	Fatkeqësi natyrore	
Rreziku	Termet	
Modeli	Gjatë vitit	
VLERËSIMI	<p>Komuna e Deçanit nuk është vatër e shpeshtë sizmike por, në rastin e ndodhjes së tërmetit, pasojat do të jenë katastrofike, duke pas parasysh nivelin e ndërtimit, pastaj dendësinë e madhe të banorëve në km², mundësia e fatkeqësive sekondare, infrastrukturën e dobët të paralajmërimit të hershëm si dhe aftësia e kufizuar e njëjësive reaguese për këtë lloj fatkeqësie.</p>	

Profili i Rrezikut	
Rreziku: Tërmetet	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): Kritike: 25 deri 50%	
FREKUENCA E NDODHJES: Ka gjasa: Mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një shans në 100 vitet e ardhshme.	Modeli : gjatë vitit
Zonat që mund të goditen më së shumti: Tërë teritori i Komunës,	
Kohëzgjatja e mundshme: E qastit	
SHPEJTËSIA E MUNDSHME E MËSYMJES (SHUMA E MUNDSHME E KOHËS SË PARALAJMËRIMIT): Pa paralajmërim	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: Nuk ka	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë? Po	

Cënueshmëria nga goditjet në Faktorët Kyç të Komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Shkalla e goditjes në banorë gjatë kohës së tërmetit në vendin e incidentit e ashpër (dhjetëra vdekje dhe qindra lëndime të rënda, për shkak të shembjes së shtëpive, zjarreve, përmytjeve, avarive elektrike...)	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim i pasurisë private dhe shtetërore. Në shumë shtëpi banimi, ndërtesa kolektive, në administratën komunale, shkolla, ambulanta, hotele etj.	E ashpër
Infrastruktura Vitale	Dëmtimi i sistemit energjetik, ujësjellësve, sistemit të furnizimit me ushqim..	E ashpër
Objektet e Rëndësisë së Veçantë	Shkatërrim dhe dëmtim i sistemit shtetëror, shkollave, QKMF, amb. etj...	E ashpër
Shërbimet Emergjente	Dëmtime të pajisjeve të njëjësve reaguese (NJPZSH).	E mesme
Ambienti	Për shkak të rrëtimeve të mëdha zjarrit dhe tymit, kontaminimit të ujërave, dëmtohet mjedisi si dhe krijohen parakushtet për erozion masiv.	E ashpër
Trashëgimia Kulturore	Shkatërrim dhe dëmtim i objekteve të trashëgimisë kulturore	E ashpër
Shërbimet shtetërore	dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë	E mesme
Dëmet Ekonomike	Shkatërrim dhe dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj...	E ashpër

1.4.1. Karakteristikat seizmologjike të terrenit dhe rreziku seizmologjik:

Historiku dhe situata e tanishme

Kosova, si dhe vendet tjera, bën pjesë në Brezin e fuqishëm Sizmik Mesdhetar Transaziatik dhe nga pikëpamja sizmike është një ndër vendet me aktive në Evropën Juglindore. Rreziku sizmik mund të konsiderohet si kritik në Kosovë, sepse është një vend i cili ndodhet mbi një zonë sizmike aktive. Nga pikëpamja sizmologjike Kosova paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmetet autoktone shumë të forta, të cilët i kanë vatrat e cekta, që gjenerohen në koren e tokës, maksimum 15 - 20 km thellë në nëntokë.

Territori i Kosovës gjatë shekullit të kaluar e deri tash është prekur nga 82 tërmete me intensitet 5 ballë, nga 34 tërmete me intensitet 6 ballë, nga 12 tërmete me intensitet 7 ballë, nga 10 tërmete me intensitet 8 ballë (1 tërmet i përket periudhës para vitit 1900) dhe nga 3 tërmete me intensitet 9 ballë (2 tërmete i përkasin periudhës para vitit 1900).

Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur Komunën e Deçanit duhet cekur tërmeti i Pejës, 11 nëntor 1662 me intensitet epiqendror $I_0=8$ ballë shkalla MCS dhe magnitudo 6.0 shkalla Riter,

Territori i Kosovës në aspektin sizmotektonik përfaqëson një terren aktiv, të dhënat për tërmetet nga e kaluara dëshmojnë qartë se dukuria e tërmeteve të forta në disa pjesë të territorit të Kosovës ka qenë evidente shumë herët dhe në bazë të këtyre ngjarjeve sizmike në të kaluarën, Kosova zë vend në zonën me aktivitet sizmik. Gjatë periudhës pas viteve 2000, Kosovën e kanë goditur tre tërmete të fuqishme të mëdha. Në qytetin e Gjilanit në vitin 2002 me intensitet në epiqendër 8 ballë. Tërmeti i Istogut, i vitit 2010 me intensitet në epiqendër 7 ballë dhe i fundit, Tërmeti i Vushtrrisë në vitin 2013 ndersa viteve të fundit në Deçan, Pejë, Gjakovë e përreth ka pasur her pas here tërmete të "vegjël" që nuk ka pasur pasoja as në njerëz dhe materiale.

- Me 10 mars 2010, n'ora 14:38 minuta, një tërmet i fuqishëm goditi Kosovën. Qendra Amerikane e Gjeologjisë (USGS) konfirmoi tërmetin e ndodhur në Kosovë duke saktësuar se fuqia e tërmetit ishte 4.9 shkallë Magnitude. Dridhje të fuqishme të tokës janë ndjerë edhe në disa qytete të Kosovës por edhe në Shkup, ndërsa nuk është raportuar përdëm edhe viktima.

Një orë pasi ndodhi tërmeti, me një komunikatë zyrtare Rjeti Sizmologjik i Kosovës ka njoftuar se sot, në orën 14:38 minuta, sipas kohë lokale, sizmografët e Rrjetit Sizmologjik të Kosovës, detektuan tërmet me epiqendër 6 kilometra në juglindje të Istogut. Magnituda e tërmetit ishte $M=5.2$ shkallë të Rihterit, ndërsa intensiteti në epiqendër VII ballë sipas MCS-64 thellësia 5.2 km.

Ndërkohë që, sipas Qendrës Amerikane të Gjeologjisë (USGS), thellësia e lëkundjeve ka qenë 10 km ndërsa epiqendra në largësi 50 km nga Prishtina, 95 km nga Tetova, 115 km nga Shkupi dhe 225 km nga Beogradi. Qytetarët të shqetësuar janë larguar me shpejtësi nga banesat e tyre dhe kanë dalë në rrugë. Edhe punonjësit e institucioneve kanë braktisur për disa minuta vendet e tyre të punës dhe kanë dalë në Sheshin "Nënë Tereza", të frikësuar se tërmeti mund të përsëritet.

Sipas njoftimeve, edhe pse epiqendra e Tërmetit ka qenë në Istog, ku sipas njoftimeve "është shënuar dridhje të fuqishme e Tokës", në këtë rajon nuk ka pasur dëme materiale në objektet e banimit dhe as në njerëz. Megjithatë, shumë banorë të qytetit dhe të fshatrave për rreth nga frika, për një çast, kanë dalë jashtë ndërtesave të banimit dhe këtë ngjarje e kanë përjetuar keq.

Pas tërmetit për disa minuta nuk kanë funksionuar edhe rrjetet i dy operatorëve të telefonisë mobile.

Termeti i kësaj date është ndier edhe në Komunën e Deçanit, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale, pos shqetësimit të banorëve në terë tërëtorin e Komunës.

-Në teritorin e Komunës së Deçanit, në një periud të gjatë kohore, nuk ka ndodhur ndonjë tërmet me intensitet të lartë, i cili kishte mundë të shkakëtoj dëme të mëdha materiale dhe viktima njerzore, kësaj është vështirë në mënyrë precize dhe gjithëpërfshirëse, të vlerësohet shkalla e pregaditjes dhe paisjes së strukturave të Mbrojtjes e Shpëtimit dhe subjekteve tjera përgjegjëse juridike në Komunë për Mbrojtje dhe Shpëtim nga kjo

fatkeqësi natyrore. Mirëpo, duke marrë parasysh se strukturat e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, shiquar në mënyrë gjenerale, janë dobët të organizuara dhe të paisura me mjete Materjale Teknike e paisje, mundë të thuhet se shkalla e mbrojtjes dhe shpëtimit nga kjo fatkeqësi natyrore, e cila mund të shkakton shkatërrime të mëdha të mirave materjale dhe viktima të konsiderueshme njerzore, është në nivel të ultë.

Në strukturën organizative të Sektorit për Mbrojtje e Shpëtim nuk funksionon Njesia e Specializuar për Kërkim-Shpëtim në male (bjeshkë) e cila kishte mundur me u shfrytëzuar edhe për kërkim-shpëtim nga gërmadhat në rast të ndodhjes së termetit.

Mirëpo, fatmirësisht, në komunën tonë, në institucionet gjegjëse shëndetësore janë mirë të organizuara, të paisura dhe të aftësuara shërbimet për dhënjen e ndihmes mjekësore me kohë e kualitative të lëndurve nga termeti. Gjithashtu, në Komunë ndodhen edhe kapacitete të mjaftueshme mjekësore (QKMF, QMF dhe Ambulatat) për përkujdesje mjekësore të pesonave të goditur.

1.4.2. Planifikimi, ndertimi urbanistik dhe masat mbrojtëse seizmologjike:

Duke marrë për bazë shkallën e urbanizimit, karakterin e teknologjisë së ndertimit si dhe mos respektimin "aseizmik" të ndertimit të objekteve ndertimore, mund të themi se Komuna e jonë është teritor i rrezikuar në pikëpamje seizmike.

Në bazë të fakteve të paraqitura, mund të konstatohet se vlerësimi i shkallës së mbrojtjes dhe mundësija e shpëtimit të njezve dhe të mirave materjale nga veprimi i termetit është një pyetje shumë komplekse, sepse kjo mvaret nga intenziteti dhe largësija e epiqendres së termetit nga rajoni i Komunës. Sikur edhe nga karakteristikat statike të objekteve ndertimore, gjegjësisht nga qendrueshmerija e tyre nga aktiviteti seizmik. Në bazë të kësaj, mund të themi se në nivelin lokal, mundësit për shpëtim nga gërmadhat janë minimale. Mirëpo, mundë të themi se në teritorin e Komunës, kemi parakushte të mira për përkujdesje shëndetësore të lënduarve, Është e pamundur që të parandalohet një tërmet ose një dukuri tjetër sizmike, por është e mundur që të merren masa për të kufizuar efektet më negative që lidhen me cenimin e jetës dhe të pasurisë së qytetarëve. Mu për këtë duhet të ndërmerren masa adekuate për zvogëlimin e dëmeve në raste të tilla, si dhe të zbatohen:

- kodet dhe standardet e ndertimit për t'i përballuar lëkundjet sizmike,
- planifikimi hapësinor urbanistik i qytetit, e të ndërmerren masa mbrojtëse për rrezikshmërinë e disa fshatrave duke marr parasysh llojin e ndertimit dhe materialin e përdorur, si dhe dyndjen e popullsisë së qytetit,
- masat parandaluese dhe përgatitore ulin edhe dëmtimet potenciale ndaj infrastrukturës mbështetëse (objektet shëndetësore, ndërtesat publike dhe private, rrugët, sistemet e furnizimit me ujë, energji, e të cilat do të jenë shumë të rëndësishme për fazën e përballimit dhe të rimëkëmbjes nga një goditje eventuale sizmike,
- sensibilizimi i strukturave në nivel komunal e më gjerë, i cili është shumë me rëndësi,- informimi i publikut dhe i institucioneve përkatëse, përmes mediave dhe mjeteve tjera të komunikimit,- planifikimi i stërvitjeve për raste të tilla në terren.

Pasojat e tërmetit në zonën sizmologjike ku ndodhet teritori i komunës së Deçanit, e sidomos qyteti, për objektet e banimit kolektiv, ndërmarrjet publike, objektet tjera shumëkatëshe do të ishin në shkallë të lartë, mu për këtë duhet planifikuar masat për evakuimin dhe strehimin e popullsisë së rrezikuar, si dhe sigurimin e gjërave të domosdoshme ushqimore, veshmbathje dhe medikamente në sasi të domosdoshme nga institucionet përkatëse që veprojnë në teritorin e komunës. Kjo do të jetë njëra nga detyrat kryesore që duhet të ndërmerret si masë mbrojtëse kundër rrezikut nga tërmeti eventual.

1.4.3. Zonat, shpeshhtësia, intensiteti dhe epiqendra e termetit:

Territori i Kosovës ka tri zona të fuqishme të burimeve sizmike, ose zona sizmogjene:

- **Zona sizmogjene Prizren-Pejë me magnitudë maksimale M=6.6 shkalla Riter, (duke përfshij edhe Komunën e Deçanit).**
- **Zona sizmogjene Ferizaj-Viti-Gjilan me magnitudë maksimale M=6.1 Shkalla Riter,**
- **Zona sizmogjene Kopaonik me magnitudë maksimale M=6.0 shkalla Riter.**

Me se matet madhësia e nje termeti?Sizmologet përdorin Ball (Magnitude) për të shprehur energjinë sizmike të ciluar nga termeti. Ja ca nga efektete të termeteve të madhësive të ndryshme.

Me pak se 3.5 ballë.....në përgjithësi nuk mund ta ndjesh,por regjistrohet.

3.5 deri në 5.4 ballë.....shpeshherë ndjehet por në raste të rralla mund të shkaktojë dëmtime.

Me pak se 6 ballë.....shkakton dëmtim të vogël në ndërtesat me struktura të forta,dhe demton shumë godinat me nderim të dobët.


6.1 deri në 6.9 ballë.....mund të jetë shkatërrues në zonat e populluara që shtrihen deri në 100km larg epiqendrës.

7.0 deri në 7.9.ballë...Termet i madh mund të shkaktojë dëmtime serioze në zona të mëdha.

8 ballësh e lart....Katasrofal !Mund të shkaktojë dëmtime tepër serioze në zona që shtrihen qindra kilometra larg epiqendrës.

Edhe pse çdo termet ka një masë unike ballësh pasojat varen shumë nga largësia e epiqendrës,struktura e ndërtesave,terreni etj.


4.



UTM GRID Zone 34T WGS 84

EARTHQUAKE RISKS IN KOSOVO

DN 00 EN



DM 00 EM

SCALE 1:250,000

LEGEND

Boundaries

- International Border
- Region/Province Boundary
- Municipal Boundary

Roads

- Main Road

Hydro

- Rivers
- Lakes

Other

- Forest
- City

Earthquake Risk Legend

Risk Level	Description
Low	Low seismicity and low population density.
Moderate	Moderate seismicity and moderate population density.
High	High seismicity and high population density.
Very High	Very high seismicity and very high population density.

Information portrayed on this map was derived from data collected by NATO Military Operations in Kosovo (MOK) and other force map makers. NATO Mapping Group (MAG) is the primary source of the data.

Boundary Overview

Map Use Instructions

- Read the map scale (1:250,000) to determine the distance between two points.
- Use the map scale to determine the distance between two points.
- Use the map scale to determine the distance between two points.

Produced under the direction of the Chief Geographic Officer, HQ KFOR 2000. Maps should only be used for informational purposes and not for navigation. Maps produced for use on behalf of the Chief Geographic Officer, HQ KFOR are not to be taken as representing the views of NATO or its member states. Further enquiries to the Director of Intelligence (DIO) should be made.

Produced by: C. Gen HQ KFOR

1.4.5. Pasojat e termetit në zonat e goditura:

Magnituda e Rihterit	Mgnituda e Merkalit	Dëmet dhe Pasojat
2	I-II	Nuk ndihet. Zakonisht zbulohet vetem me instrument (seizmograf)
3	III	Diktohet në katet e epërme. Objektet e lehta mundë të luhaten.
4	IV	Diktohet nga shumica e popullit. Dëmetë lehta.
5	V-VI	Diktohet nga të gjithë. Njerzit dalin jasht, Dritare të thyera. Qarje muresh. Rrëzimi i objekteve jo stabile. Dëme të vogla.
6	VII-VIII	Të gjithë dalin jashtë. Dëme mesatare deri të aso të mëdha. Ka dame në ndertesave të forta. Dëmtim i oxhaqeve, kanë rënë muret e ndertesave të cilat janë ndertuar me material të dobët etj. Burimet e ujit psojnë ndryshime.
7	IX-X	Dëme të mëdha. Ndërtesat ndahen nga themelet. Toka është qar. Shkatërrim i ndertesave nga betoni. Binarët e hekurudhave janë lakuar. Ka rrshqitje të dheut. Uji derdhet jashtë brigjeve të lumejve. Dëmtim i urave.
8	X-XII	Dëme shumë të mëdha dhe të tërësishme. Pak ndërtesa nga betoni mbeten të pa shkatërruara. Urat shkatërrohen. Ujsjellësi, kanalizimi dhe gaz sjellësi ja shtë përdorimit. Shifen valë në sipërfaqen e tokës. Relefi është zhbër. Objektet janë hedhur në ajr.

Faktorët e përkeqësimit:

Ndërtimet pa kritere sizmike si pasojë e komponentës sizmike si dhe cilësia jo adekuate e strukturave ndërtimore në Deçan i bën të ndjeshme vendbanimet e saj.

Flukset e rrezikut:

- Shembja e ndërtesave të banimit dhe të atyre publike,
- Dëmet në infrastrukturë dhe transport
- Çrregullimet në ambient (rrjedha e ujit, rrëshqitja e terrenit)
- Efektet sekondare (zjarret, shembjet, rrjedhja e kanalizimeve dhe e prodhimeve toksike etj).

Skenarët më të mundshëm :

Dy skenarët më të mundshëm ose më të shpeshtë varen nga thellësia e epiqendrës:

- Shkatërrimi i pjesshëm i objekteve të banimit, ndërtesave që pranojnë publik, shkollave etj, pa efekte sekondare
- Shkatërrimi Qendres Administrative Deçanit dhe fshatrave me efekte sekondare (zjarre, kontaminime etj)

Pasojat:

Deçani nuk është vatër e shpeshtë sizmike por, në rastin e ndodhjes së tërmetit, pasojat do të jenë katastrofike, duke pas parasysh nivelin e dobët të ndërtimit, pastaj dendësinë e madhe të banorëve në km², mundësia e fatkeqësive sekondare infrastrukturën e dobët të paralajmërimit të hershëm si dhe aftësia e kufizuar e njësive reaguese për këtë lloj fatkeqësie.

Ndikimi i reshjeve, erërave dhe temperaturave:

Zakonisht janë faktor përkeqësues, si në mundësinë e dridhjeve të mëvonshme, po ashtu edhe në përkeqësimin dhe krijimin e kushteve të vështirësuar për reagim dhe përkujdesje për banorët goditur.

1.5. SHKAQET TJERA NATYRORE

1.5.1. Stuhitë:

Kategoria e rrezikut	Atmosferike
Lloji	Fatkeqësi natyrore
Rreziku	Stuhi
Modeli	Vjetore
VLERËSIMI	<p>Pasojat janë të shumta dhe manifestohen duke ndikuar në: ambient, objekte vitale, objekte të rëndesishme së veçantë, objekte banimi, trashëgimi kulturore, ifrastruktur, bujqësi etj. Stuhit e breshërit, që zakonisht ndodhin në periudhen në mes pranveres së hershme e vjeshtes së vonë, gjithashtu janë karakteristike e klimes së Deçanit. Kohëzgjatja e stuhisë së breshërit sillet prej disa sekondave e deri një orë. Më së shpeshti zgjatë 10 deri 15 minuta.</p>



Stuhia është çrregullim atmosferik, e cila shkakton ndryshime atmosferike që inicojnë ndryshime të rëndësishme në fushen e erërave, shtypjes dhe temperaturës në shkallë hapsinore që zgjaten nga madhësia e tornados (me shpejtësi nga 1 km.) deri të ciklonet tropikale (me shpejtësi nga 300 deri 500 km.) Stuhi quhet edhe era e cila ka shpejtësin minimalen nga 20,8 m/s (74,9 km/h) ose sipas shkallëve të Boforit 9 shkallë. Erërat me të shpejta se 32,7 m/s ose 12 Bofor quhen Uragane.

Stuhitë korrespondojnë me fenomenet e rafalëve të erës. Këto fenomene meteorologjike kanë të bëjnë me një shtrirje që shkon nga disa qindra metra deri në disa dhjetëra kilometra dhe një kohëzgjatje nga disa minuta në disa orë. Situatat meteorologjike në origjinën e tyre kanë një jo stabilitet të fuqishëm të atmosferës.

Ky lloj i fenomenit duket mjaft i shpeshtë në Kosovë sidomos këto vitet e fundit që korrespondon me periudhat e ngrohjes së klimës në mes të qershorit dhe shtatorit.

E efektet e këtyre fatkeqësive natyrore janë të shumta, bëhet fjalë për:

- Shkuljen e drunjve,
- Rrëzimin e kulmeve
- Lëvizja dhe hëdhja e objekteve të ngurta (mobile të kopshtit, kontejnerëve...)
- Shkatërrimi i pjeshëm i rrjetit elektrik dhe të telefonisë,
- Çrregullimi i transportit (ajror, hekurudhor dhe rrugor)
- Vërshimet,
- Ndotjet e ujërave nëntokësore, ose sipërfaqësore

Pasojat:

Aksidentet e komunikacionit
Zvogëlimi, madje paralizimi i aktiviteteve socio-ekonomike,
Vdekje ose lëndime, nga goditjet ose nga rëniet e objekteve,
Mbytjet,
Vdekje ose lëndim nga rënja

1.5.2. Shembjet dhe Erozioni:

Kategoria e rrezikut	Gjeologjike
Lloji	Fatkeqësi natyrore
Rreziku	Shembje dhe Erozion
Modeli	Sezonal
VLERËSIMI	Duke marrë për bazë kushtët fiziko-gjeologjike, përbërjen litologjike të korës së tokës, kushtet klimatologjike dhe faktorët tjerë të cilët kanë ndikim në krijimin e shembjeve dhe erozionit të tokës , është vlerësuar se një dukuri e tillë nuk është e theksuar në përmasa të mëdha në Komunën e Deçanit, megjithëate, viteve të fundit ka ndodhje të fenomeneve të tilla për shkak të ndryshimeve klimatike.



Duke marrë për bazë kushtët fiziko-gjeologjike, përbërjen litologjike të korës së tokës, kushtet klimatologjike dhe faktorët tjerë të cilët kanë ndikim në krijimin e shembjeve dhe erozionit të tokës , është vlerësuar se një dukuri e tillë është e rrallë e ndodhjes në Komunën e Deçanit. Ky konstatim sidomos vlenë për procesin e shembjeve masive të dheut dhe materjalit tjetër të kores së tokës, meqenëse deri më tani nuk janë evidentuar ndodhje të shembjeve massive, me përjashtim të ndonjë shembje lokale që simbas vëllimit të shembjes është shumë e vogël ose proceseve tjera erozive të shkaktuara nga grryerja e brigjeve të lumejve dhe projeve.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpetim në bazë të inspektimit, parametrave si relievit, këndit të pjerrtësisë dhe faktorëve të aktivizimit, ka konstatuar se ndodhje të shembjeve masive të trollit në teritorin e Komunës së Deçanit nuk ka tendenca të ndodhjeve masive.

Gjatë inspektimit të shtretërve të lumenjve të cilët përshkojnë teritorin e Komunës së Deçanit si :

Lumbardhit të Lloqanit , Lumbardhit të Deçanit, Liqeni i Radoniqit dhe të projeve të: Lëbushes, Behovcit dhe Durakut nga zyrtarë e Drejtorisë janë identifikuar disa zona Erozive në shtretërit e këtyre lumejve dhe përgjatë brigjeve të tyre*

Gjatë viteve të fundit kemi pas raste të shpeshta të rrëshqitjeve të dheut me përmasa jo të mëdha si në fshatrat: Ratish, Glllogjan, në rrugën që te qon në bjeshke te Deçanit, rruga e re për Plave etj

* Plani i Vlersimit të Rrezikut nga Shembja dhe Erozioni



Drejtimi i atakimit të materialit eroziv



Rrëshqitja e truallit



Shkëputja e truallit të sipërfaqës erozive

Për identifikimin e zonave dhe vlersimin e rrezikshmeris së tyre, nga ana e Grupit punues, janë studiuar dhe janë mare për bazë elementet dhe parametrat që ndikojn në mundësin e ndodhjeve erosive si

Përberjen:

1. gjellogjike të tokës,
2. gjeomorfologjike,
3. pjerrtësin e terrenit,
4. kushtet klimatologjike dhe hidrologjike dhe
5. bimësin.

Si dhe faktorët e aktivizimit:

1. sasija e ujit në shtratin e lumit,
2. % e ujit në masivin gjeologjik,
3. heqja e mbrojtjes anësore (damtimi i bimësisë)
4. eksploatimi i rrës dhe zhavorit në shtratin e lumejve.

Në bazë të parametrave të vlersimit të shembjeve dhe erozionit si:

- Përberja gjeologjike e truallit
- Llojeve të lëvizjeve të materjalit (dheut dhe gurëve)
- Tipologjis së materjalit,
- Shpejtësisë së levizjes,
- Këndit të pjerrtësisë,
- Thellësisë së rrshqitjes,
- Vëllimit të masës së rrshqitur.
- Shkaktarët e shembjeve dhe erozionit dhe
- Factorët e aktivizimit

MASAT PREVENTIVE NGA SHEMBJA DHE EROZIONI NË TERITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT

Me qëllim të pengimit të krijimit të ndodhjeve të vërshimeve, shembjeve dhe erozionit në teritorin e Komunës së Deçanit përgjatë rrjedhës së lumejve dhe projeve, të cilët përshkojnë këte teritor, e me qëllim të pengimit të ndodhjeve emergjente, ruajtjes së tokave bujqësore, ruajtjes së ambientit dhe ruajtjes së shendetit të njerzve e ruajtjen e pasuris së tyre, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, propozon që të ndermeren këto masa preventive të domosdoshme:

1. Kërkimi i mundësive financiare për rregullimin e shtretërve të lumejve dhe mbrojtseve anësore të brigjeve të tyre me qëllim të ruajtjes së tokave bujqësore , akseve rrugore dhe urave.
2. Pastrimi i shtretërve të lumejve nga mbeturinat.
3. Ndalimi i hudhjes së mbeturinave përgjatë rrjedhës së tyre.
4. Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të rrës dhe zhavorit nga shtretërit e lumejve.
5. Ndertimi i pendave për pengimin e grryrjes së shtratit të lumejve dhe ndaljen e bartjes së rrës, zhavorit, gurve dhe materjalit tjetër që bartin rrymat e ujit.
6. Ndalimi i prerjes së drujve përgjatë brigjeve të lumejve.
7. Mbjellja bimësisë përgjatë brigjeve.
8. Pastrimi i shtretërve të lumejve nga bimësia e cila ka mëbi vetëvetiu (shelgje, verra etj) të cilat pengojnë rrjedhen normale të lumit.
9. Mbushja e pjerrtësisë së brigjeve të lumejve me mjete natyrore dhe artificiale.
10. Pastrimi i pendave në shtretërit e lumejve dhe projeve nga gurët,zhavori, rrës dhe materjali tjetër,
11. Renovimet e pendave të damtuara,
12. Inspektimi në teren i objekteve të evidentuara në këte vlersim nga inspektorët Komunal të urbanizmit, bujqësisë dhe ambientit dhe propozimi i masave sanuese dhe sanksionuese.

- 13 Si dhe masa tjera që do te propozoheshin nga Drejtoria e Bujqësisë, Urbanizmit dhe Ndermarja Hidro-ekonomike.
- 14 Mos respektimi i normave teknike të punëve ne dhe me rastin e ndërtimit të objekteve ndërtimore, si dhe masat e ndalimit të ndërtimit të objekteve ndërtimore në zonat të cilat janë evidentuar si terene jo stabile.
- 15 Gjithashtu, ndalimi me Ligj i punëve, nuk sanksionohen sipas normave ligjore, qe edhe më tepër rëndon dhe komplikon situatën.

Kanali derivues i Liqenit të Radoniqit: (gjendja është sanuar)

- 16 ndertimin e kaskadave në gryken e kanjonit,
- 17 ndertimin e mureve mbrojtëse për pengimin e proceseve erozive në kanjon
- 18 ndertimet në kaskada me qëllim të "zbutjes" së fuqisë ramëse të ujit nga kaskadat,
- 19 pastrimin e rrjedhës së kanalit ,
- 20 pastrimet anësore të Kanalit nga druajt dhe shkurret.
- 21 vuarja e rrjetes mbrojtëse përgjatë kanalit ne vende te caktuar.



PUNIMET NË SANIMIN E GJENDJES Së KANJONIT

TABELA E OBJEKTEVE TË NDERTUARA NË RRJEDHAT E LUMEJVE DHE PROJEVE NË TERITORIN E KOMUNES SË DEÇANIT

	Lumejt dhe projekt	Ura	Penda	Mure mbrojt	Kaptaz ha për ujë	Rregullim	Rregullim shtrati	Vend ndodhja e urave
1	Lumbardhi i Pejës	1	/	/	/	/	/	Vranoc i Vogël
2	Lumbardhi i Lloqanit	9	2	/	1	1	I rreg.1.6km	Hulaj, Kasum, Carrabreg i E. Ura e Bajramhasanve, Prejlep, Rostovicë, Baballoq, Gramaqel, Jasiq i Ri
3	Lumbardhi i Deçanit	9	/	2	2	/	Duke u rregulluar	Gryka e Deçanit, Deçan, Llukë
4	Prrojet e Vokshit	3	/	/	/	/	/	Rruga Deçan-Junik, Qesta
5	Prroni i Selishtave	1	/	/	/	/	/	Lëbushë
6	Prroni i Lëbushes	1	5	/	/	/	/	Lëbushë
7	Prroni i Behovcit	6	3	1	/	/	Pjesa e epërme e lumit e rreg	Strellc i Ep, Isniq, Dubovikë
8	Prroni i Durakut	2	8+5	/	/	/	/	Lybeniq, gryka e Durakut
9	Kanali i Radoniqit	11	/	/	/	/	I rreg. 8km.	Llukë e E. Kodrali, Irzniq
10	Kanali i ujit. Deçan-Lumba.	3	/	/	/	/	Rr. 6.981km	Deçan-Lumbardh
	Gjithësjt	47	18+5	4	5	1		

1.5.3. Bora dhe Orteqet

Kategoria e rrezikut	Atmosferike
Lloji	Fatkeqësi natyrore
Rreziku	Bora dhe orteqet
Modeli	Stinor (dimën, pranverë)



VLERËSIMI

- Të reshurat e mëdha të borës, mbulesa e lartë e borës dhe përgjjet (grumbujt) e lartë të borës, shkaktojnë një numer problemesh në jetën e përditëshme dhe në punë.
- Grumbullimi i borës stabil
- Vetem zonat e veçuara të pa qëndrueshme
- Qarkullimi në zonë është i sigurtë
- Orteket natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, janë pak të mundshme
- Rreziku i pa përfillshëm

Bora:

Bora është reshje e rregullt e dimrit në këtë rajon. Ka patur vite kur ka pasur pasoja shumë të rënda nga bora. Anomalitë ekstreme të reshjeve të bores dhe temperaturave të ajrit në Janar të vitit 1985, rezultojnë me stuhi të papritura të bores. Më i goditur i në Rrafshin e Dukagjinit ishte Deçani.

Në Komunën e Deçanit, pas të reshurave në formë të shiut, ato paraqiten shpesh edhe në formë të bores prej Nëntorit deri në Prill e mund të jenë edhe në Tetor e Maj. Mesatarisht në Komunën e Deçanit janë 39 ditë me mbulesë bore 10 cm. Mbi 10 cm borë ka 22 ditë. 30cm. e më tepër bore ka 6 ditë, e mbi 50cm. gjithsejt 2 ditë mesatarisht.

Mbulesa e bores në teritorin e Komunës së Deçanit ka kohë zgjatje të ndryshme të qëndrueshmërisë mvarsisht nga reliefi dhe lartësia mbidetare. Qëndrueshmëria ma e madhe e bores është në lartësi mbi 2000m.

Lartësia mbidetare në m.	Dita e paraqitjes së borës		Përvoja e qëndrueshmërisë në ditë	
	Dita e parë	Dita e fundit	Me borë	Pa borë
600	15 XII	13 III	89	276
1000	17 XI	24 IV	159	206
1500	1 XI	2 V	183	182
2000	13 X	10 V	210	155

Të reshurat e mëdha të borës, mbulesa e lartë e borës dhe përgjjet (grumbujt) e lartë të borës, shkaktojnë një numer problemesh në jetën e përditëshme dhe në punë.

Vjen deri të ndërprerja e komunikacionit rrugor në rajonet urbane e sidomos në rajonet rurale, duke vështirësuar zhvillimin normal të jetës e punës në rajonet e përmendura, e cila pasqyrohet në vështirësimin e furnizimit të banorve me artikuj jetësor, vështirësimin e qasjes së objekteve të ndryshme publike si shkollave, enteve shëndetësore, të punës dhe atyre ekonomike.

Në situata të tilla, shpesh vjen deri të prishja në linja elektrike, PTK, sistemin e ujësjellësit dhe objekte tjera ifrastrukturore që shkaktojnë ndërprerje të shpeshta në furnizimin e objekteve banesore dhe objekteve tjera

me energji elektrike, me ujë dhe nderprerje të lidhjeve të PTK-së, që si pasoj ka shkaktim të konsiderueshem të dameve materjale. Shpeshëher vjen deri të ndërprerjet e shkurta të punës në shkolla dhe ente tjera arsimore, ndermarjeve ekonomike dhe institucioneve tjera. Mirëpo, këto ndërprerje, kohë zgatjen e kanë shumë të shkurtër dhe më së shumti një eventualisht në faste të veqanta dy ditë.

Në terë teritorin e Komunës, organizohet mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale dhe rrugëve tjera të pa kategorizuara, të cilat janë nën autortetin e Komunës, si dhe rruget e qendres administrative të Deçanit.

Në periudhën e gjerëtanishme, në kushte të zakonshme të reshjeve të borës, mirëmbajtja e rrugëve në teritorin e Komunës është realizue relativisht në mënyrë të kënaqëshme dhe kësisojë është mbajtë kalueshmerija e rrugëve krahas problemeve të zakonëshme. Problemet paraqiten në ditët e para të reshjeve intenzive, përshkak se firmat me të cilat është lidhë kontrata për mirëmbajtje dimërore të rrugëve, nuk i kryen obligimet e veta në mënyrë kualitative ngase edhe kontrolla e institucioneve përgjegjëse rrugore nuk është adekuate.

Edhe temperaturat e ulta janë faktor i rendësishem meteorologjik që ka ndikim të madhë në klimen e këtij teritori. Temperaturat e ulta në vjeshten e hershme dhe pranverën e vonë lënë pasja të rënda posaqërisht në rritjen e frutave dhe në kultivimin e përimeve.

Orteqet e borës:

Ortekët janë dukuri tipike për reliefin e llojit alpin, siç është reliefi i vargmaleve të Bjeshkëve të Nemuna. Mbështetja sportive dimnore dhe e turizmit për rekreacion në rajonet e Bjeshkëve të Nemuna, në të njeiten kohë nenkupton edhe ekspozimin ndaj rreziqeve nga bora. Problemi i ortiqeve nga bora në këto vise ende nuk është hulumtuar dhe kerkon të i kushtohet kujdes i duhur.

Orteku është grumbull i madh bore qe rrëshqet nga malet me pjerrtësi të madhe dhe është rrjedhim i një "lufte" të pa barabartë në mes të trysnisë dhe fuqisë në një pjerrtësi.

Orteku paraqitet kurë trysnija (graviteti) që provon të shtyjë boren teposhtë është më e madhe se fuqija e lidhjes së mbështjellësit (shtresave) të borës. Janë katër faktor që kontrollojnë zhvillimin e një orteku:

- Shkalla e pjerrtësisë,
- Shtresa e borës
- Shtresa e brishtë e mbështjellësit të borës,
- Aktivizimi.

Shkalla e pjerrtësisë duhet të jetë e mjaftueshme qe të ia mundësoj borës të rrshqas. Frekuenca e ortekut është e ndërlidhur me këndin e pjerrtësisë. Rastët më të shpeshta paraqiten (90%) në shkallën mesatare të pjerrtësisë 30 deri në 45°, dhe rreth 98% të rasteve të orteqeve paraqiten në pjertësinë 25 deri 50°. kurse, nën kandet prej 20° zakonisht janë pjerrtësi shumë të ulta për të u paraqitur orteku.

Anatomia e ortekut.

Orteku ka tri pjesë kryesore:

- Zona e nisjes,
- Shtegu i ortekut,
- Zona e zbrazjes.

Faktorët që shkaktojnë ortekun:

- Kshtët atmosferike,
- Temperatura,
- Pjerrtësija e këndit,
- Drejtimi i pjerrtësisë,
- Drejtimi i erës,
- Tereni,
- **Bimësija,**
- **Gjendja e përgjithëshme e grumbujve të borës.**

Shkalla e rrezikshmërisë së ortekut:

SHKALLA e RREZIKSHMËRISË	PËRSHKRIMI I RREZIKSHMËRISË
E ULTË	<ul style="list-style-type: none"> • Grumbilli i borës stabil • Vetem zonat e veçuara të pa qëndrueshme • Qarkullimi në zonë është i sigurtë • Orteket natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, janë pak të mundshme •
MESATARE	<ul style="list-style-type: none"> • Disa zona të pa qëndrueshme • Orteket natyrore kanë pak gjasa, ato të shkaktuara nga njeriu kanë gjasë • Qarkullimi në zonë është i mundshëm, por me kujdes
E MADHE	<ul style="list-style-type: none"> • Janë të mundshme zona jo stabile • Janë të mundshëm orteket natyrore, por edhe ato të shkaktuara nga njeriu • Qarkullimi në zonë është i mundshëm, por me një kujdes të jashtëzakonisht të madh
E LARTË	<ul style="list-style-type: none"> • Janë shumë të mundshme zonat jo stabile në pjerrtësi dhe aspekte tjera • Janë shumë të mundshëm orteket natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu • Ata që qarkullojnë në zonë duhet të ju shmangen pjerrtësive të mëdha dhe pjerrtësive që i godet era
SHUMË E LARTË	<ul style="list-style-type: none"> • Shtresa tepër jo stabile në grumbullin e borës • Orteket natyrore dhe ato të bëra nga njeriu janë të kufizuara • Janë të mundshëm ortekte të mëdhenjë • Ata që qarkullojnë në zonë duhet të ju shmangen tereneve me pjerrtësi të madhe dhe zonave të orteqeve

II./2. Katastrofat tekniko – teknologjike

2.1. Fatkeqësitë e shkaktuara në objektet ekonomike:

Në sektorin shoqëror janë të regjistruara 25 ndërmarrje të cilat para futjes së masave të dhunëshme nga sistemi I kaluar, kanë patur një trend të lartë të zhvillimit ekonomik e sidomos :

- Industria e drurit,
- Industria metalike,
- Industria ushqimore dhe
- Turizmi .

Gjendja e tanishme në këto ndërmarrje është mjaftë e rëndë nga fakti se pos dantimeve dhe plaqkitjeve që kanë pësuar nga lufta ka ndikuar edhe kompetencat e AKM – es në menaxhimin e këtyre pronave.

Industria metalike ka patur këto ndërmarrje:

- Fabrika e autopjesëve “Ramiz Sadiku”
- Fabrika e Pompave me piston
- Fabrika e rjetit të armiruar. (të privatizuara)

Industria e përpunimit të drurit:

- Kompleksi përpunimit të drurit “Gjeravica”
- Fabrika e mobiljeve massive (të privatizuara)

Industria ushqimore:

- Fabrika e përpunimit të mjaltit “Apiko”
-
- Kopërativat bujqësore. (të privatizuara)

Gjendja e tanishme:



2. 2. Fatkeqësitë e shkaktuara në objektet e banimit:

Historiku

Kosova, e në këtë kuadër të saj edhe Komuna e Deçanit është e ndjeshme ndaj rreziqeve në ndërtesat kolektive dhe familjare, sidomos tani ku mund të jetë si pasojë e ndërtimeve të shumta pa leje dhe pa kritere, objekte të cilat janë lënë pas dore që nga paslufta ose objekte të braktisura si na shqiptaret, serbet etj.

Gjendja Aktuale

Nuk ekziston ndonjë regjistrim i ndërtesave që pranojnë publik e as ndërtesa të banimit të grupit të 3 dhe të 4.

Në këtë studim ne konsiderojmë si ndërtesa kolektive NPP (ndërtesat për publik) të grupit të parë, ndërtesat e larta, ndërtesat kolektive për banim për familje dhe ndërtesat e ngritura për t'u përdorur si zyra.

Një ndërtesë e lartësisë së madhe është një godinë që pjesa e poshtme e saj ndodhet në përdhese dhe mund të përdoret për mjete të shërbimeve publike për luftë kundër zjarrit në një lartësi:

- më shumë se 50 metra për ndërtesat e banimit
- më shumë se 28 metra për ndërtesat tjera

Ndërtesat që pranojnë publik të grupit të parë përmbledhin të gjitha objektet e kategorisë së parë, të dytë, të tretë dhe të katërtë. Ky klasifikim bëhet varësisht nga efekti teorik i publikut që mund të pranohet në ndërtesën përkatëse.

Ai pason tabelën përkatëse:

Kategoria e parë: efektiv më i madh se 1500 përsona

Kategoria e dytë: nga 701 deri në 1500 përsona

Kategoria e tretë: nga 301 deri në 700 përsona

Kategoria e katërtë: deri në 300 përsona, përveç objekteve që përfshihen në kategorinë e pestë.

Kategoria e pestë: përfshinë të gjitha ndërtesat në të cilat efekti i publikut nuk arrin njërin nga shifrat e caktuara për llojin e ndërtesës.

Objektet që pranojnë publik klasifikohen po ashtu edhe për nga lloji i shfrytëzimit të ndërtesës që paraqitet përmes një shkronje që tregon përdorimin për të cilin është ndërtuar.

L: Salla për audicion, konferenca, mbledhje, spektakle, për përdorim të shumëllojshëm.

M: Dyqane, qendra tregtare.

N: Restorante dhe shitje e pijeve

O: Hotele dhe pansione për familje

R : Objekte për mësim-Shkolla,

Rr: Objekte për pushime

S : Biblioteka, qendra të dokumentacionit dhe të konsultimit të arkivave

T : Salla të ekspozitave (për qëllime komerciale)

U : Objekte mjekësore

V : Objekte të kultit

Ë : Administratat, bankat, zyrat

X : Objektet sportive të mbuluara

PA:Objektet në qiell të hapur

OA: Hotele, restorante në lartësi të madhe mbidetare.

Shkaqet e rrezikut

Flukset kryesore të rreziqeve të mundshme nga rreziku i ndërtesës kolektive janë:

- Zjarri
- Tërmeti
- Eksplodimi
- Rrënimi
- Vërshimi

Faktorët e përkeqësimit :

Zonat që paraqesin një dendësi shumë të madhe të popullatës mund të paraqesin një faktor shumë të rëndësishëm të seriozitetit në rast të ndodhjes së një fatkeqësie eventuale (si lagjet e populluara të Deçanit, Isniqit, Strellcit, Prelepit, Irzniqit dhe fshatrave tjera).

Flukset e rrezikut

Flukset kryesore të rreziqeve të mundshme nga rreziku i ndërtesës kolektive janë:

- Zjarri
- Eksplodimi
- Rrënimi
- Vërshimi

Skenarët më të mundshëm

Janë parashikuar katër skenarë :

- Zjarre ku ka banues
- Shembja i një ndërtese të lartë
- Eksplodimet
- Tërmeti

Pasojat

Pasojat e këtyre fatkeqësive manifestohen duke shkaktuar vdekje , rrënimë ndërtesash, avari, zjarre, shkatërrime të infrastrukturës vitale dhe infrastrukturës teknike, dëmtimin e ambientit si dhe trashëgimisë kulturore.

Përiudhat e rrezikut:

Gjatë stinëve me të reshura, zjarreve urbane, tërmeteve etj.

Shenjat pararendëse:

Situatat para rëndese mund të identifikohen vetëm në raste. vërshimesh kurse në rastet tjera shenjat para rëndese nuk mund te identifikohen



2.3. Fatkeqësitë në komunikacion:

Historiku:

Vitet e para të pasluftë infrastruktura rrugore ka qenë e dëmtuar poashtu ka munguar edhe sinjalizimi horizontal dhe vertikal i shenjave të komunikacionit. Me kalimin e kohës infrastruktura rrugore poashtu edhe shenjat e komunikacionit u rregulluan dhe janë të standardizuara në të gjitha rrugët e komunës tonë. Instituti Kombëtar shpreh shqetësimin lidhur me numrin e madh të aksidenteve në trafik, ku si pasojë kanë gjetur vdekjen qinda persona që paraqesin shifra alarmante dhe shumë shqetësues fakti se shumica e viktimave janë këmbësorë. Shkaqet janë të ndryshme por sigurisht se faktori njeri është më i shpeshtë pasi që nuk janë duke u respektuar rregullat e përgjithshme në trafik, nga manipulimi i pasigurt me automjet, tejkalimi i shpejtësisë, mos mbajtja e distancës, mos respektimi i shenjave të trafikut dhe mos përshtatja e kushteve të rrugës përdorimi i shpeshtë i telefonave mobil, vozitja nën ndikimin e alkoolit, substancave narkotike, ndikimi i lodhjes apo pagjumësisë, trajnimi joserioz gjatë dhënies së provimit për shofer, por duke mos munguar as faktori rrugë dhe automjet ngase akoma në shumë vende mungojnë shenjat e komunikacionit dhe veturat e vjetra me mangësi të shumta teknike, ku infrastruktura është problematike dhe drejtuesit e mjeteve janë të pakujdesshëm gjatë vozitjes.

Duhet ndërmarrë masa të përgjithshme për zvogëlimin e rrezikut nga aksidentet në komunikacion edhe atë:

- Zhvillimin e infrastrukturës rrugore, sidomos në qytet, në bazë të planit urbanistik të qytetit;
- Largimi nga komunikacioni i veturave që nuk janë në gjendje të rregullt teknike;
- Inspektimet e rregullta në komunikacion;
- Edukimi dhe arsimimi i vozitësve;
- Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve;
- Kufizimi i shpejtësisë dhe mbikëqyrja e trafikut;
- Kontrollimi teknik i automjeteve i detyrueshëm, si dhe masat tjera adekuate.

Vlerësimi që vijon, ka të bëjë me dy lloj aksidente të transportit kolektiv rrugor:

Siç e dimë, kjo mënyrë e transportit kolektiv rrugor është relativisht e përdorur në Komunën e Deçanit. Ky rrezik lokalizohet kryesisht në akset e përdorura nga linjat e rregullta dhe atyre të përdorura nga fluksi i madh i qarkullimit në mengjes, në mesditë dhe në orët e mbramjes, posaqerisht në Magjistralen Pejë – Deçan – Gjakovë dhe në akset e rrugëve Rajonale të Komunës. Mirëpo, aksidentet janë të shpeshta edhe në rrugët lokale të Komunës tonë nga mos përshtatja e shpejtësisë, mungesës së shenjave vertikale dhe horizontale të komunikacionit, kafshëve në rrugë etj, etj.

- Aksidentet e autobusëve, ku të gjithë udhëtarët e autobusit (ose autobusëve) janë të përfshirë.
- Aksidentet që përfshijnë një numër të madh automjetesh (më se paku 10) që shkaktojnë bllokimin dhe qarkullimin e më shumë rrugëve

Një aksident (vdekjeprurës ose jo) i komunikacionit rrugor:

- Shkakton se paku një viktimë
- Ndodhë në një rrugë të hapur për qarkullim publik
- Përfshinë së paku një automjet

Një aksident përfshinë një numër të caktuar të pjesëmarrësve në komunikacion. Në mes tyre, dallojmë:

- Të shpëtuarit - të përfshirët në aksident që nuk kanë vdekur dhe që gjendja e tyre nuk kërkon asnjë trajtim mjekësor;

- Viktimat - të implikuar në aksident që nuk kanë shpëtuar pa pasoja

Në mesin e viktimave, dallojmë:

- Të vdekurit - viktimat e vdekura në vend ose deri në gjashtë ditë pas aksidentit
- Të lënduarit - viktimat që nuk kanë vdekur,

Në mesin e të lënduarve dallojmë:

- Të lënduarit rëndë - të lënduarit gjendja e të cilëve kërkon hospitalizim më të gjatë se gjashtë ditë;
- Të lënduarit lehtë - të lënduarit gjendja e të cilëve kërkon një hospitalizim ose përkujdesje mjekësore prej zero deri në gjashtë ditë.

Shkaqet e rrezikut

- të gjithë automjetet e transportit kolektiv
- Zonat me dendësi të madhe të trafikut.

Faktorët e përkeqësimit

Gjendja e rëndë e rrugëve, kushtet atmosferike, gjendja e rëndë e makinave transportuese (autobusëve, veturave), mungesa e sinjalistikës, mungesa e edukatës në komunikacion, etj.

Karakterizimi i flukseve

Për rrezikun e transportit të përbashkët rrugor, ekziston një numër i flukseve të rreziqeve e ndër ato më kryesoret janë:

- Goditjet (rrotullimi, derdhjet, rrokullisjet)
- Ndeshjet
- Zjarri

Pasoja

Pasoja e këtyre fatkeqësive manifestohen duke shkaktuar vdekje, lëndime, shkatërrime të automjeteve dhe ndotje të ambientit.

Profili i Rrezikut	
RREZIKU: TRANSPORTI KOLEKTIV RRUGOR	
MADHËSIA E MUNDSHME (PËRQINDJA E KOMUNITETIT QË MUND TË GODITET) : KRITIKE: 25 DERI 50%	
FREKUENCA E NDODHJES:	Modeli: gjatë vitit
<ul style="list-style-type: none"> • Shumë e mundshme: Mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm. 	
ZONAT QË MUND TË GODITEN MË SË SHUMTI: TËRË RRJETI RRUGOR I KOMUNËS, NË VEÇANTI MAGJST. PEJË-DEÇAN-GJAKOVË	
KOHËZGJATJA E MUNDSHME: 3 DRI NË 6 ORË.	
SHPEJTËSIA E MUNDSHME E MËSYMJES (SHUMA E MUNDSHME E KOHËS SË PARALAJMËRIMIT):	
<ul style="list-style-type: none"> • Pa paralajmërim 	
SISTEMET EKZISTUESE TË PARALAJMËRIMIT: SISTEMI I INTEGRUAR 112	

Cënueshmëria nga goditjet në Faktorët Kyç të Komunitetit

Profili	Pasoja e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Shkalla e goditjes gjatë kohës së rreziqeve të transportit kolektiv, në vendin e incidentit e ashpër (vdekje dhe lëndime të rënda, për shkak të ndeshjeve, rrokullisjeve dhe zjarreve)	E ashpër
Pasuria	Shkatërrimi dhe dëmtimi i automjeteve private dhe publike	E ashpër
Dëmet Ekonomike	Shkatërrimi i automjeteve, pasurisë, infrastrukturës vitale, infrastrukturës teknike, etj.	E ashpër
Ambienti	Dëmtohet mjedisi për shkak të derdhjeve të karburanteve të ndryshme nga ndeshjet, tymrat nga zjarret, kontaminimi i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe kontaminimi me materie të rrezikshme.	E ashpër



Statistika për aksidente të trafikut në Komunën e Deçanit

Viti:	Aksidente me dëme	Aks. me lëndime të renda	Aks. me lëndime të lehta	Përsona të lënduar	Aks. me fatalitet	Përsona të vdekur	Gjithsej:
2010	47	66	0	129	2	4	115
2011	28	107	7	237	1	1	143
2012	19	69	1	176	2	2	91
2013	13	67	1	156	2	2	83
2014	17	55	10	165	1	1	83
2015	10	67	9	181	1	2	87
2016	20	66	0	157	0	0	86
2017	22	78	0	196	3	4	103
2018	19	102	0	265	1	1	122

2.4. Fatkeqësitë Nukleare dhe Radiologjike

Vendet e ndotura me Uranium të Varfëruar



Gjatë 79 ditëve të bombardimit të NATO-s në vitin 1999, në teritorin e Kosovës janë kryer 112 sulme me Uranium të Varfëruar, nga të cilat disa caqe janë goditur nga dy herë. Janë hudhur 31 000 predha me nga 271 gr., që përmbajnë gjithësejtë 8401 kg. të Uraniumit të Varfëruar, ku koncentrimi nga Deçani shkon në Veri-Lindje në drejtim të Pejës dhe në Jug në drejtim të Gjakovës në brezin kufitar me Shqipërinë dhe mbrendësi të Rrafshit të Dukagjinit (të shifet harta e Republikës së Kosovës).

Ekipi i UNEP-it (Programi i Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Ambientit ka vizituar 11 fusha në Rrafshin e Dukagjinit dhe ato:

- 5 në sektorin Italian të KFOR-it dhe
- 6 në sektorin Gjerman të KFOR-it.

Këtu duhet të veqohet Sektori Italian i KFOR-it i cili 4 mostra i ka mbledhë në teritorin e Komunës së Deçanit e 1 në teritorin e Komunës së Gjakovës në këto lokalitete:

1. Irzniq- ish ndertesat e Koopërativës Bujqësore,
2. Bregu i Vranocit të Vogël,
3. Liqeni artificial i Radoniqit,
4. Lokaliteti Bandera afër fshatit Pozhar dhe
5. në Gjakovë- ish kazerma e Armatës Jugosllave.

Misioni dy javor (5-17 Nëntor 2008) i UNEP-it nga Univerziteti i Bristolit të Anglisë, kishte për detyrë të përcaktonte nese përdorimi i Uraniumit të Varfëruar, gjatë bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe, mundë të ishte rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Në këto Lokalitete janë mbledhur mostra të dheut dhe ujit.

Mostrat e dheut janë nxjerrë nga thellësit e tokës, kurse mostrat e ujit janë marë nga projet, lumejt dhe pusët. Si dhe janë marë mostra të ndryshme nga bari, drunjët, frutat dhe këpurdhat.

Janë mbledhur gjithësejt 340 mostra, dhe ato:


- 247 mostra dheu;
- 45 mostra uji;
- 30 mostra nga vegjetacioni;
- 10 teste të ndotjes;
- 5 mbështjellës;
- 7 penetrator dhe

- 1 fragmë (pjesë penetratori).

Nga Raporti Final i Univerzitetit të Bristolit, është konstatuar e se pjesa më e madhe e mostrave të dheut kishin Uranium të koncentruar mbrenda koncentrimit normal të të ambijentit (1-300 mg/kg). Vetem një sasi e vogël e mostrave kanë lartësi të ulët të koncentrimit të Uraniumit dhe kjo ndodhë vetem në kontakt të drejtëpërdrejtë me penetratorin, izotopet e analizuaratë Uraniumit, tregojnë se Uranijumi i varfëruar përmbanë 0.2 % të U-235. Uraniumi i varfëruar gjithastu ka gjurmë të koncentrimit të U-236 dhe të Plutoniumit PU-239 dhe PU-240 dhe ka indikacione se ky metal është prodhuar nga karburantët nuklear. Ky koncentrim, nganjëherë është më i ultë se U-236 dhe Plutoniumi, dhe vijon të jetë më shumë se 1 % në kufi me radioaktivitetin e metalit 0.2% U-235.



Eksplodimi Nuklear



www.mycity.co.yu

Historiku:

Me përfundimin e luftës, në Republikën e Kosovës mbeten një numer shumë i madh dhe i pa përcaktuar i minave, eksplozivëve dhe mjeteve tjera të pa shpërthyer në tërë teritorin e Kosovës, e në veqanti në brezin kufitar me Republikën e Shqipërisë, duke përfshi edhe teritorin e Komunës së Deçanit, i cili teritor pothajse i teri ka qenë i “mbjellur” me mina Kundër Kembësorike, Kundër Tankiste dhe Kaset Bomba. Qe të gjitha të lanuna gjatë tërheqjes së Trupave serbe nga teritori ynë, si edhe asosh të mbetura gjatë bombardimeve të forcave të NATO-s ndaj caqeve serbe.

Menjëher pas lufte, shumë Organizata Qeveritare, Joqeveritare e Humanitare si “Helo Trust”..... dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës(FSK)” e shtrien aktivitetin e tyre, në Komunën tonë, për pastrimin e teritorit të minuar nga këto mbetje të luftës dhe me qëllim të ngritjes së vetëdijes kombëtare dhe qytetare për vetëdijesim për ekzistimin e rrezikun e përherëshem nga mjetet shpërthyes dhe municionit, të ndihmojnë dhe parandalojnë rrezikun e përherëshem ndaj fëmijëve të cilët çdo ditë ekspozohen para mjeteve të pa shpërthyer, për gjetjen e tyre në ato Zona ku ende kanë mbetur sipërfaqe toksore të minuara qe nga koha e luftës së fundit.

Rreziku është ende i pa eliminuar terësisht në Komunën tonë nga minat dhe mjetet tjera të pa shpërthyer, sepse ato ende ekzistojnë dhe janë mundësit reale për ndodhjen e fatkeqësive nga këto mjete.

Gjatë kësaj kohe dhjetë vjeqare, në teritorin e Komunës, tonë kanë ndodhur fatkeqësi të ndryshe e duke filluar nga ato me pasoja të lehta e deri të ato më të randa me këputje të ekstremiteteve e deri të ato të cilat kanë përfundue me fatalitet për shëndetin dhe jetën e viktimave, nga eksplozimet e këtyre mjeteve.

Këto fatkeqësi kanë goditur të gjitha shtresat dhe kategorit e qytetarëve të Komunës, si nga mosha ashtu edhe nga gjinia.

Sipas Qendres Koordinuese te Deminimit që ng paslufta e deri me tani si pasoje e eksplozimit të mjeteve të pashpërthyer kanë humbur jeten rreth 116 persona dhe janë lënduar 458.

Forcat serbe përpos vrasjeve, masakrimeve, dhunimeve, vjedhjeve, pas vete po lënë edhe një numër të madh minash dhe Eksplozivi. Qëllimi i tyre është që edhe pas largimit të tyre, ta dëmtoi dhe frikësoi popullaten civile edhe për një kohë të gjatë.

Me qëllim të fitimit të njohurive elementare për minat të cilat i hasim ne teritorin e Komunës tonë, po paraqesim shkurtimisht të dhënat taktiko-teknike dhe mënyren e vendosjes dhe gjetjes së tyre.

“Sa më mirë të njohim rrezikun, aq më mirë mund të mbrohemi!”

2.5 Fatkeqësite mino-eksplozive

Të dhënat do të i paraqesim për këto lloje të minave:


1. MINAT KUNDERKEMBESORIKE (MKK)
2. KUNDERTANKISTE (MKT)
3. MINAT E BEFASISË (MB)
4. MINAT E IMPROVIZUARA (MI)
5. MJETËT LUFTARAKE TË PAEKSPLODUARA

1) MINAT KUNDERKEMBESORIKE-KUNDËRTANKISTE (MKK-MKT) bëjnë pjesë në grupin e parë më të rrezikshëm dhe më me shumicë që mundesh ti hasish sot në KOSOVË. Keto mina janë të vendosura në të shumten e rastëve rrugëve, përgjatë rrugës, oborreve, rrugicave, lëndinave, brezmaleve etj. Pra janë të vendosura në vendet më me të frekuentuara nga popullata civile.

MKK-MKT janë të vendosura nën dhe mbi dhe. Aktivizohen me shkelje apo tërheqje. Janë të qendrushme ndaj kushteve atmosferike, kështu që efekti i tyre është i njëjtë edhe pas disa vitesh. Nëse Serbia i ka vendosë minat pak para dhe gjatë tërheqjes, është më lehtë që të gjinden dhe lokalizohen sesa ato që i ka vendosur para një viti. Gjetjen dhe qminimin e tyre e bëjnë vetëm njerzit e profesionalizuar në këtë drejtim ku me anën e shkopinjeve prekës apo aparateve minekerkues bëhen hulumtimet e tyre.

Në vendin ku është gjetur një mine apo dyshohet të ketë mina duhet vendosur tabelat me mbishkrimet. ; **MINE, KUJDES MINE, ZONË E MINUAR apo VEND I MINUAR.** Pastaj të mirren masat adekuate, të mundëshme, që ai vend të kufizohet dhe sa më parë të lajmrohen organet kompetente pranë UÇK-së apo KFOR-it. Më se shumti duhet patur kujdes te MKK që aktivizohen në tërheqje sepse ato mund ti aktivizoi edhe bagtia prej një largësie 10-15m kurse mina të

jetë fare afër personit civil.



2) MINAT E BEFASISË (MB)- janë lloj minash që kryesisht përdoren për të asgjësuar apo friguar popullatën civile gjatë kthimit të tyre në shtëpi dhe objekte të tjera. Këto janë MKK, MKT, Bomba e dorës, eksploziv, minat e improvizuara etj. Quhen MB sepse vetë natyra e tyre se ku janë të vendosur, shkaktojnë befasi dhe humbje të mëdha.

- Vendosen në: Dyer, dritare, pragun e derës, dysheme, TV, poqe elektrike, shkallë, kuzhinë, auto, traktorë etj, etj. Pra vendosen në çdo vendë apo sendë që hapet, shkilet apo terhiqet. Mund t'i hasim në oborr, në ndonjë lojë fëmijësh, top futboll, ushqim, granata, biçikletë, vegla punësh etj. Disa shembuj:

- Në oborrë qendron një kallashnjikov i harruar. Nën të është montuar MB e maskuar. Me të marrë pushkën, me tërheqje ajo aktivizohet.

- Hapim derën e oborrit, shtëpisë dhe më të hapur derën tërheqim siguresen e bombës së dorës që është e përgaditur aqë mirë që mjafton një forcë shumë e vogël tërheqëse e të aktivizohet.

- Te pusi (Bunari) e tërheqim kovën e ujit dhe së bashku me të e tërheqim siguresen e minës MKK M2.

- Në oborr qendron një top futboll. E marrim apo shytojmë topin dhe me këtë rastë kemi aktivizuar Minën MKK antimagnetike M2A. etj etj.

Është e preferueshme që para hyrjes në oborr, shtëpi e gjekundi ti kemi këto masa para syshë dhe të lajmërohem te organet kompetente për kontroll para hyrjes. Në pamundësi të ardhjes së tyre, duhet vepruar si më poshtë:

- Të hapim derën me një shkop të gjatë dhe me kujdes dhe paraprakisht të fshihemi pas ndonji objekti të fortë për mbrojtje.

- Të mosë shkelim në ato vende ku me sy dyshohet se vendi nuk është ashtu sikur para ikjes (psh. Gropa në oborr, vrimat në dysheme, etj).

-Gjërat që gjinden nëpër oborrë të hedhura, të lidhen me kujdes të madh dhe të terhiqen prej një largësie dhe të mbrojtur pas objektit të fortë. -Me automatet, traktorët e pa demtuar duhet patur kujdes të madh që nga afrimi, hapja e derës, ulja, starti, e deri te nisja. Këtu në të shumtën e rasteve vendosën minat që aktivizohen me kontakt elektrik (bateri automjeti). Po ashtu duhet pasur kujdes sidomos te fëmijët sepse sot teknologjia ushtarake ka arrijtur atë lartë sa që MB të jenë në formë të Stilolapsit, qokolate, doza të Coca Colles, konzerva, pliko, dhe lodra të ndryshme fëmijëve.



a) Me shkrepesë lartë (ku bari është i lartë)
 b) Me shkrepesë poshtë (ku bari është i vogël).



Vendosja e MKKM -M1



Të lënduar nga minat

3). MINAT E IMPROVIZUARA (MI)- janë një lloj minash të bëra enkas për qëllime të caktuara me mjet e ndryshme të cilat anmiku i posedon në momentin. Këto janë: dozat e Coca Colles, konzervat, shishët e ndryshme, enët e amvisnisë, bojlerët e ndryshëm, gypat metalik si dhe qdo gjë tjetër që mundet të përdoret për mbushje eksplozive. Meqenë MI janë të bëra jashtë ofiqinave specijale, eksplozimi nuk është i sigurtë (gjithëher) prapsepër rrezikshmeria e tyre është e madhe që me rastin e tërheqjes, goditjes, hudhjes mundet të eksplodojnë.

4). MJETËT E PAEKSPLODUARA. Këtu bëjnë pjesë të gjitha mjetet luftarake që gjinden në vendin e ngjarjes e që armiku i ka hudhur por për shkakë teknike nuk kanë eksploduar. Edhe avionët e NATO-s kanë hedhur bomba të ndryshme dhe se mund të ketë ndodhur që ndonjë të mos ketë eksploduar. Këto janë: Fishek zjarrët, bombat e dorës, minat, raketat, granatat, eksplozivi etj. Për dallim nga tri grupet e para këto mjete munemi ti hasim qdo kundë . Edhe nëpër fusha e pyje. Këtu bëjnë pjesë edhe mjetet e rrezikshme për eksplozim që anmiku i ka lënë me qëllim në vende të hapura. Meqenë se janë të paeksploduar pas hedhjes, rrezikshmeria e tyre është ndër më të mëdhat. Mund të eksplodojnë shumë lehtë në dorë nga fërkimet, rënja apo tërheqja. E mira e së mirës është që këto mjete të mos preken fare vetëm të kufizohen dhe të lajmrohen organet kompetente.

4.a. BOMBAT AVIO KASETORE:

Me termin Bombat Avio Kasetë (BAK) nënkuptohen avi-bombat klasike, me ramje të lirë, të formuara në mënyrë arodinamike, në principin e avio-bombave të dirigjuara, me koka mbushëse luftarake- "kontenjer special" në të cilin vendosen me dhetra deri me disa qindra avio-bombëza të vogla të kalibrit dhe destinimit të ndryshëm, të ashtu qujtura submunition (Submunition). Bejnë pjesë në grupin e fluturakeve ajrore të sistemit të armëve kasetore me koka luftarake.

Avio-bombat kasetore janë të konstruara asisojë që në mbrendësin e tyre bartin submunition të veprimit me të ndryshëm:

- Shpërndarëse,
- Shpërthyesëse,
- Djegëse
- Ose të kombinuara.

Sasia e këtyre bombicave të vogla (subprojektil) sillet nga disa qindra gram, e deri në disa kilogram.

Në botë ekzistojnë shumë lloje të avio bombave, por më të përhapura janë amerikane dhe disa nga shtetet Europiane antare të NATO-s.

Për shumë luftarake ajrore në botë terma "klaster" bomba (Cluster bombë – bomba mbjellëse). është bërë sinonim për avio-bombën kasetore BL – 755, e firmës Hunting Engineering, nga Britanija e Madhe., të cilën RAF e ka futë në përdorim në vitin 1972 dhe është e destinuar për asgjatimin e automjeteve, tankeve dhe njerzve.


Submunitioni mundë të paraqitet në formë "kokteli" dhe mundë të aktivizohen menjëher pas ramjes, mundë të jenë mina të zakonëshme me ngadalsim kohor të ndryshëm ose mina speciale, të paisura me sensor të tipeve të ndryshëm (IC, akustik dhe seizmik) për detektim dhe vetëdrejtim në objektivin e sulmit.




Në Kosovë, zyrtarë të Forces së Sigurisë së Kosovës, thanë se do të duhen edhe tetë (8) vjet për të pastruar minat e vëna gjatë luftes kjo pasi që në Kosovë ende mbeten edhe 69 zona të afektuara nga minat apo nga mjete tjera eksplozive.

Megjithëse egziston ende rreziku nga minat në Kosovë, FSK-së do ti duhet një kohë e gjatë për të pastruar tërë territorin e vendit.

Atakimi i caqeve me Bomba Kasetore






Harta e Zonave të minuara në territorin e Komunës së Deçanit

Vërejtje: Vendet e shenuara në hartë konsiderohen të pastruara nga minat, sipas KFOR-it

2.6. Fatkeqësitë Epidemiologjike



Kategoria e rrezikut	Fatkeqësi Natyrore
Lloji	Biologjike
Rreziku	Epidemi
Modeli	Sezonal
VLERËSIMI	Sipas të dhënave nga QKMF, rezulton se në Komunën e Deçanit, gjatë tri viteve të fundit, nga smundjet Epidemiologjike janë trajtuar gjithësejt shtatë raste simptomatike. Në bazë të këtyre të dhënave rezulton se rastet kanë qenë individuale dhe të veçuara.*



Nr	Viti Trajtimi	Gripi i derrit		Gripi i shpezëve		Ethet hemorragjike		Bruceloza		Tularemia		Rastet e vdekjes
		QKMF	QKU	QKMF	QKU	QKMF	QKU	QKMF	QKU	QKMF	QKU	
1.	2007					1				1		/
2.	2008					1	1					/
3.	2009	1	1						1			/
4.	2010											
5.	2011											
6.	2012											
7.	2013	1				1						
8.	2014	2	2			2						
9.	2015	1		2		1	1					1
10.	2016	1										
11.	2017											
12.	2018											
Nr përgjithshëm		6	3	2		6	2		1	1		Raste të trajtuara 21

Sëmundjet ngjitëse në Kosovë gjatë viteve të fundit

Komuna	ITPR & ARI	SARI	Influenca sezonale					DIARREA ACUTE	VARIÇELA	Gjithsej:
			ILI	A H1N1	A H3N3	A (e papërcaktuar)	Influenca B			
Deçan	111	1	2461	3				1117	47	3740

Depërtimi i agjenësve biologjik dhe shumëzimi i tyre në organizmin e sulmuar quhet infektim. Nese ky infektim përcillet me reaksion të organizmit të sulmuar, është fjala për qfaqjen e smundjes ngjitëse.

Kushtet e nevojshme për shfaqjen dhe zhvillimin e smundjes ngjitëse- infektimit janë:

1. Burimet e infektimit : janë njerzit e smuar, kafshët, bartësit e bakterjeve dhe virusëve, si dhe kufomat e njerzve dhe kafshëve.

* Të dhënat Epidemiologjike në K. E Deçanit janë marë nga QKMF

2. Rrugët e bartjes: janë mënyrat e bartjes së agjenësve biologjik, prej burimit të infektimit deri në organizmin pranues. Të shumten janëpërsonat e infektuar, uji, ajri, ushqimi, toka si edhe faktor tjerë si brejtësit dhe insektet.

3. Dyerit e hyrjes: janë lëkura, mukoza, organet e frymëmarrjes dhe organet e tretjes.

4. Numri dhe virulentshmerija: është aftësija e bakterjeve dhe virusëve për të depërtue në organizem, të i përshtaten ambijentit të ri, të fillojnë të shmëzohen dhe të shkaktojnë smundjen ngjitëse. Pas virulentëshmerisë edhe numri i bakterjeve dhe virusëve luen rol të caktuar në mekanizmin e lindjes së sëmundjes ngjitëse.

5. Dispozita dhe imuniteti: Dispozita është prirja e organizmit për ndonje infektim. Në këtë ndikojnë: vjetërsija , gjinia, profesioni, kushtet sociale-ekonomike, kondicioni fizik, stina dhe kushtet tjera jetësore. Imuniteti është rezistenca e organizmit për ndaj sëmundjes së caktuar ngjitëse.

Vijat mbrojtëse të organizmit: Njeriu, si edhe qenjet tjera të gjalla, ka tri vija mbrojtëse, për luftë kundër mikroorganizmave:

- Vija e parë mbrojtëse: lëkura dhe mukoza e shëndoshë.
- Vija e dytë mbrojtëse: rruzat e kuqe të gjakut dhe sistemi limfatik.
- Vija e tretë mbrojtëse: mëlqija dhe pankreasi.

Sëmundjet infektuese çfaqen në formë:

- Endemije: përfshinë një lokalitet të caktuar,

- epidemija: përhapja e shpejtë e infektimit të popullatës në një zonë të caktuar dhe

- Pandemija; kur popullatën e një ose më shumë kontinenteve e përfshinë smundja ngjitëse. Shembull tipik të pandemisë kemi në dhetëvjeqarin e këtij mileniumi "Gripin e Shpezëve" dhe Gripin e Derrave".

GRIP I DERRIT H1N1:

Historiku

Sipas ekspërtëve virusi i Gripit të ri konsiderohet të jetë mutacion i 4 nëntipave të virusit A. Virusit përhapet me rrugë aerogjenë gjatë kollitjes, teshtitjes si dhe gjatë kontaktit me gjësendet e kontaminuara. Burim i infeksionit është njeriu i sëmurë. Për herë të parë virusi është lajmëruar te derrat dhe është bartë në Amerikën Veriore përmes njerëzve të infektuar nga kontakti me derrat e sëmurë. Me rëndësi është se tani infeksioni bartet direkt nga njeriu në njeri. Rastet e para të gripit të ri janë lajmëruar në Meksikë në maj të vitit 2009 dhe sëmundja ka marr karakter epidemik.

Në fillim të qershorit kur janë regjistruar rastet e infeksionit me virusin H1N1 në shumë vende të botës, OBSH ka shpallur pandeminë e Gripit të ri duke theksuar se tani më virusi është i rrezikshëm.

Rasti i parë i konfirmuar i Gripit të ri H1N1 në Kosovë është regjistruar në korrik të vitit 2009. Nga korriku i vitit 2009 gjer më 15 nëntor 2009 janë regjistruar 39 raste të konfirmuara të gripit (janë përfshirë edhe 3 rastet nga vendet e banuara me popullatë serbe).

Në Komunën e Deçanit, nga rastet simptomatike të paraqitura gjatë vitit 2009, asnjë rast (2raste) i dyshimt nuk ka rezultue pozitiv. Njeni rast është trajtue në QKMF, kurse tjetri është dërgue në QKU për trajtim. As në vitet në vazhdim në Komunën e Deçanit nuk ka pasur raste vdekje dhe nuk është shtuar numri i të prekurve.

Në vitin 2019 kemi një riaktivizim të gripit të Derrit ku deri me tani ka marrur jetën 1 personi në Kosovë. Numri i pacienteve është në rritje dhe këtë e ben të mundur edhe gripin sezonal ku ka prekur më shumë se 25.000 veta

Faktorët e përkeqësimit

Duke marr parasysh se infeksioni mund të merr përmasa pandemie (përfshin shumë shtete) faktorë i përkeqësimit është grumbullimi në vende publike dhe lëvizja e njerëzve nga një vend në tjetrin.

Karakterizimi i flukseve

Numri më i madh i rasteve pritet të jetë gjatë fundit të vjeshtës dhe gjatë dimrit edhe pse nga paraqitja e rastit të parë e gjer më tani, smundja është paraqitur edhe gjatë muajve të verës.


Skenari 1

Skenari i ashpër - shkalla e sulmit është %?, numri i të sëmurëve është %, shkalla e vdekshmërisë %?, numri i të vdekurve %. Vdekshmëria në Kosovë, një vend me popullsi të re, mundë të jetë relativisht e lartë pasi që pandemitë në të kaluarën kanë prekur në veçanti popullsinë e re.

***ÇFARE ESHTË GRËPI I DERRIT?** Gripe i derrit, është një virus i tipit A (H1N1) dhe shkakton sëmundje tek njerëzit. Kjo sëmundje për herë të parë u pa në Meksikë dhe në SHBA pastaj me pas u përhap në shumë shtete.

***ÇILAT JANË SËMPTOMAT?** Simptomat janë të ngjashme me ato të gripit që shihet tek njerëzit. Temperatura, kollë, dhimbje grykesh, dhimbje e gjymtyreve, dhimbje koke dhe lodhje. Në disa raste mund të shkaktojë të vjella ose diarre.

***SI BARTET?** Gripe i derrit përhapet në një mënyrë si llojet e tjera të gripit zakonisht me kollë dhe teshtime.



***SI MUND TE MBROHEM? -**

- Kur kolliteni ose teshtini gojen dhe hundën mbylleni me një shami. Shamën që përdoret hidhjeni.
- Pasi teshtini ose kolliteni duart lajini me ujë dhe sapun ose me antiseptikë që përmbajnë alkool.
- Mos prekni me duar të palara hundën dhe gojen.
- N.q.s. sëmurëni 7 ditë e para qëndroni në shtrat.
- Qëndroni larg njerëzve që dyshoni.
- Ajrojeni shpesh ambientin ku qëndroni.

***ÇILAT JANË SËMPTOMAT QË KERKOJNË NDERHYRJE TË MENJEHERSHME TEK TË RRËTURIT?** - Vështiresi në frymëmarrje, trullullim i llogjikës, të vjella të shpeshta dhe për një kohë të gjatë. TEMPËRATUR MBI 37.8°

***PO TEK FEMIJET?**

- Marrje fryme ose marrje fryme me shpejtesi
- Zbehje ose mavijosje te trupit
- Humbje oreksi
- Gjendje gjumi ose qetesi e tepërt
- Tempërate dhe njolla te kuqe ne trup

PËR ATA QE UDHETOJNE:

- Informohuni për vendin ku shkoni
- Merrni me vete maske dhe dezinfektant.
- Lani shpesh duart me sapun
- Zbatoni rregullat e higjenes qe thame me lart.
- Rrini larg vendeve te mbipopulluara si autobuza ,trena, qendra tregetare etj.
- Gjate udhetimit ose pas tij po qe se keni semptoma shkoni menjehere tek mjeku.

VEÇANERISHT TË NDJESHËM NË GRIPIN E DERRIT – GRUPI I RREZIKUAR:

- Të smuarit nga zemra
- Të smuarit nga veshket
- Të smuarit kronik nga kallja e rugëve të frymëmarjes
- Të smuarit nga smundet kronike te melqisë
- Diabetikët
- Të smuarit nga smundja e Parkinsonit dhe skleroza Multiple
- Përsonat me qrrregullim të sistemit imunologjik
- Pacijentët të cilëtnë tri vitet e fundit kanë marë barna kundër astmës
- Shtatëzënat
- Përsonat më të vjetër se 65 vjeqar
- Fëmijët më të rij se 5 vjeqar.

GRIPI I SHPEZËVE:

Historiku

Gripi i shpezëve është infeksion të cilin e shkakton virusi i AVIAN Influcencës. Ky virus i gripit zakonisht lajmërohet te shpezët, mirëpo mund të paraqitet si virus i pastër i shpezëve (AVIAN) që i adaptohet njerëzve përmes mutacionit gradual. Në teori një numër i konsiderueshëm i viruseve të shpezëve kanë potencial të zhvillohen në pandemi virusale.

Deri më sot janë regjistruar tri pandemi të mëdha në botë:

- Gripi spanjoll i vitit 1918/19,
- Gripi aziatik i viteve 1957-1958
- Gripi i Hong Kongut i viteve 1968-1969

Duke u bazuar në përvojën historike dhe karakteristikat biologjike të virusit të gripit, një pandemi tjetër globale është e pa evitueshme. Andaj përgatitja dhe përgjigja epidemiologjike mundëson parandalimin valës goditëse apo së paku shtyrjen e shpërthimit masovik të pandemisë. Pasojat pas shpërthimit pandemik do të ndihën si në aspektin human ashtu edhe në atë ekonomik. Në teori një numër i konsiderueshëm i viruseve të shpezëve kanë potencial të zhvillohen në pandemi virusale, sidoqoftë neve na brengos më së shumti H5N1.

Gjatë periudhës tri vjeçare 2007, 2008 dhe 2009, në Komunën e Deçanit nuk është evidentuar asnjë rast i prekur nga Gripi i Shpezëve.

Ne vitin 2015 dyshohet se një përsos ka vdekur si pasojë e këtij gripi.

Faktorët e përkeqësimit

Faktori i përkeqësimit është kontrolli jo i rregullt veterinar i fermave ekzistuese.

Karakterizimi i flukseve

Numri më i madh i rasteve të sëmundjes mund të paraqitet gjatë sezonës së ardhjes së shpezëve shtegtare nga vendet ku janë të regjistruara rastet e gripit të shpezëve.

Skenarët më të mundshëm

Janë adaptuar dy skenarë, përkatësisht i lehtë dhe i ashpër i pandemisë, për qëllim planifikimi. Këta skenar janë bazuar në përvojat e fituara në pandemitë e kaluara. Sipas **skenarit të lehtë** shkalla e sulmit %, numri i të sëmurëve ?, shkalla e vdekshmërisë ?%, numri i vdekjeve ?. Sipas **skenarit të ashpër** shkalla e sulmit ?%, numri i të sëmurëve ?, shkalla e vdekshmërisë ?%, numri i vdekjeve ?.

Përiudhat e rrezikut

Rreziku i paraqitjes së sëmundjes është përmanent, por, mund të jetë më i theksuar gjatë periudhave të ardhjes së shpezëve shtegtare.

ETHET HEMORAGJIKE - KRIME KONGO:

Historiku

EHHK është sëmundje ngjitëse virale që karakterizohet me sindromë të theksuar hemorragjike (gjakderdhje), shfaqet në vatra natyrore, pas pickimit të këpushave (rriqrave) gjatë sezonës pranverë-vjeshtë.

Ethet Hemorragjike – Krime Kongo, është sëmundje e rëndë ngjitëse e shkaktuar nga virusi me të njëjtin emër. Sëmundja radhitet ndër sëmundjet ngjitëse më vrastare të kohës pas Ebolës. Letaliteti të kjo sëmundje sillet prej 20 – 50%. Sëmundja përhapet me rriqra të familjes Hyalom (e njohur më emrin Hyalom Marginatum) si dhe me gjakun e përsosave të prekur nga kjo sëmundje. Një karakteristikë e këtyre rriqrave është se pickojnë pa dhembje, e durojnë urinë me muaj deri në tre vite dhe e bartin infeksionin në mënyrë transovariale (prej gjeneratave në gjeneratë).

EHKK është karakteristike për vendet me klimë të butë, blegtori të zhvilluar, vise me shkurre që në tërësi i përgjigjet Kosovës Qendrore, duke përfshirë komunat e: Malishevës, Rahovecit, Therandës, Klinës, Drenasit, Prizrenit, Gjakovës, Pejës dhe Skenderajt.

Krime–Kongo për herë të parë në Kosovë është regjistruar në fshatin Nishor të Therandës (ish Suharekës) në vitin 1954 në një familje, me tetë (8) të vdekur.

Në vitin 1989, EHKK paraqitet sërish në fshatin Kijevë të Klinës (sot komuna e Malishevës) në një familje me katër (4) të sëmurë dhe dy (2) të vdekur. Rastet e kësaj sëmundje paraqiten edhe gjatë viteve 1991 dhe 1992

Në vitin 1995, në Kosovë zhvillohet një epidemi masive me 65 raste të EHKK (të dyshimta) të shtrira në 47 vendbanime me incidencë më të lartë në këto komuna: Malishevë, Klinë, Rahovec, Skenderaj dhe Drenas.

Në Komunën e Deçanit, të dyshuar me Ethe Hemorragjike gjatë vitit 2007 është paraqitur një rast, kurse në vitin 2008 ka patur dy raste, prej të cilave njeri është trajtuar në QKMF, kurse tjetri është dërgue për trajtim në QKU.

Ndërsa në vitin 2016 janë vdekur 11 persona në Kosovë.

Ne vitet në vazhdim kemi pasur raste më të shtuara të pickimit me rriqrave por që nuk kanë rezultuar me ndonjë pacient në gjendje të rënde ose raste të vdekjes.

Faktorët e përkeqësimit

Nuk ka dilemë se Krime Kongo është problem madhor i shëndetësisë kosovare e sidomos i shëndetësisë publike. Prej vitit 1989 kjo sëmundje fatale regjistrohet në mënyrë sporadike në pjesët e Kosovës Qendrore dhe Jug – Përqendrore. Kjo sëmundje sot regjistrohet në 55% të territorit të Kosovës gjë që e bën edhe më alarmante situatën.

Karakterizimi i flukseve

Prej vitit 1995 e deri në vitin 2008, EHKK është regjistruar në 13 komuna apo në 37% të territorit të Kosovës. Duhet theksuar se këto komuna përbëhen prej 720 vendbanimeve rurale. Gjatë këtyre viteve, në 70 vendbanime rurale është regjistruar Ethja Hemorragjike Krime Kongo apo në 9.7% të tyre. Në viset e prekura jetojnë rreth 900 000 banorë (vlerësimi).

Në përgjithësi mund të përfundojmë se janë 82 vatra hipër endemike me rrezik shpërthimi epidemik permanent apo vendbanimet më të rrezikuara në Kosovë për Ethen Hemorragjike Krime Kongo janë këto vendbanime më përparësi hulumtimi.

Nga shënimet e mësipërme mund të përfundojmë se në zonat e prekura nga Ethja Hemorragjike Krime Kongo jetojnë rreth gjysma e popullsisë së Kosovës dhe kjo e bën këtë problematikë edhe më serioze.

Në të ardhmen e tërë veprimtaria parandaluese duhet të koncentrohet në këto vendbanime nëse dëshirojmë që sëmundja të mbahet nën kontroll dhe të pengohen shpërthimet epidemike.

Skenari 1

Zakonisht numri i të sëmurëve është 14% nga numri total i të pickuarve.

Skenari i ashpër - Persona të pickuar nga rriqrat _____, numri i të sëmurëve është _____, shkalla e vdekshmërisë _____%, numri i të vdekurve _____.

Përiudha e rrezikut

Sëmundja karakterizohet me paraqitje sezonale, zakonisht gjatë muajve të pranverës dhe verës. Numri më i lartë i rasteve të sëmundjes lajmërohet prej qershorit deri në shtator kur dendësia dhe aktiviteti biologjik i rriqrave është jashtëzakonisht i shprehur. Rastet e sëmundjes fillojnë të paraqiten që nga muaji maj.

Zonat endemike me EHKK në Kosovë



BRUCELOZA

Është sëmundje e cila shumë lehtë mund të shfrytëzohet për qëllime bio terroriste. Duke marr parasysh se në Kosovë, një pjesë e konsiderueshme e popullatës merret me blegtori dhe niveli edukativo shëndetësor nuk është i kënaqshëm, Bruceloza si sëmundje dhe pasojat e saja rrezikojnë shëndetin publik në Kosovë në mënyrë permanente. Kjo sëmundje nëse nuk zbulohet me kohë dhe nuk trajtohet në mënyrë adekuate mund të lejë invaliditet të përjetshëm.

Nga kjo sëmundje më të rrezikuar janë veterinarët, barinjtë dhe amviset. Gjithashtu të rrezikuar janë edhe personat që merren me përpunimin e produkteve të kafshëve të sëmura si kasapët, punëtorët e thertoreve dhe lëkurëpunuesit, gjahtarët. Bruceloza mund të përhapet edhe pas konsumimit të produkteve të qumështit të papërpunuar (sidomos qumështi i dhisë).

Gjer më tani në Kosovë nuk janë të regjistruara raste të vdekjes nga kjo sëmundje. Mirëpo, humbjet janë të mëdha në ekonomi (mungesat nga puna, invaliditeti i pacientëve, asgjësimi i kafshëve).

Historiku

Bruceloza është sëmundje ngjitëse sistemike që shkaktohet nga bakterja e gjinisë Brucella. Sëmundja karakterizohet me rrjedhë akute apo të fshehtë, temperaturë intermitente me kohëzgjatje të ndryshme. Kjo sëmundje është zoonozë, e cila kryesisht haset tek kafshët shtëpiake (dhitë, gjedhet, delet, derrat dhe kuajt). Sëmundja konsiderohet jo kontagjioze pasi nuk mund të bartet nga njeriu në njeri, por bartet nga kafsha e sëmurë në njeri. Sëmundja njihet që nga koha e Hipokratit. Të dhënat shkencore për këtë sëmundje datojnë që nga gjysma e dytë e shekullit XIX. Sëmundja për herë të parë është përshkruar më 1800 në ishullin Maltë. Sëmundja është e përhapur në tërë botën. Shkalla e përhapjes është në lidhje të drejtpërdrejt me zhvillimin e blegtorisë dhe aplikimin e masave parandaluese.

Situata epizotike dhe epidemike përkeqësohet dukshëm gjatë viteve '90. Në Kosovë, zonë endemike për Brucelozë konsiderohet i tërë territori. Nga të dhënat e IKSHPK nga viti 1985 gjer më 2008 janë raportuar 1798 raste të brucelozës me 1 të vdekur në vitin 1993 në Therandë.

Të infektuar nga Bruceloza, në vitin 2009 ka patur një rast dhe i njëjti është trajtuar në QKU në Prishtinë.

Në Komunën e Deçanit nuk ka raporte se mund të kemi pasur ndonjë pacient me këtë sëmundje.

Faktorët e përkeqësimit

Faktori i përkeqësimit është kontrolli jo i rregullt veterinarë e fermave ekzistuese si dhe amvisërive që mbajnë këto shtazë shtëpiake.

Shitblerja e pakontrolluar e shtazëve, mishit, qumështit dhe produkteve të tyre si dhe përpunimi joadekuat i këtyre prodhimeve.

Karakterizimi i flukseve

Sëmundja ka karakter sezonal edhe pse regjistrohet gjatë tërë vitit.

Skenari 1

Shkalla e sulmit është ____%, numri i të sëmurëve është _____. Disponueshmëria me antibiotik dhe nivel të edukimit shëndetësorë mund të reduktojnë sëmundshmërinë.

Zonat endemike me Brucelozë në Kosovë



TULAREMIA

Historiku

Tularemia është sëmundje kryesisht e kafshëve, posaçërisht e brejtësve. Në kushte natyrore sëmundja shfaqet te më shumë se njëzet lloje kafshësh të egra dhe shtëpiake. Sëmundja bartet në njerëz përmes ujit/ushqimit të kontaminuar, ajrit të ndotur dhe me rriqra. Sëmundja prek të gjitha grup-moshat. Për herë të parë sëmundja është përshkruar në vitin 1653 në Norvegji. Tularemia nuk ka qenë asnjëherë e pranishme në Kosovë me herët, qoftë me tablo klinike të qartë apo në formë atipike. Rastet e para të sëmundjes në Kosovë janë paraqitur në Rajonin e Gjakovës, fshatin Brovinë në vitin 2000. Përderisa, sëmundja në fillim kishte shtrirje në Rrafshin e Dukagjinit, në vitet pasuese ishte përfshirë Rrafshi i Kosovës. Kështu sot tularemia ka përfshirë gjithë territorin e Kosovës. Gjer më tani në Kosovë janë lajmëruar dy valë të epidemisë ajo e vitit 1999-2000 me 245 raste dhe ajo e vitit 2000-2001 me 338 raste ndërsa vetëm në vitin 2016 Kosova ka pasur 206 raste. Në vitet pasuese rastet e sëmundjes ishin sporadike, por megjithatë konsiderohet si numër i lartë, 784 raste me shkallë mesatare të sëmundshmësisë 6.7 të sëmurë në 100 000 banorë.

Nga tularemija, në Komunën e Deçanit , në vitin 2007, në QKMF është trajtuar një pacient, por edhe në vitet në vazhdim kemi pas raste kur janë prekur nga kjo sëmundje.

Karakterizimi i flukseve

Sëmundja ka kryesisht karakter sezonal. Më tepër lajmërohet në vjeshtë, dimër dhe fillimin e pranverës, por, nuk përjashtohet mundësia e paraqitjes së rasteve gjatë tërë vitit.

Skenari 1

Shkalla e sulmit është ____% ,numri i të sëmurëve është _____.

III. Pasojat nga veprimet terroriste

Çka është terorizem e çka jo, veq një kohë të gjatë i ka preokupue teoricientet, ekspertet dhe politikanët. Deri me tani nuk është harmonizue definicioni mbi terorizmin. Shpeshëher termi terorizem zëvendësohet me termin teror ose anasjelltas, për këtë arsye është e nevojshme të bëhet dallimi teorik në mes të këtyre dy kuptimeve.

Terrorizëm është dhunë e paramenduar ndaj masës jo luftuese me qëllim ndikimin e opinionit publik për te arritur më pas në goditjen e objektivave me natyrë politike, ushtarake apo ideologjike. Për rrjedhoje marrin kuptimet e tyre fjalët terrorist dhe terrorizoj.

Terrorizmi konsiston në kryerjen e një krimi nga një individ, një grup apo nga një shtet. Terrorizmi përdoret për të ngjallur tek njerëzit një ndjenjë frike e cila në shumë raste është shumë më e madhe se pasojat e vërteta të aktit. Këto akte kane dy shënjestra, popullsinë ose dikasteret e rëndësishme të një shteti. Shkaqet e terrorizmit janë politike, për destabilizimin e një shoqërie por edhe për hakmarrje. Qëllime të ndryshme kanë çuar në themelimin e organizatave të ndryshme të cilat më pas nëpërmjet mesazheve të tyre me karakter politik ose fetar ngjallin frikë dhe panik në radhët e popullsisë. Shumë ide politike janë instrumentalizuar nga organizata terroriste për të justifikuar veprimet e tyre. Si rrjedhojë grupe terroriste eksitojnë në çdo ideologji.

Me analizimin e përmbajtjeve të definicioneve të terrorizmit, mundë të konkludojmë se pak a shumë prezentohen këto kuptime: kërcnimi, dhuna, frika, aspekti politik –efekti –qëllimi, efekti psikologjik dhe reagimi i pa kontrolluar, mos zgjedhja e caktit dhe viktimave, planifikimi i qëllimshëm dhe organizimi sistematik i akcioneve, mënyra e luftës, akti kundër ligjor etj.

Duhet të theksohet se Kosova nuk ka përjetuar ndonjë sulm terrorist dhe, në përgjithësi, nuk konsiderohet si vend me rrezik të veçantë për sulmet terroriste. Sidoqoftë, ngjarjet e sulmeve terroriste janë rritur. Përvojat e fundit në Irak, Afganistan, Pakistan, Spanjë, Turqi e vende tjera demonstrojnë se ky rrezik është me evident se më parë. Në këtë shtojcë është dhënë një përshkrim i përgjithshëm që lidhet me sulmet terroriste.

Karakteristikat bazë të veprimeve terroriste :

- Ekspertiza për aktet terroriste dhe parandalimi i tyre realizohet nëpërmjet një pune shumë të specializuar ku përfshihen shërbimet sekrete, njësi të specializuara të policisë dhe të forcave të armatosura dhe shpesh edhe rrjete ndërkombëtare të specializuara. Si rezultat, këto çështje janë jashtë përgjegjësisë dhe parametrave të punës së atyre që merren me çështjet e emergjencave civile.
- Sidoqoftë, në rast të ndodhjes së ndonjë akti terrorist mbi objekte ose mbi njerëz, atëherë janë mekanizmat e përballimit të emergjencave civile, të cilët duhet të përgjigjen në të njëjtën mënyrë, si në rastet e fatkeqësive natyrore.
- Eksplozionet mund të kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme të grupeve të kërkim-shpëtimit dhe menaxhimit e të dëmtuarve në masë për të shpëtuar jetët e njerëzve në të njëjtën mënyrë si dhe në rastin e një tërmeti të vogël. Në mjaft situata kërcënuese terroriste janë dashur evakuime të shpejta dhe masive të njerëzve për t'i siguruar ata nga kërcënimet e mundshme, madje edhe nga një paralajmërim.
- Megjithatë, ka faktorë të veçantë shtesë që duhet të merren parasysh, duke përfshirë sulmet dytësore pas një sulmi që, nga pamja e jashtme, duket si kryesor, si dhe ngjarje jo të zakonshme, si për shembull sulmet me armë të shkatërrimit në masë (ASHM), për të cilat nuk ka shumë përvojë.
- Duke u nisur nga natyra e tyre, sulmet terroriste zakonisht ndodhin pa paralajmërim ose me një lajmërim në çastin e fundit, por mund të pasohen nga një numër ngjarjesh të lidhura dhe ndonjëherë të koordinuara që shkaktojnë panik dhe strese të mëdha. Fjala **terrorizëm** do të thotë : dhunë e paramenduar ndaj masës jo luftarake me qëllim ndikimi në opinionin publik për te arritur më pas në goditjen e objektivave me natyrë politike, ushtarake apo ideologjike.

- Parandalimi është detyrë e strukturave dhe e institucioneve të specializuara.
- Sulmet terroriste janë të paparashikueshme, kështu që, për përballimin e tyre, parapëlqehet të planifikohet në të njëjtën mënyrë si për çdo emergjencë civile tjetër, në mënyrë që të jetë e mundur të kalohet në këto plane, nëse një situatë e tillë bëhet realitet. Procedurat e evakuimit, planet, informimi i publikut, identifikimi i strehimit të sigurt dhe asistencë humanitare për emergjencat, mbështetja logjistike dhe të gjitha përgjegjësitë e tjera të lidhura me to duhet të merren nga seksioni i përballimit të PKEC-së dhe nga planet e emergjencave/gatishmërisë të përgatitura në nivel rajonal dhe lokal.
- Sulmet terroriste shpesh nuk kanë paralajmërime të hershme, megjithëse mund të ndodhë të bëhen lajmërime me telefon në minutën e fundit. Në rast të tillë, mobilizimi i shpejtë i forcave operacionale duhet të aktivizojë strukturat përkatëse si dhe për rastet e fatkeqësive natyrore. Zakonisht përparësi kanë evakuimi i shpejtë dhe i sigurt si dhe izolimi i zonës së kërcënuar.
- Për ndërgjegjësim publik në lidhje me kërcënimet terroriste është e nevojshme të merret një vendim ngainstancat e larta qeveritare. Marrja e këtij vendimi për rritjen e gatishmërisë, pra rritja e vigjilencës dhe e njohurive të publikut mbi atë çfarë duhet të bëhet në raste të tilla, është me rëndësi shumë të madhe pasi në këtë mënyrë shpëtohen jetë njerëzish. Këto aktivitete duhet të bëhen në të njëjtën mënyrë si për rastet e tërmeteve ose të përmytjeve. Si rezultat, duhet të ndërmerren të gjitha aktivitetet për angazhimin e përbashkët të publikut dhe të institucioneve në këtë drejtim. Shkollat, administrata publike, spitalet, subjektet private, media lokale dhe publike duhet të angazhohen për të transmetuar mesazhe të thjeshta dhe koherente nëpërmjet të gjitha mjeteve të komunikimit, duke u bazuar në njoftimet zyrtare.
- Praktikimi dhe testimi i planeve nëpërmjet stërvitjeve është me shumë vlerë edhe në një situatë sulmi terrorist.
- Veprimet e menjëhershme të kërkim–shpëtimit ndërmerren kryesisht nga komunitetet e prekura, ku pjesa më e madhe e njerëzve shpëtohen nga familjarët, miqtë ose fqinjët.
- Trajtimi i menjëhershëm mjekësor do të nevojitet për t’ua ofruar të plagosurve. Një fatkeqësi e një përmase të madhe do të kërkojë angazhim të gjerë jo vetëm të kapaciteteve lokale, por edhe të atyre kombëtare.
- Bëhet, gjithashtu, edhe një vlerësim i shpejtë i sigurisë së objekteve si dhe për dëmet dhe nevojat më emergjente.
- Mbajtja e rendit publik dhe dhënia e një informacioni të saktë janë shumë të rëndësishme për të vendosur qetësinë si dhe për të ulur përshtjellimin e mëtejshëm që të mos shkaktohen viktima të tjera.
- Mund të jetë e nevojshme të evakuohet e gjithë popullsia nga zona e prekur ose nga zona të tjera që mund jenë nën rrezik të lartë. Në këtë situatë nevojitet mbajtja nën kontroll e rendit publik, dhënia e informacioneve të qarta, dhënia e mesazheve dhe e udhëzimeve për popullsinë si dhe informimi për zonat e sigurta të identifikuar më parë.
- Mund të kërkohen ose të ofrohen operacione ndërkombëtare të specializuara të kërkimshpëtimit. Ardhja e skuadrave të kërkim-shpëtimit do të shoqërohet me kërkesa për transportin ajror dhe për mjetet e transportit rrugor gjatë përpjekjeve për t’i dislokuar ato në zonat e prekura sa më shpejt të jetë e mundur.
- Edhe gjatë trajtimit të menjëhershëm mjekësor dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit mund të vlerësohen rreziqet dytësore për objektet e dëmtuara.
- Mbështetja logjistike është shumë e rëndësishme për një përballim të suksesshëm. Rrjeti rrugor, telekomunikacioni dhe infrastruktura tjetër duhet të vihen në funksion sa më shpejt dhe sa më mirë që të jetë e mundur, me gjithë kufizimet.
- Nëse njerëzit mbeten brenda strukturave të prishura, skuadrat e specializuara të kërkimshpëtimit, pasi të sigurohen, duhet të fillojnë menjëherë operacionet. Pjesa më e madhe e personave që shpëtohen do të jetë gjatë 24-48-orëshit të parë pas ngjarjes.

- Siguria, eliminimi i materialeve të rrezikshme ose pastrimi i zonës nga ndotjet si dhe sigurimi i trukturave të dëmtuara duhet të garantohen përpara se popullsia të kthehet e sigurt në zonën e prekur.
- Shërbimet publike bazë ku përfshihen uji i pijshëm, ujërat e zeza, përdorimi i rrugëve dhe furnizimime energji duhet të sigurohen sa më shpejt të jetë e mundur.
- Duhet të merren vendime të shpejta në lidhje me objekte bazë publike (duke përfshirë ndërtesat e shkollave dhe të spitaleve) që mund të jenë shkatërruar ose dëmtuar rëndë. Ndërtesat që nuk riparohen, duhet të prishen plotësisht dhe të merret në konsideratë zëvendësimi i tyre i përkohshëm ose i përhershëm.



VIKTIMAT E TERRORIZMIT

IV. PROBLEMET SOCIALE

Papunësia dhe shkalla e varfërisë në Komunën e Deçanit:

Shikuar në gjendjen e gjithëmbarshme të Kosovës nga aspekti i shkallës së varfërisë, rezulton se Kosova është vendi më i varfër në rajon, këtë gjendje e jep statistika e shprehur në përqindje – 12.71 % është evidencuar shkalla e varfërisë ekstreme ndërsa përqindja e përgjithshme e varfërisë është 50.35 %.

Sipas të dhënave të marra nga qendra për punë sociale në Deçan rreth shkallës së varfërisë, del se mbi 30% e popullsisë jetojnë në varfëri.

Vlera mesatare e varfërisë së përgjithshme në komunën e Deçanit është rreth 11.56 %. Vlera maksimale e varfërisë sillet diku rreth 46 % .

Faktorët të cilët ndikojnë në rritjen e shkallës së varfërisë janë identifikuar më sa vijon :

- Shkalla e ultë e zhvillimit ekonomik
- Procesi i ngadalshëm i zhvillimit ekonomik
- Shkalla e lartë e papunësisë –

Problemi social- është nocion i cili paraprakisht kishte kuptim që të tregonte pasojat e mos plotësimit të nevojave të njerzve përshtak të kushteve të pa favorshme socio-ekonomike për jetë e që për pasoj kishte prodhimin e „rasteve sociale“ . Në mesin e rasteve më të shpeshta të problemeve sociale numrohen:

- Papunësia,
- Varfëria
- Sjelljet agresive
- Kriminaliteti
- Alkoholizmi,
- Çrregullimet e marrëdhënjëve familjare dhe
- Mbrojtja e grupeve etnike.

Kuptimet bashkëkohore citojnë se problemet sociale janë ngjarje apo situata objektive të cilat në mënyrë të pa favorshme ndikojnë në jetën dhe kushtet e punës së njerzëve. Shfaqja e "rasteve sociale", e më këtë edhe të problemeve sociale është dukuri normale imanente në natyrën e njeriut dhe të shoqërisë. Për këtë arsye është e mundëshme , që këto dukuri, paraprakisht të zvoglohen, disa sish të eliminohen, kurse disa prej tyre me intervenimin e shoqërisë së organizuar të parandalohen në mënyrë që mos të ndodhin pasoja të pa dëshirueshme. Problemet sociale, si grumbull i manifestimeve të pa dëshiruara për individin dhe grupet, janë komplekse dhe shpeshëher destabilizuese afat gjata për bashkësinë sociale, që kërkon masa komplekse të politikës sociale për identifikimin preventivën dhe zgjedhjen e tyre.

Varfëria: është nje nocion i cili më së shumti përdoret në rastet kur mungojnë kushtet elementare për jetë. Te jesh i varfër do të thotë të mos kesh mjaft para (mjete materiale për te jetuar) për t'i plotësuar kushtet elementare për jetesë siç janë: ushqimi, shtëpi banimi etj. Shume njerz në shumë vende në mbarë botën jetojnë në varfëri, veçanërisht në vendet e varfëra të Afrikës, Amerikës Latine dhe Azise. Sipas definicionit të OKB , të varfër llogariten individët të cilët nuk kanë jetë normale për shkak të mungesës së kushteve normale në shoqërinë në të cilën jetojnë. Varfëria matet me norma përherë të ndryshueshme të një shoqërie të caktuar. Sipas këtyre kritereve , varfëria ndahet në varfëri të skajshme, varfëri relative, paupërizëm dhe varfëri moderne. Ka shumë mënyra të përcaktimit të varfërisë. Sipas Bankës Botërore , varfëri e skajshme është atëherë kur njeriu jeton me më pak se 1 dollarë në ditë. Në vitin e fundit më se 1 miliard njerz në botë konsiderohen të varfër.

Varfëria është një ndër problemet kryesore të botës moderne.

Varfëria relative: është kur, pasuria dhe të ardhurat personale, janë të pa mjaftueshme që individi të mund arrin standard jetësor të mjaftueshëm për jetë në harmoni me jetën mesatare të qytetarit të shoqërisë përkatëse. Individët në varferinë relative kërkojnë intervenime sociale, mirë po nuk janë pa shtëpi ose në varfëri ekstreme.

Vija relative e varfërisë: paraqet nivelin e të ardhurave nën të cilin individi nuk mund të i siguron të gjitha resurset e nevojshme për jetë. Popullata nën relative të varfërisë sipas automatizmit konsiderohet e varfër dhe kërkon një varg shërbimesh sociale, prej të parave është ndihma materiale. Kjo njësi matëse është relative, sepse shtete të ndryshme shfrytëzojnë metodologji të ndryshme llogaritëse.

Varfërija absolute: Në të gjitha shtetet si varfëri absolute konsiderohen individët me të ardhura mujore më pak se 30€.

Pa kulm mbi kokë: është gjendja në të cilën individit i mungon vendqendrimi i përherëshëm dhe mjetet që të ketë ate. Individëve të till ju mungojnë aftësit sociale, dija ose stabiliteti emotiv që pa ndihmën e tjerëve nuk mund të ndryshojnë gjendjen në të cilën gjinden.

Destituimi: është gjendje e varfërisë ekstreme në të cilën mungojnë mjetet themelore për jetë, duke përfshi ushqimin dhe strehimin. Destituimi apo paupërizëm mund të sjell edhe vdekjen nga uria.

Të varfërit e rinjë: janë personat të cilët rishitas janë varfërue ose të cilëve në mënyrë të dukshme ju ka ulë standardi, më së shpeshti nga shkaku i humbjes së vendit të punës. Kjo dukuri është e theksuar në të gjitha shoqëritë në tranzicion dhe shoqëritë në zhvillim. Sociologët dhe ekonomistët këtë kategori e ndajnë nga "varferia klasike" sipas asaj se ndajnë vlerat e klasës së mesme.

Lypja (Lëmosha): është formë e përfitimit material duke shfrytëzuar prirjen e njerzëve për mëshirë ndaj njerzve të cilët meren me këtë dukuri. Nga kjo shpeshher vjen deri të keqpërdorimi i cili manifestohet nëpërmjet kriminalitetit të organizuar dhe shfrytëzimin e personave, veçanërisht të fëmijve të cilët detyrohen në këtë formë aktiviteti. Kjo, sidomos ka të bajë më një numër të njerzve me aftësi të kufizuara ose pjestar të grupeve minoritare. Lypja si veprimtari ka pasoja negative psikike-sociale në gjendjen e individëve si dhe në veshtrësitë e funksionimit social, kërkon vemendje të veçantë të shërbimeve sociale për parandalimin dhe krijimin e kushteve përkatëse për terpë sociale dhe rehabilitim.

Cikli i varfërisë: është varfërija e cila zgjatë më tepër se një gjeneratë familjare dhe shpeshher bartet në gjeneratën e ardhëshme. Shpeshher fëmijet e prindëve të varfër nuk kanë çasje në arsimim kualitativ, stileve të shëndosha jetësore, mundësive të punësimit, mbështetjeve financiare e karrierës, përkrahjes së fortë familjare etj. dhe është besueshmerija e madhe që të mbetën të varfër dhe të i rritin fëmijët e tyre në varfëri.



TABELA KLASIFIKUESE E RREZIQEVE

Lloji i rrezikut	Gjasat e ndodhjes	Efekti	Dëmet		Rangimi	Frekuenca e ndodhjes	%
			Viktima	Vlersi./€			
Vërshimet	Shumë i mundëshem	-i ultë, -i ngritur			1	Zjarret pyjore	85-100% mundësja e ndodhjes vitin e ardhëshem
Zjarr.pyjore	Shumë i mundëshem	-i mesëm, -serioz			2	Zjarret në objekte banimi	80-100% vitin e ardhëshem
Zj.ob.banimi	Shumë i mundëshem	-i mesëm, -serioz	1		3	Vërshimet	75-90% vitn e ardhëshem
Zj.stac. karb	I mundshëm	-seriz			4	Fatk. komunik	32.49% në vitin e ardhëshem
Termetet	Ka gjasa	-katastrofi.			5	Pikat e karburantëve	20-80% një ndodhje 10 vitet e ardhëshme
Stuhit	I mundshëm	-i ultë			6	Epidemitë	10-100% një gjasë në 10 vite
MME	I mundshëm	-i ultë -i ngritur	?		7	Bora dhe orteqet	10-100% një gjasë në 10 vite
Radioaktivit.	Ka gjasa	-katastrofi.			8	MME	10-100% një gjasë në 10 vite
Epidemit	I mundshëm	-i msëm -serioz			9	Erozioni	10-100% një gjasë në 10 vite
Thatësirat	Ka gjasa	-i ultë			10	Stuhitë	10-60% një gjasë në 15 vite
Bora e orte.	I mundshëm	-i ultë			11	Radioaktiviteti	10-50% një gjasë në 20 vite
Erozioni	Ka gjasa	-i mesëm			12	Termetet	1-10% në 10 vite ose një ndodhje në 100 vite

Pjesa e tretë

V. FORCAT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

5.1. Struktura, organizimi, detyrat dhe kapacitetet reaguese të forcave për mbrojtje dhe shpëtim:

1. Komiteti Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim (KKMSH)
2. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
a/ Njësia profesionale e Zjarrëfiksëve,
b/ Zyra për Alarmim dhe Koordinim Emergjent.
3. Policia e Kosovës,
4. Forcat e Sigurisë së Kosovës
5. KFOR-i,
6. Shërbimet Publike Komunale.
7. Shërbimet medikale emergjente
8. Organizatat joqeveritare:
a/ Kryqi i Kuq Komunal

II/1 KOMITETI KOMUNAL PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Kompetencat:

- Komiteti, është organi më i lartë vendim-marrës, në udhëheqjen dhe koordinimin e veprimeve dhe aktiviteteve për situata emergjente në komunë.
- Komiteti numëron gjithsejtë 10 anëtarë, ndërsa kryetar i këtij Komiteti sipas funksionit është Kryetari i Komunës.
- Komiteti mund të mblidhet edhe në përbërje të zgjeruar, varësisht nga problematika e situatës emergjente dhe veprimet intervenuese,
- Komiteti është i vetmi organ i autorizuar, për shpalljen e gjendjes emergjente civile në teritorin e Komunës së Deçanit,
- Është organ kompetent për vënien e bashkëpunimit, komunikimit dhe bashkërenditjes së veprimeve me strukturat e nivelit qendror në aspektin e emergjencës dhe sipas nevojës kërkon ndihmë në shfrytëzimin e resurseve dhe kapaciteteve njerzore dhe teknike me të cilat posedon niveli qendror.
- Në rast të fatkeqësive të përmasave më të mëdha, përveç kontaktit me strukturat qendrore, bashkëpunon edhe me strukturat emergjente të komunave fqinje, dhe merrë obligimet që i takojnë në kuadër të këtij bashkëpunimi.

Detyrat dhe obligimet:

- Udhëheqë dhe vënë në lëvizje të gjitha subjektet e involuara në situata emergjente dhe mbikqyrë realizimin e punëve dhe detyrave të cilat zhvillojnë ekipet e reagimit emergjent në terren.
- Bënë caktimin e prioriteteve dhe koordinimin sa më efikas të subjekteve involuare të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rast të fatkeqësive: natyrore, teknologjike, njerzore, sociale etj.
- Krijon kushte për veprime të shpejta në kohë dhe hapsirë me qëllim që të shpëtohen jetërat e njerzve dhe të të mirave materiale , gjithashtu edhe në marrjen e veprimeve për t'a filluar stabilizimin e gjendjes,

• Sipas dinamikës , bazuar në principin të reciprocitetit, shkëmben informacione dhe të dhëna tjera me ineteres të veçant, me entet dhe institucionet e specjaluara në nivel të Kosovës siqë është: enti seizmologjik, enti hidrometeorologjik, epidemiologjik etj.

• Cakton kriteret për shpalljen e gjendjes emergjente civile si dhe mekanizmat për funksionimin racional të strukturave shtetërore dhe civile në komunë gjatë situatës emergjente, dhe sipas nevojës ndërmerrë masat adekuate që situata të mos del jashtë kontrollit.

• Gjendja e emergjencës civile mund të shpallet në një pjesë të territorit apo në tërë shtrirjen e saj, dhe atë Komiteti e shpallë kur me mundësitë dhe burimet ekzistuese nuk do të mund të përballoheshin pasojat që do të shkakttoheshin nga fatkeqësitë.

• Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile janë të nevojshme përcaktimi i disa kriterëve dhe të dhënave:

a/ shtrirja territoriale e zonës së dëmtuar,

b/ ndikimet e këtyre dëmeve në prishjen e ekuilibrit të jetës normale të komunitetit,

c/ të dhënat e verifikuara nga subjektet relevante komunale dhe nga institutet përkatëse (për rastin konkret të fatkeqësis).

• Për të gjitha masat dhe veprimet që ndërmerrë Komiteti komunal për menaxhim emergjent, paraprakisht shfrytëzon të gjitha materialet-dokumentet e Planit Komunal për Gadishmëri Emergjente të hartuar nga Drejtoria Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

LISTA E KOMITETIT KOMUNAL PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

	EMRI E MBIEMRI	NR. KOTAKTUES TË TEL.		POZITA E ANTARVE JASHT KOMITETIT	VËREJTJE
1	BASHKIM RAMOSAJ	045 120 - 707		KRYETAR I KOMUNËS	
2	JASHAR DOBRAJ	045 120 - 701		DREJTOR I ADMINISTRATËS	
3	IZET ZENUNI	045 120 – 700		DREJTOR I MSH & SHERBIMEVE PUBLIKE	
4	MUSA BERISHA	044 129-660		DRJTOR I SH E M. & SOCIALE	
5	NYSRET XHURKAJ	0390 361 – 020 192		KOM. I POLICISË	
6	BESIM SELMANAJ	045 120 - 710		K.DANT I BRIG. ZJARRFIKJES	
7	AGRON DEMUKAJ	045 120- 555		DREJTOR PËR BUGJET - FINANCA	
8	GENTIANA MAZREKAJ	044 658- 503		SHEFE E SEKTORIT PËR MBROJTJE SHPETIM	
9	PËRFAQSUESI I FSK-SË				
10	PËRFAQSUESI I KFOR-IT	049 773 483 049 773 484			VEND TAKIMI NË NDERTESEN E KOMUNËS OSE NË AFËRSI TË ZONËS EMERGJENTE

DETYRAT E ANËTARVE TË KOMITETIT KOMUNAL PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM:

Komandanti i Incidentit

*Komandanti i Incidentit do të:

- Verifikon gatishmërinë për intervenim të njësive emergjente dhe resurseve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihme;
- Udhëqehq mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të fatkeqësive
- Siguroj ndërlidhje dhe veprim të koordinuar për të gjitha SMSHN
- Ben propozime lidhur me përgatitjen e SMSHN si dhe për rimëkëmbje nga katkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- Kërkoj aktivizimin e Qendrave Operative Emergjente

Komandanti i Incidentit mund të caktoj përgjegjës për të menaxhuar intervenimet individuale të mbrojtjes, shpëtimin dhe ndihmës.

Drejtori i Drejtorisë për MBROJTJE DHE SHPËTIM:

- Se bashku me Policinë, FSK-në Brigaden e Zjarrfikseve evidenton ekipet profesionale intervenuese, përgatisin koordinimin në mes të këtyre subjekteve, parashohin radhitjen e aktivizimit të këtyre subjekteve në intervenim, varesisht nga situata.
- Se bashku me Policinë, FSK-në Brigaden e zjarrfikseve, shqyrton mundësitë e kontaktimit (ndërlidhjes) në mes të anëtarëve të keshillit të emergjencës, para ndodhjes së fatkeqësive (menyres së lajmerimit) dhe gjatë gjendjes emergjente,
- Paraprakisht shqyrton mundësinë e formimit të njësive të ndryshme intervenuese për rastet e ndryshme të fatkeqësive si p.sh. termetet, vërshimet, rrenimet e objekteve etj. të cilat do të jenë mbeshtetje e njësive të formuara qeveritare.
- Me bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit shqyrton mundësinë e informimit të nxenesave për veprimet e tyre në rast termeti apo fatkeqësive tjera në çdo shkollë të formohet grup-ekip, i cili në raste emergjente e në veçanti në rast të termetit do të koordinoj veprimet (duke u bazuar në planin e evakulimit të secilës shkollë)
- Në bashkëpunim me përfaqësuesin e Policisë dhe FSK-së koordinon aktivitetin e ekipeve në terren.
- Kontakton ekipet për intervenim emergjent dhe njoftohet me rrjedhat dhe gjendjen momentale
- Jep informata Komandantit të Incidentit (kryetari i komunës) dhe së bashku me të dhe anëtarët e tjerë të Komitetit shqyrton gjendjen dhe m'varesisht nga gjendja propozon masat e domosdoshme.
- Vepron konform situatës dhe udhëzimeve të dhëna nga Komandanti i Incidentit.

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetsi dhe Mirëqenjen Sociale

*Formon regjistrin e personelit të mundshëm për intervenim në raste urgjente

*Harton listen e mjeteve materiale të cilat mund të aktivizojnë në raste emergjente (automjete të ambulancës paisje kirurgjike fushore etj).

*Bënë kërkesën për nevojat e tij për përkrahje në personel dhe mjete materiale për raste emergjente.

*Parashoh mundësinë e formimit të spitalit fushor në rast nevojë dhe përcakton pozicionin e tij në disa alternativa.

*Në raste emergjente mledh informata nga ekipet, jep udhëzimet fillestare, njofton Komandantin e Incidentit me gjendjen aktuale, merr pjesë në procesin e marrjes së vendimeve për aktivitetet e mëtejme.

Komandanti i Policisë

- Komandanti i Policisë në bazë të udhëzimeve të Komandantit të Incidentit si dhe sipas detyrave dhe rregulloreve të policisë i përcakton detyrat dhe përgjegjësitë sipas situatave të krijuara.

Komandanti i FSK-së

- I përcakton detyrat vet
- Jep shenime mbi mundësin e angazhimit të kapacitetit mjeksor, potencialit njerzor dhe paisje materiale dhe ate nese fatkeqesia ndodh vetem ne Komunë dhe nese ndodh ne regjion.

Përfaqesuesi i (KFOR-it)

- I përcakton detyrat vet dhe jep propozimet për mënyren e koordinimit të ekipeve tjera me njësi të KFOR-it.
- Jep të dhëna për mundësit e ndihmave në mjete materiale.

Komandanti i Sherbimit të Zjarrfikjes

- Shqyrton mundësinë e lajmerimit të anëtareve të brigadës dhe parashef kohën e nevojshme për lajmerim.
- Ndërmerr masa për shuarjen e zjarreve në rast shpërthimi të tyre.
- Aktivizon Ekipin e Kerkim-Shpëtimit,
- Ndërmerr masa për shpëtim të personave në raste të rrënimit të objekteve apo fatkeqesive të tjera.
- Bënë kërkesen për plotësimin në mjete materiale dhe në personel ndihmës apo profesional

KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Në raste të krizës themelohet qendra informative e mediave e pranë vendit të aksidentit, por larg nga qendra kryesore. Të punësuarit e organizatës zakonisht drejtohen të kjo qender dhe kanë për detyrë të shoqërojnë përfaqesuesit e mediave, raportereve nuk duhet të lejohet hyrja në zonën e rrezikshme, edhe pse do të deshironin të shkonin atje. Me këtë rast caktohet një zadhenes i përshtatshme i cili ka për obligim leximin e materialeve informative të përgaditura nga ekspertet. Zedhenes nuk mund të jetë Drejtori i mardhenieve me publikun. Qendra informative duhet të vendoset në një dhomë të përshtatshme prej nga raportohet lehtë dhe mund të japin informata për gjendjen.

KOMUNIKIMI DHE NDËRLIDHJET

Komunikimi për rreth vendit të ngjarjes:

- *Vendi i komandës do të monitoroj të gjitha radiorrjetet dhe do të jetë qender e të gjitha komunikimeve.
 - *Çdo ekip për reagim ndaj emergjences do të ketë radio lidhjen e vet të mrendshem për komunikim mrenda ekipit.
 - *Çdo ekip do të dergoj një nderlidhje në vendin e komandës (V.K.)
- Komunikimi nga vendi i komandës (V K) me zyren e alarmimit dhe koordinimit emergjent (ZAKE):
- *Radiot e dores do të jenë mjetet primare për komunikim
 - *Komandanti i incidentit (KI) do të komunikoj drejtpërdrejt me ZAKE .
 - *Çdo ERE (Ekip i Reagimit Emergjent) do të dergojë një person për ndërlidhjet me ZAKE.
 - *Do të përdoren telefonat celular si përkrahje.

II /2 SEKTORI PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

- Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim është organ profesional i cili mirret me çështjet emergjente në komunë dhe si e tillë bënë planifikimin dhe marrjen e masave për parapengimimin, zbutjen dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike e të tjera.
- Struktura e saj organizative dhe pregaditjet e planeve mbrojtëse mundësojnë mbulimin e të gjitha segmenteve me të cilat do të ballafaqohet shoqëria civile dhe strukturat shtetërore në komunë në rast të situatave emergjente.
- Në punën e saj të përditshme ajo i përgjigjet Kryetarit të Komunës dhe Asamblesë Komonale në Deçanit , e sipas resorëve edhe nivelit Qendror-Agjencionit për Menaxhim të Emergjencave,ndërsa me shpalljen e emergjencave civile i përgjigjet dhe është komplet me tërë potencialin e saj në shërbim të Komitetit Komunal për Emergjencë,
- Planifikimi efektiv që bëhet në kuadër të sektorit është në funksion fillestar të menaxhimit i cili njëherit siguron udhëheqje të mirëfillt dhe rekomandon metodën ekzekutimit (reagimit),përmes të cilave u ipet përgjigje shumë pyetjeve siç janë: detyrat, potenciali njerëzor, koordinimi reciprok,ndarja e përgjegjësisë , ndarja e mjeteve gjatë emergjencave etj.
- Në bazë të vlerësimeve të gjithanshme profesionale dhe konstatimeve faktike në terren dhe duke marrë për bazë kompetencat dhe funksionet që ushtron ky sektor i jep propozimin Komitetit Komunal për Emergjencë shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në një pjesë apo në tërë territorin e komunës .
Në kuadër të Drejtorisë për M dhe Sh veprojnë ekipet:
 - a/ Njësia e Zjarrfikësve
 - b/ Zyra për Alarmim dhe Koordinim emergjent



a. Njesija e zjarrfikësve

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Në raste të aksidenteve-fatkeqësive të përmasave të mëdha, Njësia e Zjarrfikësve së bashku me subjektet tjera përkatëse të involvuara në raste emergjente do të kryejnë këto veprime:

- Zjarrfikje dhe detyra të tjera në raste zjarri. (Koha e arritjes është pasqyruar në tabelë).
- Pozicionimi dhe shuarja e zjarreve përgjat akseve rrugore dhe hapja e korridoreve për intervenim deri ne zonën e incidentit.
- Do të sigurojë hyrje për shpëtimtarët për në lokacionet me tym, nëse ata nuk janë të pajisur me mjete standarde (boca oksigjeni etj).
- Misione shpëtuese lidhur me akcidentet dhe katastrofat natyrore, në raport me mundësitë dhe pajisjet e tyre.
- Do të sigurojnë operacione të shpëtimit në pyje.
- Veprime të Evakuimit dhe Shpëtimit në rast zjarri.
- Veprime të kërkim-shpëtimit në aksidente rrugore.
- Veprime të kërkim-shpëtimit në ambiente nënujore etj.
- Kryen edhe shërbime tjera të natyrës medikale në vendin e incidentit dhe bartjen e të lënduarëve në qendrën spitalore.
- Kryen edhe punë e detyra tjera sipas nevojës dhe situatës emergjente dhe lidhur me këto detyra i përgjigjet në vertikale Kryetarit të Komitetit Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Aktualisht, Njesija e Zjarrfikësve, në përbërjen e vetë ka:

- ⇒ 14 zjarrfikës dhe
- ⇒ Komandantin e njësisë
- ⇒ Si dhe 56 zjarrfikës vullnetarë të certifikuar dhe
- ⇒ 1 shefi te shërbimit

Njësia kujdestaron 24 orë, sipas orarit të hartuar nga Komandanti i njësisë.

Duhet të cekët se në Komunën e Deçanit, pos Njesisë së Zjarrfikësve nuk ka asnjë njësi apo ekip tjetër për intervenime në rastë të krijimit të situatave emergjente edhe pse potenciali kadrovik ekziston si për ekipe të Kërkim Shpëtimit ashtu edhe për Ekipin Paramedikal, ku për këtë të fundit, Kursin Bazik Paramedikal nga Komuna e jonë e kanë krye 15 vajza. Minimumi i mjeteve dhe pajisjeve teknike për Shërbimin e Zjarrfikës dhe Shpëtimit rregullohet në pajtueshmëri me Udhëzim administrativ mbi bazat e themelimit dhe organizimit të shërbimit të zjarrfikës në teritorin e Republikës së Kosovës².

Aktualisht, Njësia e NJPZSH-së në Deçan, ka në dispozicion një numër të konsiderueshëm të mjeteve materialo-teknike dhe të pajisjeve me anë të të cilave i kryen punët dhe detyrat e përshkuara sipas Ligjit.

Nga automjetet ka:

- 2. auto-cisternë “Fap” dhe “BetFord”
- 1. auto-ambulancë “Fiat-Dukato” dhe
- 1. auto tereni 4x4 “Tojota”
- 2. auto sulmuese “Volvo f7” “Isuzu”
- 1. auto për terene malore Iveko 4x4



Foto. Automjetet në shfrytëzim të NJPZSH-së

**AUTOMJETET TË CILAT JANË NË SHFRYTEZIM TE NJPZSH-së
- DEÇAN**

Nr	Targa e automjetit	Lloji	Fuqia	Viti i prodhimit	Lloji i karburantit	Kapaciteti i rezerv	Numri i ulësve	Shfrytëzuesi i automjetit	Gjendja teknike
1	112-116-04	Auto-cisternë "Fap"	6.2	1980	Naftë	120	3	NJPZSH	Jo rregullt
2	112-144-04	Auto-sulmues "Volvo"		1983	Naftë		5	NJPZSH	E Rregullt
3	112-142-04	"Tojota" 4x4 autoter.	3.0	1999	Naftë	60	5	NJPZSH	Në rregull
4	112-117-04	Auto-ambula. "Dukato"	2.0	1999	Benzinë	60	7	NJPZSH	Në rregull
5	112-129-04	Auto-Sulmues "Isuzu"	3.0	2017	Naftë		3	NJPZSH	Ne rregullt
6	112-127-04	Auto-Terene malore "Iveko"	3.0	2014	Naftë		6	NJPZSH	E rregullt
7	%	Auto-cisterne "BetFord"		1983	Naftë		2	NJPZSH	E rregullt

Kurse prej pajisjeve personale dhe të kolektive, njësia ka 93 artikuj pajisjesh të ndryshme, të blera ose donacione të ndryshme.

Sipas Udhëzimit administrativ mbi minimumin e pajisjeve teknike dhe mjeteve për njpzsh-së - kriteri "4" neni 9 dhe 10³ në bazë të cilit duhet të themelohet dhe organizohet Njësia e NJPZSH-së në Deçan, duhet të ketë këto automjete:

- automjet komandues _____ 1 copë
- automjet sulmues _____ 2 =/=
- autocisternë _____ 2 =/=
- automjet për shuarje me shkumë dhe ujë _ 1 =/=
- automjet për shuarje me pluhur _____ 1 =/=
- automjet për intervenime teknike _____ 1 =/=
- automjet për intervenime të vogla _____ 1 =/=
- automjet për shpëtim nga lartësitë me shkallë hidraulike 30 m lartësi punuese _____ 1 copë
- automjet për fikjen e zjarreve malore dhe fushore ----- 1 =/=

Po sipas të njëjtit Udhëzim neni 10, minimumi i mjeteve dhe pajisjeve teknike të cilat duhet të i posedoj njësia e NJPZSH-së në depo përmban:

- ➔ katërdhjet e katër (44) artikuj me
- ➔ dyqind e nëndë (209) copë.

³ Kapitulli V neni 29 të Ligjit mbi Mbrojtjen nga zjarri

Deri me tani njësitë e zjarrefiksësve ka qenë vendosur në objektin e Pallatit të Kulturës, ku kanë qenë kushtet larg standardeve të kërkuara për tekniken, automjetet dhe personelin e tyre. Tani në muajin Janar 2019, janë dislokuar në objektin e ri që gjendet në rrugën "Elez Geci dhe Maxhun Berisha". Objekti i ndërtuar me financim të komunës është i standardeve dhe kërkesave që ju nevojitet njësitit si për vendosjen e automjeteve (garazhdave) ashtu edhe objekti administrativ për personelin.



Foto: Objekti i ri i zjarrefiksësve

b. Zyra për Alarmim dhe Koordinim Emergjent "ZAKE"

Roli dhe rëndësia:

- Sigurimi me kohe i të dhënave (informacioneve) kualitative për të ndërmarrë vendime dhe aksione drejtuese për të përballuar situatat emergjente në komunë e me gjërë.
- Bënë grumbullimin, ruajtjen dhe distribuimin e të gjitha informacioneve që kanë të bëjnë me të gjitha llojet e rreziqeve për jetën e njerëzve, qenieve të gjalla, pronës dhe ambientit.
- Kontrolli dhe komunikimet në operacionet emergjente.
- Koordinimi i ekipeve dhe pajisjeve emergjente.
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet, ekipet dhe personelin tjetër të involvuar në situatat emergjente.
- Mosfunksionimi i ZAKE- rrezikon shfaqjen e defekteve serioze në menaxhimin e emergjencave në komune.

Lidhjet dhe qasjet e ZAKE, me shërbimet emergjente

Momentalisht me të gjitha shërbimet emergjente ZAKE, ka qasje përmes:

- Telefonisë fikse dhe asaj mobile të PTK-së,
- Rrjetit të radioveleve në dy frekuenca,

Ndërsa në perspektivë planifikohet që në kuadër të modernizimit dhe përsosjes së teknikës edhe qasja përmes :

- Rrjetit të Internetit,
- Rrjetit të Intranetit, dhe
- Rrjetit të mikroveleve.

Qytetarët do të kenë mundësi të kontaktojnë ZAKE, përmes :

- Telefonisë fikse,

•Radiolidhjes, përmes bashkëpunëtorëve të ZAKE, në teritorin e komunës , ndërsa në të ardhmen qytetareve do t'iu mundësohet qasja edhe përmes telefonisë mobile dhe Internetit.



II/3 POLICIA E KOSOVES

Policia e Kosovës, në raste të aksidenteve të mëdha (katastrofave) do të kryejnë:

- Të rrethoj përimetrin e sigurisë në vendincident
- Sigurimin e kontrollit në vend të ngjarjes (zonën e incidentit)
- Sigurimin e lëvizjeve dhe trafikut në vendin e ngjarjes dhe për rreth vendit të ngjarjes.
- Evakuimin e qytetarëve në rast shpërthimi-eksplozimi nga objektet.
- Mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave me interes me subjektet tjera të involvuara në situata emergjente.
- Veprimet e hetuesisë në vendngjarje.
- Parandalimin e dukurive negative dhe vënien nën kontroll të situatës në rastet emergjente (vjedhjet, kaosi, anarkia, abuzimet e ndryshme etj).
- Mbështetjen në sigurinë fizike të personelit komandues të incidentit.



II/4 FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS (FSK)

Forca e Sigurisë së Kosovës në rast të situatave emergjente do të kryejnë gati të gjitha detyrat e emergjencës dhe do të jenë bashkëveprues në këto raste. Brigada e BRSH – FSK e cila operon në përfundim të territorit të Kosovës do të kryejnë :

- Të sigurojnë shërbime në raste të shkatërrimeve,
- Të kryejnë shërbime të kërkim-shpëtimit në situata të ndryshme emergjente, dhe angazhimi i tyre në eliminimin e pasojave të shkaktuara.
- Të sigurojnë asistencën humanitare në regjione të izoluara.
- Të kryejnë shërbime Emergjente medikale.
- Zbatimin e detyrave të transportit në rast të këkesës.
- Deaktivizimin e mjeteve të paeksploduara.
- Ndihmë në zbatimin e evakuimeve, si dhe detyra tjera të cilat paraqiten në raste Emergjente



II/5 KFOR-i

KFOR-i cili vepron në territorin e komunës së Deçanit përbëhet nga forcat ushtarake të shteteve të nryshme që janë me mision në Kosovë me seli në lokacionin e Pushimores së fëmive “Pishat e Deçanit” përveç rolit prioritar të cilin e ka (ruajtja e integritetit territorial, mbrojtja e rendit kushtetues dhe qetesisë publike etj), roli i KFOR-it në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera është në rolin e vëzhguesit por në raste të kërkesës nga Kryetari i Komunes kërkon ndihmën e tyre si nga ana e personelit ashtu edhe të pajisjeve.

II/6 SHËRBIMET MEDIKALE EMERGJENTE

Ekipet profesionale të shërbimeve medicinale janë bartëse kryesore të aktiviteteve në sferën e shpëtimit të jetës dhe mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve në situata emergjente.

Struktura organizative e shërbimeve medicinale të cilat veprojnë në territorin e komunës së Deçanit, mundëson që në situata emergjente, të ofrojë shërbime cilësore si në terren (mobile) ashtu edhe në mjekimin stacionar. Kapacitetet medicinale në kuptimin e kuadrit profesional, teknikës dhe pajisjes medicinale si dhe të objekteve tjera përcjellëse për veprim emergjent, në komunën e Deçanit janë relativisht të mira.

Koncept të ri paraqet zhvillimi i Mjekësisë Familjare me qendrën e saj në Deçan dhe 11 punkte të shpërndara nëpër Bashkësi Lokale në komunë.

Detyrat e ekipeve për shërbime medicinale në situata emergjente:

- Ofrimi i ndihmës së parë medicinale në vendin e incidentit,
- Trijzhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të trijzhës së pacientit dhe mbajtja e evidencës,
- Evakuimi dhe bartja adekuate e personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet tjera të specializuara medicinale,
- Marrja e masave preventive anti-epidemiologjike si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre,
- Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rastin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive e të tjera,
- Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në terren dhe dhënia e udhëzimeve-këshillave adekuate medicinale për veprim në situata të caktuara emergjente,
- Asanimi i terrenit-lokacionit të aksidentuar.
- Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte tjera farmaceutike për funksionim adekuat në situata emergjente.

II / 7 SHËRBIMET PUBLIKE

Për funksionimin efikas të shoqërisë në situata emergjente civile, kontribut tejet të rëndësishëm japin shërbimet publike komunale të cilat me organizimin dhe shkallën e tyre të gatishmerisë vepruese, ndikojnë direkt në kualitetin e menaxhimit të emergjencave.

Ndërmarrjet të cilat kryesisht i japin ngjyren infrastrukturës publike në territorin e komunës së Deçanit janë: SHP, KEDS-i, PTK, Ndermarrja për pastrim "HIGJIENA" si dhe disa kompani nga sektori privat që kryesisht mirren me veprimtari shërbyese, furnizuese, transportuese, rrugore-ndërtimore dhe të pastrimit. Në situata emergjente secila nga fushëveprimtaria e saj:

- Zbaton vendimet e Komitetit komunal për Menaxhim Emergjent dhe për aktivitetet e saja i përgjigjet këtij organi,
- Merr pjesë aktive në punën e këtij Komiteti dhe jep propozimet konkrete për tejkalimin e gjendjes emergjente duke u bazuar në profesionalizmin dhe përvojat nga fushë-veprimtaria e tyre,
- Me kohë bëjnë planifikimin e resurseve njerëzore dhe teknike për funksionim racional në situata emergjente dhe lidhur me këtë njohton KKME mbi mundësitë reale të tyre.
- Caktojnë prioritetet në kryerjen e shërbimeve të tyre, dhe me pelqim të KKME vendos disiplinimin e vet të kryerjes së shërbimeve.

II / 8 ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Në situata emergjente, organizatat joqeveritare bëjnë:

- Senzibilizimin e opinionit të mbrendshëm dhe të jashtëm lidhur me situatën emergjente,
- Informimi i drejtë lidhur me masat dhe veprimet të cilat subjektet involvuese në situata emergjente ndërmarrin për tejkalimin e gjendjes së krijuar,
- Parandalojnë panikun dhe shpërndarjen e dezinformatave tek qytetarët.
- Hartimi i projekteve të cilat janë në funksion të përballimit të situatave emergjente në komunë,
- Krijimi i fondeve emergjente dhe thithja e donacioneve të ndryshme për plotësimin e nevojave akute,
- Pjesëmarrja aktive në furnizimin e qytetarëve nga zonat e aksidentuara me artikujt dhe gjërat tjera elementare për jetesë
- Pjesëmarrja aktive në lëminë e evakuimit dhe strehimit,
- Bëjnë kërkime për burime të metëjme për nevoja emergjente,
- Bashkëpunimi i ngushtë reciprok i tyre me të gjitha subjektet involvuese në emergjenca,
- Hartimi i analizave, raporteve, bilanseve dhe përpunimi i treguesve (indikatorëve) përmes të cilave përcillen rrjedhat në situata emergjente.

LISTA E NDËRMARJEVE PUNUESE TË CILAT MUNDË TË NDIHMOJNË NË RASTE EMERGJENTE

Nr.	Subjekti afarist	Pronari	Selia	Nr. tel.	Veprimtaria	Mjetet e punës													Vrejtje Në rubrik. Nr.tel. numri i par fiks: 0390/ I dytë mob. 044/					
						Kamion	Autobus	Kamion- Kamion- kipër	Auto-ving	Traktor-LKT	Bager	Eskavato r	Ngarkues	Auto-friaorifer	Cistern uji	Cistern deriva	Pompë uji	Nd.në njerz						
1	Bonita	Esat Jasiqi	Deçan	361-588 154 870	Tregtare ex-impò																			
2	Solid-Export	Selim Cacak	Deçan	361-029 180-275	ShTT																			Jo funktionale
3	NHE "L.Bardhë"	Xhemë Pajazitaj	Deçan	361-438 178-854	Hidro- ekonomi	1				1		1							1	4				
4	NP-Ujësjiellësi	Nazmi Selmanaj	Deçan	361-034 149-649	Ujësjiellë s-kan.	2					1										10			
5	NP-Higjena	Sali Kuçi	Deçan	61-034 142-637	Higjeno- teknike	3				1														
6	Dekor	Enver Cacak	Deçan	361-535 137-416	Furnizi. derivate																		E mbyllur	
7	Gogaj- AG	Isuf Gogaj	Deçan	361-160 118-788	ShTT																			
8	Lika- trade	Hysen Likaj	Isniq		Gurthye.	2		1	1			2	1				1	1			3			
9	Fidani - L	Lulzim Beqiraj	Baball oq		Ndertimt ari	2						1	1								5			
10	Ndërtimi	Xun Qorraj	Carra.	180-404	Ndertim	1		1						1							4			
11	NTT-Mendi	Armend Alaj	Deçan	361-962	Tra.turis		1																	
12	Delij Abazi	Abaz Kadriaj	Rosto.	131-400	Tra.turis		1																	
13	Monika	Shabanaj	Deçan	361-520	Tra.turis		2																	
14	Tropikana	Sylë Likaj	Deçan		Tregtare																			
15	ETC		Deçan		Tregtare																			
16	Viva Fresh		Deçan		Tregtare																			
Gjithsej mjete :						1 1	4	2	1		2	4	3	1		1	1	1	1	26				

MBËSHTETJA FINANCIARE E SITUATAVE EMERGJENTE

Situatat emergjente sjellin edhe ndërlikime financiare të cilat mund të jenë afat gjata dhe afat shkurta, të cilat duhet të zgjidhen në at mënyrë që përgjigja ndaj situatës emergjente të jetë efektive. Për këtë arsye, kostot e mundshme duhet të planifikohen paraprakisht me kujdes në të gjitha nivelet.

Problemet financiare të fazës së reagimit mund të renditen si vijon:

- **Problemet primare financiare:**

Të gjitha strukturat të cilat kanë përgjegjësi dhe detyrime për situatat emergjente civile, duhet të jen të pa varur në veprime, në mënyrë që të jenë në gjendje të veprojnë menjëherë dhe në çdo kohë. Është më se e nevojshme që strukturat të kenë mundësi për të siguruar mjete financiare të mjaftueshme për veprim. Duhet të merren të gjitha masat që pajisjet, mjetet e transportit, nafta, kostot e komunikimit që parashikohen të nevojshme, të jenë në dispozicion dhe të bëhen paraprakisht të përdorshme nga të gjitha strukturat e përfshira në situata emergjente, në mënyrë që të filloj menjëherë veprimi.

- **Problemet sekondare financiare:**

Gjatë zhvillimit të situatës emergjente, problemet financiare rriten dhe bëhen afatgjata. Këtu përfshihen kostot për orë shtesë të personelit, kostot për sigurimin dhe vënien në funksion të pajisjeve të specializuara dhe mjeteve të transportit si dhe kostot për sigurimin e vendstrehimeve, asistencën mjekësore dhe ato humanitare në përgjithësi për ata që janë të prekur nga situata emergjente. Këto shpenzime përbëjnë probleme afat gjata buxhetore dhe duhet të planifikohen.

- **Problemet terciare financiare:**

Në të shumtën e rasteve, janë të lidhura me përpjekjet për stabilizimin e situatës para rikthimit të fazës në gjendjen normale. Këto mund të përfshijnë kostot për:

- Riparimin e ndërtesave,
- Të infrastrukturës,
- Të ujit,
- Të energjisë elektrike,
- Të strehimit

Për të gjithë ata të cilët për një periudhë më të gjatë kohore nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre, këto burime financiare buxhetore duhet të garantohen nëpërmjet procedurave të brendshme, duke krijuar mekanizma lehtësues për përdorim në mënyrë sa ma të efektshme në situata emergjente.

5.2 Stërvitja fushore e FSK-së i koduar “Ujku Vigjilent 2” Qershor 2017 Deçan



Foto nga ushtrimi fushor

Me datën 19, 20 dhe 21 Qershor 2017 Komuna e Deçanit, Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike në bashkëpunim me FSK-në - BRSH, konkretisht batalioni i dytë i kësaj Brigade organizuan stërvitjen fushore të koduar “Ujku Vigjilent 2”.

Duke filluar nga muaji Prill 2017 kanë filluar përgatitjet nga Komuna, Njësi i zjarrfikësve, QKMF-ja, Kryqi i Kuq, Policia dhe të gjitha Agjencitë emergjente që aktivitetin e tyre e kryejnë në komunën e Deçanit dhe pas një angazhimi tre mujor të përbashkët u finalizuan veprimet mes agjencioneve emergjente të komunës së Deçanit dhe FSK-së.

Qëllimi i stërvitjes së përbashkët ishte testimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike të komunës sonë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe koordinimi, bashkëveprimi civilo-ushtarake.

Numri pjesëmarrës nga komuna e Deçanit dhe agjencioneve tjera civile ishte gjithsej 52 veta duke përfshirë Drejtorinë për Mbrojtje shpëtim, Policinë, Zjarrfikësit, Kryqi i Kuq dhe QKMF-ja. Në të përgjithshmen funksionimi, koordinimi i veprimeve ishte në nivelin e duhur nga Komuna e Deçanit, duke përjashtuar disa mangësi të vogla.

Pas përfundimit të stërvitjes së përbashkët ka ardh si konkluzion nga pjesëmarrësit se testimi i kapacitetit njerëzor poashtu edhe teknik si në kërkim-shpëtim, dhënia e ndihmës së parë, aksidente të trafikut, menaxhimi i turmave dhe aktivitete tjera është menaxhuar dhe janë ndarë detyrat sipas planifikimeve të bëra më parë edhe në situata reale.

Stërvitje të ngjashme janë të parapara edhe në vitet në vazhdim ku së bashku me agjencionet emergjente, Forcën e Sigurisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, Komunës së Deçanit do të bëhen testime në kapacitete njerëzore dhe teknike në situata të reja për t’ju dal në ndihme qytetarëve të komunës së Deçanit për shpëtimin e jeteravë të njerëzve dhe të mirave materiale.

RAPORTI I NDODHJËS EMERGJENTE:

KOMUNA E DEÇANIT

DREJTORIA PËR MSH & SHP

NR: _____ DATE: _____

PËR: DEPARTAMENTIN E MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE – PRISHTINË

NGA: DREJTORIA E MSH – DEÇAN

LËNDA: RAPORTI I NDODHJES EMERGJENTE

I/1. SITUATA E PËRGJITHËSHME:

Bora me trashësi mbi 80cm që kishte rënë disa ditë me radhë në teritorin e Komunës së Deçanit, ka filluar të shkrihet si pasojë e temperaturave të larta ndikuar edhe nga pasojat e ngrohjes globale. Kjo shkrirje e shpejtë ka bërë që vërshimet të mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të teritorit të Komunës së Deçanit, duke rrezikuar njerëzit dhe shkaktuar shkatërrime në pasuri, në rrugë, ujësjellës, kanalizime, rrjetin elektrik, paralizimin e shërbimeve emergjente dhe shërbimeve tjera për qytetarë. Numri i personave që duhet evakuuar për një kohë 10 deri 15 ditë është mbi 150 në tërë teritorin e Komunës së Deçani:

- NGA KËTO TË RESHURA KA ARDH DERI TË RITJA ENORME E NIVELIT TË UJIT TË RRJETIT TË LUMEJVE DHE PROJEVE E PROJEVE NË TERITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT.
- GJITHASHTU, NGA SHKAKU I TË RESHURAVE INTENSIVE, KA ARDHË DERI TË STERNGOPJA E TRUALLIT ME UJË DHE PARAQITJA E UJRAVE NËNËTOKËSORE SI DHE PARAQITJA E DUKURIVE EROSIVE DHE RRSHQITJES SË DHEUT.
- FAKTORËT E LARTË CEKUR KANË NDIKUAR NË PARAQITJEN E PLASARITJEVE TË TRUALLIT NË ZONËN E INSPEKTUAR.

I/2. ZONA EMERGJENTE:

- KRAHU I MAJT I LUMBARDHIT TË LLOQANIT NË DREJTIM TË QESTES DHE KRAHU I DJATHTË I LUMIT NË DREJTIM TË LAGJES TOLAJ NË VERI – LINDJE TË FSHATIT LLOQAN.
- ZONA EMERGJENTE NDODHET NË KUADRATIN V: _____ DHE L: _____ TË FLETËS SË HARTËS TOPOGRAFIKE PEJA – 4.
- PIKA KRITIKE E (V: 42° 31' 37" DHE L: 20° 16' 49") SË NJEJTËS HARTË.

I/3. RREZIKU:

- KUR: NJËZET E KATER ORËT E FUNDIT.
- KU: NË PJESEN VERI-LINDORE TË FSHATIT LLOQAN.
- ÇKA: RRËSHQITJA E DHEUT, ZËNJA E SHTRATIT TË LUMIT,
 - NDRYSHIMI I RRJEDHES SË LUMIT,
 - VERSHIMI I SHTEPIVE TË BANIMIT DHE EKONOMIVE FAMILJARE ETJ.
- PSE: NGA RESHJET INTENSIVE TË CILAT KANË NDIKUAR NË RITJEN ENORME TË NIVELIT TË LUMIT.

III. KLASIFIKIMI I RASTIT EMERGJENT:

- NATYROR.

IV. PJEËMARËSIT NË RASTIN EMERGJENT:

- H. POLICIA E KOSOVES
- I. SHEPM (SHERBIMI EMERGJENT PARA-MEDIKAL)
- J. NJPZSH,
- K. NDERMARRJET PUBLIKE KOMUNALE,
- L. NDERMARRJET PRIVATE NDERTIMORE,
- M. NDERMARRJET PRIVATE PËR TRANSPORT TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE,
- N. KRYQI I KUQ,
- O. OJQ –ET, ETJ

V. MASAT E NDERMARA:

1. EVAKUIMI: EVAKUOHEN _____ FAMILJE ME _____ ANTAR,
2. STREHIMI: I FAMILJEVE TË EVAKURA NË LAGJEN “LAGJIA E DËSHMORËVE” NË BABALLOQ
3. KËRKIM SHPETIM: EKIPET E BRIG. SË ZSH – ËS. PËR KËRKIM SHPETIM.
4. NDIHMA SHENDETËSORE: NGA EKIPET E SHEPM – IT
5. PASTRIMI I DIGËS MBROJTËSE,
6. PËRFORCIMI I DIGËS,
7. QITJA E BLOQEVE TE BETONIT NË SHTRATIN E LUMIT ETJ ETJ.

VI. PASOJAT NGA RASTI EMERGJENT:

- A. TË LENDUAR: NUK KA.
- B. TË VDEKUR: JO.
- C. DEMET MATERJALE: TË KONSIDERUESHME. KOMISIONET E FORMUARA DOTE BEJN VLERSIMIN E TYRE.

VII. AKTIVIZIMI I PLANIT TË REAGIMIT EMERGJENT:

PAS VLERSIMIT TË SITUATES SË KRIJUAR ME TENDENCË ESKALIMI TË MË TUTJESHME, ME PROPOZIMIN E DREJTORIT TË DREJTORIS SË MSH, NË ORA _____ TË DATES _____ ËSHTË AKTIVIZUAR KOMITETI KOMUNAL PËR MENAGJIMIN E EMERGJENCAVE NË PËRBËRJE TË PLOTË. PËR KOMANDANT TË INCIDENTIT (KI) ËSHTË EMRUAR DREJTORI I DREJTORIS SË MSH Z.

VIII. GJENDJA SINOPTIKE DHE KALUESHMERIJA E RRUGËVE:

SIPAS PARASHIKIMEVE SINOPTIKE TË ENTIT METEOROLOGJIK TË KOSOVËS, VALA E PËRKEQËSIMIT TË MOTIT QË KA PËRFSHI TERITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT DO TË VAZHDON EDHE DITËT E ARDHËSHME. RRUGA RAJONALE DEÇAN – VOKSH – JUNIK NË PJESEN CARRABREG I EP. – LLOQAN E PA KALUESHME.

IX. KOMUNIKIMI DHE KOMANDIMI:

- QENDRA KOMUNALE E INFORMIMIT DHE ALARMIMIT I KA PLOTËSUAR NEVOJAT PËR KOMUNIKIM.
- RADIO RRJETI NË BASHKËSITË LOKALE KA QENË FUNKSIONAL DHE SI I TILLË I KA PËRMBUSHUR PARAMETRAT E PARASHIKUAR TË NEVOJES SË EGZISTIMIT TË TYRE.
- SITUATËN EMERGJENTE E KA MENAXHUAR KI Z. _____.

DREJTORI I DREJTORISË PËR MSH

Shtesë e këtij raporti: Harta e Zonës Emergjente

Azhurimi i planit "Vlerësimi i Rrezikut" është i bazuar në bazë të ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera Nr 04/L-027, Plani i Reagimit Kombëtar Pika III (Rolet dhe Përgjegjësitë/ Komuna), Vlerësimi i rreziqeve nga Fatkeqësitë tjera i nivelit qendror.

Në grumbullimin e të dhënave për azhurim të planit janë shfrytëzuar burime nga:


- ASK (Agjensioni i statistikave të Kosovës)
- KEDS
- Policia e Deçanit
- FSK
- Qendra për Punë Sociale
- QKMF- Deçan
- Ujësjiellësi Deçan
- Enti për Punesim
- Të gjitha Drejtoritë përkatëse të Kuvendit Komunal Deçan
- Plani paraprak i vitit 2010
- Si dhe burime tjera nga literaturat e ndryshme, rrjetet sociale etj.

Plani u azhuru nga Shefja e Sektorit për Mbrojtje dhe Shpëtim:
Gentiana Iberhysaj- Mazrekaj

01.Nr.II-5
Deçan, dt. 28.02.2019

Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj



	DEÇAN, D. 28.02.2019 PËR SHËRBIMIN E QYLLIMET DHE PËR SHËRBIMIN E DEÇANIT KRYETARI I KUVENDIT KOMUNAL DEÇAN
<u>K. Komercos</u>	7022
<u>d</u>	05.03.19
DEÇAN, D. 28.02.2019	